


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT  
DEPARTAMENTI I KONSTRUKSIONEVE DHE  
INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT**

**DOKTORATURA ME TEMË:**

**KONTROLLI I TRAFIKUT DHE I SIGURISE NE  
KRYQEZIMET RRUGORE NE NJE NIVEL;  
KRAHASIMI MIDIS PERFORMANCESE SE KRYQEZIMEVE  
SEMAFORIKE DHE RRETHRRROTULLIMEVE**

Punoi: MSc. Alma AFEZOLLI (KRASNIQI)

Udhëheqës Shkencor: Akademik Jorgaq KACANI

**Juria e miratuar:**

- |    |                        |                |
|----|------------------------|----------------|
| 1. | <b>Gezim HASKO</b>     | <b>Kryetar</b> |
| 2. | <b>Andrea MALIQARI</b> | <b>Anetar</b>  |
| 3. | <b>Nikolla KONOMI</b>  | <b>Anetar</b>  |
| 4. | <b>Fisnik KADIU</b>    | <b>Anetar</b>  |
| 5. | <b>Hasan JAHO</b>      | <b>Anetar</b>  |

TIRANE, Dhjetor 2013

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

## **ABSTRAKT**

**Titulli i Disertacionit:**

**“KONTROLI I TRAFIKUT DHE I SIGURISE NE KRYQEZIMET RRUGORE NE  
NJE NIVEL;  
KRAHASIMI MIDIS PERFORMANCESE KRYQEZIMEVE SEMAFORIKE DHE  
RRETHRRROTULLIMEVE”**

**MSc. Alma AFEZOLLI**

*Pedagoge pranë Departamentit të Konstruksioneve dhe infrastrukturës së transportit*

**Udheheqës i disertacionit: Akademik Jorgaq KACANI**

*Rektor i Universitetit Politeknik te Tiranes*

*Pedagog pranë Fakultetit te Inxhinierise Mekanike*

Midis problemeve qe shqetesojne realitetin qytetar, ato te lidhura me levizshmerine e trafikut, kane marre, ne keto vitet e fundit, nje rol gjithnjë e me determinues. Nje qarkullim urban fortësish i perspektuar dhe drejtuar, jo vetem qe krijon shqetesime ne perdonuesit, per vete rritjen e kohes mesatare te udhetimit, qe ato duhet te pershkruajne per zhvendosjet e tyre, por shkakton edhe nje ulje te ndjeshme te sigurise se qarkullimit, duke rritur gjithashtu edhe ndotjen atmosferike dhe ate akustike.

Midis shkaqeve kryesore te rritjes se dendesise se trafikut, me e rendesishmja eshte sigurisht rritja e forte e kerkeses komplekse te transportit; nje rritje e tille eshte e lidhur me nje seri faktorësh te natyrave nga me te ndryshmet dhe shpesh te lidhura ngushte edhe midis tyre. Midis tyre me te rendesishmit jane: shperndarja ne rritje e autoveturave, shperndarja e vendodhjeve ne territor per vete rritjen e hapesirave urbane, ndryshimi i stileve te jetesës dhe shpesh nje sherbim transporti publik me mangesi te caktuara.

Nje drejtim racional dhe fleksibel i infrastrukturave dhe nje programim i gjere i rrjetit te trafikut, te mbështetura keto nga strategji te pershtatshme, infrastruktura

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

dhe zgjidhje politike, jane konsideruar si instrumentat me efikase per zgjidhjen e problemit te levizshmerise urbane.

Ne rastet ne te cilat nuk eshte e mundur rritja e kapacitetit te rrjetit nepermjet permiresimit te infrastrukturave rrugore, analiza dhe projektimi i instrumentave te kontrollit te trafikut ka nje rol themelor; nje vemendje e vecante i kushtohet kontrollit te kryqezimeve (semaforike ose jo), sepse, nese ato jane te projektuara mire, mund te paraqesin nje instrument te vlefshem per permiresimin e ketij bllokimi te trafikut. Ne fakt nyjet e rrjetit rrugor Jane ato vende ku lindin konfliket midis rrymave te ndryshme te trafikut, qe sjellin si vonesa ashtu edhe aksidente, duke ulur nivelin e sherbimit dhe sigurine e tyre. Prej ketu, zgjedhja e tipit te kryqezimit (semaforike, me precedence, ose me rrethrrrotullim) behet shume e rendesishme per permiresimin e parametrave te siperpermendur. Kontrolli semaforik ne fakt eshte ne gjendje te ofroje, me kosto relativisht modeste, siguri, adoptim karshi variacioneve te trafikut, eficence dhe zvogelim te impaktit mjedisor. Ne vitet e fundit ne te gjitha vendet, perfshi edhe Shqiperine, po perhapet nje tip tjeter kryqezimi, ai rrethrrrotullim, qe nese perdoret brenda disa hapesirave, mund te permiresoje ne menyre te dukshme performancen, ne lidhje me ato qe mund te jene arritur me kryqezimet semaforike.

## Falenderime

Me shumë kënaqësi do të doja të shprehja falenderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën moralisht gjatë realizimit të kësaj teme disertacioni.

Së pari do të falenderoja Udhëheqësin Shkencor të kësaj teze, Akademik Jorgaq KACANI, i cili me kontributin e tij shkencor dhe metodik, më ka qëndruar pranë, më ka konsultuar, me ka nxitur, motivuar e ndihmuar gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi.

Falenderime meritojne të gjithë kolegët e mi të Departamentit të Konstruksioneve dhe Infrastrukturës së Transportit, ne menyra te vecante mikesha ime Elfrida, të cilët direkt ose indirekt janë bërë pjesë e punës sime disavjecare në realizimin e këtij punimi.

Falenderimet e mijë i dedikohen edhe shume miqve te mi, te cilet me eksperiencen e tyre shumevjecare ne fushen e inxhinierise se trafikut, me dhane suportin profesional teknik e moral ne perfundimin e ketij punimi. Nuk mund te le per permendur ketu suportin direkt te mikut tim te ngushte Z. Edmond ALITE, i cili me ka perkrahur shume per iniciativen e marre, si dhe me ka orientuar drejtpersedrejti ne perzgjedhjet e mijë.

Së fundmi falenderimet e mia i takojnë familjes sime, bashkëshortit tim dhe motres time, që me durim e përkushtim më kanë kuptuar, nxitur, ndihmuar e më kanë besuar e ndenjur pranë në ditët e gjata të punës për perfundimin e kësaj teme.

**PERMBAJTJA:**

**1) HYRJE**

- 1.1 Kontrolli i trafikut ne zonat urbane
- 1.2 Qellimi i studimit
- 1.3 Fusha e marre ne studim
- 1.4 Kufizimet perkatese te studimit

**2) KRYQEZIMET SEMAFORIKE**

**2.1. Hyrje ne percaktimet themelore**

- 2.1.1. Percaktimi i fluskit te saturimit
- 2.1.2. Cikli semaforik
- 2.1.3. Struktura e nje faze
- 2.1.4. Vonesa per manovrat e penguara
- 2.1.5. Kapaciteti per manovrat e penguara (me korsi eskluzive kthese)

**2.2. Karakteristikat e kontrollit semaforik**

- 2.2.1. Rregullimi semaforik i nje fluksi trafiku
- 2.2.2. Plani semaforik i nje kryqezimi tek
- 2.2.3. Plani i rregullimit te nje rrjeti kryqezimi
- 2.2.4. Analiza e voneses ne nje kryqezim semaforik

**2.3. Prirja drejt voneses per kryqezimet semaforike**

- 2.3.1. Vonesa per nje hyrje te izoluar
- 2.3.2. Vonesa per nje hyrje jo te izoluar

**2.4. Prirja e arritjeve ne kryqezimet semaforike**

- 2.4.1. Prirja e arritjeve ne nje hyrje te izoluar

**2.5. Metodat e optimizimit te rrjetit**

- 2.5.1. Metodat e bazuara ne njohjen e flukseve
- 2.5.2. Rregullimi i nje kryqezimi tek ne rregjimin e nen saturimit
- 2.5.3. Rregullimi i nje rrjeti kryqezimi ne rregjimin e nen saturimit

**2.6. Metodat e optimizimit semaforik**

- 2.6.1. Metoda me strukture faze te paracaktuar
- 2.6.2. Otimizimi nepermjet programimit

**3) KRYQEZIMET JO SEMAFORIKE**

**3.1. Hyrje**

- 3.2. Klasifikimi tipologjik i kryqezimeve ne nje nivel jo semaforike
- 3.3. Analiza e te dhenave

### **3.4. Metodologja e llogaritjes**

- 3.4.1. Volumi kritik  $V_{c,x}$
- 3.4.2. Intervali kritik  $t_c$  dhe koha e shkallezimit ne rradhe  $t_r$
- 3.4.3. Kapaciteti potencial  $c_{p,x}$
- 3.4.4. Kapaciteti efektiv  $c_{m,x}$
- 3.4.5. Vleresimi i gjatesise se rradheve
- 3.4.6. Koha e voneses
- 3.4.7. Niveli i sherbimit

## **4) KRYQEZIMET ME RRETHRRROTULLIM**

4.1. Shtrirja e kryqezimeve me rrethrrrotullim ne Europe, Shqiperi dhe ne pjesen tjeter te botes

### **4.2. Pronesi operative e rrethrrrotullimeve**

- 4.2.1. Elementet funksionale karakteristike
- 4.2.2. Qarkullimi ne rrethrrrotullime

### **4.3. Modelet empirike dhe modelet probalistike**

#### **4.4. Afrimi empirik**

- 4.4.1. Studime statistikore ne Angli
- 4.4.2. Studime mbi baza statistikore te kryera ne France
- 4.4.3. Krahasimi midis niveleve te ndryshme te paraqitura per llogaritje te kapacitetit te flukseve hyrese te trafikut

4.5. Afrimi i bazuar ne teorine e “Pranimit te distances nga nje mjet ne nje tjeter ose Gap Acceptance”

#### **4.6. Projekti gjeometrik i rrethrrrotullimeve**

#### **4.7. Mini rrethrrrotullimet**

- 4.7.1. Siguria ne minirrethrrrotullimet

#### **4.8. Semaforimi i rrethrrrotullimeve**

## **5) METODOLOGJIA E PERDORUR PER SIMULIMET PERFORMUESE TE KRYQEZIMEVE**

### **5.1. Modeli SIDRA**

### **5.2. Struktura e programit SIDRA**

### **5.3. Te dhena hyrese**

### **5.4. Procedura e llogaritjes se kohes**

### **5.5. Rezultatet**

5.6. Tabelat grafike

5.7. Simulimi i funksionalitetit

## **6) SIMULACIONET E SIGURISE NE KRYQEZIME**

6.1. Modelet e simulacioneve per sigurine rrugore

6.2. Modeli anglez TRLL (Transport Research Laboratory)

6.3. Modeli Australian (Mainroads)

## **7) SIGURIA**

7.1. Siguria ne rrethrrrotullime

7.1.1. Konsiderata mbi sigurine ne rrethrrrotullimet moderne te SHBA-se

7.1.2. Siguria ne Angli. Konsiderata mbi sigurine ne rrethrrrotullimet perpara viti 1966

7.1.3. Efektet mbi sigurine te shkaktuara nga ndryshimi i rregulles se perparese ne rrethrrrotullime

7.1.4. Efektet e projekteve te reja te rrethrrrotullimeve mbi sigurine

7.1.5. Aksidentet ne rrethrrrotullimet me kater dege

7.1.6. Efektet e variablate gjeometrike mbi sigurine

7.1.7. Karakteristikat influencuese mbi sigurine ne flukset standarte te trafikut

7.1.8. Permiresimi i sigurise ne rrethrrrotullimet egzistuese

7.1.9. Analiza te ndryshme

7.1.10. Siguria e ciklisteve dhe ciklomotorave ne rrethrrrotullimet urbane

7.1.11. Zvogelimi i sigurise me moshen e rrethrrrotullimeve

7.1.12. Siguria e kembesoreve

7.1.13. Siguria e ciklisteve

## **8) KONKLUZIONE**

8.1. Analiza konkluzive lidhur me funksionalitetin dhe sigurine e kryqezimeve ne nje nivel ne zona urbane

8.2. Avantazhet dhe dizavantazhet e rrethrrrotullimeve

## **Lista e tabelave:**

*Tabla 2.1 - Ekuivalentimi i mjeteve ne mjetet njesi*

*Tabla 2.2 - Koeficientet e interferences se trafikut per shkak te qendrave te renduara*

*Tabla 3.1 – Marredhenia e koheve krike me tipin e manovres*

*Tabla 3.2 - Faktori i pengimit pedonal  $P_{p,x}$*

*Tabla 3.3 – Niveli i Sherbimit NSH*

*Tabla 4.1 – Llogaritja e hapesirave, shpejtesive dhe shpejtimeve ne nje mjet gjenerik qe kalon rrethrrrotullimin*

*Tabla 4.2 – Follow-up Headways ( $t_{fa}$ ) e fluksit dominant ne s (vlera fillestare)*

*Tabla 4.3 – Raporti midis Critical Gap Acceptance dhe Follow up Headway*

*Tabla 4.4 – Kohet e kalimit per Follow- up headway te fluksit dominant*

*Tabla 4.6 – Headway mesatar midis mjeteteve te grupuara ne trafikun qarkullues ( $\tau$ ) dhe numrit te korsive efektive ne unaze*

*Tabla 4.7 - Perqindjet e makinave te grupuara,  $\Theta$*

*Tabla 4.8 – Vonesa gjeometrike per mjetet e “ndaluara”*

*Tabla 4.9 – Vonesa gjeometrike per mjetet “jo te ndaluara”*

*Tabla 4.10 - Klasifikimi i rrethrrrotullimeve urbane - elementet gjeometrike*

*Tabla 4.11 - Klasifikimi i rrethrrrotullimeve urbane-shembuj ushtrimesh*

*Tabla 4.12 - Gjerseite e kerkuara per mjetet qe kthehen prane njeri tjetrit*

*Tabla 4.13 - Gjerseite e kerkuara per rrethrrrotullimet me permasa reale*

*Tabla 4.14 - Frekuencia mesatare e PIA ne vit per kryqezim*

*Tabla 5.1.a – Lista e parametrave thelbesore te pranishem ne CONFIG (pjesa e pare)*

*Tabla 5.1.b – Lista e parametrave thelbesore te pranishem ne CONFIG (pjesa e dyte)*

*Tabla 6.1 – Numri i rrethrotullimeve ne mostren e ndare sipas tipit te kryqezimit*

*Tabla 6.2 - Frekuencia vjetore e aksidenteve ne grade C te fluksit te pershkimit*

*Tabla 6.3 - Numri i frekuencies, rendesia dhe norma e aksidenteve*

*Tabla 6.4- Numri i aksidenteve te verifikuar ne 1988 te ndare ne baze te vitit se venies ne sherbim te rrethrrrotullimeve*

*Tabla 6.5 – Perdoruesit e perfshire ne aksidente*

*Tabla 6.6 – Katalogimi i tipeve te aksidenteve*

*Tabla 6.7 – Rradhitja e tipeve te ndryshme te aksidenteve*

*Tabla 6.8 – Numri i aksidenteve me perdorues te dobet*

*Tabla 6.9 – Numri i aksidenteve me perdorues te dobet, Modeli 2*

*Tabla 6.10 – Te dhena dhe rezultate te per gjithshme te studimit para/pas*

*Tabla 6.11 – Zvogelimi i numrit te aksidenteve dhe viktimate*

*Tabla 6.12 – Zvogelimi i numrit te aksidenteve dhe viktimate si pasoje e kthimit te kryqezimeve ne rrethrrrotullime dhe per tipologji rrugore*

*Tabla 6.15 – Performanca e numrit mesatar te viktimate per rrethrrrotullim ne vit*

*Tabla 7.1 - Raporti i rezultateve te analizes se sensibilitetit*

## **Listë e figurave**

*Figura 2.1- Mbarevajtja e rradhes ne funksion te kohes*

*Figura 2.2 - Mbarevajtja e nisjeve ne nje hyrje semaforike*

*Figura 2.3 - Shembulli i planit semaforik ne nje kryqezim tek*

*Figura 2.4 - Mbarevajtja e voneses percaktuese*

*Figura 2.5 - Prirja e arritjeve dhe nisjeve dhe vleresimi relativ i voneses*

*Figura 2.6 – Prirja e funksionit te voneses per mbinsaturimin*

*Figura 2.7 – Mjete ne rradhe ne funksion te kohes*

*Figura 2.8 - Prirja e funksionit te voneses stokastike te nensaturimit*

*Figura 2.9 - Prirja e funksioneve te voneses te Webster-it*

*Figura 2.10 – Prirja e funksionit te Webster-it e transformuar*

*Figura 2.11 - Shembulli i shtremberimit dhe shperndarjes se nje grupimi*

*Figura 2.12 - Modeli i perdredhjes*

*Figura 2.13 – Modeli i shperndarjes*

*Figura 3.1 dhe 3.2 Kryqezime ne forme T dhe me 4 dege*

*Figura 3.3 - Hierarkia e flukseve te trafikut*

*Figura 3.4 - Volumi kritik i ktheses djathtas nga sekondarja  $V_{C,9}$*

*Figura 3.5 - Percaktimi i volumeve kritike  $V_{C,x}$*

*Figura 3.6 - Kapaciteti potencial*

*Figura 3.7 - Ishulli i shperndarjes se trafikut*

*Figura 3.8 Zgjerimi i korsise ne linjen e ndalimit*

*Figura 4.1 – Gjeometria e nje rrrethrrrotullimi*

*Figura 4.2 - Pikit e konfliktit per nje rrrethrrrotullim dhe nje kryqezim tradicional*

*Figura 4.3 - Shpjegimi grafik i termave te ekuacionit i treguar me siper*

*Figura 4.4 – Elementet gjeometrike kryesore te nje rrrethrrrotullimi*

*Figura 4.5 – Parametrat gjeometrike te hyrjes*

*Figura 4.6 – Profili tipik i shpejtesive te mjeteve ne nje rrrethrrrotullim*

*Figura 4.6.1 – Profili teorik i shpejtesise ne nje rrrethrrrotullim urban*

*Figura 4.6.2 – Lidhja ndermjet shpejtesise dhe rrezes se ktheses per vlera te ndryshme te mbingritjes ne kthese*

*Figura 4.7 – Parametrat shoqerues te voneses gjeometrike ne rrrethrrrotullime*

*Figura 4.8 – Lidhja midis kapacitetit te dy degeve A dhe D*

*Figura 4.9 – Parametrat per formulat e kapacitetit te rrrethrrrotullimeve*

*Figura 4.10 – Numri i korsive te kerkuara*

*Figura 4.11 – Kapaciteti ne hyrje te nje rrrethrrrotullimi qe ka nje korsi hyrese te gjere 4 m dhe vetem nje korsi qarkulluese*

*Figura 4.12 – Kapaciteti ne hyrje te nje rrrethrrrotullimi qe ka dy korsi hyrese te gjera 4 m dhe dy korsi qarkulluese*

*Figurat 4.13 – Perqindja e mjeteve te ndaluara ne nje rrrethrrrotullim tek*

*Figurat 4.14 – Perqindja e mjeteve te ndaluara ne nje rrrethrrotullim me korsi shumefiske*

*Figurat 4.15 – Percaktimi i termave te perdonura ne Tabelat 4.8 e 4.9*

*Figura 4.16 - Parametrat gjeometrike per llogaritjen e kapacitetit*

*Figura 4.17 - Gjeresia e karrekhates rrethore per rrrethrrotullimet*

*Figura 4.18 - Perdonimi i ishullit te kanalizimit per te eliminuar manovrat e rrezikshme dhe te gabuara*

*Figura 4.19 - Konfigurimi tipik i hyrjes dhe daljes se nje rrrethrrotullimi ne zona urbane*

*Figura 4.20 - Dizenjimi tipik i nje rrrethrrotullimi per nje zone rurale (ne rruge me shpejtesi te larte)*

*Figura 4.21 - Ilustrimi i kriterit te devijimit te nje rrrethrrotullimi me nje korsi*

*Figura 4.22 – Shembull permasimi per uljen e shpejtesise se afritit*

*Figura 5.1 – Arkitektura e procedurave prezente ne SIDRA*

*Figura 5.2 – Vlerat e pranuara per parametrat e volumit te trafikut*

*Figura 5.3 – Percaktimi i parametrave te kohes ne levizjet e mjeteve*

*Figura 5.4 – Percaktimi i parametrave ne rradhet e automjeteve*

*Figura 5.5 – Percaktimi i shpejtesive per nje mjet qe perballat me nje kryqezim te semaforizuar*

*Figura 6.1 – Efektet e parashikuara te fluksit te trafikut*

*Figura 6.2 – Aksidente me te plagosur ne vitet 1975-80 ne rruget me dopio karrekhate*

*Figura 6.3 - Numri i aksidenteve ne funksion te rrezes se brendshme te rrrethrrotullimeve*

*Figura 6.4 - Numri i aksidenteve ne funksion te fluksit te trafikut*

*Figura 6.5 – Skematizimi i aksidenteve*

*Figura 6.6 – Numri mesatar i aksidenteve ne vit per rrrethrrotullim ne funksion te intensitetit te trafikut ne rrrethrrotullim*

*Figura 7.1 - Kategorite dhe frekuencat e aksidenteve*

*Figura 7.2- Elementet gjeometrike te nje rrrethrrotullimi dhe tipologjite e aksidenteve te rregjistruar me vende te aferta te zonave ku ndodhin*

*Figura 7.4 - Histograma e ndjeshmerise e variablate te ekuacionit Aksidente te jeteve hyrese/qarkulluese*

*Figura 7.6 - Histograma e ndjeshmerise e variablate te ekuacionit Aksidente te mijeteve ne qasje*

*Figura 7.8 - Histograma e parametrave te variablate te ekuacionit Aksidente me nje mjet te vetem*

## **KAPITULLI 1**

### **HYRJE E PERGJITHSHME**

#### **1.1.Kontrolli i trafikut ne zonat urbane**

Midis problemeve qe shqetesojne realitetin qytetar, ato te lidhura me levizshmerine e trafikut, kane marre, ne keto vitet e fundit, nje rol gjithnje e me determinues. Nje qarkullim urban fortesisht i pershpejtuar dhe drejtuar, jo vetem qe krijon shqetesime ne perdoruesit per vete rritjen e kohes mesatare te udhetimit, qe ato duhet te pershkruajne per zhvendosjet e tyre, por shkakton edhe nje ulje te ndjeshme te sigurise se qarkullimit, duke rritur gjithashtu edhe ndotjen atmosferike dhe ate akustike.

Midis shkaqeve kryesore te rritjes se dendetise se trafikut, me e rendesishmja eshte sigurisht rritja e forte e kerkeses komplekse te transportit; nje rritje e tille eshte e lidhur me nje seri faktorësh te natyrave nga me te ndryshmet dhe shpesh te lidhura ngushte edhe midis tyre. Midis tyre me te rendesishmit jane: shperndarja ne rritje e autoveturave, shperndarja e vendodhjeve ne territor per vete rritjen e hapesirave urbane, ndryshimi i stileve te jetesës dhe shpesh nje sherbim transporti publik me mangesi te caktuara.

Nje drejtim racional dhe fleksibel i infrastrukturave dhe nje programim i gjere i rrjetit te trafikut, te mbeshtetura keto nga strategji te pershtatshme, infrastruktura dhe zgjidhje politike, jane konsideruar si instrumentat me efikase per zgjidhjen e problemit te levizshmerise urbane.

Ne rastet ne te cilat nuk eshte e mundur rritja e kapacitetit te rrjetit nepermjet permiresimit te infrastrukturave rrugore, analiza dhe projektimi i instrumentave te kontrollit te trafikut ka nje rol themelor; nje vemendje e vecante i kushtohet kontrollit te kryqezimeve (semaforike ose jo), sepse, nese ato jane mire te projektuara, mund te paraqesin nje instrument te vlefshem per permiresimin e ketij dendetimi. Ne fakt nyjet e rrjetit rrugor jane ato vende ku lindin konfliket midis rrymave te ndryshme te trafikut, qe sjellin si vonesa ashtu edhe aksidente, duke ulur nivelin e sherbimit dhe sigurine e tyre. Prej ketu, zgjedhja e tipit te kryqezimit (semaforike, me precedence, ose tip rotonde) behet shume e rendesishme per permiresimin e parametrave te siperpermendor. Kontrolli semaforik ne fakt eshte ne gjendje te ofroje, me kosto relativisht modeste, siguri, adoptim karshi variacioneve te trafikut, eficence dhe zvogelim te impaktit mjedisor. Ne vitet e fundit ne te gjitha vendet, perfshi edhe Shqiperine, po perhapet nje tip tjeter kryqezimi, ai rrethrrrotullim, qe nese perdoret brenda disa hapesirave, mund te permiresoje ne menyre te dukshme performancen, ne lidhje me ato qe mund te jene arritur me kryqezimet semaforike.

## 1.2 Qellimi i punimit

**Qellimi kryesor i kesaj teme doktorature** eshte te ilustroje dhe te krahasoje karakteristikat dhe performancen e kryqezimeve semaforike dhe kryqezimeve me rrrethrrrotullim.

## 1.3 Struktura e punimit

Punimi do te perbehet nga pjeset e meposhtme:

- Trajtimi *kryqezimeve semaforike* nga pikepamja funksionale me renditjen e te gjitha percaktiveve themelore dhe te gjitha metodave te llogaritjes per optimizimin semaforik te thjeshte te rrjetit, te kryqezimeve te izoluara dhe rrjeteve te kryqezimeve;
- Trajtimi i *kryqezimeve me rrrethrrrotullim* nga pikepamja funksionale dhe gjeometrike e projektuese, me renditjen e percaktiveve themelore per hartimin e nje projekti sa me efikas dhe te te gjitha metodave te llogaritjes per vleresimin e kapacitetit te tipologjive te ndryshme (afrim empirik dhe probabilistik);
- Kryerja e llogaritjes se kapacitetit, nivelit te sherbimit, voneses mesatare dhe parametrave te tjere karakteristike te funksionimit te kryqezimeve, per te krahasuar dhe diskutuar funksionimin e kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve ne situata te ndryshme reale: kryqezime me nje, dy ose tre korsi per cdo dege ne drejtim te levizjes, respektivisht ne rastet e flukseve te ekuilibruara per deget pa kthim majtas, flukseve jo te ekuilibruara ne deget pa kthim majtas, flukseve te ekuilibruara ne deget me kthim majtas, flukseve jo te ekuilibruara me kthim majtas.
- Trajtimi i sigurise ne kryqezimet, qe i referohen kryesisht rrrethrrrotullimeve, si nga pikepamja e monitorimit te aksidentalitetit referuar gjendjes aktuale, si nga pikepamja e modeleve te perdonura per llogaritjen e sigurise, ashtu edhe persa i perket vleresimit te parametrave gjeometrike qe ndikojne; per kete do te paraqiten shembuj te llogaritjes per tre tipe kryqezimi;
- Kryerja e vleresimit te sigurise, me modelet australiane dhe angleze, nepermjet perdonimit te diagramave, grafikeve dhe tabelave me shembull llogarites per te krahasuar dhe diskutuar funksionimin e kryqezimeve te marra ne konsiderate;
- Ne pjesen e mbylljes do te renditen dukshem avantazhet dhe dizavantazhet e kryqezimeve te marra ne konsiderate me komentet perkatese per rezultatet e arritura nepermjet simulimit te tyre.

## **1.4 Fusha e studimit**

Trafiku i renduar ne Shqiperi, paraqitet ne mjaft nga qytetet me te rendesishme te Shqiperise. Per efekt studimi, jane preferuar te selektohen zona me zgjdhje jo definitive te nyjeve te trafikut.

Jemi te ndergjegjshem qe mundesite e zgjedhjeve ishin te shumta, por konkretisht fokusi eshte perqendruar ne tre kryqezime ne hyrje te qytetit te Durrësit.

Aresyeja e kesaj perzgjedhjeje, mes shume varianteve qe u menduan paraprakisht, lidhet edhe me lehtesine praktike te kryerjes se matjeve reale te volumeve te trafikut.

Kryerja e ketyre matjeve do te ndihmonte ne realizimin e anes aplikative te ketij punimi, per te evituar ne maksimum, realizimin e saj, mbi bazen e hipotezave apo perafrimeve, qe edhe programi llogarites i lejon.

## **1.5 Kufizimet e studimit**

Pavarësisht sa ambicioz është një studiues, është e pamundur që në një studim të jepen të gjitha përgjigjet e pyetjeve që shtrohen. Edhe ky punim nuk përbën përjashtim.

Gjatë kohës së kryerjes së këtij punimi jam ndeshur në disa kufizime, të cilat i kam renditur si më poshtë:

- 1- Në studim nuk ka qene e mundur te behen simulime per pjesen e sigurise rrugore, per aresye se edhe te dhenat statistikore te mbledhura, nuk ishin te mjaftueshme per te nxjere konkluzione te sakta. Mungesa e te dhenave, te cilat do te kerkonin statistika shume te vjetra ne kohe, ben qe konsideratat qe jepen mbi performancen dalluese mbi keto dy lloje kryqezimesh, te jene deri diku hipotetike, dhe jo shume te vertetuara.
- 2- Ne studim jane analizuar konkretisht vetem kryqezimet, dhe jo rrjeti ne teresi, pjese e te cilit jane edhe vete ato.
- 3- Studimi u kufizua vetëm në qytetin e DURRESIT, jo per mungese te egzistences se nyjeve (kryqezimeve) problematike te zgjdhura dhe te pazgjadhura ne territorin e Shqiperise, por per mundesi matjesh reale te trafikut. Kjo e kufizon pak ne dukje studimin, por konsideratat e nxjerra jane lehtesisht te pershatshme per ti per gjithesuar edhe ne nje shtrirje me te gjere.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

Kufizimet gjithsesi nuk ndikojnë dukshem rezultatet e studimit, pasi është bërë kujdes, si në studimin e trafikut, ashtu edhe në trajtimin e informacionit, duke shfrytëzuar, jo vetëm matjet reale ne terren, por dhe përvojën e disa prej inxhiniereve te transportit në Shqipëri.

Për këtë arësygjetjet, përfundimet dhe rekomandimet që rrjedhin nga ky studim, jo vetëm që mund të përdoren nga inxhinieret shqiptarë, por do të ndihmonin në shhangjen e gabimeve subjektive ne zgjedhjen e formave me efikase e te sigurta te kryqezimeve, duke evitar kostot e tepruara te zgjidhjeve te gabuara, si dhe cenimin e pashmangshem te sigurise se perdoruesave.

## **KAPITULLI 2**

### **KRYQEZIMET SEMAFORIKE**

#### **2.1. Hyrje ne percaktimet themelore**

Kryqezimet e nje rrjeti rrugor Jane pikat e takimit te segmenteve te ndryshme te rrugeve. Prania e perdoruesave (mjete ose kembesore) qe ndjekin menyra te ndryshme kalimi, midis tyre ne konflikt, ben te nevojshme adoptimin e nje rregullimi sa me oportun.

Teknikat me te perdorura Jane:

- 1) Kryqezime ne nivel me rregulla perparesie (djathtas)
- 2) Kryqezime ne nivel me rregulla perparesie (sinjalizimi fiks)
- 3) Kryqezime me rrethrrrotullim
- 4) Kryqezime semaforike
- 5) Kryqezime ne disnivele

Mbi te gjitha ne hapesiren urbane, ku densiteti i kryqezimeve eshte rritur, kostot e dukshme te realizimit dhe impakti mbi ambjentin, perjashtojne, vetem ne raste te vecanta, realizimin e kryqezimeve ne disniveli, ose atyre ne forme rrethrrrotullimi.

Rregullimi semaforik, per me shume, eshte teknika e perdorur zakonisht per kryqezimet urbane te karakterizuara nga flukse te dukshme, te tilla per te mos lejuar adoptimin e nje rregullimi te bazuar mbi rregulla te zakonshme te perparesise, ose mbi rregulla te prioritetit.

Kjo tekniqe lejon rritjen e sigurise se kryqezimit, duke ulur pikat e konfliktit te trajektoreve te mjeteve; pervec kesaj lejon qe:

- uljen e vonesave te pritjes ne kryqezime
- zvogelimin e gjatesise se rradheve te pritjes, duke evitar keshtu perhapjen e shtrirjes ne kryqezime te tjera
- sigurimin e perparesise ne grupe te vecanta perdoruesish, ne te cilat p.sh. mjete te transportit kolektiv dhe/ose kembesore
- permbajtjen, te pakten ne menyre indirekte, te konsumit te karburantit dhe emetimit te ndotesave ne ambjent

Rregullimi semaforik luan, pervec ketyre, nje rol te rendesishem mbeshtetes ne implementimin e skemave te qarkullimit, duke lejuar privilegjin e disa itinerareve ne report me te tjere, dhe kontrollin e hyrjes ne disa zona te territorit urban, dhe me e per gjithshmja, lehtesimin e perdoruesit ne perceptimin e hierarkise se percaktuar midis akseve rrugore.

Ne vazhdim, propozohen disa modele per analizen e nje rrjeti tek kryqezimi, ose te nje rrjeti kryqezimesh. Ne vecanti, analizohen ne detaje kryqezimet semaforike. Ne shtojce pershkruhen metodat e llogaritjes te disa parametrave baze per vleresimin e funksionalitetit te te njejtave (fluksi i ngopjes, struktura e fazes, kohet e ciklit, etj.). Gjithashtu, trajtohet edhe analiza e kryqezimeve me rregulla prioriteti.

Percaktohet si hyrje ajo pjese e nje rrule, e perbere nga nje ose me shume korsi, qe ndikon ne kryqezim, e tille qe, fenomenet e rradhes te jene afersisht te njejtë per cdo korsi rradhitje, nderkohe qe mjetet kane semafor jeshil njehkosisht, cilado qofte korsia ne te cilen jane ne pritje. Fluksi i trafikut, eshte nje bashkesi mjetesh qe pershkojne kryqezimin, duke u nisur nga e njejtë hyrje.

Fluksi i trafikut eshte pra, njesia me e vogel, e konsideruar ne kontrollin e trafikut te nje kryqezimi. Ne per gjithesi nje rryme eshte e perbere nga nje ose me shume manovra.

Nje manover eshte e perbere nga te gjithe perdoruesit, qe ndjekin te njejtën trajktore pershkimi te kryqezimit. Ne per gjithesi rregullimi semaforik indukton nje efekt perqendrimi te flukseve te perdoruesave ne dalje te kryqezimit. Ky efekt tregues zvogelohet gjate degeve te rruleve te kryqezimeve, kryesisht per shkak te diferencave te shpejtesive midis mjeteve, deri ne lenien pas dore, deri ne nje fare distance te vete kryqezimit.

Kjo distance, e ndryshueshme me karakteristikat gjeometrike te rrjetit rrugor, me perberjen e parkut te mjeteve, me qendrimet e drejimit, etj., eshte ne per gjithesi e rregullit ne disa qindra metra. Mbi bazen e ketyre konsideratave, nje hyrje e nje kryqezimi, quhet e izoluar, ne qofte se fenomeni i perqendrimit te duhur ne kryqezimet ne rrjedhen e siperme eshte i paperfillshem, perndryshe quhet jo i izoluar.

Nje kryqezim me te gjitha hyrje te izoluara quhet i izoluar, perndryshe quhet jo i izoluar.

Kjo diferenca merr nje rendesi te dukshme ne analizen e voneses, meqe eshte i rendesishem dallimi midis kryqezimeve te izoluara dhe jo te izoluara, sic do te shihet me poshte. Rezulton ne fakt pa influence, per vete analizen e kushteve te saturimit te secilit kryqezim, qe me nje qellim te tille, mund te jete gjithsesi i analizuar si i izoluar.

Ne vazhdim do te pershkruhen elementet e nevojshme per percaktimin e rregullimit semaforik te nje rryme. Do te pershkruhen pra elementet e nevojshem per percaktimin e rregullimit te nje kryqezimi tek dhe variablat e metejshem te nevojshem per pershkrimin e rregullimit e nje rrjeti kryqezimesh.

### *2.1.1. Percaktimi i fluksit te saturimit*

Mund te percaktohet fluks ngopjeje ne nje hyrje semaforike, vlera mesatare e fluksit qe mund te pershkruaje ne kushte hyrje te ngopura (sipas Manualit Highway

Capacity Manual, mbi kryqezimet semaforike, eshte numri maksimal i mjeteve qe do te mund te pershkruaje nepermjet krahut te kryqezimit, ne qofte se semafori do te ishte gjithmone jeshil); niveli i saturimit shprehet ne mjetë/orë te jeshiles efikase. Meqe ne perpjithesi defluksi ndodh ne kushte te sforcuara, faktoret qe sjellin ulje te shpejtesise, sjellin edhe zvogelim te ketij niveli. Faktore te tille jane:

- perberja e fluksit te mjeteve levizese
- pjerresia e rruges
- vendodhja e kryqezimit ne zonat urbane
- manovrat e kthesave (majtas dhe djathtas) dhe interferencat me mjetet levizese dhe kembesoret

Metoda qe ndiqet per percaktimin e nivelit te saturimit ne nje hyrje kryqezimi konsiston ne vleresimin e nivelit te saturimit baze  $S_b$  ne kushte ideale gjeometrie te nje kryqezimi rrugor, dhe korrigimi i metejshem i nje niveli te tille, i shumezuar me disa koeficiente  $K_i$ , qe marrin parasysh diferençat midis nivelit ideal dhe atij real. Rezulton qe:

$$S = S_b * K_1 * K_2 * K_3 * K_4 \quad [2.1]$$

Ku:

$K_1$  – eshte koeficienti relativ i perberjes se mjeteve levizese

$K_2$  – merr parasysh pjerresine e hyrjes ne kryqezim

$K_3$  – eshte relativ sipas vendodhjes se kryqezimit ne hapesiret urbane

$K_4$  - merr parasysh tipin e manovres dhe kryqezimit me mjetë dhe kembesore

Per hyrje te zena vetem nga “manovra direkte” ne prezenca vetem te autoveturave, pa pjerresi, pa interferencia me mjetë ose kembesore, si dhe te vendodhur ne zona rezidenciale, jemi ne kushte baze te siperpermendura dhe niveli i saturimit jepet me relacionin e meposhtem:

$$S_b = 525 \text{ L} \quad \text{me } 5.5 < L < 18.5 \quad [2.2]$$

Ku:  $L$  eshte gjeresia e rruges se hyrjes ne metra dhe  $S_b$  eshte e shprehur ne mjetë/orë te jeshiles efikase. Ne tabele janë treguar vlerat e  $S_b$  per hyrje me gjatesi me te vogel se 5.5. m.

$L$ (metra)	3.05	3.66	4.27	4.57	4.88	5.18
$S$ (mjetë/orë)	1850	1900	2075	2250	2475	2700

Me qellim marrjen parasysh te mjeteve te parkuara ne afersi te hyrjes ne kryqezim, zvogelohet gjeresia  $L$  e sasise  $L_r$  qe rezulton:

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

$$L_r = 1.65 - [0.9 (D - 7.5) / v] \quad \text{ne qofte se } D > 7.5 \quad [2.3]$$

$$L_r = 1.65 \quad \text{ne qofte se } D < 7.5$$

Ku **D** eshte distanca ne metra nga linja e ndalimit te mjetit te pare te ndaluar dhe **v** eshte zgjatja e jeshiles (ne sekonda). Per te patur parasysh llojin e mjeteve, shtohet edhe koeficienti **K<sub>1</sub>** qe rezulton:

$$K_1 = 1 / \sum a_i E_i \quad [2.4]$$

Ku **a<sub>i</sub>** eshte perqindja e mjeteve te tipit **i** dhe **E** eshte koeficienti korrespondues i ekuivalences, vlerat treguese te te cilit jane dhene ne tabelen e meposhtme:

Tipi i mjetit	E <sub>i</sub>
Autoveture	1
Mjete te renda	1.75
Autobuz	2.25
Tram	2.5
Motociklete	0.33
Biciklete	0.2

*Tabela 2.1 – Ekuivalentimi i mjeteve ne mjete njesi*

Per hyrje te vendosura ne pjerresi, niveli i ngopjes zvogelohet me 3% per cdo 1% pjerresi ne ngjitje dhe rritet me te njeften mase per cdo 1% pjerresi ne zbritje. Per me teper, quajme me **i** pjerresine ne zbritje dhe **-i** ate ne ngjitje; koeficienti **K<sub>2</sub>** i korrigimit per pjerresine vlen:

$$K_2 = 1 \pm 0.03 I \quad [2.5]$$

Persa i perket efekteve, si pasoje e interferencave me mjetet dhe kembesore, ato rriten duke kaluar nga zonat rezidenciale ne ato qendrore tregtare. Mund te merren parasysh keto efekte nepermjet disa llojeve te koeficienteve **K<sub>3</sub>** te shprehura ne tabelen e meposhtme:

Vendodhja	K <sub>3</sub>
Zone rezidenciale	1
Zone tregtare	0.98
Zone industriale	0.93
Qender tregtare	0.85

*Tabela 2.2 - Koeficientet e interferences se trafikut per shkak te qendrave te renduara*

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Nese, pervec manovrave direkte, jane te lejuara edhe manovrat e ktheses, mund te arrihen ulje te ketij niveli per shkak te motiveve te meposhtme:

- ulje te shpejtesise per rrezen e kthimit
- interferencia me rryma te tjera mjetesh

Koeficienti  $K_4$  qe merr parsysh keto efekte jepet me formulen:

$$K_4 = 1 / \sum a_i E_i \quad [2.6]$$

Ku  $a_i$  jane pjesa te nivelist hyres relativ karshi manovrave te thjeshta dhe  $E_i$  koeficientet korrespondues te ekuivalences; te tille jepen ne tabelen e meposhtme:

Tipi i manovres	$E_i$
Ecje drejt	1
Kthese djathtas	$1 \div 1.25$
Kthese majtas	$1 \div 1.75$

Per kthesen djathtas koeficienti rritet me zvogelinin e rrezes se ktheses, per ate majtas luan nje rol percaktues interference me mjetet levizese, qe vijnë nga ana e kundert dhe per me shume koeficienti eshte me i larte.

Kur hyrja ne kryqezim eshte e zene vetem me manovra djathtas ose majtas, duhet te dallohen dy raste:

- mungesa e interferences me kembesore ose mjete (kthesa e mbrojtur nga interferencat e levizjeve te tjera)
- prania e interferencave me kembesore ose mjete (kthese e lejuar)

Ne rastin a) niveli i saturimit baze vlen:

$$S_b = S' / [1 + (1.5/r)] \quad (\text{mjete/orë te jeshiles efikase}) \quad [2.7]$$

Ku  $r$  eshte rrezja e ktheses ne metra,  $S' = 1800$  mjete/orë te jeshiles efikase per hyrje ne nje korsi te vetme,  $S' = 3000$  mjete/orë te jeshiles efikase per hyrje me dy korsi. Ne kete rast mjetet qe duhet te kthehen kryejne manovren vetem gjate nderprerjes se rrjedhjes te rrymes se kundert.

Ne rastin b) niveli baze, i llogaritur me (1), shumezohet me koeficientin  $K_5$  qe vlen:

$$K_5 = 1-a \quad [2.8]$$

Ku:

$a = 0.05$ ; per nivele te uleta te kalimit te kembesoreve ( 100 kembesore/orë)

$a = 0.15$ ; per nivele mesatare te kalimit te kembesoreve (300 kembesore/orë)

**a = 0.25;** per nivele te larta te kalimit te kembesoreve ( 100 kembesore/ore)

Mjetet qe ne keto raste duhet te kthehen majtas, per me teper, duhet ti japid perparesi shfaqjes se jeshiles, mjetete te hyrjes se kundert, qe kryejne manovren direkte, ose ate te ktheses djathtas; per keto motive duhet te presin perpara se te krijohet rradhe, qe vjen nga hyrja e kundert e nivelist te saturimit dhe me tej te pritet qe te shfaqet intervali i pershtatshem per kryerjen e manovres.

Shkurtimisht gjate periudhes se fundit, (mungesa e rradheve nga drejtimi i kundert), nga analizat eksperimentale, niveli i saturimit baze rezulton:

$$S_b = S'/(1+1.5 r) - 0.75 f \quad (\text{mjeti/ore te jeshiles efikase}) \quad [2.9]$$

Ku **f** eshte shuma e niveleve orare direkte dhe me kthime djathtas, qe vijnë nga hyrja e kundert, ndersa **r** eshte gjithmone rrezja e ktheses e shprehur ne metra.

### *2.1.2. Cikli semaforik*

Sekuenza jeshile-jeshile+verdhe-e kuqe, e nje semafori eshte quajtur cikel ose plan semaforik dhe zgjatja e saj eshte quajtur koha e ciklit. Nje cikel, megjithate, mund te skematizohet si i perbere vetem nga dy interval kohore: nje periudhe e te kuqes efektive e ndjekur nga nje e jeshiles efektive. E para perfaqeson ate pjese te ciklit semaforik, gjate te ciles, ne vleresimin e voneses, supozohet qe asnje mjet i ardhur nga krahua i analizuar, nuk do te kaloje kryqezimin; i dyti perfaqeson pjesen e mbetur te ciklit, gjate te cilit supozohet qe mjetet te kalojne krahun e kryqezimit me nje vlere fluksi konstant dhe te barabarte me fluksin e saturimit.

### *2.1.3. Struktura e nje faze*

Zgjatja e nje faze ndahet vetem ne:

- jeshilja semaforike, ne te cilin flukset e nje faze kane jeshile
- jeshilja e ndermjetme, eshte jeshilja vetem per flukset qe kane jeshile ne fazen ne vazhdim dhe ne fakt eshte pjeserisht e verdhe dhe pjeserisht e kuqe, per flukset qe nuk kane jeshile ne fazat e tjera.

E jeshilja e ndermjetme eshte pra e perbere nga dy periudha te ndara: zgjatja e te verdhes semaforike dhe zgjatja e te gjithe te kuqes. Sasia e pare ne per gjithesi varion ne nje interval nga 2 deri ne 5 sekonda, ndersa zgjatja e komplet te kuqes perfshihet ne intervalin nga 0 deri 2 sekonda; kjo e fundit jepet me shumen algjebrike midis kohes qe i duhet mjetit te fundit te braktise zonen e konfliktit dhe kohes qe i duhet mjetit te pare te fluksit se kundert per te arritur nje zone te tille:

$$(S_{pi}/v_i) + (S_{p2}/v_2) + k \quad [2.10]$$

Ku:

$S_p$  eshte distanca midis linjes se ndalimit dhe pikes se konfliktit per hyrjen i

$v_i$  eshte shpejtesia e mjetit ne hyrjen i

$k$  eshte koha e braktisjes se zones se konfliktit

Shpejtesite e zbrazjes varojne nga nje minimum 5 km/ore ne nje maksimum 40 km/ore. Zgjatjet e teperta te te kuqes se plete duhet te evitojen, nderkohe qe drejtuesit e fluksit se kundert do te tentonin te kalonin gjate nje periudhe te tille.

Nese duhet te kihet parasysh edhe kalimi i kembesoreve, llogaritja e te kuqes se plete do te behet duke perdorur shprehjen e meparshme, duke e konsideruar fluksin e kembesoreve te njeje me ate te mjeteve levizese.

Jeshilja e ndermjetme midis fazave i dhe  $i+1$  duhet te kete parasysh edhe kohen e zbrazjes, qe eshte koha minimale nga fundi i te verdhes dhe fillimi i jeshiles te dy flukseve te kunderta, midis flukseve, qe kane jeshile ne fazen i dhe atyre qe kane jeshile ne fazen  $i+1$ .

#### *2.1.4. Vonesat per manovrat e penguara*

Nese kthesa gjate intervaleve nga nje mjet ne tjetrin, mund te neglizhohet, vonesa mesatare e ktheses se kundert mund te vleresojet me cdo lloj modeli te literatures, p.sh. ai i *Webster*, ku vlera e arritjeve eshte me e vogel, ose e barabarte me kapacitetin e kryqezimit.

Ne qofte se fluksi kalues ne kryqezim eshte me i vogel, ose i barabarte me vete kapacitetin e tij, minimizimi i voneses mund te llogaritet sipas metodes Webster.


Ne qofte se kthesa nuk mund te neglizhohet, modelet e meparshme te llogaritjes se voneses mesatare nuk mund te aplikohen ne trafikun e kundert, meqe ka dy flukse te ndryshme te saturimit ne brendesi te jeshiles efikase. Ne keto raste egzistojne shprehje te nxjerra ne menyre analoge me metoden e *Webster*, qe nuk jane vertetuar eksperimentalisht.

Duke vezhguar figuren 2.1., konsiderohet nje fluks trafiku ne te cilin mjetet arrijne ne nje kryqezim rregullisht me vleren  $f$ . Supozohet qe fluksi te ndaloje per nje periudhe  $r$ , keshtu qe rradha qe formohet e mjeteve eshte  $h = f \cdot r$ . Mjetet lene linjen e ndalimit ne vleren  $s$ , derisa te jete mbaruar rradha, dhe vlera e arritjes vazhdon te jete e barabarte me  $f$ .

Vonesa totale eshte:

$$D(f,h,s) = h^2 s / 2f(s-f) = h^2 / 2 f (1-y) \quad [2.11]$$

Ku anetari i dyte perfaqeson siperfaqen e trekendeshit ne figuren e meposhtme 2.1.



*Figura 2.1- Mbarevajtja e rradhes ne funksion te kohes*

Ne rregullimin e kryqezimeve rrugore semaforike, nje nga veshtiresite me te medha eshte rregullimi i nje manovre qe, duke u kthyer nga nje rrule me dy drejtime qarkullimi, kryqezohet me fluksin e drejtimit te kundert. Levizje te tilla te trafikut jane quajtur “manovra te penguara”.

Hyrja nga vjen nje manover e penguar, mund te perbehet nga nje ose me shume korsi. Ne per gjithese trafiku i penguar mund te jetet i kufizuar;

- 1) me nje korsi speciale (ose mbi nje zgjerim ne afersi te kryqezimit)
- 2) me nje korsi te ndare me trafikun bashkengjitur

Ai mund te kaloje kryqezimin:

- a) duke marre te drejten e kalimit perpara se ti jepet trafikut pengues (nisje e vonuar)
- b) duke kaluar ne hapesirat boshe te fluksit te kundert
- c) duke vazhduar te kete te drejten e kalimit, pasi e ka humbur ai i fluskit te kundert
- d) duke vazhduar te kaloje kryqezimin ne periudhen e jeshiles se ndermjetme pasardhese

Ne qofte se ka dy korsi kthimi te vecanta, trafiku qe kthehet nuk interferon me ate bashkengjitur, perndryshe trafiku kthyes dhe ai bashkengjitur duhet te konsiderohen te bashkuar.

### *2.1.5. Kapaciteti per manovrat e penguara (me korsi te vecante kthimi)*

#### **Rasti kur kthesa penguese mund te injorohet**

Ne qofte se kthesa ne hapesirat boshe mund te injorohet, (ose kur fluksi eshte i larte), kapaciteti per trafikun kthyes pengues mund te shprehet si produkt i fluksit te saturimit per porcionin e jeshiles efikase te ciklit.

Metoda e trajtimit me kthim perpara gjendjes ne te cilen shfaqet jeshilja e trafikut te kundert (p.sh. nepermjet nisjes se vonuar), varet nga fakti qe kjo periudhe do te konsiderohet variable ose fiks: nese do te konsiderohet variable, do te trajtohet si

nje gjendje ne te cilen vetem trafiku bashkengjitur dhe ai kthyes kane perpare; nese do te konsiderohet fiks, atehere do te trajtohet si nje kohe e humbur dhe zgjatja e saj do ti shtohet kohes se jeshiles efikase ekstra (rikuperimi i jeshiles) per trafikun bashkengjitur kthyes.

**Rasti ne te cilin mund te konsiderohet kthesa nepermjet intervalit nga nje mjet ne tjetrin**

Supozojme qe kthesa nepermjet intervaleve nga nje mjet ne tjetrin nuk mund te injorohet. Ne qofte se ciklet jane te dalluar, kapaciteti per fluksin e kthimit te kundert mund te vleresohet me *Metoden e Webster* (1963). Ne qofte se maksimizimi i kapacitetit eshte i dukshem dhe flukset e kthimit te kundert kufizojne kapacitetin e kryqezimit, duhet te merret ne analize lidhja midis kapacitetit te ketij fluksi dhe ciklit semaforik.

### Kapaciteti pa korsi speciale kthimi

Aty ku korsite e perdonura nga trafiku i kthimit jane te perdonura edhe nga trafiku bashkengjitur, trafiku kthyes i drejtimit te kundert mund te trajtohet vecmas.

Prania e trafikut kthyes te drejtimit te kundert influencon ne kapacitetin hyres, duke ulur fluksin e ngopjes. Si perfundim, fluksi i ngopjes per nje hyrje te tille duhet te matet ne rruge. Aty ku kjo nuk eshte e mundur, teknika me e mire eshte ajo e supozimit qe cdo mjet kthyes kerkon nje kapacitet te barabarte me nje numer **k** te mjeteve te ngjashme, qe i perkasin trafikut te bashkengjitur. Numri **k** vlen **1.75**, sipas *Webster*, ndersa ne Australi kjo vlere eshte **k = 2.9**. Supozojme qe fluksi i saturimit te hyrjes te arrihet vetem ne mungese te mjeteve qe kthehen ne drejtimin e kundert dhe te jete **S<sub>p</sub>**, kur ka nje perqindje te trafikut kalues nepermjet hyrjes ne kryqezim.

$$S_p = 100 s_0 / [100 + (k-1)p] \quad [2.12]$$

Problemet qe mund te paraqiten jane dy:

**1.** I pari eshte qe, gjate nje fundi te avancuar, ose fillimi te vonuar, fluksi i saturimit do te jete **S<sub>o</sub>** ne vend te **S<sub>p</sub>**. Ne qofte se keto se bashku zgjasin per nje kohe T ne cdo cikel, rritja e fluksit te saturimit gjate kesaj kohe mund te konsiderohet duke i shtuar jeshiles efikase ekstra per hyrjen e sasise:

$$(T_{so} - S_p) / S_p \quad [2.13]$$

dhe duke supozuar **S<sub>p</sub>** si nje fluks te saturimit per te gjithe kete periudhe. Per te bere kete korrigjim duhet te njihet zgjatja T, dhe ne qofte se kjo nuk eshte e dukshme, duhet te vleresohet paraprakisht pa marre ne konsiderate fluksin e saturimit.

**2.** Problemi i dyte duhet te merret ne konsiderate, vetem ku ka me shume kthesa te kunderta, qe mund te kalojne nepermjet boshllekut te trafikut te kundert, por nuk ka nje gjatesi paraprake.

## 2.2. Karakteristikat e kontrollit semaforik

### 2.2.1. Rregullimi semaforik i nje fluksi

Percaktohet si fluks (mesatar) ne arritje ose drejtim i nje rryme ( $f$ ), numri mesatar i mjeteve qe kalojne tranzit gjate nje seksioni ne nje periudhe reference. Fluksi i saturimit te nje fluksi ( $s$ ) eshte numri i mjeteve qe mund te kalojne vijen e ndalimit ne njesine e kohes ne prani te nje rradhe. Fluksi i saturimit varet nga karakteristikat e kryqezimit, ne vecanti te hyrjes korresponduese, qe con ne nje variacion te fluksit ideal, nepermjet shumefishimit me koeficiente te pershtatshem, sic parashikohet ne *Highway Capacity Manual*. Pervec kesaj *Highway Capacity Manual* konsideron variablin “grupe korsie” si nje o me shume korsi qe ndajne te njejten manover kthese.

Rregullimi semaforik bazohet ne nje seri te rregulluar te sinjaleve per cdo fluks: *Jeshilja (G)* eshte intervali i kohes gjate te cilit mjetet kane rruge te lire kalimi, e *Verdha (A)* eshte intervali i kohes gjate te cilit mjetet duhet te ngadalesojne levizjen per te siguruar ndalimin ose siguruar kalimin e kryqezimit, e *Kuqja (R)* eshte intervali i kohes gjate te cilit mjetet duhet te presin ne vijen e ndalimit. Quhet *Zgjatje cikli (c)* intervali minimal i kohes se nevojshme per verifikimin e nje serie te pote sinjalesh:

$$c = G + A + R \quad [2.14]$$

Zgjatja e te verdhes eshte zakonisht e percaktuar nga rregullat e sigurise, pra parametrat e rregullimit jane te percaktuar nga zgjatja e jeshileve (ose te kuqes) dhe nga zgjatja e ciklit.

Tregohet me  $a(t)$  funksioni qe shpreh mbarevajtjen e kohes se fluksit te mjeteve ne nisje. Ne kushte qendrimi te rradhes ne fund te periudhes jeshile, vihet re qe distancimi kohor midis mjeteve te tjera nuk eshte konstant. Ne vecanti, vlerat me te medha takohen per gjashte mjetet e para, ndersa per ato qe mbeten, tentohet te arrihet nje vlere minimale (zakonisht prej 2 sekonda); tentohet ne zero gjate periudhes se te verdhes, sic tregohet ne fig. 2.2.

Duke e supozuar konstante, dhe te barabarte me 1/sek, intervalin midis dy mjeteve qe kalojne kryqezimin, zgjatja e ciklit mund te ndahet ne dy periudha: *jeshile efikase (g)*, gjate te ciles behen nisjet me nje ritem 1/sek dhe e *kuqe efikase (r)*, gjate te ciles nuk behet asnjë nisje.

$$g = (1/s) \int a(t) dt \quad [2.15]$$

$$r = c - g = G + A + R - g \quad [2.16]$$




Figura 2.2 - Mbarevajtja e nisjeve ne nje hyrje semaforike

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

Quhet, gjithashtu, *kohe e humbur* pjesa e periudhes se jeshile + e verdhe e pa perdorur si nje jeshile efikase, per shkak te nje lloj inercie ne fillim te jeshiles ( $l_1$ ) dhe te ndalimit gradual gjate te verdhes ( $l_2$ ); ajo varet kryesisht nga gjeometria e kryqezimit, nga karakteristikat e mjeteve dhe perdonuesve dhe eshte zakonisht e perfshire midis 2 dhe 3 sekondave.

$$1 = G + A - g = r - R \quad [2.17]$$

Ne fund te analizes e/o te projektit te nje plani semaforik do ti referohet ne vazhdim zgjatjes se ciklit (c) dhe jeshiles efikase (g), nderkohe zgjatja e te kuqes efikase (r) mund te percaktohet nga keto variabla; vec kesaj duke njojur zgjatjet e kohes se humbur (l) dhe te verdhes (A), eshte e mundur te percaktohen zgjatjet e jeshiles dhe te kuqes semaforike:

$$G = g + 1 - A \quad [2.18]$$


$$R = c - (g + l) \quad [2.19]$$

### *2.2.2. Plani semaforik i nje kryqezimi tek*

Quhet *plan i rregullimit semaforik* te nje kryqezimi tek seria e sinjaleve te jeshile - verdhe - e kuqe per secilen rryme. Per nje sqarim te metejshem:

- c eshte zgjatja e ciklit, e marre e njeje per te gjithe flukset e trafikut;
- $\gamma_i = (g_i / c)$  eshte e jeshilja efikase e shprehur si fraksion i ciklit per fluksin i;
- $f_i$  fluksi i mberritjes per i
- $s_i$  fluksi i saturimit per i

Seria e sinjaleve mund te pershkruhet nga momentet e nisjes dhe deri ne fund te periudhes jeshile te verdhe per secilin fluks trafiku.



*Figura 2.3 - Shembulli i planit semaforik ne nje kryqezim tek*

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrerrotullimeve”**

---

Supozohet per konvencion origjina e akseve lokale ne perputhje me fillimin e jeshiles treguese te fluksit 1 (ose e cfaredo fluksi tjeter). Supozohet gjithashtu, qe rregullimi te perseritet ne menyre ciklike. Plani i rregullimit semaforik i nje kryqezimi tek, duke patur parasysh jeshile te alternuar ne flukset e ndryshme, lejon kapercimin me siguri te flukseve te ndryshme, me qellim te tille qe, dy flukse te quhen jo kompatibel, kur nuk mund te kapercejne njehkohesish kryqezimin me siguri, meqe manovrat perkatese konvergojne ne te njejten korsi, ose kaperchen.

Mosperputhjet midis flukseve mund te jene te shprehura nepermjet nje matrice, ne te cilien elementi gjenerues vlen 1, ne qofte se rrymat i, j jane jokompatibel, ose ne rast te kundert.

Matrica e mosperputhshmerise eshte simetrike me diagonalen kryesore 0. Supozohet qe ajo permban te pakten nje element njesi per rrjesht (ose per kollone); nje hipoteze e tille perjashton mundesine, qe nje fluks te jete kompatibel me te gjithe te tjeret.

Duke u nisur nga kjo matrice, mund te percaktohet grafi i mosperputhshmerise, nje graf i paorientuar me nje kulm per cdo fluks dhe nje brinje (i, j) per cdo cift flukshesh i, j jokompatibel. Analogjikisht eshte e mundur te percaktohet nje **matrice kompatibiliteti** dhe nje **graf kompatibiliteti**.

Ne rregullimin e kryqezimeve rrugore semaforike nje nga veshtiresite me te medha eshte rregullimi i nje manovre qe, duke u kthyer nga nje rruge me dy drejtime levizjeje, takon drejtimin e rrjedhes se fluksit, qe vjen nga drejtimi i kundert. Manovra te tilla (te quajtura te penguara) jane te perfshira ne faza specifike, ose mund te kalojne kryqezimin, duke i dhene perparesi manovrave qe i japin te drejte, te quajtura penguese.

Zgjatja e ciklit, zgjatja e fazave dhe zgjatja e jeshiles efikase te flukseve te trafikut jane te lidhura me relacione te ngushta.

Analiza e kushteve te saturimit te nje kryqezimi fillon nga struktura e fazave dhe mund te jete e drejtuar me tregues te ndryshem ekuivalente midis tyre, duke u nisur nga njobja e fluksit mesatar ne arritje per fluksset e ndryshme, pavaresisht nga mbarevajtja ne kohe. Do te jene:

$$y_i = f_i / s_i \quad \text{raporti i fluksit per rrymen } i, \text{ rapporti midis fluksit ne arritje dhe atij te saturimit}$$

$$s_i \gamma_i \quad \text{kapaciteti i fluksit } i, \text{ si produkt midis fluksit te ngopjes dhe zgjatjes se jeshiles efikase ne proporcion me zgjatjen e ciklit}$$

$$x_i = (f_i, c) / (s_i, g_i) = y_i / \gamma_i \quad \text{raporti i ngopjes per fluksin } i, \text{ rapport midis fluksit ne arritje dhe kapacitetit te fluksit} \quad [2.20]$$

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

$\mu_i = (s_i, g_i) / (f_i, c) = 1 / x_i$  faktori i kapacitetit te fluksit **i**, faktori shumezues i fluksit ne arritje i tille qe te arrihet kapaciteti, inversi i raportit te saturimit

[2.21]

**$\mu_i - 1$**  rezerva e kapacitetit te rrimes **i**

Fluksi **i** konsiderohet ne kushte te nen saturimit (ose mbi saturimit) ne qofte se numri i perdonuesave ne nje cikel eshte me i vogel (ose me i madh) se numri i mjeteve qe mund te nisen gjate jeshiles efikase:

$$f_i < s_i, g_i$$

$$f_i < s_i \gamma_i$$

$$y_i < \gamma_i$$

qe mund te jene te shprehura edhe si:

$$x_i < 1$$

$$\mu_i > 1$$

$$\mu_i - 1 > 0$$

Treguesit definitive per flukset teke mund te jene lehtesish te shtrire ne te gjithe kryqezimin. Percaktohen ne fakt:

**$x = \text{MAX}_i x_i$**  rapporti i saturimit se kryqezimit

**$\mu = \text{MIN}, \mu_i$**  faktori i kapacitetit te kryqezimit

**$\mu - 1$**  rezerva e kapacitetit te kryqezimit

Kushti i nensaturimit per kryqezimin eshte dhene nga nje nga shprehjet e meposhtme:

$$x < 1$$

$$\mu > 1$$

$$\mu - 1 > 0$$

### *2.2.3. Plani i rregullimit te nje rrjeti kryqezimi*

Sic eshte vene re, ne rastin e kryqezimeve jo te izoluara eshte e nevojshme, per te bere nje analize te voneses, te konsiderohet nje bashkeveprim i ndersjellte midis kryqezimeve. Ato nuk mund te studjohen si kryqezime teke (analiza e kapacitetit nuk kerkon ne fakt marrjen ne konsiderate te ketyre bashkeveprimeve). Ne vecanti, per nje rrjet me **n** kryqezime me nje zgjatje te njejtë cikli dhe (ose me nje

shumefishues c), me origjine te aksit global te perkohshem te fiksuar, duhet te percaktohet pozicioni i origjines se aksit lokal te planit te rregullimit per secilin kryqezim, sipas origjines globale (*plani i koordinimit*).

Nje pozicion i tille eshte i percaktuar nga nje *sfazim absolut* ( $\Phi_k$ ) i planit te rregullimit te kryqezimit k.

Mbas percaktimit te zgjatjes se nje cikli te zakonshem, *plani i rregullimit te kryqezimeve teke* (zgjatja e jeshileve dhe vazhdimi i tyre) dhe *plani i koordinimit* (sfazimet), percaktojne *planin e sinkronizimit te rrjetit*.

#### *2.2.4. Analiza e voneses ne nje kryqezim semaforik*

Vonesa e shkaktuar nga nje mjet ne nje kryqezim percaktohet nga diferenca midis kohes, qe nevojitet per kalimin e kryqezimit dhe te njejtës, qe do te duhej ne mungese te tij.

Nje vleresim mund te arrihej duke perdorur disa shprehje analitike, qe japin vonesen ne funksion te parametrave te rregullimit dhe fluksit te mberritjes.

Ne vecanti vonesa ne hyrje te nje kryqezimi mund te merrej si shuma e dy termave: *vonesa percaktuese*, qe shpreh komponenten e voneses se marre ne arritjet e supozuara periodikisht konstante, dhe *vonesa stokastike*, qe shpreh vonesen e shkaktuar nga luhatjet stokastike te arritjeve, ne perputhje me vleren mesatare, dhe eventualisht vonesen per shkak te kushteve te mbi saturimit.

Ne vazhdim analizohet fillimisht rasti i hyrjes se izoluar, ne te cilen supozohet qe arritjet te mos jene te influencuara nga kryqezimet ne vazhdim, dhe me tej analizohet rasti i hyrjes jo te izoluar. Per thjeshtesi, menjanohet treguesi relativ me fluksin e trafikut.

### **2.3. Analiza e voneses per kryqezimet semaforike**

#### *2.3.1. Vonesa per nje hyrje te izoluar*

Vonesa percaktuese. Ne kushte nensaturimi, ose kur  $y \leq \gamma$ , vonesa percaktuese (e njesishme) eshte dhene ne Modelet dhe Metodat per inxhinierine e trafikut – (kap.1).


$$d_d = [c(1 - \gamma)^2] / [2(1 - \gamma)] = [c(1 - \gamma)^2] / [2(1 - \gamma x)] \quad [2.22]$$

ku:

$\gamma = g/c$  eshte zgjatja e jeshiles efikase si fraksion i ciklit;

$y = f/s$  eshte rapporti i fluksit

Figura 2.4 jep prirjen e voneses percaktuese ne funksion te raportit te fluksit (y).



*Figura 2.4 - Mbarevajtja e voneses percaktuese*

Shprehja e sjelle eshte lehtesisht e arritshme nga kushti i nensaturimit. Ne fakt:

$$f t_0 - s(t_0 - r) = 0 \quad \text{nga ku: } t_0 = sr / (s-f) \quad [2.23]$$


ku:

$t_0$  eshte moment ne dispozicion te rradhes

Vonesa percaktuese totale  $D_d$ , per te gjithe mjetet e arritura gjate cilkit jepet nga figura 2.4.:

$$D_d = (fr^2 / 2) + (fr^2 (t_0 - r) / 2) = (fr^2 / 2) [ s / (s-f) ] \quad [2.24]$$

Meqe numri total i mjetave qe arrijne kryqezimin gjate nje cikli c eshte i barabarte me  $f_c$ , ndare per  $D_d$  per nje numer te tille arrihet  $d_d$ .



*Figura 2.5 - Prirja e arritjeve dhe nisjeve dhe vleresimi relativ i voneses*

Ne kushte mbisaturimi,  $y > \gamma$  per nje interval zgjatje T, vonesa percaktuese mund te vleresohet si shuma e dy termave:

- 1)  $d_{d1}$  - vonesa e pesuar nga mjetet qe arrijne te pershkruajne kryqezimin gjate intervalit T, qe rezulton i pavarur nga fluksi ne arritje dhe vleresohet duke perdorur ekuacioni 2.22 dhe duke vendosur  $y = \gamma$ :

$$d_{d1} = [c(1-y)^2] / [2(1-y)] = [c(1-y)^2] \quad [2.25]$$

- 2)  $d_{d2}$  - vonesa e njesishme e pesuar nga mjetet ne rradhe ne fund te intervalit te proves, qe varet nga zgjatja e periudhes se mbinsaturimit T dhe nga shkalla e saturimit x sipas shprehjes:

$$d_{d2} = (x-1) T/2 \quad [2.26]$$

Figura 2.6 jep prirjen e voneses percaktuese ne kushte te mbi saturimit ne funksion te raportit te fluksit.




Figura 2.6 – Prirja e funksionit te voneses per mbi saturim

Shprehja e sjelle mund te jete lehtesishet e arritshme duke analizuar prirjen e rradhes. Ne fakt rradha (mesatare) e mbinsaturimit ne momentin e gjeneruar t vlen:

$$h = (f - \gamma s) t \quad [2.27]$$




Figura 2.7 – Mjete ne rradhe ne funksion te kohes

Duke qene  $T$  zgjatja e periudhes se mbisaturimit, vonesa totale percaktuese e mbisaturimit  $D_{d2}$  jepet nga shprehja e meposhtme:

$$D_{d2} = (hfT/2) = [f - \gamma s] fT^2/2 = (x-1) f T^2/2 \quad [2.28]$$

Vihet re qe kjo eshte direkt proporcionale me njesine e rradhes mesatare, me fluksin e mjeteve dhe me zgjatjen e periudhes se mbisaturimit.

Vonesa njesi  $d_{d2}$  arrihet duke ndare vonesen totale  $D_{d2}$  me numrin e mjeteve ne arritje ( $fT$ ) ne kryqezim gjate periudhes se mbisaturimit  $T$ .

Vonesa stokastike. Ne hipotezen e kushteve stacionare, pra ne ate te nengopjesaturimit global, vonesa stokastike  $d_{stt}$  mund te shprehet duke perdonur teorine e rradhes, duke supozuar nje kohe sherbimi te barabarte me 1/s:

$$d_{stt} = \Theta y [ 2s (\gamma - y) ] = \Theta x / 2s(1-x) \quad [2.29]$$

ku  $\Theta$  eshte nje parameter, i matur ne sekonda, vlera e te cilit varet nga hipoteza mbi karakteristikat stokastike te luhatjeve te arritjeve kundrejt vleres mesatare, dhe vlen 1 ne rast te ligjit te arritjeve ne forme eksponenciale negative.

Eshte e mundur ne per gjithesi te zgjerohet lindhja ne rast mbinsaturimi per nje kohegjatje  $T$ , dhe ne rast kushtesh jo stacionare.

Megjithate arrihen shprehje shume komplekse, qe ne shume raste eshte e mundur te vleresohen vetem ne rruge numerike.

Adoptohet ne kete menyre nje zgjidhje e perafert e problemit, duke modifikuar shprehjen e voneses stokastike te nensaturimit, ne menyre qe te paraqese nje asimptode te zhdrojte per  $x=1$ , e shprehur nga vonesa percaktuese e mbisaturimit.

Per  $T$  qe tenton drejt infinit, nje asimptode e tille behet vertikale dhe vonesa stokastike jepet nga relacioni, i vlefshem ne rast kushtesh stacionare te nensaturimit.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

Shprehja rezultante jep nje vonese stokastike ne funksion te fluksit te arritjes dhe te zgjatjes se periudhes se mbinsaturimit T:

$$d_s = T [(A^2 + B)^{(1/2)} - A] / 4 \quad [2.30]$$

ku:

$$A = (\gamma - y) / \gamma + 2\theta / (T_s) = (\gamma - y) / \gamma \quad [2.31a]$$

$$B = (8\theta y) / (T_s \gamma) \quad [2.31b]$$

Nje relacion i tille per  $y > \gamma$  perfshin termin e dyte te voneses stokastike te mbinsaturimit  $d_{d2}$ .

Le te jene  $x_1, x_2$ , dhe x vlerat e shkalleve te saturimit relative, respektivisht karshi funksioneve te voneses se nensaturimit stokastik, te mbinsaturimit percaktues dhe te funksionit qe duhet te ndertohet, ne lidhje me te cilet te tre funksionet japin te njejten vlere te voneses d.

Kushti qe vendoset me qellim qe te arrihet nje kurbe e voneses, e cila tenton asimtodikisht drejt x dhe drejt infinitit (fig.2.6), me asimptoden e zhdrojte te dhene nga funksioni i voneses se mbisaturimit, (referuar ek.2.26), eshte qe distanca midis asimptodes vertikale dhe kurbes se voneses te nensaturimit, duhet te jete e njejte me distancen midis asimptodes se zhdrojte dhe kurbes se re, dmth:

$$1 - x_1 = x_2 - x$$

Duke marre:  $x = y/\gamma$  kemi:

$$\gamma - y_1 = y_2 - \gamma$$

$$y = y_1 + y_2 - \gamma$$

Duke marre:  $y_1$  nga 2.29 dhe  $y_2$  nga 2.26 ne funksion te d, kemi:

$$y_1 = s \gamma d / (q + sd) \quad \text{dhe} \quad y_2 = (2\gamma d / T) + \gamma$$




Figura 2.8 - Prirja e funksionit te voneses stokastike te nensaturimit

Funksionet vonese-fluks per nje hyrje te izoluar. Shprehjet e mesiperme mund te kombinohen per te dhene nje vonesa komplekse ne funksion te fluksit ne arritje dhe parametrave te rregullimit si dhe eventualisht te zgjatjes se periudhes ser mbinsaturimit.

Nder formulat e propozuara ne literature (nje analize e detajuar jepet ne Hutchinson 1972) per llogaritjen e kushteve te nensaturimit, ato me te perdorshmet jane formulat e Webster. Ne vecanti, arrihet formula ne tre terma te Webster, duke supozuar kushtet e nensaturimit,  $\theta=1$  ne shprehjen e voneses stokastike dhe duke futur nje term te percaktuar nepermjet simulimit. Shih shprehjen 2.32

$$d = \frac{c(1-\gamma)^2}{2(1-\gamma x)} + \frac{x^2}{2f(1-x)} - 0.65 \left(\frac{c}{f^2}\right)^{0.33} x^2 + 5\gamma \quad [2.32]$$

Nga vezhgimet eksperimentale, rezulton qe termi i fundit percakton tek vonesa nje zvogelim rreth 10%. Nje konstatim i tille e con formulen ne dy terma ku figurojne vetem komponentja percaktuese dhe ajo stokastike e voneses. Shih shprehjen 2.33

$$d = 0.9 \left[ \frac{c(1-\gamma)^2}{2(1-\gamma x)} + \frac{x^2}{2f(1-x)} \right] \quad [2.33]$$

Eshte gjithashtu e mundshme te perdoret formula e Doherty

$$t_a = \frac{T}{2} (1 - \lambda)^2 + \left( \frac{0.55}{\lambda s} \right) \left( \frac{q}{\lambda} s - q \right)$$

e perbere nga dy terma, i pari nga te cilet jep vonesen mesatare per fluks te pavlefshem, ndersa i dyti paraqet vonesen e shkaktuar nga bllokimi (konxhestioni), per  $x \leq 0.95$ , shih shprehjen e me poshtme 2.34

$$d = \left[ \frac{c(1-\gamma)^2}{2} + \frac{\theta x}{c(1-x)} \right] \quad [2.34]$$

Ku  $\theta$  eshte nje konstante qe varet nga ligji i arritjeve dhe eshte e perfshire midis 0.55 dhe 0.6 dhe  $C$  eshte kapaciteti i qasjes. Ne qofte se shkalla e saturimit se qasjes eshte me e madhe se 95% perdoret shprehja e marre duke perafruar vleren e funksionit te voneses me tangenten e tij.

Ne vecanti ne rastin e formules se Doherty perafrimi eshte i dhene me shprehjen e me poshtme:

$$d = a + b f \quad \text{nese } x > 0.95 \quad [2.35]$$

$$\text{me } a = 35.9 - 209/C \quad \text{dhe } b = 220/C^2$$

Hutchinson ne vitin 1972 ka propozuar nje shtrirje te formules ne dy terma te Webster qe merr parasysh nje vonese stokastike me hipotezen qe arritjet ndjekin nje ligj eksponencial, shih shprehjen 2.36.

$$d = 0.9 \left[ \frac{c(1-\gamma)^2}{2(1-\gamma)} + \frac{\theta x}{2c(1-x)} \right] \quad [2.36]$$

me:

$\theta$  = variacioni i numrit te arritjeve per cikel/ numrin mesatar te arritjeve per cikel.




Figura 2.9 - Prirja e funksioneve te voneses te Webster-it

Shprehja e fundit limitohet ne formulen e Webster-it ne dy terma kur  $\theta$  supozon nje vlera te njesishme. Ne per gjithesi vlera e  $\theta$  mund te varioje nga 1 ne 1,5.

Nga nje krahasim midis vlerave te marra nga formulat e mesiperme, per kombinime te ndryshme te  $f$ ,  $g$ ,  $s$  vihet re qe per  $\theta=1$  shprehjet e ndryshme, ne per gjithesi, jepin nje vonese qe ndryshon nga jo e vleresuara me formulen e Webster-it te pote, per jo me shume se 10%, vetem nese koha e jeshiles efikase eshte nje nderprerje e madhe e ciklit. Per  $\theta>1$  formula e Hutchinson-it jep vlera me te medha nga ato te marra nga formula komplete e Webster-it, ne vecanti kur eshte ne prani te nje shkalle te larte saturimi; formula e Hutchinson-it mund te jape vlera te ndryshme nga te tjerat kur  $\theta$  eshte prane 1.




Figura 2.10 – Prirja e funksionit te Webster-it e transformuar

Perdorimi frekuent i formules me dy terma te Webster-it eshte justifikuar nga nje thjeshtesi e madhe algjebrike ne raport me shprehjet e tjera.

Ne kushte mbisaturimi mund te zgjerohet shprehja me dy terma e Webster-it duke zevendesuar ne termin e voneses stokastike, ate te voneses se mbisaturimit stokastik, (2.30), e dhene me pare:

$$d_1 = 0.9 \left[ \frac{(c(1-\gamma^2)/2(1-y)) + d_s}{y \leq \gamma} \right] \quad [2.37a]$$

$$d_2 = 0.9 \left[ \frac{(c(1-\gamma)/2) + d_s}{y > \gamma} \right] \quad [2.37b]$$

### 2.3.2. Vonesa per nje hyrje jo te izoluar

Ne rast te nje hyrje jo te izoluar, vonesa percaktuese influencohet nga ligji i arritjeve, ndersa vonesa stokastike nuk varet nga nje ligj i tille dhe llogaritet si ne rastin e nje hyrje te izoluar. Verehet qe, vonesa e perdoruesave per shkak te fenomeneve te mbisaturimit, te shkaktuara nga luhatjet stokastike te flukseve, ne lidhje me tendencat e arritjeve, eshte e perfshire ne vonesen stokastike  $d_s$ .

Persa i perket nje aksi rrugor, dmth per nje bashkesi kryqezimesh qe takohen gjate nje itinerari, praktika me e perhapur e kontrollit eshte vecanerisht e dobishme kur kryqezimet rrugore jane te afruar, gje e cila konsiston ne realizimin ne kohe fikse te nje vale jeshile. Kjo teknike koordinimi semaforike eshte e zbatuar nepermjet sfazimit te kalimit me jeshile ne semafore te ndryshem, ne menyre te tille qe nje mjet, ne nisje nga ekstremiteti i aksit rrugor ne nje cast qe bie ne nje interval te percaktuar kohor, mund te vazhdoje te njejten rruge, duke gjetur te gjithe semaforet jeshile, nese udheton me nje shpejtesi te paracaktuar koordinimi. Raporti midis nje intervali te tille kohor dhe koha e ciklit perben gjeresine e bandes jeshile. Nese kjo e fundit eshte mjaft e gjere, atehere te gjithe mjetet e grumbulluara ne semafor gjate qendrimit te tyre ne te kuqe, do te ndeshen me semaforet e tjere ne jeshile; ne qofte se gjeresia e bandes eshte e vogel ne raport me volumin e trafikut, disa mjete do te perballen me nje numer me te madh ndalesash dhe vonesash.

Me qellim qe nje teknike e tille koordinimi te jete e realizueshme, eshte e nevojshme qe dispozitivat semaforike te kene nje kohe te perbashket cikli T. Duke u nisur nga njojja e:

- zgjatja e zakonshme T e ciklit;
- pozicioni reciprok i kryqezimeve rrugore;
- zgjatja e se kuqes per secilin nga dispozitivat semaforike ne drejtimin e konsideruar;
- shpejtesia dhe norma e fluksit midis cifteve te semaforeve bashkengjitur;
- problemi kryesor eshte ai i realizimit te bandave sa me te gjera te mundshme;

Zgjidhja e nje problemi te tille, te thjeshte ne rastin e akseve me nje drejtim, sjell veshtiresi shtese ne rast te akseve me dy drejtime. Progreset e bere ne fushen e optimizimit dhe te informatizimit kane bere te mundur zevendesimin e llogaritjeve me dore te diagramave hapesire–kohe, me teknika me te avancuara dhe me te frutshme te llogaritjeve elektronike. Dy jane metodat me te perhapura. E para (Morgan dhe Little, 1964), bazohet ne nje teknike orientuese-kombinuese te optimizimit; e dyta (Little, 1964) eshte bazuar ne fakt mbi nje instrument te fuqishem dhe frytdhenes te programimit matematik.

## 2.4. Tendenza (prirja) e arritjeve ne kryqezimet e semaforizuara

### 2.4.1 Tendenca e arritjeve ne nje hyrje te izoluar

Tendenca (prirja) e arritjeve ne kohe, ose forma e grupit ne arritje, ne nje hyrje jo te izoluar, eshte ne perpjthesi jouniforme dhe varet nga tre fenomene te ndryshme qe konstatohen midis dy kryqezimeve te bashkengjitur.

- Shtremberim, ne kryqezimin e siperm
- Shperndarje, gjate nje dege rrugore
- Ndarje, ne kryqezimin luginor

*Shtremberimi* i nje grapi qe hyn ne nje dege rrugore eshte variacion i formes per shkak te pranise se nje rregullimi semaforik ne kryqezimin e siper te vete deges. Ne fakt fluksi ne dalje ne cdo moment, (lartesia e grupit) nuk mund te superoje fluksin e ngopjes **s** dhe koha e perdorur nga mjetet per te kaluar vijen e ndalimit nuk mund te kaloje zgjatjen e jeshiles efikase. Forma e grupit, qe hyn ne degen rrugore, eshte e percaktuar duke mbledhur grupet qe perdorin hyrje te ndryshme te kryqezimit te siper.

*Shperndarja* e grupit eshte variacion i formes qe ai peson gjate nje dege rrugore, per shkak te differencave ne sjelljen e drejtuesave dhe eficensen e mjeteve.

*Ndarja* e nje grapi eshte variacion i formes qe konstatohet kur grapi (plotoni) arrin ne linjen e ndalimit te kryqezimit luginor, dhe nendahet ne manovrat qe e perbejne. Keto tre fenomene te ndryshme mund te paraqiten me teorine e profileve ciklike te flukseve.




Figura 2.11 - Shembulli i shtremberimit dhe shperndarjes se nje grupimi

Profili ciklik i fluksit paraqet mbarevajtjen (prirjen) ne kohe te fluksit referuar nje seksioni rrugor dhe eshte e shprehur vetem me nje histograme. Disa karakteristika te nje profili ciklik mund te perdoren per marrjen e karakteristikave te trafikut. Ne menyre te vecante:

- Siperfaqja e profileve eshte proporcionale me fluksin mesatar gjate nje seksioni rrugor. Pervec kesaj duke dalluar kohet e jeshiles ne kryqezim, ne qofte se siperfaqja e vezhguar eshte mjaftueshmerisht e limituar, flukset e ktheses mund te vleresohen nepermjet vezhgimit te fluksit mesatar gjate nje pjesë te pershtatshme te ciklit.
- Variacioni i lartesise se profileve jep tregues mbi koordinimin e sinjaleve: ne vecanti profilet me piqe frekuente, qe i korrespondojnë grumbullimeve te trafikut, do te jene objekt i perfitimeve ne saje te koordinimit; ne raste te

tjera, ku trafiku gjate nje cikli mbetet pak a shume konstant, perfitimet e marra nga koordinimi do te jene patjeter te perfshira.

Sjellja e trafikut te nje dege jepet duke patur parasysh tre tipet e profileve ciklike te fluksit:

*Profili ne hyrje:* eshte fluksi (i vleresuar) i trafikut qe duke u nisur nga nje kryqezim i siper (i ngritur) arrin ne linjen me te afert te ndalimit ne lugine (zbritje), duke supozuar qe, fluksi te mos jete i penguar nga sinjalet ne vijen e ndalimit.

*Profile ne dalje:* eshte fluksi (i vleresuar) qe len nje dege.

*Profili i kalimit:* eshte fluksi (i vleresuar) qe do te kalonte nje vije (linje) ndalimi nese do te ishte shume fluks per tu saturuar ne periudhen jeshile.

*Perdredhja* eshte variacioni i formes qe peson grumbullimi i trafiku (plotoni) per shkak te pranise se semaforit ne kryqezimin e siper dhe per shkak te manovrave te ndryshme te lejuara. Forma e plotonit qe hyn ne nje degezim rruget (referuar fig. 2.11) varet nga forma e plotonit qe impenjojne hyrjet e ndryshme te kryqezimit malor.

Ne per gjithesi, supozohet si model i nisjeve nje ploton katerkendor me lartesi te barabarte me s, deri ne momentin ne te cilin rradha zhduket, pastaj forma e plotonit do te koincidoje me prirjen normale te arritjeve. (fig. 2.12)




Figura 2.12 - Modeli i perdredhjes

Ne qofte se supozohen arritje uniforme, plotoni i perdredhur (i deformuar) eshte nje tip me shkalle te vogla me lartesi te barabarte me fluksion e saturimit, ne te cilin rradha eliminohet ( $t_0$ ) ; nje model i tille eshte percaktuar si modeli Tadpole.

Shperndarja (fig. 2.11) eshte variacioni i formes se plotonit e shkaktuar nga nje sjellje e ndryshme e drejtuesave te mjeteve gjate degezimit. Afrimi i pare ne modelizimin e ketij fenomeni (modeli i perhapjes), supozonte qe, cdo mjet i plotonit te kishte nje shpejtesi konstante te shperndare normalisht.

Pastaj me tej Robertson ne vitin 1969 propozoi nje model te shperndarjes (modeli i perseritjes), qe ka avantazhin e te qenit llogaritur thjeshte dhe jep disa rezultate

shume afer realitetit. Nje model i tille i implementuar ne metoden TRANSYT, jep plotonin ne formen me diskrete (fig. 2.13) dhe shprehet me ekuacionin e meposhtem:

$$f_{i+k}^* = \pi f_i + (1 - \pi) f_{i+k-1}^* \quad i \in [1, \dots, n] \quad [2.38]$$

ku:

$f_i$  eshte fluksi ne hyrje ne harkun qe vjen nga kryqezimi malor ne intervalin i;  
 $f_i^*$  eshte fluksi ne arritje ne vijen e ndalimit te kryqezimit luginor ne intervalin i;  
 $k \approx 0.8 t$ , mat perkthimin kohor midis fillimit te profilit malor dhe fillimit te profilit luginor relativisht ne distancen per te cilen eshte llogaritur shperndarja.  
 $t$  eshte koha mesatare e udhetimit (e matur ne te njejtet intervale kohore te perdorur per  $f$  dhe  $f^*$ );  
 $\pi = 1/(1+\alpha t)$  eshte faktori i shperndarjes, me  $\alpha (0.2 \div 0.6)$  koeficient korrigjues




Figura 2.13 – Modeli i shperndarjes

Ndarja eshte variacion i formes, qe plotoni peson kur arrin ne vijen e ndalimit ne kryqezimin luginor (te tatepjete). Nje model realist per fenomenin ne fjale, do te kerkonte nje njohje te ngjarjeve te perdorura efektivisht nga origjina dhe destinacioni i zhvendosjes. Zakonisht merren ne konsiderate ne perqindje te ktheses nga secula hyrje e kryqezimit.

## 2.5. Metodat e optimizimit te rrjeteve

Ne kete paragraf pershkruhen disa metoda per rregullimin e kryqezimeve semaforike, duke perdorur elementet e pershkruar ne paragrafet e meparshem, persa i perket analizes se performances se nje kryqezimi.

Strategjite e bazuara ne njohjen e flukseve perdorin teknika programimi matematik ose kontrolli optimal per percaktimin e parametrave te rregullimit, duke filluar nga njohja e flukseve. Ne *strategjite me plane te paracaktuara* adoptohen skema rregullimi

te paracaktuara (off-line), duke filluar nga te dhena “historike” mbi kushtet e trafikut mbizoterues, si dhe duke diferencuar eventualisht skemen ne periudha te ndryshme te dites.

Ne strategjite e *vendosura nga flukset*, skema e rregullimit e adoptuar varet nga kushtet e trafikut korrent, te percaktuara me masa te pershtatshme ne linjen (on-line) te flukseve te perdoruesave.

Ne vecanti, nese zgjidhet nje plan rregullimi nga nje biblioteke me plane te percaktuara jashte linje, perdoret nje strategji me *zgjedhje plani*; nese, anasjelltas, plani i rregullimit eshte llogaritur ne linje, perdoret nje strategji tjeter e quajtur *perpunimi i planeve*.

Metodat e pershkruara kane ne per gjithesi kosto realizimi shume te ndryshme, ne fakt strategjite e zbatuara nga flukset kerkojne adoptim te nje sistemi zbulimi automatik te vete flukseve, vecanerisht te shtrire ne rastin e strategjive dhe perpunimit te planeve.

Jane kerkuar, pervec kesaj, sisteme llogarites te afte te veprojne ne kohe shume te kufizuara. Strategjite e zbatuara nga flukset lejojne, nga ana tjeter, nje pershtatje me te mire ndaj kushteve efektive te trafikut, edhe nese ne kushte te dallueshme konxhestioni (bllokim trafiku), mund te kene oshilacione te rregullimit, me nje shkalle degradimi komplekse te sistemit.

Strategjite e rregullimit semaforik te zbatuara nga mjetet levizese diferencojne dukshem, nga ato te pershkruara me pare, meqe percaktimi i parametrave te rregullimit rrjedh nga njohja e sakte e flukseve te arritjes (qofshin keto te percaktuara dinamikisht ose te llogaritura nga te dhena historike). Alternimi i sinaleve jeshile – e kuqe, ne hyrje te ndryshme te kryqezimit, eshte vleresuar direkt (on-line) nga arrija e sinjalizuar e mjeteve, tek kontrollori, nga spirale te ndryshme zbulimi.

Strategjite e rregullimit te zbatuara nga mjetet levizese rezultojne vecanerisht efikase per kryqezime te izoluara jo shume te ngarkuara; per vlera te larta te flukseve jepin nje rregullim te percaktuar nga vlera maksimale te zgjatjes se periudhes se jeshiles (e ngjashme me ate te nje strategje me plane te paracaktuar).

Eshte per tu shenuar qe nuk jane efikase ne rastin e kryqezimeve jo te izoluara. Ne baze te eksperimenteve jane perpiluar disa instruksione per zhvillimin e nje strategje efikase kerkese – oferte per kontrollin e trafikut.

- a) Strategjia duhet te jape rezultate me te mira se metodat off-line. Edhe pse kjo mund te duket jo shume evidente, jo gjithmone eshte e njohur ne zhvillimin e strategjive te zbatuara me pare, te zevendesuara, ne disa raste nga kriteri me pak percaktuese;
- b) Nevojitet zhvillimi i koncepteve te reja te kontrollit dhe eliminimi i atyre egzistuese. Nje kontroll i zbatuar nuk mund te arrihet duke implementuar me frekuence superiore te metodave off-line, por duhen metoda te reja me te pershtatshme per variabiliteten e trafikut. Per shembull, konceptet e koheve

jeshile, sfazimet dhe kohet e ciklit, mund te jene te pershtatshme per nje kontroll kerkese-oferte;

- c) Strategjia duhet te jete efektivisht kerkese-oferte, (do te thote adaptim ndaj kushteve korrente te trafikut dhe jo ndaj vlerave historike, ose te siperpermendurit qe mund te jene larg ndaj atyre korrente);
- d) Strategjia nuk mund te jete arbitrarisht e limituar ne periudhat e kontrollit te gjatesive te specifikuara, por duhet te kete aftesine e azhornimit ne menyre frekuente, nese eshte e nevojshme. Pervec kesaj, nuk duhet te jete e lidhur me nje strukture rigjide te modelit te rrjetit, por ne fakt e bazuar ne procese vendimesh te decentralizuara.

#### *2.5.1 Metodat e bazuara ne njohjen e flukseve*

Ne paragrafet e meposhtem do te sillen disa metoda te propozuara ne literature per rregullimin e kryqezimeve semaforike, qe mund te perdoren per implementimin e seciles strategji; te bazuara mbi njohjen e flukseve. Ne vecanti ne rast te nje kryqezimi te izoluar adoptohet zakonisht nje rregullim semaforik qe; me zvogelimin e kohes totale te pritjes (minimizimi i voneses **i**) ose, ne prani te nje ngarkese te dukshme, tenton te beje maksimal numrin e perdoruesave, qe mund te kapercejne kryqezimin me maksimumin e kapacitetit. Ne rastin e fundit, rregullimi i kryqezimit tek rezulton i pavarur nga influanca e kryqezimeve perreth.

#### *2.5.2 Rregullimi i nje kryqezimi tek ne rregjinin e nensaturimit*

Pershkruhen me poshte metodat qe supozojne perdorimin e matrices faze. Do te jepen disa modele, qe lejojne projektimin edhe te matrices faze per nje kryqezim te izoluar

Metoda Webster. Metoda e propozuar nga Webster synon arritjen e nje zgjatje te ciklit dhe koheve jeshile per nje kryqezim te thjeshte per te cilin dallohet matrica e fazes. Supozohet qe secila faze **i** te prezantohet nga nje fluks i vetem, ajo qe karakterizohet nga vlera me larte e fluksit  $y=f/s$  (nje rryme e tille merr jeshile vetem per fazen **i**). Do te jene per cdo faze **i**: **f<sub>i</sub>** sjellja, **s<sub>i</sub>** fluksi i ngopjes, **l<sub>i</sub>** koha e humbur, dhe **g<sub>i</sub>** jeshilje efikase.

Kohet e jeshiles efikase per secilen nga fazat jane te percaktuara ne hipotezen qe te gjitha fluksset prezente te kene te njejtin factor kapaciteti, i pranuar si faktor i kapacitetit te kryqezimit.

Metoda e *Webster-it* ka nje aplikim te thjeshte, por kerkon nje individualizim, jo gjithmone te mundur, te flukseve prezente dhe nderkohe, nuk lejon nderhyrjen e detyrimeve te jeshiles dhe te kuqes minimale. Keto hipoteza kufizuese jane superuar ne metodat SIGCAP dhe SIGSET te pershkruara me poshte.

### *2.5.3 Rregullimi i nje rrjeti kryqezimi ne rregjimin e nensaturimit*

Ketu pershkruhen dy metoda per rregullimin e nje rrjeti kryqezimi. E para aplikohet ne nje arterie te semaforizuar, ose ne nje varg kryqezimesh (mungesa e rratheve). Metoda e dyte, e tipit orientues, lejon sinkronizimin e nje rrjeti te per gjithshem.

*Metoda MAXBAND per koordinimin e arterieve te semaforizuara.* Metodat per koordinimin lejojne llogaritjen e koheve te cikleve, sfazimet, shpejtesine e progresimit dhe rregullin e fazave te kthesave majtas (ne te gjithe kryqezimet), qe maksimizojne gjerresine e bandave ne te dy drejtimet e levizjes, gjate nje arterie te semaforizuar.

*Metoda TRANSYT.* Optimizimi i parametrave te rregullimit te nje rrjeti kryqezimesh (zgjatja e ciklit, jeshilja, sfazimet), mund te zbatohet nepermjet metodave orientuese te nje efikasiteti te larte. Metoda TRANSYT (Traffic Network Study Tool) realizon llogaritjen e parametrave te meposhtem off-line, duke perdorur nje seri te dhenash historike. Per me shume, mund te simulohen rregjime te ndryshme te flukseve te trafikut per te prodhuar nje bashkesi programesh rregullimi per tu perdorur ne situata te ndryshme te trafikut. Ndryshime midis programeve mund te behen cdo dite, ose ne baze te matjeve on-line te kushteve te trafikut, p.sh. mbi fluksset, ose mbi gjatesite e rradheve, ne disa zona te percaktuara te rrjetit. Metoda TRANSYT eshte realizuar fillimisht nga Robertson ne vitin 1969 dhe, duke mbajtur te njejt qasje baze, ka disa revizione thelbesore, duke e bere keshtu nje instrument shume fleksibel ne dispozicion te inxhiniereve te trafikut.

Rezultatet finale jepin informacione mbi rrjetin, vonesen, numrin e ndalimeve, shpejtesine dhe konsumin e karburantit. Metoda bazohet mbi disa hipoteza qe lidhen me modelin e trafikut: te gjitha kryqezimet ne rrjet jane te kontrolluara nga sinjale ose nga rregulla prioriteti, te gjithe sinjalat veprojne me kohe cikli te perbashket ose me nje shumefishues, fluksset hyrese ne rrjet, fluksset midis kryqezimeve dhe fluksset e ktheses ne kryqezime jane te dalluar dhe konstante, ndalimet dhe nisjet e mjeteve jane momentale. Metoda TRANSYT eshte e karakterizuar nga dy pjese baze: modeli i trafikut dhe procedura e optimizimit te sinjaleve. Modeli i trafikut paraqet mekanizmat e funksionimit te i duke perdorur teorine e profileve ciklike te fluksit te pershkruara me pare.

Sjellja e trafikut ne nje dege paraqitet duke patur parasysh tre tipet e profilit ciklik te fluksit:

*Profili ne hyrje:* eshte fluksi (i vleresuar) i trafikut qe duke u nisur nga nje kryqezim te siper (me kurri ose i ngritur), arrin ne ne linjen me te afert te ndalimin ne zbritje, duke supozuar qe fluksi nuk eshte i penguar nga sinjale ne linjen e ndalimit.

*Profili ne dalje:* eshte fluksi (i vleresuar) qe len nje dege te kryqezimit

*Profili i kalimit:* eshte fluksi (i vleresuar) qe do te kalonte (kapercente) linjen e ndalimit, nese do te kishte shume fluks per te ngopur periudhen jeshile.

Gjate ciklev te metejshem, te quajtur profile do te variojne per shkak te sjelljes rastesore disa mjete teke. Dimensioni i pikeve eshte nje informacion i dobishem per optimizimin e koordinimit semaforik. Komponentet e voneses te konsideruar ne modelin e trafikut jane:

1. Vonesa uniforme ose percaktuese e nensaturimit te llogaritur nga profilet ciklike;
2. Vonesa percaktuese e mbisaturimit dhe vonesa stokastike, shuma e te ciles eshte llogaritur nepermjet nje shprehje, e cila merr parasysh kohezgjatjen e nje periudhe te mundshme te mbisaturimit.

Duke ju afuar saturimit vlerat e voneses jo uniforme rriten dhe behen te ndjeshme ndaj ndryshimeve te vogla te kerkeses.

*Metoda e optimizimit te sinjaleve* kerkon nje konfigurim optimal te parametrave te rregullimit qe minimizon nje tregues eficence PI. Nje tregues i tille eshte nje mase cilesie e rrjedhjes ne kryqezim dhe eshte i percaktuar nga shuma e voneses totale dhe numrit te ndalimeve, te matura ne menyre oportune.

Bashkesia e mire e sinjaleve eshte arritur nepermjet nje procedure orientuese te ngjitjes (e quajtur hill-climbing), duke u nisur nga nje konfigurim fillestar, e llogaritur p.sh. me metoden Webster per secilin kryqezim. Procedura me komplekse TRANSYT jep:

- Informacione per guiden e zgjedhjes te kohes se ciklit
- Vleresime te metodes te trafikut mbi rregullimin e sinjaleve

Cdo vleresim i modelit te trafikut jep per secilin hark: shkallen e saturimit, kohen mesatare te udhetimit, taksen e voneses mesatare, taksen e voneses uniforme, taksen e voneses aktuale dhe mbisaturimit, numrin mesatar te ndalesave per mjet, koston e ndalimit, rradhen maksimale, treguesin e eficencës, kohet jeshile dhe kohet e nderrimit te fazave, si dhe nje bashkesi informacioni mbi rrjetin, qe perfshin totalin e distancave te pershkruara, kohen totale te harxhuar ne rrjet, shpejtesine mesatare te udhetimit dhe te dhena mbi konsumin e karburantit.

Ne metoden TRANSYT eshte e mundshme, qe zgjatja e ciklit te ndonje kryqezimi te jete sa gjysma e asaj te zakonshmes, per te gjithe te tjerat (cikel dopio). Pervec kesaj, eshte prezant nje model kontrolli, nepermjet rregulles se perparese, qe lejon modelimin e kryqezimeve me te drejten e perparese dhe flukse me kthim majtas te penguara. Eshte i parashikuar gjithashtu nje opzion qe lejon specifikimin e nje gjatesie te rradhes maksimale ne deget e seleksionuara, me qellimin e zvogelimit te mundesise se rradheve te teperta, qe pengojne rrjedhjen ne kryqezimin malor. Rezulatet (output-et) japin:

- Kostot monetare te voneses se ndalimeve, te bazuara mbi vlerat e seleksionuara per termat e treguesit te eficenses.
- Vleresimin e konsumit te karburantit ne te cilin perfshihen: konsumi ne lidhje me nje shpejtesi kalimi konstante midis dy linjave te njepasnjesme te ndalimit, konsumin per shkak te voneses, konsumin per shkak te nxitimit mbas ndalimit, deri ne arritjen e shpejtesise se kalimit.

## 2.6 Metodat e optimizimit semaforik

Metoda SCOOT (Splits-Cycle-Offset-Optimisation-Tecnic) eshte nje tekniqe ne linje optimizimi te parametrave te rregullimit semaforik te trafikut, e zhvilluar, qe lejon aplikimin e principeve te metodes TRANSYT ne profilet ciklike te treguar. SCOOT ka nje bashkesi kohesh semaforike qe, nese nuk ndryshojne gjate procesit te optimizimit, do te perbenin ne fakt nje plan fiks semaforik.

Nepermejt ndryshimeve te vogla frekuente, SCOOT kontrollon sinjalizimin semaforik ne brendesi te planit qe zhvillohet ne kohe. Ndryshimet jane te tre tipeve; variacione ne kohet jeshile, ne sfazimet dhe ne zgjatjen e ciklit. Tipi i pare ndryshon kohen jeshile ne gjendjen e nje cikli, me qellim zvogelimin e gjendjeve te saturimit ne afimet. Ndryshimi vleresohet per cdo cikel dhe eshte i perkohshem, duke cuar ne nje ndryshim te vogel te qendrueshem ne kohet jeshile. Nje variacion mbi sfazimet zbatohet per rregullimin e koheve te lidhura me fillimin e fazes midis kryqezimeve afer njeri tjetrit, ne qofte se kjo sjell nje permiresim ne kushtet e rrjedhjes midis kryqezimeve. Ndryshimet ne sfazimet vleresohen per cdo cikel – SCOOT punon me te njejten zgjatje cikli ne kryqezimet sub-urbane: ndryshimi ne kohen e ciklit percakton rritjen ose zvogelimin e kohes se ciklit per nje zone sub-urbane. Koha e ciklit ndryshon, me qellimin qe shkalla me e larte e saturimit te nje kryqezimi te jetë 90%.

Karakteristikat me te rendesishme te versionit te fundit te SCOOT jane mundesite e menaxhimit te situatave te ngarkuara, qe lejojne percaktimin e strategjise ne kushte ekstreme – SCOOT perdor dy strategji kryesore: *gatting* ose futjen e barrierave dhe *congestion weighting*, ose detyrat e peshes ne zonat e ngarkuara.

Te dyja shkaktohen nga nje lak induksioni, ne menyre te tille qe, nje okupim i qendrueshem te thote ngarkese. *Gatting* do te thote shtim trafiku ne zonat e ndjeshme, duke shtuar kohet jeshile per trafikun qe le kete zone dhe duke zvogeluar ne fakt kohet jeshile per trafikun qe tenton te hyje. Keto variacione ndodhin ne per gjithesi ne kryqezime ne nje distance te caktuar nga lidhja e interesuar.

Me rritjen e ngarkeses se zones, *gatting* shkaktohet automatikisht, duke penguar shpejtesine e trafikut hyres dhe duke lejuar nje shpejtesi me te madhe per trafikun e ngarkuar.

*Congestion weighting* shkarkon ne nje funksion te ngjashem, duke i dhene me shume rendesi degeve shume te ngarkuara dhe duke rritur ne menyre te tille kohet e tyre jeshile ne ngarkim te disa degeve jo te ngarkuara.

### *2.6.1 Metoda me strukture fazash te paracaktuara*

Arrija e nje mjeti ne nje hyrje me sinjal jeshil, percakton rritjen e kohezgjatjes te periudhes jeshile, deri ne arritjen e nje vlere maksimale. Ne rritje e tille mund te jetë zbritese me numrin e mjeteve te kaluara, me qellim evitimin e rradheve te teperta ne hyrjet me sinjal te kuq. Nese egziston nje hierarki midis hyrjeve te kryqezimit, eshte e mundshme te imponohet qe, nje jeshile ne nje hyrje kryesore te behet e kuqe, vetem kur ka mjetet te pranishme ne pritje te hyrjeve sekondare me sinjal te kuq. Per te evituar qe, rradhet ne hyrjet me sinjal te kuq, ti interesojne me shume kryqezimeve te aferta, eshte e mundur te krijohen disa spirale zbulimi, qe sinjalizojnë arritjen e rradhes maksimale te arritjes ne nje hyrje me sinjal te kuq, duke percaktuar ne kete menyre nje variacion te sinjaleve.

Kontrollori Volum-Densitet. Kontrollori volum-densitet realizon nje forme te zbatuar kontrolli, ne te cilen koha e jeshiles fillestare dhe shtrirja e intervalit variojne ne funksion te kushteve te trafikut dhe kohes. Standartet NEMA njohin tre tipe variacionesh te intervalit fillestar.

1. Jeshile e arritur fillestare, ne te cilen ka nje vlere te percaktuar te intervalit fillestar te jeshiles.
2. Jeshile fillestare e llogaritur, ne te cilen vlera minimale dhe maksimale e intervalit fillestar, jane vendosur ne kontrollor se bashku me numrin e kerkesave te zbatuara per arritjen e nje maksimumi fillestar.
3. Jeshile fillestare e shtrire, ne te cilen nje vlere minimale dhe maksimale e intervalit fillestar jane percaktuar ne kohen fillestare te arritur per zbatim.

Te tre tipet e variacionit te intervalit fillestar, jane konceptuar per arritjen e te njejtit objektiv: rregullimi i jeshiles fillestare per te garantuar qe rradha e pritjes te paraprije me pare se te mbaroje nje faze e dhene. Kontrolloret qe fabrikohen aktualisht, ofrojnë vetem nje forme unike te variacionit te intervalit fillestar.

Vlera fillestare e shtrirjes eshte e dhene nepermjet kohes se kalimit te vendosur ne kontrollor, ndersa vlera finale e shtrirjes eshte e percaktuar nga shtrirja minimale. Norma me te cilen shtrirja mund te reduktohet percaktohet duke perdorur perafrimet e meposhtme:

Formulimi i nje kohe per te zvogeluar nje shtrirje minimale, ka:

$$\text{Norma} = (\text{Koha e tranzitit - Shtrirjen minimale}) / \text{Koha per zvogelim}$$

Zvogelimi/ Reduktimi i shtrirjes cdo sekonde. Ne nje rast te tille koha per zvogelim eshte e lidhur me “zvogelimin e hapesires cdo sekond (RGES)” nepermjet ekuacionit te meposhtem:

$$\text{Koha per reduktim} = (\text{Koha e tranzitit} - \text{Shtrirjen minimale}) / \text{RGES}$$

Kontrolloret e bazuar ne zbuluesit Long–Loop. Zbulimi i pranise se Long-Loop behet duke sjelle nje thirrje per mjetet, te barabarte me kohen gjate te ciles mjeti eshte mbi detector. Zbuluesi (detektori) Long–Loop eshte per gjithesish i perdorur me kontrolloret plotesisht te vendosur, ne nje procedure e percaktuar si kontroll i okupimit te korsise ose kontroll i okupimit te ciklit (LOC).

Operacioni LOC nderhyn kur kontrollori eshte programuar per intervale te jeshiles fillestar te barabarta me zero.

Shtrirjet jane te marra zero, ose me nje vlore shume te vogel. Ne per gjithesi, nuk eshte i nevojshem nje interval fillestar ndryshe nga zero, ose te pakten nje kohe minimale e jeshiles, meqe Long–Loop rregjistrojne ne menyre te vazhdueshme pranine e mjeteve qe jane ne pritje, duke e nxitur kontrollorin ne nje zgjatje te jeshiles, derisa e tere rradha nuk ka mbaruar.

Rezultati eshte nje veprim sinjalesh qe i per gjigjet me shpejtesi ndryshimeve te fluksit te trafikut.

Kontrolloret MOVA. MOVA (Microprocessor Optimised Vehicle Actuation) eshte nje sistem kontrolli i zhvilluar kryesisht per kryqezimet e izoluara. Nje sistem i tille karakterizohet nga dy spirale per secilen korsi; ne hapesiren urbane keto spirale jane te vendosura respektivisht ne 40 m dhe 100 m nga vija e ndalimit.

Fillimisht cdo korsi merr nje zgjatje te jeshiles eficiente, per te vene ne dispozicion mjetet ne rradhe nga vija e ndalimit dhe spirale se pare (ne 40 m). Me tutje analizon intervalet e kalimeve te mjeteve per te percaktuar kur rradha eshte pozicionuar dhe norma e nisjeve ulet nen fluksin e saturimit.

Ne kete moment, nepermjet nje procesi optimizimi vleresohen leverdite e shtrirjes se gjatesise se jeshiles me jo leverdite e mjeteve te ndaluara nga sinjali i kuq.

Nje veprim i tille lejon arrijen aktualisht te nje hapesire te perkoheshme ne brendesi te te ciles, shtrirja e zgjatjes se jeshiles duhet te jete ne kushte hyrje te saturuar dhe jo te saturuar.

### **2.6.2 Optimizimi nepermjet programimit**

Programimi dinamik (DP) eshte nje teknike matematike e perdorur per optimizimin e proceseve te vendimeve ne shume nivele: vendimet (vlerat e kontrollit), qe prekin procesin optimizohen ne menyre simultane.

Kjo realizohet duke ndare problemin e origjines ne nenprobleme (gjendje) te tjera me te vogla, lehtesisht te trajtueshme nga kendveshtrimi kompjuterik.

DP eshte nje procedure sistematike per percaktimin e kombinimit te vendimeve, qe maksimizojne efikasitetin total, ose minimizojne mungesen totale te leverdishmerise; kjo bazohet ne principin e Bellman, viti 1957: “Nje politike optimale ka vetine qe, cilido qofte vendimi dhe gjendja fillestare, vendimet mbetese duhet te perbejne nje politike optimal, ne lidhje me gjendjen resultante nga vendimi i pare.” Duhet vleresuar nje kryqezim, fazat semaforike te te cilit, konsistojne vetem ne jeshilen dhe te kuqen efikase. Supozohet qe te gjitha arritjet ne dege te ndryshme te kryqezimit, te jene te dukshme per nje interval kohor te caktuar. Procesi i optimizimit eshte i shperbere ne N gjendje, ku cdonjeri prej tyre shpreh nje interval kohor prej 5 sekondash.

Funksioni i optimizimit eshte dhene nga ekuacioni i meposhtem:

$$f_j^* = \min_{x_j} \{R_j(i_j, a_j, x_j) + f_{j+1}^*(i_{j+1}, a_{j+1})\} \quad [2.39]$$

Kthimi ne gjendjen  $j$  eshte vonesa per shkak te rradheve ne ate gjendje dhe matet ne njesi mjeti/intervali.

Rezultati i optimizimit eshte nje politike kompjuterike, qe minimizon vonesen totale ne te gjithe periudhen e horizontit fillesttar per nje gjendje fillestare te dhene i. Kjo politike identifikon sekuencen e vendimeve ne te gjitha gjendjet (stadet) e procesit te optimizimit.

*Implementimi dhe rezultati.* Metoda OPAC eshte provuar intensivisht duke perdorur modelin e simulimit NETSIM dhe ka treguar permiresime te dukshme ne report me metodat e tjera. Vonesat mesatare jane reduktuar ne 30-50% ne report me rregullimin fiks dhe 5-15% ne report me rregulimin e zbatuar.

Eshte per tu theksuar qe, perfitimet me te medha vihen re ne kushte te nje fluksi te larte, kur kryqezimi eshte shume i ndjeshem ndaj kontrollit. Metoda OPAC, e pare per nje kryqezim te vetem, eshte e pershtatshme edhe per aplikimin ne rrjete. Ne nje rast te tille, eshte e nevojshme nje analize lokale kapaciteti ne cdo kryqezim, sikurse edhe nje komunikim midis kontolloreve aferndenjes.

Rezultati do te ishte nje sistem kerkese – oferte i koordinuar ne nje menyre fleksibel dhe te decentralizuar.

*Sistemi UTOPIA.* Prioriteti ne kontrollin e nje sistemi te trafikut urban eshte me siguri ai i evitimit te situatave me shume ngarkese, duke favorizuar nderkohe transportet publike ne kryqezime. Nje sistem kontrolli, qe te realizoje keto objektiva dhe te jete i fuqishem dhe eficient, duhet te kete nje perfarim me cikel variable dhe qe, sipas njesise se trafikut, te mund te optimizoje rrjedhjen e mjeteve.

Me kete qellim, problemi kryesor ndahet ne nenprobleme, per tu zgjidhur me strategji retroaksiuni, ne brendesi te nje skeme te pergjithshme te tipit “trafile-responsive”

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrerhrotullimeve”**

---

Ne nje detajim me te madh, supozohet qe te perdoren specifikimet e meposhtme per kontrollin:

- a) Prioritet absolut mjeteve publike ne kryqezime (me perjashtim te rasteve kur ka konflikt midis tyre);
- b) Permiresime te dukshme per levizshmerine private ne te gjitha kushtet e trafikut, duke perfshire edhe kushtet e ngarkeses se pjesshme te rrjetit, ose te ndryshimeve te papritura te kapacitetit (p.sh. per shkak aksidentesh)

Te dy kërkesat imponojne nje zgjidhje me retroaksiون. Nje perafrim i tille kerkon, sipas rradhes, qe stabiliteti i rrjetit te analizohet se bashku me pranueshmerine dhe fuqishmerine e sistemit te kontrollit. Nje perafrim global i problemit eshte:

- a) Gjetja e nje dekompozimi te problemit te kontrollit, ne menyre te decentralizuar hierarkike.
- b) Percaktimi funksional per rezultanten e te gjithe problemeve, se bashku me rregullat e nderveprimit.
- c) Percaktimi i algoritmeve dhe metodave per zgjidhjen e te gjithe problemeve permblodhes.

Rregulla e dekompozimit eshte ajo topologjike (rrjeti eshte i perbere nga nje seri kryqezimesh), pra problemi reduktohet ne gjetjen e nje menyre te forte kontrolli ne retroaksiون per kryqezimet, me rregulla themelore per nderveprimin nepermjet kryqezimeve. Per garantimin e stabilitetit ne nivel rrjeti, nevojiten edhe nderveprime ne nje nivel me te larte. Mbi kete perafrim te pergjithshem, te pershkruar me poshte, bazohet sistemi UTOPIA, i realizuar dhe implementuar ne zona urbane europiane.

Supozohet qe kohet e arrijes ne kryqezimet e mjeteve jane te dhena, p.sh. nga nje sistem monitorimi i mjeteve, qe jep periodikisht azhornime te arrijeve te parashikuara.

Konceptet baze te sistemit. Problemi kompleks eshte i dekompozuar ne nje seri problemesh me te vogla, qe i perkasin dy klasave kryesore; niveli i kryqezimit dhe niveli i zones.

- a) *Niveli i kryqezimit*

Ne kete nivel adoptohet ne cdo kryqezim nje kontroll lokal, i nendare me tutje ne “observator” dhe ne “kontrollor”.

Observatori ka per detyre te azhornoje vleresimin e gjendjes se kryqezimit, duke perdonur te dhenat e trafikut. Ai bazohet ne nje model mikroskopik: elementet e gjendjes jane grupe mjetesh te cdo dege dhe diskretizimi kohor perbehet nga interval prej 3 sekondash.

Vektori i gjendjes se te gjithe kryqezimit eshte nje bashkesi e vektoreve te gjendjeve si perfaquesues te degeve teke. Keto te fundit jane formuar nga mjetet ne keto dege, te

rregulluara sipas momenteve te parashikuara te arritjeve dhe te grupuara ne interval prej 3 sekonda.

Pra, nje dege me gjatesi maksimale ne kohe, do te paraqitet me nje vektor prej 10 elementesh.

Dalja e kontrollorit eshte rregullimi i aplikueshem ne semaforet e kryqezimit. Cdo kontroll optimizon nje funksion disponibel, qe adaptohet ne gjendjen e trafikut te asaj zone.

Optimizimi vjen duke bere parashikime ne interval 120 sekonda: rregullimi i mire aplikohet per 6 sekonda dhe arrihet keshtu nje kontroll me cikel te mbyllur. Kjo mund te shihet si nje kontroll i tipit OLFO (Open Loop Feedback-Optimal), ose si nje aplikim i konceptit te horizontit variable.

Edhe pse optimizimi ne nivel kryqezimi nuk garanton persosmerine ose perfitime perdoruesave, ai jep dy karakteristika te rendesishme:

1. Adoptohet koncepti i “nderveprimit te forte”: ne brendesi te funksionales per tu optimizuar nderfuten disa terma, qe marrin parasysh gjendjen e kryqezimeve aferndenjes. Keshtu arrihet nje kapacet, me cikel te mbyllur, per ti hapur rruge koordinimit te rregullimit.
2. Kontrolloret ne kryqezime veprojne ne brendesi te nyjeve te vendosura nga niveli i zones, qe percakton edhe peshat ne brendesi te funksionales. Ne nje menyre te tille, niveli i zones mund te imponoje mbi rrjetet rruge “te preferuara”, dhe kriteret te varura nga trafiku ne nivel kryqezimi.

*b) Niveli i zones*

Objektivi ne nivelin e zones eshte te arrije nje fluks te rregullt trafiku ne cdo kondicion kerkese dhe ne te gjithe qytetin. Kjo arrihet duke zgjedhur funksionalet ne dispozicion te kontrolloreve te kryqezimit. Ne te njejten kohe, niveli i zones jep disa te dhena per vezhguesit lokale.

Qellimi i vezhguesit eshte parashikimi ne kohe reale i rrugeve me te rendesishme qe do te zgjidhen nga trafiku privat. Nivelet e fluksit ne keto rruge parashikohen nepermjet nje vezhguesi te bazuar ne nje model kohe diskret, me interval kohore prej 3 minutash. Rrjeti i rrugeve kryesore paraqitet nga nje seri “njesish ruajtje” te orientuara dhe te lidhura. Secila prej tyre mund te permboje me shume kryqezime reale. Ketij rrjeti i mbivendosen nje seri rrugesh per rregullimin e tyre: gjendjet e modelit perbehen nga numri i mjeteve ne cdo njesi ruajtje perkatese per cdo rruge. Kontrollori duhet te optimizoje funksionalen e rrjetit, duke vepruar mbi kontrollet fiktive, si shpejtesia mesatare dhe fluksi i saturimit ne cdo njesi. Detyrimet qe shprehin situaten aktuale jane te imponuara ne te dy kontrolllet.

Kontrolli eshte akoma i arritshem nepermjet metodes OLFO (ose e quajtur e horizontit variable). Rillogaritet, kur vezhguesi shpreh nje ndryshim ne kushtet e

trafikut. Ne fund daljet e kontollorit perdoren per percaktimin e informacionit dhe komandave per tu perdonur ne nivel kryqezimi.

Niveli i kontrollit te kryqezimit. Ne kryqezim perdoren disa detektore spirale te afte te bejne numerimin e mjeteve, te instaluar ne dalje te kryqezimit. Spiralet e daljes se nje kryqezimi jane te hyrjes per pasardhesin. Arrihet ne kete menyre kapaciteti i shkelqyer per parashikimin e arritjeve per cdo linje ndalimi.

Vezhguesi lokal. Dy grupet e variablate duhet te vleresohen ne kohe reale:

1. Nje grup parametra sh lethesisht te ndryshueshem si kohe udhetimesh (ne cdo dege), perqindje kthesash dhe flukse saturimi;
2. Gjendja e kryqezimit

Kerkohet nje vleresim korrekt i te dy grupeve per nje kontroll me cikel te mbyllur efikas dhe te plete.

Vleresimi i gjendjes zbatohet nga nje filtrim i Kalman i modifikuar me llogaritjet e trafikut.

Edhe vleresimi i parametrave behet nepermjet filtrimit dhe numerimit on-line te trafikut si dhe gjendjes se semaforeve.

Nje azhornim behet per cdo cikel dhe bazohet gjithmone ne diferencat midis numerimeve te parashikuara dhe atyre te realizuara.

Vezhguesi parashikon nje vleresim efikas te te gjitha variablate te kryqezimit: me qellim rritjen e forces dhe stabilitetit te vezhguesit, perdoren disa informacione te marra ne nivel zone, ne vecanti vlera referuese per perqindje kthese, kohe udhetimi dhe flukse saturimi.

Kontrollori lokal. Si percaktim, arrijet e parashikuara ne vijen e ndalimit percaktohen ne cdo moment per disa dhjetera sekonda, dhe nje horizont kohor shume i shkurter per te garantuar nje kontroll “te bute”, per shkak te lidhjeve mbi zgjatjen e fazave dhe prioriteten e mjeteve publike.

Pra, percaktohet nje horizont kohor me i gjate (120 sekonda), megjithate, meqe nuk ka nje parashikim korrekt te arrijteve per kohen ekstra, rregullimi semaforik behet duke ndjekur metoda te ndryshme ne brendesi te dy pjeseve logjike te horizontit kohor.

Behet nje seleksionim deduktiv i rregullimit semaforik ne periudhen ekstra (p.sh. nga 30 ne 120 sekonda), duke vleresuar nje funksion kostoje qe merr parasysh: mundesine jo te dhenies perparesti te mjeteve publike, devijimet e rregullimit te vendosur ne perafimet e meparshme, si dhe devijimet e rregullimit te references te dhene ne nivelin e zones. Rregullimi i arritur nuk do te implementohet, por do te perdoret ne vazhdim. Ne intervalin me cikel te mbyllur (30 sekondat e para) do te llogaritet nje rregullim optimal, duke optimizuar nje funksion shtese, qe ka si kosto kohet e humbura nga mjetet, ndalesat e mjeteve dhe gjatesite maksimale te rradheve.

Per deget e kryqezimit, te njejtat kosto vihen re ne kryqezimet prane nga mjetet, qe lejne kryqezimin korrent: koha e humbur nga nje mjet publik tek nje kryqezim dhe kostoja e modifikimit te kerkuar nga politika.

Ne kete kuader, vetem kostot relative per gjatesite maksimale te rradheve nuk jane lineare: kerkesa e zgjidhjes optimale behet nga nje algoritem branch and bound.

Peshat e elementeve jane zgjedhur nga niveli i zones, mbi bazen e kushteve te rrjetit. Ne menyre te tille niveli i zones permbush rolin e vet.

Eshte per tu shnuar qe, koordinimi on-line i rregullimit, arrihet automatikisht duke futur kostot relative ne kryqezimet prane. Ne fund arrihet nje rregullim optimal ne nivel mesatar (20-30 sekonda) dhe pasojat e tij vleresohen deri ne 120 sekonda. Nje rregullim i tille pershtatet per 6 sekonda dhe me pas llogaritet.

Problemet e mbisaturimit lokal. Nese saturimi eshte i parashikueshem, ai trajtohet nisur nga niveli i zones dhe efektet e saj minimizohen. Megjithate, mund te kete raste te saturimit ne nivel local, per shkak te ndryshimeve lokale te parashikuara ne kerkese, ose devijimeve te trafikut dhe aksidenteve. Kontrolli me cikel te myllur eshte ne gjendje te trajtoje keto raste ne dy menyra:

1. Duke i dhene vezhguesit detyren shtese te evidentimit te situatave kritike ne dege specifike;
2. Duke i dhene nje peshe numrit te mjeteve ne nisje drejt kryqezimeve prane, ne funksionalen e kontrollit-si pasoje ne disa raste mund te rezultoje e pershtatshme, mbajtja e mjeteve per nje periudhe te shkurter.

Keto dy karakteristika i hapin rruge dy veprimeve. E para konsiston ne minimizimin e saturimit, duke rritur kalimin. E dyta, nese e para nuk ka sukses, konsiston ne zvogelin e kerkeses. Te dy karakteristikat bazohen ne bashkepunimin ndermjet kryqezimeve afer njeri tjetrit dhe te dy veprimet drejtohen nga nje tregues saturimi, qe duhet vleresuar nga vezhguesi.

Niveli i kontrollit te zones. Qellimi i nivelit te kontrollit eshte i dyfishte: 1) arritjen e nje fuqie te caktuar ne cdo situate, duke percaktuar nje skeme referimi me afat mesatar per kontrollin e kryqezimit dhe 2) ofrimin e te dhenave referuese vezhguesave locale.

a) *Vezhguesi ne nivel zone*

Ka per detyre te vleresoje dhe parashikoje gjendjet e modelit makroskopik te percaktuar me pare. Me kete qellim, supozohet qe trafiku te jete i perbere nga nje seri komponentesh.

Para se gjithash, ka nje numer te kufizuar rrugesh, qe kane atributet e origjine-destinacionit. Merret parasysh ngashmeria ditore: numri i mjeteve ne arritje, castet e nisjes, rruget e mjeteve.

Vezhguesi eshte i perbere nga dy pjese: nje veprim mbi baze ditore dhe azhornon ne menyre te shkelqyer te dhenat e pershkruara per te gjithe elementet e trafikut, e dyta punon ne kohe reale dhe evidenton, ne baze te ngjarjeve, aktivizimin efektiv te nisjeve te parashikuara. Parashikimi behet duke aplikuar parametrat e filtruar te flukseve te matura.

Se dyti, ka nje numer te vogel te fenomeneve te trafikut te zones per tu marre ne konsiderate ne shperndarjen e trafikut dhe jane modeluar nga variacione te perkoheshme. Ne kete rast, vezhguesi vlereson parametrat e ligjit te varacionit kohor.

*b) Kontrollori ne nivel zone*

Rezultatet on-line te vezhguesit (kerkesa e trafikut koha-varianti, te pershkuara per percaktimi dhe madhesia e parashikuar e flukseve, jo te modeluar mbi te gjitha deget kryesore), lejojne formulimin e problemit te kontrollit te shkelqyer:

$$\min_c T_t = \min_c \int^{+T} N dt \quad [2.40]$$

ku:  $T_t$  eshte koha totale e udhetimit;

$C$  eshte fusha e zgjidhjeve te pranueshme te kontrollit te zones;

$t$  eshte casti korrent;

$N$  eshte numri i mjeteve ne rrjet;

Modeli thjeshtohet duke marre ne konsiderate nje seri njesish ruajtje me nje ligj te thjeshte perhapje. Variablat e kontrollit jepen me nje seri ciftesh  $\alpha$  dhe  $\beta$  per cdo relacion hyrje –dalje te njesive te tilla.

Shpejtësia mesatare dhe kapaciteti percaktues per rregullimin e trafikut jepen respektivisht nga  $\alpha$  dhe  $\beta$ . Bashkesia e  $\alpha$  dhe  $\beta$  per te njeften njesi eshte e kufizuar nga lidhje te realizueshme. Problemi eshte nje problem kompleks kontrolli determinues per nje sistem te madh dinamik. Zgjidhet me nje metode kohe-diskrete, me hap 3 minutash. Kontrollori i zones llogarit te gjithe parametrat e nevojshem per kontrolloret lokale, duke filluar nga vlerat e  $\alpha$  dhe  $\beta$  per cdo njesi. Pertej funksionit te vezhguesit dhe kontrollorit, niveli i zones kryen te gjithe funksionet operative te sistemit: te mbledhura nga te dhenat e niveleve lokale te afert dhe midis dy niveleve te kontrollit. Keto lidhje realizohen nga nje rrjet lidhjesh fizike midis kontrolloreve te afert dhe me disa lidhje me nivelin e zones.

Keto lidhje shfrytezojne linja te tipit telefonik dhe nje protokoll software parashikon nje adresim ekzakt te mesazheve ne te gjithe rrjetin.

## **KAPITULLI 3**

### **KRYQEZIME PA SINJALISTIKE (JO SEMAFORIKE)**

#### **3.1 Hyrje**

Përcaktimi i ecurisë së elementeve të një rrjeti të transportit është pjesë thelbësore e procesit të planifikimit, kontrollit dhe menaxhimit të sistemit. Në veçanti, me termin kryqezime pa sinjalistike, josemaforike, nenkuptohen të gjitha ato nyje te një rrjeti rrugor, ku fluksi i automjeteve është i rregulluar me sinjalistike te tipit konvencional (shenja e ndalimit ose dhenies perparesi).

Studimi dhe analiza e këtij konfigurimi tipologjik rezultojne thellesisht te domosdoshem, duke patur parasysh përdorimin e gjerë të këtyre kryqëzimeve, ne veçanti në zonat urbane, veçanërisht kur volumet e trafikut janë shumë të ndryshme në të dy drejtimet dhe kur një nga dy drejtimet (kryesore) eshte e një rëndësie hierarkike superiore ne raport me tjetren (dytesore).

Më poshtë janë renditur elementet bazë për të përcaktuar kapacitetin, kohen e vonesës, gjatësine e vargut dhe procedurën për llogaritjen se nivelit të shërbimit për kryqezimet pa sinjalistike, siç përcaktohet në kapacitetin manual të përdorur në SHBA (kapacitet HCM Highway Manual 2000 - Bordi i Kerkimeve të Transportit).

#### **3.2 Klasifikimi tipologjik i kryqezimeve pa sinjalistike**

Kryqezimet pa sinjalistike janë klasifikuar ne konfigurimet tipologjike te me poshtme:

- Kryqezimet T;
- Kryqëzimet me katër degë.

Kryqëzimet T janë kryqëzime të thjeshta tre degeshe, dy prej të cilave percaktojnë drejtimin kryesor, dega e tretë perfaqeson rrugen dytesore, që hyn në kryesoren me një manovrim të rregulluar nga një shenjë e ndalimit, ose dhenies perparesi. Kryqëzimet me katër degë janë karakterizuar nga prania e katër degeve për të përcaktuar këto dy drejtime (teorikisht pingule), ose rruga kryesore dhe dytesore, te cilat duhet të rregullohen me shenjat e ndalimit ose dhenies perparesi. Shumëlojshmëria e zgjidhjeve të projektimit ka çuar në një seri të konsiderueshme rastesish tipologjike, të cilat nuk hyjne direkt në klasifikimin e sa po percaktuar, megjithate duhet theksuar se çdo zgjidhje e projektimit, që ndryshon nga skema T, ose nga katër degë, mund t'i atribuohet siç duhet njëres nga këto, ose kombinimeve të tyre, si dhe të jene studjuar dhe analizuar, duke përdorur procedurat e përshkruara më poshtë.

Në figuren 3.1 dhe 3.2 jane pasqyruar dy vodosje tipike planimetrie te kryqezimeve me tre dhe katër degë.




Figura 3.1 dhe 3.2 Kryqezime ne forme T dhe me 4 dege

### 3.3 Analiza e te dheneve

Me percaktimin e konfigurimit tipologjik te kryqezimit, duhet te vazhdohet me tej me analizën per karakteristikat e mëposhtme:

- Analiza e karakteristikave gjeometrike
- Analiza e volumeve te trafikut
- Analiza e llojeve të automjeteve në tranzit (përqindja e automjeteve të rënda)
- Analiza e flukseve të këmbësorëve
- Analiza e kushteve kufitare (prania e kryqëzimeve të tjera në rrjedhën e sipërme). Përshkrimi i hollësishëm i gjeometrise se kryqezimit duhet të përfshijë një numer te caktuar të korsive, karakteristikat dimensionale te tyre, gradientet gjatësore dhe

përdorimin specifik të tyre, në funksion të manovrave qe u interesojne degëve te kryqëzimit (kalimit, kthesa nga ana e djathtë, kthesa nga ana e majtë). Duhet te demonstrohet, nese jane te ndara ose te bashkendara për çdo manovrim, nese takohen (ne koke) ne kryqezim, duke u zgjeruar mbas takimit, ose jo.

Analiza dhe sasitë e vëllimit të trafikut duhet të bëhen për të gjitha lëvizjet ( $v_x$ ), që lidhen ne kryqezim, duke përfshirë kembesoret; rrjedhat e trafikut janë matur për periudha prej një orë (mjete/ore), ose per nenperiudha, përgjithësisht 15 minuteshe.

### 3.4 Metodologja e llogaritjes

HCM 2000 (Highway Kapaciteti Manual), klasifikon levizjet e mundshme, që mund të bëhen në një kryqezim te sheshte, pa sinjalistike, ose josemaforik, në 4 kategoritë e mëposhtme:

- Levizje kthese majtas nga rruga kryesore (me e madhe LT)
- Levizje kthese djathtas nga rruga dytesore (më të ulët RT)
- Levizje kaluese te pjeses kryesore të atyre që vijnë nga dytesori (TH më të ulët)
- Levizje kthese majtas nga dytesori (LT më të ulët).

Secila nga këto drejtime te trafikut eshte karakterizuar nga veçoritë specifike, të cilat varen nga rregullat e rrugës dhe veçanërisht nga metoda e sinjalistikes, që rregullon përparësite. Në këtë kuader, manovra të tilla janë kategorizuar në katër prioritete përparësie 1,2,3,4; kjo do të thotë se një makinë, fluksi i te ciles eshte i rradhës 1, do te kryeje kete manovër para çdo mjeti tjetër. Të katër renditjet do të shfaqen më tutje, përkatësisht, me prapashtesat i, j k, l.

Hierarkia e flukseve te trafikut (Figura 3.3, H.CM. eksposite 17-3);




Figura 3.3 - Hierarkia e rrymave te trafikut

#### 3.4.1 Vëllimi kritik $V_{c,x}$

Ne kryqezimet e sheshta pa sinjalistike, një manovrim i veçantë "x" eshte i drejtpërdrejtë dhe ndryshueshmerisht i ndikuar nga flukset e trafikut, qe se bashku pengojne kryqezimin.

Konstatohet qe, cdo tip manovre mund te paraqese nje numer te mundshem skenaresh shqetesimi per cdo levizje objekti, të cilat sjellin metoda të ndryshme analizash në ecurinë e vete lëvizjes.

Madhesia e perdorur për vlerësimin e madhësisë së këtij konflikti eshte ajo e vëllimit kritik  $V_{c,x}$ , ose është numri maksimal i automjeteve, që çregullojnë një manovrim të veçantë "x".  $V_{c,x}$  shprehur në automjete per ore (mjete/ore) varet nga hierarkia që konkuron një manovrimin e veçante (renditja 1,2,3,4).

Supozojme se duam të analizojmë funksionimin e kthimit nga e djathta nga një rruge dytesore (Figura 3.4) dhe llogaritjen e volumit kritik qe është ( $V_{c,9}$ ).
















Figura 3.4 - Volumi kritik i ktheses djathtas nga sekondarja  $V_{c,9}$

Ky fluks automjetesh hyn ne konflikt me fluksin kryesor (fluksi 2 dhe 3) dhe me ate këmbësorëve (fluksi 14 dhe 15).  $V_{c,9}$  eshte dhene nga shuma e fluksit në kryesore  $V_2$  (pjesëtar me numrin N te korsive që bënë manovra 2) plus gjysmen e fluksit qe kthehet ne te djathte ( $V_3$ ) në dytesoren, plus fluksin e këmbësorëve që objekti ne lëvizje ndërpert ( $V_{14}$  dhe  $V_{15}$ ). Në figurën 3.5 tregohen të gjitha skenarët e mundshëm të konflikteve dhe relacionet për të llogaritur vëllimin kritik. Kollona e parë tregon raste të thjeshta, ku manovra është kryer në një fazë, kolona e dytë gjithashtu konsideron rastin kur manovra është kryer në dy faza te mevonshme, në praninë e një hapesire qendrore ndalimi (Faza I - Faza II).

**Tema e Doktoraturës:**  
**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Levizja e subjektit	Subjekti dhe levizjet konfliktuale Rrymat e konfliktuarë te trafikut $v_{c,x}$	
E Madhja LT (1,4)	 $v_{c,1} = v_5 + v_6^{[a]} + v_{16}$	 $v_{c,4} = v_2 + v_3^{[a]} + v_{15}$
E vogla RT (9,12)	 $v_{c,9} = \frac{v_2^{[b]}}{N} + 0.5v_3^{[c]} + v_{14} + v_{15}$	 $v_{c,12} = \frac{v_5^{[b]}}{N} + 0.5v_6^{[c]} + v_{13} + v_{16}$
E vogla TH (8,11)	<p>Niveli 1</p>  $v_{c,I,8} = 2v_1 + v_2 + 0.5v_3^{[c]} + v_{15}$	 $v_{c,I,11} = 2v_4 + v_5 + 0.5v_6^{[c]} + v_{16}$
	<p>Niveli 2</p>  $v_{c,II,8} = 2v_4 + v_5 + v_6^{[a]} + v_{16}$	 $v_{c,II,11} = 2v_1 + v_2 + v_3^{[a]} + v_{15}$
E vogla LT (7,12)	<p>Niveli 1</p>  $v_{c,I,7} = 2v_1 + v_2 + 0.5v_3^{[c]} + v_{15}$	 $v_{c,I,10} = 2v_4 + v_5 + 0.5v_6^{[c]} + v_{16}$
	<p>Niveli 2</p>  $v_{c,II,7} = 2v_4 + \frac{v_5}{N} + 0.5v_6^{[d]} + 0.5v_{12}^{[e]} + 0.5v_{11} + v_{13}$	 $v_{c,II,10} = 2v_1 + \frac{v_2}{N} + 0.5v_3^{[d]} + 0.5v_9^{[e,f]} + 0.5v_8 + v_{14}$

*Figura 3.5 - Percaktimi i volumeve kritike  $V_{c,x}$*

### 3.4.2 Intervali kritik $t_c$ dhe koha e rreshtimit $t_f$

Ne fund te llogaritjeve te kapacitetit potencial te nje kryqezimi ne nje nivel josemaforik duhen percaktuar dy gjera shume thelbesore:

- Intervali kritik  $t_c$  (gapi kritik): distancimi minimal kohor, i vleresuar ne sekonda, midis dy automjeteve ne rrugen kryesore, i tille qe te lejoje futjen ideale te nje mjeti, qe vjen nga rruga dytesore.
- Koha e shkallezimit ne rresht  $t_f$ : distancimi kohor mesatar, i vleresuar ne sekonda, qe nderhyn nga nisja e automjetit qe vjen nga rruga dytesore dhe automjetit me pas tij, ne rastin ku dy automjetet kryejne manovren e futjes, duke shfrytezuar te njejtin interval hapesire kohe midis automjeteve te fluksit kryesor.

Per llogaritjen e  $t_c$  aplikohet formula e propozuar nga HCM 2000:

$$t_{c,x} = t_{c,baze} + t_{c,HV} P_{HV} + t_{c,G} G - t_{c,T} - t_{3,LT} \quad [3.1]$$

Ne te cilen:

- $t_{cx}$  = intervali kritik i manovres sekondare x (sek)
- $t_{c,baze}$  = intervali kritik baze i manovres sekondare x ,merret nga tab 3.1
- $t_{c,HV}$  = faktori korrigjues per automjetet e renda (merret 1 per rruget kryesore me dy korsi dhe 2 per ato me kater korsi) (sek)
- $P_{hv}$  = perqindja e automjeteve te renda te manovres sekondare
- $t_{c,G}$  = faktori korrigjues i pjerresise (merret 0.1 per manovren 9 dhe 12 dhe 0.2 per manovrat 7,8,10,11)(sek)
- $G$  = pendenca gjatesore
- $t_{c,T}$  = faktori korrigjues per secilen manover me dy faza (1.0 per fazen e pare ose te dyte; dhe zero nqs eshte vetem nje faza) (sek)
- $t_{3,LT}$  = faktori korrigjues per gjeometrine e kryqezimit (0.7 per manovrat e kthimit ne te majte, nga dytesorja per kryqezim T)

Tipi i manovres	Koha kritike baze $t_c, baze$ (sek)		$t_f, baze$ (sek)
	Rruga kryesore me 2 korsi	Rruga kryesore me 4 korsi	
Kthim majtas nga kryesorja	4.1	4.1	2.2
Kthim djathtas nga sekondarja	6.2	6.9	3.3
Kalim nga sekondarja	6.5	6.5	4
Kthim majtas nga sekondarja	7.1	7.5	3.5

Tabela 3.1

Koha shkallezimit ne rresht eshte dhene nga:

$$t_{f,x} = t_{f,baze} + t_{f,HV} P_{HV} \quad [3.2]$$

- $t_{f,x}$  = koha e shkallezimit ne rresht nga manovra dytesore x(sek)
- $t_{f,baze}$  = koha baze e shkallezimit ne rresht (sek) shiko tab 3.1
- $t_{f,HV}$  = faktori korigjues per automjetet e renda (0.9 per rruga kryesore me dy korsi dhe 1 per ato me 4 korsi)(sek)
- $P_{HV}$  = perqindja e automjeteve te renda ne manovrat dytesore

Intervali kritik dhe koha e shkallezimit ne rrjesht llogariten vec e vec per cdo tip levizje.

#### 3.4.3 Kapaciteti potencial $C_{p,x}$

Termi kapacitet potencial  $C_{p,x}$  do te thote kapacitet i nje levizje te dhene x, duke supozuar kushtet ideale te me poshtme :

- Fluksi i automjeteve qe u interesojne kryqezimeve fqinj nuk nderhyne ne kryqezimin e konsideruar.
- Rruga dytesore eshte parashikuar me korsi te ndara per cdo lloj manovre
- Nuk duhet te kete ne kryqezimet e rrjedhes se siperme kushte te tilla, qe te modifikojne shperndarjen e mjeteve ne rrugen kryesore (psh rrrethrrrotullime ose kryqezime semaforike me pak se 400 m)
- Nuk duhet te kete levizje te metejshme (qe i takojne nivelit 2, 3 ose 4), qe pengojne manovren e nje objekti

Ne figuren 3.6 paraqitet vlera e  $C_{p,x}$  ne funksion te volumit konfliktor  $v_{c,x}$  per cdo tip manovre.




Figura 3.6 - Kapacieti potencial

Sipas metodes llogaritese, qe bazohet ne teorine e intervalit kritik, kapaciteti potencial i manovres dytesore ne korsine e rezervuar jepet nga shprehja e meposhtme:

$$c_{p,x} = v_{c,x} \frac{e^{v_{c,x} t_{c,x} / 3600}}{1 - e^{-v_{c,x} t_{f,x} / 3600}} \quad [3.3]$$

ku:

- $c_{p,x}$  = kapaciteti potencial i manovres dytesore x (mjetë/ore)
- $v_{c,x}$  = volumi kritik i manovres dytesore x (mjetë/ore)
- $t_{c,x}$  = intervali kritik i manovres dytesore x (sek)
- $t_{f,x}$  = koha e shkallezimit ne radhe e manovres dytesore x (sek)

#### *3.4.4 Kapaciteti efektiv $C_{m,x}$*

Kapaciteti potencial  $C_{p,x}$  i referohet kushteve ideale, qe ndonjehere rezultojne te veshtira per tu takuar, duhet pra qe, ti referohemi karakteristikave reale te cdo kryqezimi specifik, per te llogaritur kapacitetin efektiv  $C_{m,x}$ . Si vazhdim do te thellohen ceshtjet me domethenese, ne te cilën kjo behet e domosdoshme.

*Kufizimet e manovrave qe u kushtohen makinave.* Te gjitha levizjet jane rregulluar nga një mekanizem prioritar manovrimi (rank 1,2,3,4), te bazuara ne te drejtë e perparese; megjithatë mund te verifikohen raste, ne te cilat një levizje me perparesi inferiore, jo vetem qe pengohet, por edhe mund te ndalohet nga ajo me perparesi superiore; ky eshte rasti tipik ne te cilën kryqezimi eshte i kushtezuar dhe paraqiten fenomene te rastit te tillë si formimi i rradheve.

Presupozohet qe flukset e trafikut te rankut i nuk Jane te penguar nga asnjë manover tjeter, si rrjedhim nuk do te kete as vonesa dhe as ngadalesime. Flukset e rankut 2 Jane te varur, vetem nga ai i rank 1 (qe nuk formojne rradhe); pra kapaciteti efektiv i cdo manovrimi te ketij niveli eshte i njëjtë me kapacitetin potencial (j tregon levizjet e rank 2):

$$C_{m,j} = C_{p,j} \quad [3.4]$$

Flukset e rankut 3 mund te hyjne ne fakt ne konflikt me manoven e ktheses ne te majte nga rruga kryesore, ne fakt nje interval kohe, qe ne kushte normale do te ishte i mjaftueshem per te kryer manoven e rankut 3, mund te ishte e papranueshem, sepse eshte i zene nga mjetet e rankut 2 te kthyeshem ne te majte. Pra duhet pasur parasysh probabiliteti qe, kthimi ne te majte nga kryesorja, te ndodhe ne kushte rradhe. Ky probabilitet shprehet:

$$p_{0,j} = 1 - \frac{v_j}{c_{m,j}} \quad \text{ku: } j = 1 \text{ dhe } 4 \quad [3.5]$$

Ku Vj eshte fluksi i rankut 2

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Kapaciteti efektiv i manovrave k te rankut 3 eshte llogaritur duke perdorur faktorin korrigjues  $f_k$ , qe merr parasysh efektet penguese te dhena nga:

$$f_k = \prod_j p_{o,j} \quad [3.6]$$

Merret keshtu kapaciteti efektiv  $C_{m,k}$  per manovrat e rankut 3:

$$C_{m,k} = (c_{p,k}) f_k \quad [3.7]$$

Analogjikisht levizjet e rankut 4 (te treguara me l), te kthyer ne te majte nga dytesorja, mund te jene penguar nga rradhet e formuara:

- Ne rrugen kryesore per kthim ne te majte (ranku 2 )
- Ne rrugen dytesore per manovrat e kapercimmitt (ranku 3)
- Ne rrugen dytesore per kthesen ne te djathte (ranku 2)

Duhet dalluar qe, probabilitetet qe te formohen keto lloje te ndryshme radhe, nuk jane te pavarura nga njeri tjetri. Faktori korrigjues  $f_i$  ne kete rast rezulton:

$$f_i = (p')(p_{o,i}) \quad [3.8]$$

$$\text{me: } p' = 0,65 p'' - \frac{p''}{p''+3} + 0,6 \sqrt{p''} \quad [3.9]$$

- $p'' = (p_{o,j}) (p_{o,k})$
- $p_{o,j}$  = probabiliteti i radhes per kthesen ne te majte nga kryesorja
- $p_{o,k}$  =probabiliteti i radhes per kalimin nga dytesorja

Perftohet keshtu kapaciteti efektiv i levizjeve te rankut 4:

$$C_{m,l} = (f)(c_{p,l}) \quad [3.10]$$

Ndalime te manovres te detyruara nga kembesoret. Mjetet qe vijne nga rruga dytesore duhet ti jalin perparesti fluksit te kembesoreve. Tabela 3.2 tregon hierarkine ekzistuese te flukseve te kembesoreve dhe fluksit te mjeteve. Me pas llogaritet faktori korrigjues:

$$f_{pb} = \frac{(v_x) (\frac{w}{s_p})}{3600} \quad [3.11]$$

- $f_{pb}$  = faktori i bllokimit te kembesoreve, ose ndarja e kohes ne te cilen nje korsi eshte bllokuar per 1 ore
- $v_x$  = numri i grupit te kembesoreve ( $x$  eshte levizja 13,14 ,15, ose 16)
- $w$  = gjeresia e korsive (m)
- $s_p$  = shpejtësia e hapit te kmbesoreve, e marre e barabarte me 1.2 m/s

Lumi i mjeteve levizese	E dhene per lumin e kembesoreve	Faktori pengues per kembesoret
V <sub>1</sub>	V <sub>16</sub>	P <sub>p,16</sub>
V <sub>4</sub>	V <sub>15</sub>	P <sub>p,15</sub>
V <sub>7</sub>	V <sub>15, V<sub>13</sub></sub>	(P <sub>p,15</sub> ) (P <sub>p,13</sub> )
V <sub>8</sub>	V <sub>15, V<sub>16</sub></sub>	(P <sub>p,15</sub> ) (P <sub>p,16</sub> )
V <sub>9</sub>	V <sub>15, V<sub>14</sub></sub>	(P <sub>p,15</sub> ) (P <sub>p,14</sub> )
V <sub>10</sub>	V <sub>16, V<sub>14</sub></sub>	(P <sub>p,16</sub> ) (P <sub>p,14</sub> )
V <sub>11</sub>	V <sub>15, V<sub>16</sub></sub>	(P <sub>p,15</sub> ) (P <sub>p,16</sub> )
V <sub>12</sub>	V <sub>16, V<sub>13</sub></sub>	(P <sub>p,16</sub> ) (P <sub>p,13</sub> )

*Tabela 3.2 - Faktori i pengimit pedonal P<sub>p,x</sub>*

Faktori pengues per levizjen pedonale x jepet nga:

$$p = 1 - f_{pb} \quad [3.12]$$

qe, transformon ekuacionet 3.6 dhe 3.8 ne:

$$f_k = \prod j(p_{o,j}) p_{p,x} \quad [3.13]$$

$$f_l = (p') (p_{o,j}) p_{p,x} \quad [3.14]$$

Korsite e ndara Ne rastin kur me shume manovra ndajne te njejten korsi ne rrugen dytesore dhe mjetet nuk mund te ndalojne afer e afer ne linjen e parkimit, kapaciteti i korsise eshte shprehur nga relacioni:

$$C_{SH} = \frac{\sum_y V_y}{\sum_y \left( \frac{V_y}{C_{m,y}} \right)} \quad [3.15]$$

Ne te cilen:

C<sub>SH</sub> = kapaciteti i korsise se ndare (mjete/ore)

V<sub>y</sub> = volumi i trafikut te levizjes y ne korsine e ndare ne objekte (mjete/ore)

C<sub>m,y</sub> = kapaciteti efektiv i levizjes y ne korsine e ndare ne objekte (mjete/ore)

Ne rastin kur korsia e ndare i perket rruges kryesore, trafiku i kalimit dhe ai i kthimit ne te djathte, mund te jete penguar nga mjetet e kthyera ne te majte nga kryesorja, ne pritje te intervalit te pranuar, per te kryer manovren e tyre. Per te marre parasysh kete mundesi, llogariten 2 faktore, p<sup>\*</sup><sub>0.1</sub> dhe p<sup>\*</sup><sub>0.4</sub> indikatore te probabilitetit te formimit te rradheve ne korsite respektive te ndara:

$$p_{0,j}^* = 1 - \frac{1-p_{0,j}}{1 - \left[ \frac{v_{i1}}{s_{i1}} + \frac{v_{i2}}{s_{i2}} \right]} \quad [3.16]$$

- $p_{0,j} =$  probabiliteti i radhes per manovren j ne hipotezen e nje korsie te preferueshme te kthimit ne te majte nga rruga kryesore
- $j =$  manovra 1 dhe 4 (ranku 2)
- $i_1 =$  manovra 2 dhe 5 (ranku 1)
- $i_2 =$  manovra 3 dhe 6 (ranku 1)
- $S_{i1} =$  fluksi i saturimit per fluksin e trafikut te kalimit ne kryesoren, manovrat 2 dhe 5. Perfaqeson fluksin orar te shprehur ne mjete ekuivalente per ore per korsi qe, (ne mungese te fenomeneve te rradhes) kalon tranzit ne nje kryqezim me semafor, ne te cilen faza jeshile perputhet me te gjithe zgjatjen e ciklit (semafor gjithmone jeshil). Mund te merret i barabarte me 1700-1800 pcphpl
- $S_{i2} =$  fluksi i saturimit per fluksin e trafikut qe kthehet ne te djathte te kryesorja, manovra 3 dhe 6. Si me lart del i barabarte me 1700-1800 pcphpl
- $v_{i1} =$  fluksi i kalimit ne kryesore mjete /ore manovra 2 dhe 5
- $v_{i2} =$  fluksi i kthimit ne te djathte nga kryesorja manovra 3 dhe 6

Vlerat e  $p^*_{0,1}$  dhe  $p^*_{0,4}$  te gjetura zevendesohen me  $p_{0,1}$  dhe  $p_{0,4}$  ne ekuacionin 3.5

#### Kryqezime te vendosura ne rrjedhen e siperme te rruges kryesore

Nje faktor kryesor ne fund te llogaritjeve te kapacitetit te manovres sekondare eshte tipi i ardhjeve qe ndiqen ne rrugen kryesore. Ndonjehere mund te ndodhe qe, mbi te gjitha ne afersite e kryqezimeve semaforike, mjetet te udhetojne te grupuara ne plotone, ose sipas kollonave uniforme te distancuara mes tyre me interval  $T_c$ , duke veshtiresuar manovrat nga dytesorja. Ne keto kushte, sa me i madh te jete intervali midis plotoneve, akoma me i madh do te jete kapaciteti i manovres dytesore. Dallohen 4 tipe shperndarjes se arritjeve, qe vijnë ne kryesoren:

- Rregjimi 1: asnje ploton mjetesh;
- Rregjimi 2: plotone vetem nga e majta;
- Rregjimi 3: plotone vetem nga e djathta;
- Rregjimi 4: plotone nga te dy drejtimet

Gjate rregjimit 1, mjetet e ardhura nga sekondarja, futen ne kryqezim sipas modelit te percaktuar ne *Gap Acceptance*. Ne rastin kur, ne te dyja drejtimet, formohen plotone mjetesh (rregjimi 4), asnje mjet i sekondares nuk mund te futet ne kryqezim, nese intervali i mesit midis nje plotoni dhe tjetrit eshte me i vogel se intervali kritik. Gjate verifikimeve te rregjimit 2 dhe 3, vetem disa levizje sekondare jane te penguara te kryejne manovren e futjes ne rrugen kryesore.

Ne rastin kur kryqezimet e vendosura ne rradhe jane te rregulluara nga impjante semaforike te koordinuara, renditjet me te cilat mjetet shperndahen ne kryqezim, jane te parashikuara dhe behen me intervale te rregullta. Ne qofte se nje ose te dy


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

impjantet semaforike jane ne pune, renditjet jane te parashikueshme me veshtiresi. Analisti duhet te zoteroje te dhenat e meposhtme:

- Gjatesia e ciklit semaforik, C (sek);
- Koha e jeshiles efektive ne rrugen kryesore,  $g_{eff}$ , (sek);
- Fluksi i ngopjes, s (mjete/ore);
- Distanca midis kryqezimeve D (m);
- Shpejtesia progresive e plotoneve,  $S_{prog}$  (m/s)
- Fluksi i kalimit dhe kthesa ne te majte (vetem ne rastin kur egziston nje faze eksluzive) ne kryqezimin semaforik;
- Tipi i arritjes ne kryqezimin josemaforik: nga tipi 1 (plotonizim i dendur), ne tipin 6.

Prania e ishujve qendrore te trafikut (modeli me dy faza). Ne rastin kur ne kryqezim ka nje ishull qendror trafiku, me dimensione te mjaftueshme, disa manovra mund te jene te ndara ne dy faza te metejshme (fig 3.7): faza 1 e okupimit te ishullit te trafikut, faza 2 ajo e futjes ose e kalimit. Ne keto raste modeli merr emrin Two Stage Gap Acceptance.



*Figura 3.7 - Ishulli i shperndarjes se trafikut*

Hapesira qendrore shfrytezohet si per kthimin ne te majte nga rruga kryesore, ashtu edhe per kalimin dhe kthimin ne te majte nga sekondarja.

Linja e ndalimit e zgjeruar ne rrugen sekondare. Kapaciteti i rruges sekondare rritet ne rastin kur mund te egzistoje nje numer n mjetesh qe i perkasin nje levizjeje te dhene dhe mund te vendosen ne rradhe ne ndalim pa penguar levizjet e tjera. (fig. 3.8, n=1)




Figura 3.8 Zgjerimi i korsise ne linjen e ndalimit

Kapaciteti qe konkuron me kete konfiguracion, shume e perhapur kjo ne qendrat urbane, eshte me i larte, ne raport me rastin kur mjetet, qe synojne te kthehen djathtas, ndajne te njeften korsi me flukset e tjere te mjeteteve. Per te nxerre kapacitetin, analisti duhet te llogarise gjatesine mesatare te rradhes per cdo manover, duke konsideruar rastin e korsive te ndara, si dhe hapesiren efektive te disponueshme per atrimin ne linjen fundore te kryqezimit. Duhet patur parasysh qe, pertej konsideratave teorike, per flukse te rendesishme, ky plan tenton te krijoje ‘konfuzion’ mes automobilistave, duke i shtyre ato te kryejne manovra jo te natyrshme.

#### 3.4.5 Vleresimi i gjatesise se rradheve

Gjatesia mesatare e rradheve llogaritet si produkt i voneses mesatare per automjet dhe fluksit qe konkuron levizjen e objektit. Vonesa totale eshte e njeje me numrin e automjeteve per vonesen mesatare te rradhes. Per te llogaritur  $95^\circ$  te perqindeshit te rradhes perdoret shprehja e meposhtme:

$$Q_{95} \approx 900T \left[ \frac{v_x}{c_{m,x}} - 1 + \sqrt{\left( \frac{v_x}{c_{m,x}} - 1 \right)^2 + \frac{\left( \frac{3600}{c_{m,x}} \right) \left( \frac{v_x}{c_{m,x}} \right)}{150T}} \right] \left( \frac{c_{m,x}}{3600} \right) \quad [3.17]$$

ku:

$Q_{95}$  -  $95^\circ$ perqindja e rradhes (mjetë)

$V_x$  - fluksi per levizjen x (mjetë/ore)

$C_{m,x}$  - kapaciteti efektiv i levizjes x (mjetë/ore)

$T$  - koha e analizes (ore) ( $T = 0.25$  per analizen 15 minuteshe)

### 3.4.6 Koha e voneses

Me termin koha e voneses  $d$ , perkufizohet vonesa e pesuar nga mjetet, objekte te detyruara te perparese, ne kryerjen e manovres. Kjo perfshin frenimin fillestar, kohen e rreshtimit ne rradhe, kohen e ndalimit dhe kohen e futjes ne kryqezim. Modeli i perdorur per vleresimin e  $d$  hipotetizon qe, kerkesa (dmth fluksi i mjeteve egzistuese) te jetë me i vogel se kapaciteti (perndryshe do te verifikoheshin fenomenet e konxhestionit ne vijim te te cilave, vleresimi i voneses  $d$  do te rezultoje jo i sakte). Koha e voneses ( $d$ ) per manovren  $x$  jepet:

$$d = \frac{3600}{c_{m,x}} + 900T \left[ \frac{v_x}{c_{m,x}} - 1 + \sqrt{\left( \frac{v_x}{c_{m,x}} - 1 \right)^2 + \frac{\left( \frac{3600}{c_{m,x}} \right) \left( \frac{v_x}{c_{m,x}} \right)}{450T}} \right] + 5 \quad [3.18]$$

ku:

$d$  – koha e voneses (sek/mjet)

$v_x$  - volumi i manovres sekondare  $x$  (mjete/ore)

$c_{m,x}$  - kapaciteti efektiv i manovres sekondare  $x$  (mjete/ore)

$T$  – koha e studimit te flukseve (ore) ( $T = 0.25$  per nje periudhe 15 minuta)

Vlera konstante e 5 sek/automjet ne kete formule merr ne konsiderate, si frenimin fillestar, ashtu edhe akselerimin final per tu futur nga linja e ndalimit. Mund te llogaritet dhe koha e voneses per te gjithe kryqezimin, duke vleresuar si nje mesatare te ponderuar te koheve te voneses per secilen manover.

$$d_A = \frac{d_r v_r + d_l v_l + d_t v_t}{v_r + v_l + v_t} \quad [3.19]$$

ku:

$d_A$  – koha e voneses se afritit (sek/mjet)

$d_r, d_l, d_t$  – koha e voneses kthese djathtas, kalim dhe kthim nga e majta

$v_r, v_l, v_t$  - volumi per kthimin djathtas, kalim, kthim majtas (mjete/ore)

Analogjikisht mund te llogaritet  $d_i$  per te gjithe kryqezimin, duke perdorur  $d_{A,i}$  dhe

$v_{A,i}$ :

$$d_i = \frac{\sum_i d_{A,i} v_{A,i}}{\sum_i v_{A,i}} \quad [3.20]$$

Duke aplikuar 2 ekuacionet e meparshme, supozohet qe eshte zero koha e voneses per te gjitha manovrat Rankut 1 te automjeteve ne rrugen kryesore. Megjithate, kjo vlore mund te jetë  $>0$ , nese nuk ekziston nje korsi e preferuar e kthimit majtas per automjetet e rruges kryesore; keto, ne fakt, mund te bllokojne ose ngadalesojne manovrat e rankut 1 te kalimit dhe kthimit djathtas, qe sipas rradhes influencoje manovrat me nje rendesi te vogel. Kjo vonese mund te llogaritet dhe jepet me:

$$d_{\text{ranku } 1} = \frac{(1-p_{o,j}^*)d_{M,LT}\left(\frac{v_{i,t}}{N}\right)}{v_{i,1}+v_{i,2}} \quad [3.21]$$

ku:

- $d_{\text{Rank1}}$  - koha e voneses per automjetet e Rankut 1 (sek/mjete)
- $N$  - numri i korsive te pershkimit ne rrugen kryesore
- $P_{o,j}^*$  - proporcioni i automjeteve te Rankut jo te bllokuar
- $d_{M,LT}$  - vonesa e automjeteve qe kthehen majtas (sek/mjete)
- $V_{i,1}$  - automjetet ne korsine e ndare ne kryesoren qe pershkohet (mjete/ore)
- $V_{i,2}$  - automjetet ne korsine e ndare ne kryesoren qe kthehen djathtas (mjete/ore)

### 3.4.7 Niveli i sherbimit

Koha e voneses eshte parametri ku referohemi per llogaritjen e nivelit te sherbimit (NSH) te nje kryqezimi. NSH i korrespondon nje mase te kushteve operative te kryqezimit dhe tregon ne praktike nivelin kualitativ te parametrave te ndryshem objektive te qarkullimit dhe bashkefunksionimit rruge-automjet, ashtu sic perceptohen nga perdoruesi.

HCM perkufizon 6 N.SH te dallueshme nga nje germe e alfabetit, duke i bashkengjitur nje interval specifik te kohes se voneses, si me poshte:

Niveli i Sherbimit	$d = \text{koha e voneses (sek/mjet)}$
A	<10
B	>10 dhe <15
C	>15 dhe <25
D	>25 dhe <35
E	>35 dhe <50
F	>50

*Tabela 3.3 – Niveli i Sherbimit NSH*

Niveli i sherbimit A tregon nje situate optimale dhe nje vonese shume te ulet (<10 sek), ndersa niveli i sherbimit F i korrespondon ne fakt nje situate me te nderlikuar, duke sjelle vonesa me te larta se (>50 sek). Duhet te permendim se, vleresimi i eficiencies se nje kryqezimi, nuk duhet te drejtohet duke u bazuar vetem ne nivelin e sherbimit te nje dege teke te tij, por edhe mbi bazen e parametrave te tjere tregues, si rapporti sjellje/kapacitet, rezerva e kapacitetit, gjatesia e rradheve eventuale, po ashtu edhe te parametrave qe shprehin kapacitetin e tij. Ne terma te tjera, pikerisht sepse niveli i sherbimit eshte nje bashkesi kushtesh operative, mund te jete e nevojshme,

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

ne varesi te llojit te vleresimit, qe duhet te kryhet, dalja ne pah e parametrave qe tregojne qe vetem vonesa mesatare, mund te mos jepet.


Kryqezimet e karakterizuara nga kohe vonese te ndryshueshme, (nivele te ulet sherbimi), nuk jane te sigurta per sa perdoruesi, ne vazhdim te koheve pritjes te gjata, mund te vendose te pranoje intervale kritike, pertej pragut te sigurise. Ne kete prizem, shihet si te mundesohet interpretimi i koheve te voneses edhe ne emer te sigurise.

## KAPITULLI 4

### KRYQEZIME ME RRETHRRROTULLIME

#### 4.1 Shperndarja e rrethrrrotullimeve ne Evrope, Itali dhe ne pjesen tjeter te botes.

Ideja per rrethrrrotullimin e pare lindi ne France ne 1903 per merite te Eugène Hénard. Gjithsesi, duhet pritur nderhyrja paradhese ne unaze, (dmth te gjithe flukset e mjeteve te degeve prane rrethrrrotullimit duhet te ndalen per ti dhene perparese flukseve te trafikut qe okupojne unazen), per te pare nje zhvillim te vertete dhe rritje te perdorimit te rrethrrrotullimeve. Ne fakt organizimi paraardhes ishte ne favor te flukseve hyrese te mjeteve (domethene flukset e trafikut qe hyjne ne unazen e rrethrrrotullimit, kishin te drejten e kalimit prioritar, ne raport me ato mjete qe ndodheshin prezent ne korsine qarkulluese). Ne France rregulli i perparese ne unaze eshte bere zyrtar ne Kodin Rrugor Francez ne 1984 me emrin *carrefours giratories*, dhe duke filluar nga vitet 80, numri i rrethrrrotullimeve te perdorura eshte rritur ne menyre te shpejte, sic e tregon dhe figura e meposhtme, duke patur madje edhe teprime.




Mbarevajtja e numrit te rrethrrrotullimeve ne vende te ndryshme te Frances

Influenta e vendit fqinj Frances ka sjelle edhe ne Zvicer “ethet” e rrethrrrotullimeve; pikerisht ne fund te viteve 70, ne pjesen frankofone te Konfederates Elvetike asistohet trasformimi ne rrethrrrotullime i disa kryqezimeve te rrezikshme. Por vetem prej 1990, rrethrrrotullimet kane patur nje perhapje ne rritje, duke kaluar nga 19 rrethrrrotullime ne 1980, ne 720 ne perdorim ne vitin 1995, ashtu sic tregohet ne grafikun (Villa 2000).

Duhet te skatesojme se ne Zvicer rrethrrrotullimet jane realizuar kryesisht neper qendrat urbane (rreth 80% me 1994) dhe keto ne thelb kane qene te tipit kompakt, me diameter te jashtem rreth 28-29 m. Ne Zvicer ka pasur nje zhvillim te disa

rrrethrotullimeve me te vogla, te karakterizuara nga mungesa e ishujve qendrore te perfaquesuara nga vizatimi i nje pike ne qender te kryqezimit.



Rritja e numrit te rrrethrotullimeve ne rruget kantonale te Zvicres

Duke filluar nga vitet 20-30 edhe ne Gjermani nisi ndertimi i shume rrrethrotullimeve, por ne vitet 70, ky tip kryqezimi ishte komplet i abandonuar. Kjo lidhet me faktin se, keto zgjidhje konsideroheshin me pak te leverdissim, se sa zgjidhjet tradicionale, mbi te gjitha, per dimensionet e egzagjeruara, qe vinin nga projektimi i tyre si hapesira shkembimi. Vetem se fundmi, ne vazhdim te eksperiencave pozitive te Frances dhe Zvicres, rrrethrotullimet kane fituar interesin e teknikeve gjermane, duke sjelle edhe nje rritje interesit ne ndertimin e rrrethrotullimeve te reja.

Nje progres analog ka patur edhe ne vendet Skandinave, qe kane filluar perdorimin masiv te tyre qe nga 1980, nderkohe qe, deri atehere specialistet nuk besonin se do te kishin rezultate positive si ato te anglezve, qe i jepnin me teper merita karakteristikave individuale te shofereve angleze (si tolerance, discipline dhe vemannje e vecante ne drejtimin e mjetit), se sa atyre te vete rrrethrotullimeve.

Britania e Madhe edhe pse nuk ishte vendi qe ideoi rrrethrotullimin e pare, ishte nje nga shtetet e para europiane ne kerkimet dhe studimet e ketyre lloj kryqezimeve. Ne fakt, edhe se eshte kaluar nga tipologjia e nje kryqezimi me te drejte perparesie te makinave hyrese ne unaze, ne nje organizimin e te njejtes, (duke nisur nga 1996), ka imponuar perparesine e mjeteve hyrese ne korsine qarkulluese, duke privilegjuar fluksin ekzistues ne kete kryqezim. E gjitha kjo ka cuar ne ndryshimin, si te projektit te perdorimit, ashtu dhe ne studimet e kapacitetit. Ne fakt tendenca e re propozonte hapesira me te medha per ti dedikuar korsive hyrese, ne menyre qe te mund te shfrytezohej kapaciteti i grumbullimit te mjeteve ne to. Keshtu zvogeloheshin hapesirat qe i ishin dedikuar unazes qarkulluese, e cila nuk duhej me te mbante fluksin ne gjendje pritjeje, por vetem ate te pershkueshmerise per ne deget e


destinacioneve te mundshme. Fenomeni per te cilin po flasim, ishte ai i nje perhapjeje te re te ketyre tipeve te kryqezimeve pas gjendjes statuquo, te verifikuar pas ngercit te rritur, qe vinte nga nje organizimi i meparshem i qarkullimit.

Vendet ekstraeuropiane, ne te cilet eshte pare dhe nje rritje, jane Shtetet e Bashkuara dhe Australia. Sidomos ne Shtetet e Bashkuara, ne vitet e fundit, rrrethrrotullimet jane adoptuar per te zgjidhur problemet relative te kryqezimeve tradicionale shume te dendura dhe rrugeve me nje rrjedhje shume te shpejte (si per ndertimet e reja ashtu dhe ato qe zevendesojne kryqezimet ekzistuese). Rezultatet e marra nga eksperiencat amerikane, si ato te ashtuquajtura “fusha e rrrethrrotullimeve”, jane me se pozitive, me rritje te per gjithshme te kapacitetit dhe reduktiveve ne vonesa. Ne SH.B.A jane zhvilluar shume studime te bera nga entet e kerkimit te cdo shteti te vecante, shume prej te cileve kane bere disa guida vetjake per ndertimin e rrrethrrotullimeve, si “Florida Roundabout Guide” dhe “Roundabout Design Guidelines” te Departmentit Maryland te Transportit.

Ne kontekstin europian Italia perfaqeson nje situate te vecante, pasi nuk duket se ka pasur tendencat e fqinjeve France dhe Zvicer, dhe nuk shenohet asnjë “boom” ne rrrethrrotullime. Kjo i detyrohej edhe mungeses se normave, sidomos te plotesuara me kodin e fundit rrugor, ku ne artikullin 145 shkruhet: “Drejtuesit e mjetit ne rrrethrrotullim duhet te respektojnë sinjalët e perparese”, duke i dhene ne kete menyre perparesi unazave, ndersa kodi i meparshem permbante jo pak paqartesira ne lidhje me kete teme (nga momenti qe kishte mangesi te cdo argumenti normativ persa i perket rrrethrrotullimeve)

Ne Itali ka patur dhe nje fare zhvillimi te rrrethrrotullimeve urbane ne periudhen para Luftes se Pare Boterore, por meqenese keto ishin te tipit “francez”, ne vazhdim me rritjen e volumit te trafikut ne qytete, qe kane patur nje bum ekonomik ne vitet e fundit, shume prej tyre jane trajtuar si unaza me semafore, ose si kryqezime ne forme kryqi, gjithmone te semaforizuara. Disa gjurme te ketyre rrrethrrotullimeve mund te gjenden ne disa kryqezime te disa rrugeve te medha si ne Torino, ne Milano dhe ne qytete tjera te medha.

Me poshte po tregojme nje permbledhje kronologjike te numrit dhe kohes se ndertimit te rrrethrrotullimeve ne Shqiperi.



#### 4.2 Pjesa operative e rrethrrrotullimeve

Rrethrrrotullimi eshte nje tip kryezimi qe ndryshon nga tipet e tjera tradicionale te kryqezimeve, si per organizimin e qarkullimit, ashtu edhe per konfiguracionin gjemantik te tij.

Ne nje rrethrrrotullim, rregullimi i qarkullimit behet nga drejtuesi i mjetit, sipas kriterit te perparese, si dhe sipas nje funksionimi te tille, qe aktivizon vemendjen dhe perjegjesine e drejtuesit te mjetit.

Rrethrrrotullimi mund te beje nje rregullim spontan te qarkullimit, por te integruar me semafore, ose me asimetri ne perparese, ne kete rast duhet te modifikohen disa nga karakteristikat operative te sistemit

Karakteristikat kryesore teknike dhe funksionale te nje rrethrrrotullimi jane si me poshte:

- ishulli qendor i rrethuar nga nje unaze e papershkrueshme nga trafiku, i ardhur nga disa hyrje.

- qarkullimi ne sens unik antiorar ne unaze (per qarkullimin ne te djathte)

- rregulli i perparese ne unaze

- reduktimi i shpejtesise i imponuar nga devijimet e trajktoreve

Ne kete kapitull ilistrohen elementet me kryesore te nje rrrethrotullimi, qe do te trajtohen me me hollesi ne kapitujt e ardhshem. Eshte ilustruar edhe tipi i qarkullimit qe ndodh ne rrrethrotullim.

#### 4.2.1 Elementet funksionale karakteristike

Skema tipike e nje rrrethrotullimi eshte e paraqitur ne fig. 4.1, ne te cilen dallohen elementet tipike te nje rrrethrotullimi:

-**ishulli qendor**, qe perben nje pengese qarkullimi, ndonjehere ovale, zakonisht i pakalueshem, vecse ne rastin e rrrethrotullimeve te vogla, ne te cilat mund te jetë i kapercyeshem.

-**unaza** e qarkullimit ose *korsia e qarkullimit* qe eshte kurora perreth ishullit qendor ne te cilin qarkullojne mjetet.

-**diametri “D”** i rrrethrotullimit i thene ndryshe edhe “*diametri i jashtem*”, ose “*diametri i jashteshkruar*”, qe eshte permasa maksimale e rrrethit qe pershkoni nga brenda limitet e rrrethrotullimit.

-**pjeset ose deget hyrese** me gjeresi “c” dhe perballja me unazën e barabarte me “v” qe ne figure janë kater.

-**rrezja anesore “rl”**

-**ishujt pike** ose **te ndare**, qe ndajne flukset hyrese nga ato dalese, dhe qe detyrojne mjetet te ngadalesojne shpejtesine, deri ne ate te lejuar (ose te negocijuar) ne rrrethrotullim.




Figura 4.1 – Gjeometria e nje rrrethrotullimi

#### 4.2.2 Qarkullimi ne rrethrrrotullim

Sekuenca e hipotetizuar e veprimeve, qe kryen nje drejtues mjetit qe futet ne nje rrethrrrotullim, eshte si me poshte:

- pret, qe te lirohet nje hapesire ne fluksin e makinave brenda ne unaze
- futet, duke u zhvendosur ne brendesi te unazes (nese unaza ka me shume se nje korsi, drejtuesi do kaloje ne korsine e jashtme, nese do te zgjedhe daljen ngjitur, perndryshe do te pershkoje ate te brendshmen, nese do te dale diku tjeter.
- te kaloje unazën deri ne afersi te daljes
- ketu ndalon ne pjesen e jashtme dhe del nga kryqezimi

Rrethrrrotullimi prezantohet keshtu si nje sistem rregullues i kryqezimit ne nivel, me nje numer te kufizuar pikash konflikti. Sic shihet ne fig. 4.2 kjo konkretizohet ne nje zvogelim te dukshem te pikave te konfliktit: nga 32 ne nje kryqezim tradicional, e perbere nga 16 tejkalime, me shume devijime e mundesi hyrjeje, ne tete pikat e konfliktit te skemes see rrethrrrotullimit, e perbere eskluzivisht nga devijime e mundesi hyrjeje. Kjo eshte edhe nje nga arsyet kryesore, pse rrethrrrotullimet rezultojne me te sigurta, sesa tipet e tjera te kryqezimeve, sidomos nese merret parasysh rreziku i aksidenteve.




Figura 4.2 - Pikat e konfliktit per nje rrethrrrotullim dhe nje kryqezim tradicional

Rregullimi i qarkullimit duhet te jete e tipit “perparezi per fluksin e qarkullimit” (ne praktike mjetet hyrese duhet ti japin perparezi atyre qarkulluese), eshte e nevojshme per te evituar tejsaturimin e unazes, gje qe e cila mund te verifikohet me nje fluks jo shume te konsiderueshem. Eshte e nevojshme qe te tregohet qarte detyrimi per dhenie perparesie mjeteve hyrese, per te cilin ne cdo hyrje, duhet te vendosen disa sinjale “Dhenie Perparesie” dhe sinjalistika perkatese horizontale.

Funksionimi i rrethrrrotullimit varet edhe nga shpejtesia e kalimit te unazes: vetem ne rregjime shpejtesie te ulet eshte e mundur realizimi i manovrave te parashikuara nga skema. Nga ana tjeter, shpejtesia duhet te jete e tille, sa te mos jape ngadalesim ne fluksin qarkullues te mjeteve, pasi kjo do te shkaktonte nje rritje te kohes se pritjes ne hyrjet. Per keto motive duhet te ndertohen rrethrrrotullime te proporcionuara sakte gjometrikisht.

#### 4.3 Modelet empirike dhe modelet probabilistike.

Metodat e analizuara dhe pse varojne nga nje vend ne tjetrin, mund ti ndajme ne dy grupe kryesore: *empirike* (ose *statike*) dhe *probabilistike*. Mund te dallohen disa metoda percaktuese te bazuara mbi eksperiençen e projektuesve, por nuk jane analizuar, meqe nuk kane ndonje rendesi te vecante.

Modelet empirike (ose statike) bazohen mbi vezhgimin e rrrethrotullimeve ekzistuese, per te nxjerre disa relacione ndermjet karakteristikave gjeometrike dhe kapacitetit, vonesave dhe gjatesise se rradheve. Modele te ketij tipi jane pershtatur ne Britanine e Madhe, France, Zvicer, Izrael, Gjermani dhe Norvegji.

Modelet probabilistike bazohen mbi vleresimin e mundesise, qe nje rryme trafiku, e perbere nga nje ose me shume makina ne rradhe, te mund te nderhyje ne hapesirat boshe te nje vargu tjeter sekondar mjetesh. Ketij grupi, i perket teoria “gap acceptance”. Edhe pse aplikohet gjeresisht per kryqezimet tradicionale, kohet e fundit po perdoret dhe per llogaritjen e kapacitetit dhe te vonesave ne rrrethrotullime. Ne keto raste fluksi me i madh, ne te cilin verifikohen ndonjehere boshlleqet (gapet), eshte i perbere nga rryma qarkulluese, ndersa fluksi i vogel, dmth ai qe do te futet ne brendesi te boshlekut (gap-it) te fluksit te madh, eshte ai i afriimeve.

Ekzistojne dhe metoda simulacioni, qe bazohen mbi modelin numerik ose analogjik te rrymave te trafikut e te sjelljes te drejtueseve ne kryqezime. Per keto metoda eshte e domosdoshme qe te perdoren programe shume komplekse dhe kompjutera te fuqishem.

#### 4.4 Perafrimi empirik

##### 4.4.1 Studime statistikore te bera ne Britanine e Madhe

*Studime para vitit 1966.* Kapaciteti i rrrethrotullimeve eshte percaktuar ne momente te ndryshme dhe ne menyra te ndryshme, sipas rregullave te perparese ne fuqi dhe karakteristikave gjeometrike.

Ne periudhen ne te cilen ishte ne fuqi rregulli i perparese per mjetet hyrese (deri ne vitin 1966), studimet e bera lejonin qe te vendosej se, manovrat kryesore ishin ato te shkembimit, prandaj kapacitetet duhesin llogaritur vazhdimisht. Nje nga formulat e para te llogaritjes se kapacitetit te rrrethrotullimeve eshte marre nga *Wardrop* ne gjysmen e dyte te viteve 50 (Philbrick 1977). Ai e konsideronte zonen ndermjet dy kraheve te rrrethrotullimit si nje zone shkembimi, e duke u bazuar ne eksperimentet e shumta te bera prej tij, nxorri formulen e meposhtme per llogaritjen e kapacitetit relativ nga nje hyrje:

$$Q_w = 345 \times W \frac{\left(1 + \frac{e}{W}\right) \times \left(1 - \frac{p}{3}\right)}{1 + \frac{W}{L}} \quad [uvp/h] \quad [4.1]$$

$$\text{ku: } e = \frac{e_1 + e_2}{2} \quad [m] \quad [4.2]$$

ku variablat kane kuptimin e meposhtem:

- W** = gjeresia e karrekhates qarkulluese
- L** = distanca ndermjet dy kraheve
- e<sub>1</sub>** = gjeresia e hyrjes
- e<sub>2</sub>** = gjeresia e unazes ne korrespondence me hyrjen
- p** = raporti ndermjet fluksit te shkembit Q<sub>e</sub> dhe atij te dy krahave Q<sub>e+Q<sub>c</sub></sub>.




Figura 4.3 - Shpjegimi grafik i termave te ekuacionit i treguar me siper

**Shembull:** Duke hipotetizuar kushtet gjometrike te nje rrrethrotullimi me nje korsi: nje gjeresi e karrekhates qarkulluese konstante rrreth 6 m, nje gjeresi e korsise hyrese prej 4 m, e nje distance ndermjet dy kraheve prej rrreth 20 m; per vlera te flukseve hyrese prej rrreth 1000 mjete/ore e me nje fluks te karrekhates qarkulluese me rrreth 1000 mjete/ore, ka nje kapacitet relativ hyres Q<sub>w</sub> e rrreth 2050 mjete, qe hyjne ne karrehaten qarkulluese. Nga momenti qe i duhet dhene perparesia mjeteve qe jane duke hyre ne degen ngjitur, nuk do t'ia dalin te kalojne te gjithe, sepse kapaciteti i nje kryqezimi T eshte rrreth 1500 mjete ne kushtet ideale pa fluks, pra kemi nje ngrirje me vlera jo shume te larta te fluksit dhe kjo nuk mund te kompensohet me hapesira mbledhese te pershtatshme.

Ne vazhdim te adoptimit te rregullave te perparesise ne unaze, te bere ne 1966, jane bere studime te tjera per te gjetur nje formule te re per llogaritjen e kapacitetit te rrrethrotullimeve, qe merrte parasysh situaten e re ne te cilen manovrat dominuese jane ato te hyrjes e daljes, e duke kuptuar qe rrrethrotullimi nuk mund te jete nje zone shkembimi. Kerkimet e zhvillura nga TRRL nga gjysma e dyte e viteve '79 (M.C Semmens, P.J. Fairweather e I.B. Harrison 1980 – Kimber 1980), jane zhvilluar ne hyrjet, duke i konsideruar ato ne rrrethrotullimeve si kryqezime te vecanta T, me deget qe jane nje kalimeshe, funksionimi i te cilave, rezulton i pavarur nga te tjerat.

Kapaciteti i nje rrrethrrotullimi shikohet pra si kapacetet kompleks i cdo hyrjeje teke, i varur nga fluksi qarkullues e nga ai hyres, pervecse nga karakteristikat gjeometrike te hyrjes.

**Kapaciteti i rrrethrrotullimit me perparesi te fluksit qarkullues.** Kerkimet e ndryshme te bera gjate viteve kane evidentuar te gjitha nje ndryshim linear midis fluksit hyres  $Q_e$ , atij qarkullues  $Q_c$ , ndersa nuk eshte konsideruar ndikues fluksi dales  $Q_u$ . Formula e adoptuar per kapacitetin eshte kjo:

$$Q_e = F - f_c \cdot Q_c \quad [pcu/h] \quad [4.3]$$

**Influenca e karakteristikave gjeometrike.** Influenca e karakteristikave gjeometrike te rrrethrrotullimit dhe ne vecanti, te hyrjes, eshte studiuar me teknika te nje regresioni linear, qe kane cuar *Kimber* ne formulimin e shprehjes per llogaritjen e kapacitetit hyres ne rrrethrrotullime.

Faktoret gjeometrike qe influencojn me shume kapacitetin e nje hyrjeje, jane gjresia e hyrjes ( $e$ ) dhe pjesa dukshme ( $S$ ), ndersa me pak te rendesishem, edhe pse domethenes, jane diametri i rrrethit te pershkruar ( $D$ ), gjresia e karrekhates qarkulluese ( $u$ ), kendi ( $\Phi$ ) e rrezja e hyrjes ( $r_1$ ). Keto elemente gjeometrike tregohen ne figuren 4. 4 ne faqen ne vazhdim.




Figura 4.4 – Elementet gjeometrike kryesore te nje rrrethrrotullimi

**Gjresia e hyrjes dhe svatasuara.** Studimet e bera kane te treguar qe kapaciteti i nje hyrjeje eshte i lidhur me numrin  $n$  te mjeteve te rradhitur (i marre si vlera mesatare e intervalit kohor) e kjo varet nga gjresia e hyrjes dhe e svasatures sipas relacionit:

$$n = a \left( v + \frac{e - v}{1 + C \cdot S} \right) \quad [4.4]$$

Ne te cilin  $v$ ,  $e$  dhe  $S$  jane simbolet e pershkruara me para, ndersa  $C$  eshte nje koeficient empirik, per te cilin vlera me e pershtatshme eshte e barabarte me 2.

Duke marre kapacitetin hyres  $Q_e$ , si funksion linear  $Q_c$  me parametrat gjeometrike  $e$ ,  $v$ , dhe  $S$  mund te shkruhet:

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

$$Q_e = a_0 + a_1 \left( v + \frac{e-v}{1+2 \cdot S} \right) - \left[ b_0 + b_1 \left( v + \frac{e-v}{1+2 \cdot S} \right) \right] \cdot Q_c \quad [4.5]$$

Nga analiza e te dhenave, themi qe konstantja  $a_0$  eshte e barabarte me zero, ndersa te tjerat jane te barabarta me:

$$a_1 = 303$$

$$b_0 = 0,210$$

$$b_1 = 0,0402$$

$$x = v + \frac{e-v}{1+2 \cdot S} \quad [4.6]$$

Perftohet formula qe merr parasysh gjeresine e hyrjes dhe ate svasatures:

$$Q_e = 303 \cdot x - [0.210(1+0.2 \cdot x)] Q_c \quad [4.7]$$

**Diametri i brendshem (D).** Diametri i brendshem D vepron si nje faktor shkalle mbi koeficientin  $f_c$ . Influencia e diametrit D barazohet mepermjet shumezimit te  $f_c$  me koeficientin t:

$$t' = 1 + \frac{0.5}{1 + e^{\left(\frac{D-60}{10}\right)}} \quad [4.8]$$

Keshtu qe, formula (4.1) per llogaritjen e kapacitetit qe merr parasysh influencen e diametrit te brendshem behet si me poshte:

$$Q_e = F - t' \cdot f_c \cdot Q_c \quad [4.9]$$

**Kendi dhe rrezja e hyrjes** Si kendi  $\Phi$  dhe rrezja e hyrjes  $r_1$  kane patur nje influence mbi kapacitetin e hyrjes. Efektet qe vijnë nga variacionet e tyre jane permbledhur me nje korrigjim te thjeshte te perqindjes k:

$$k = 1.151 - 0,00347 \cdot \Phi - 0.978 \cdot \left( \frac{1}{r_1} \right) \quad [4.10]$$

Per te marre parasysh parametrat e tjere gjeometrike, ne 1993 shprehja e  $k$ , eshte modifikuar duke iu referuar rrrethrotullimeve standarte, qe do te thote me  $\Phi=30^\circ$  dhe  $r_1=20$  m, per te cilen ajo eshte bere:

$$k = 1 - 0,00347 \cdot (\Phi - 30) - 0.978 \cdot \left( \frac{1}{r_1} - 0.05 \right) \quad [4.11]$$

Relacioni final, qe merr parasysh te gjitha karakteristikat gjeometrike domethenese, rezulton si me poshte:

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

$$Q_e = 303 \cdot k \cdot x - 0.210 \cdot t' \cdot k \cdot (1 + 0.2 \cdot x) \cdot Q_c \quad [4.12]$$

me:

$$k = 1 - 0,00347 \cdot (\Phi - 30) - 0.978 \cdot \left( \frac{1}{r_i} - 0.05 \right) \quad [4.13]$$

$$t' = 1 + \frac{0.5}{1 + e^{\left( \frac{D-60}{10} \right)}} \quad [4.14]$$

$$x = v + \frac{e-v}{1+2 \cdot S} \quad [4.15]$$

ne te cilen:


$$S = 1.6 \cdot \left( \frac{e-v}{L} \right) \quad [4.16]$$

(4.2) mund te vendoset ne te njejten forme te (4.1) per te evidentuar lidhjen lineare ndermjet  $Q_e$  dhe  $Q_c$ , kur vendosen:

$$F = 303 \cdot k \cdot x \quad [4.17]$$

$$f_c = 0.210 \cdot t' \cdot k \cdot (1 + 0.2 \cdot x) \quad [4.18]$$

Parametrat gjeometrik  $D$ ,  $\Phi$ ,  $r_i$ ,  $e$ ,  $v$  jane ata te treguar ne figure 4.4, ndersa parametri  $L$  paraqet mesataren e gjatesise mbi te cilen zhvillohet svasatura e hyrjes, sic tregohet ne figuren 4.5.



*Figura 4.5 – Parametrat gjeometrike te hyrjes*

*Shnderrimi (konvertimi) i fluksit te makinave ne njmp (njesi mjete pasagjere).*

Mjetet e ndryshme qe jane pjese e nje fluksi te caktuar duhet te klasifikohen ne baze te tipit dhe efekteve qe ato jepin. Keshtu qe, duhet shumezuar numri i mjeteve te nje tipi te vecante (mjeteve te renda, autovetura, e motora), per koeficiente te caktuar ekuivalence, ne menyre qe fluksset te shprehesh ne “*njesi mjete pasagjere*” (*njmp*). Koeficientet e parashikuara nga TRRL tregohen ne Tabelen 4.1.

Mund te perdoren edhe disa koeficiente per te patur parasysh veshtiresite e ndryshme, qe sjellin manovra e kthimit: ne te majte, ne te djathte, e parakalimet.

	<i>Vlera mesatare ne njmp ekuivalente</i>	<i>ne hyrje</i>	<i>ne unaze</i>
<i>Mjete te renda</i>		1.9	1.7
<i>Mjete me 2 rrota (kryesisht motociklete)</i>		0.2	0.8

*Tabela 4.1 – Faktoret e konvertimit ne njesi mjete pasagjere*

*Llogaritja e vonesave dhe rradheve ne rrrethrotullime*

Vonesa konsiston ne humbjen e kohes, per shkak te trafikut nga prania e nje elementi organizativ, qe mund te haset gjate rruges.

Sipas HCM, vonesa mesatare e mjetit gjenerues eshte e perbere nga “vonesa e ndaluar” dhe nga “vonesa start-stop”; shprehja ne vazhdim furnizon “vonesen e ndaluar”, e perbere nga termat “voneze uniforme” (voneze per shkak te arritjeve uniforme ne kryqezim) dhe “voneze ne rritje” (voneze ne rritje per shkak te arritjeve jouniforme, po te rastesishme):

$$d = 0,38C \frac{(1-\lambda)^2}{(1-\lambda x)} + 176^2 \left[ x - 1 + \sqrt{\left(x-1\right)^2 + \left(\frac{16x}{Cap}\right)} \right] \quad [4.19]$$

Ku :

<b>C</b>	eshte koha e ciklit
<b>X</b>	eshte shkalla e ngopjes te rrymes se konsideruar
<b>Cap</b>	eshte kapaciteti i rrymes se konsideruar
$\lambda = g/C$	eshte perqindja e jeshiles ne ciklin semaforik te rrymes se konsideruar

Duke llogaritur vonesen totale HCM (Highway Capacity Manual) sugjeron shumezimin me 1.3 te ekuacionit [4.19].

Vleresimi i vonesave dhe gjatesise se rradheve eshte shume i rendesishem ne inxhinierine e trafikut per:

- verifikimin e funksionimit ose percaktimin e nivelit te sherbimit ;

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

- parashikimin e zgjedhjeve ne shperndarjen e trafikut ne brendesi te nje rrjeti rrugor;
- vleresimin e gjatesise te korsive te grumbullimit;
- vleresimin ekonomik te kursimeve te lidhura me vonesat;
- vleresimin e marredhenieve me kryqezimet prane (ngjitur)

Vonesat qe verifikohen ne rrrethrotullim mund te ndahen ne 2 tipe:

- vonesa gjeometrike, ose vonesat per shkak te pritjes (ose te sherbimit).

Vonesa gjeometrike vjen kryesisht per shkak te shpejtesise se ulet me te cilen mjetet kalojne rrrethrotullimin. Ai eshte funksion i distances se kaluar ne rrrethrotullim dhe differences se shpejtesise te kryqezimit te mjeteve, si dhe asaj te kalimit te rrrethrotullimit. Vonesa gjeometrike nuk merr ne konsiderate kohen e pritjes ne linjen e perparesise, pra i referohet dhe llogaritet ne kushtet kur mjetet hyrese nuk duhet ti jepin perparesi mjeteve qarkulluese. Ndryshimi i dy tipeve te vonesave eshte i vlefshem, kur duhet te konfrontohen rrrethrotullimet me tipet e tjera te kryqezimeve, vecanerisht me ato te semaforizuara.

Vonesa e pritjes eshte funksion i kapacitetit (te hyrjes) te perballjes dhe te fluksit ne karrehaten qarkulluese. Ne praktike, vonesa verifikohet kur fillon te formohet nje rradhe ne hyrje te rrrethrotullimit (ne realitet eshte i vonuar edhe mjeti i pare qe gjendet ne fillim te rradhes per shkak te nje kohe sherbimi te harxhuar ne shpejtimet/ngadalesimet).

**Vonesa gjeometrike.** Sic kemi thene, vonesa gjeometrike ndodh per shkak te nderprerjes se rregjimit te shpejtesise “se lire”, te shkaktuar nga prezenca e rrrethrotullimit, e konsiderueshme ne nje ngadalesim (ne hyrje), per arritjen e nje shpejtesie kalimi (ne unaze) dhe nje shpejtimi (ne dalje) per arritjen e nje shpejtesie “te lire”. Te gjitha mjetet pesojne vonesen gjeometrike, e kjo ndodh pavaresisht fluksit te trafikut.

Metodat e para te llogaritjes se voneses gjeometrike bazoheshin mbi vezhgime eksperimentale dhe mbi trajtime te te dhenave me teknikat e regresit (renies) lineare. Dy faktoret qe influencojojnë vonesat gjeometrike janë:

- mesatarja e shpejtesise ne hyrje e ne dalje
- kendi total i ktheses

Relacioni linear i thjeshte, qe lidh vonesen me kendin dhe me shpejtesine, eshte si me poshte:

$$Vonesa = 0.03 \text{ kendi} + 0.13 \text{ shpejtesi} - 3.5$$

[ 4.20]

Me vonesen e shprehur ne sekonda, *kendi* ne grade e *shpejtesia* ne milie/ ore ( $\approx 1.6$  km/ore).

Meqë ishte mjaft i veshtire percaktimi i kendit te plotë te zhvillimit, u zhvillua një ekuacion alternativ edhe me i thjeshte:

Vonesa = $0,026 \cdot shpejtesi - 9.3$

[ 4.21]

gjithmone me *vonesen* e shprehur ne sekonda dhe *shpejtesine* ne milje/ ore. Studime te tjera te bera kohet e fundit kane perdorur modele sintetike per simulimin e profilit te shpejtesive te automjeteve, si ai i treguar ne figuren 4.6. Ne vecanti, nje model llogariste shumatoren e vonesave gjeometrike, per cdo element te manovres, per te marre ne fund vonesen komplekse te te gjithe manovres. Elementet baze te manovres se kalimit te rrrethrrrotullimit jane:




Figura 4.6 – Profili tipik i shpejtesive te mjeteve ne nje rrrethrrrotullim

- ngadalesim prane kryqezimit (pjesa A-B e figura 4.6);
- tejkalim i karrekhates qarkulluese (pjesa A-C);
- shpejtum ne rrugen e daljes (pjesa C-D);

Keto elemente jane perdorur per te llogaritur intervale mbi baza ditore te mjeteve per cdo manover, qe duke u mbledhur jepin intervallet ditore te te gjitha manovrave. Modeli bazohet ne nje seri perafrimesh empirike, ne te cilien profilet reale te shpejtesise jane paraqitur ne forma te thjeshtezuara. Per percaktimin e normave te shpejtimit dhe te ngadalesimit dhe shpejtesive te negocijimit, jane percaktuar disa relacione, me te cilet eshte bere e mundur llogaritja e ketyre tre parametrave ne funksion te gjeometrise se vendit.

Per rrrethrrrotullimet vihet re se, shpejtesia e negocijimit varet nga tipi i manovres (kthese djathtas, kalim, kthese majats) dhe nga rrezet hyrese e dalese. Modeli i vendosur lejon llogaritjen e vonesave gjeometrike me nje precizion te larte: diferencat ndermjet vonesave te llogaritura e atyre te matura ishin me te vogla se 2 sekonda. Ky gabim konsiderohet i pranueshem, ne nje kohe qe vonesat gjeometrike te vrojtuara ne rrrethrrrotullime, ne pjesen me te madhe te rasteve, perfshihen ne intervalin  $10\div20$  sekonda. Ne rastin kur ka nje fluks te konsiderueshem mjetesh te

renda, mjafton te rriten me 15% vonesat gjeometrike normale te automjeteve per te arritur ato relativet tek mjetet e renda: ne fakt eshte vene re se mjetet e renda pesojne nje vonese gjeometrike, qe eshte rreth  $10 \div 15\%$  me e larte se ajo e automjeteve.

Keto studime jane bere qe nga Institut i kerkimeve amerikane “FHWA”, qe ka munduar te studioje fenomenin e siperpermendur me disa vezhgime eksperimentale.

Jane ndertuar disa profile te shpejtesise gjate rruges, qe cdo mjet përshton ne kalimin e kryqezimit (rrrethrotullim ne kete rast), ne menyre qe te shihet periudha e ngadalesimit e shpejtimit, qe mjetet kane ne varesi, si te rrezeve te kthesave, ashtu edhe te tipit te manovres se kryer, duke konsideruar vlera te ndryshme te shpejtesise.

Kjo lejoi qe te behej nje diagrame e shpejtesise qe përshtuan mbarevajtjen e tyre ne funksion te rruges se bere nga mjeti, ne menyre qe te kuptohet entiteti i shpejtimeve/ngadalesimeve dhe shpejtesive maksimale per tu respektuar.

Me poshte jepen disa diagraama:

- Profili i shpejtesise gjate nje kalimi te drekte te nje mjeti ne nje rrrethrotullimi (figura 4.6.1);




Figura. 4.6.1 – Profili teorik i shpejtesise ne nje rrrethrotullim urban


Nga profili shihet variacioni i shpejtesise dhe hapesira ne te cilen kjo ka ndodhur dhe per te cilen arrihet te llogaritet shpejtimi, ose ngadalesimi i nje mjeti gjate nje rruge te caktuar.

Per rastet e analizuara, kemi tabelen e meposhtme qe përshtuan llogaritjet e bera per vlera te ndryshme te shpejtesise se kalimit te listuar ne profil.

Shpejtesia fillestare	70 Km/ore	55 Km/ore	40 Km/ore
Shpejtesia finale	37 Km/ore	30 Km/ore	26 Km/ore
$\Delta V$	33 Km/ore	25 Km/ore	14 Km/ore
Koha e harxhuar	7 sek	8.5 sek	8.8 sek
Hapesira fillestare	90 m	80 m	60 m
Hapesira finale	20 m	20 m	25 m
$\Delta S$	70 m	60 m	35 m
Ngadalesime	1.43 m/s <sup>2</sup>	0.82 m/s <sup>2</sup>	0.46 m/s <sup>2</sup>
Shpejtime	0.78 m/s <sup>2</sup>	0.8 m/s <sup>2</sup>	0.36 m/s <sup>2</sup>

*Tabela – Llogaritja e hapesirave, shpejtesive dhe shpejtimeve ne nje mjet qe kalon rrrethrrrotullimin*

Grafiku i rrezeve te kthesave/shpejtesive (fig. 4.6.2)



*Figura 4.6.2 – Lidhja ndermjet shpejtesise dhe rrezes se ktheses per vlera te ndryshme te mbingritjes ne kthese*

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

---

Shihet menjehere se, shpejtesia e ecjes se mjetit rritet proporcionalisht me rritjen e rrezes se ktheses, e pervec kesaj keto vlera jane te medha kur mbingritja e ktheses behet nga brenda.

Lista e shpejtesive maksimale, qe duhen mbajtur ne tipologjite e ndryshme te rrrethrrrotullimeve:

- Mini –rrrethrrrotullim	25 Km/ore
- Rrrethrrrotullime te plota urbane	25 Km/ore
- Rrrethrrrotullime urbane me nje korsi	35 Km/ore
- Rrrethrrrotullime urbane me dy korsi	40 Km/ore
- Rrrethrrrotullime rurale me nje korsi (ne periferi)	40 Km/ore
- Rrrethrrrotullime rurale me dy korsi (ne periferi)	50 Km/ore

Ky argument do te shihet ne vazhdim ne paragafin 4.5 kur do te flitet per projektin gjeometrike te rrrethrrrotullimeve, ne te cilen do te shihen relacionet e duhura.

Ekuacioni per llogaritjen e vonesave u zhvillua me tej ne 1981 dhe perfshihet ne programin ARCADY. Ky ekuacion llogarit vonesat ne baze te parametrave gjeometrike qe tregohen ne figuren 4.7 e cila eshte kjo:

$$d_g = \frac{V_A - JS}{a_{AB}} + \frac{V_D - JS}{a_{CD}} + \frac{d_{BC}}{JS} - \frac{d_1 - d_{AB}}{V_A} - \frac{d_2 - d_{CD}}{V_D} \quad [s] \quad [4.22]$$

Ne te cilen:

- **V<sub>A</sub>** dhe **V<sub>D</sub>** jane respektivisht shpejtesia e afritit dhe e rinisjes se mjetit (te shprehura ne m/sek, te matura ne pikat ne te cilat influencoohen nga kryqezimet;
- **J<sub>S</sub>** eshte shpejtesia e mjetit ne brendesi te kryqezimit, ne m/sek ;




Figura 4.7 – Parametrat shoqerues te voneses gjeometrike ne rrrethrrrotullime

- **a<sub>AB</sub>** eshte ngadalesimi ne hyrje te rrrethrrrotullimit, e perftohet nga:

$$a_{AB} = 1.06 \frac{V_A - JS}{V_A} + 0.23 \quad [m/s^2] \quad [4.23]$$

- **a<sub>CD</sub>** eshte shpejtesia qe merr mjeti ne dalje te kryqezimit, e perftohet nga;

$$a_{CD} = 1.11 \frac{V_D - JS}{V_D} + 0.02 \quad [m/s^2] \quad [4.24]$$

- **d<sub>BC</sub>** eshte distanca e pershkruar per gjate kryqezimit, e shprehur ne m;

- **d<sub>1</sub>** e **d<sub>2</sub>** jane respektivisht distancat (ose rrezet) e hyrjes e te daljes nga qendra e kryqezimit, te shprehura ne m;

- **d<sub>AB</sub>** eshte gjatesia e pjeses te ngadalesimit e perftohet nga:

$$d_{AB} = \frac{V_A^2 - JS^2}{2 \cdot a_{AB}} \quad [m] \quad [4.25]$$

- **d<sub>CD</sub>** eshte gjatesia e pjeses ku rritet shpejtesia, e perftohet nga:

$$d_{CD} = \frac{V_D^2 - JS^2}{2 \cdot a_{CD}} \quad [m] \quad [4.26]$$

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

Vlera e shpejtesise JS varion ne baze te tipit te manovrave te bera nga mjetet:

*per kthesat ne te majte:*

$$JS = 0.84 (\ln ER + \ln EXR) \text{ m/sek} \quad [4.27]$$

ku ER dhe EXR jane rrezet e hyrjes dhe te daljes (duke ju referuar aneve te trotuareve)

*per manovrat e tejkalimit* (kur  $0.5 - (ENA + EXA) < 20^\circ 30'$ );

$$JS = 0.47 - Y + 0.035 - SD - 1.18 \quad (\text{m/s}) \quad [4.28]$$

ku:

ENA = kendi i hyrjes, i dhene ne grade (sipas fig 4.7)

EXA=kendi i daljes, i dhene ne grade

$$y = 0.5(V_A + V_D), \text{ ne m/s}$$

SD = distanca e shikimit

Nese distanca e shikimit, nuk eshte e qarte, atehere mund te perdonim formulen e meposhtme:

$$JS = 0.4 - Y + 2.43 \quad (\text{m/s}) \quad [4.29]$$

*per kthesat djathtas dhe manovrat e kalimit*

(kur  $0.5 - (ENA + EXA) > 20^\circ 30'$ );

$$JS = 0.96 - \ln D + 2.03 \quad (\text{m/s}) \quad [4.30]$$

ku D eshte diametri i brendshem

Nese vlera e llogaritur e JS eshte me e madhe se  $V_A$ , atehere duhet marre  $JS = V_A$ , dhe  $d_{AB}=0$

Analogjikisht nese  $JS > V_D$ , atehere do te jete:  $JS = V_A$ , dhe  $d_{CD} = 0$

Nese  $JS > V_A$ , dhe  $JS > V_D$  atehere do te merret  $JS = 0.5 - (V_A + V_D)$

Ne fund nese vonesa e llogaritur eshte  $< 0$ , atehere duhet te merret sikur nuk ka vonese.

**Vonesa per shkak te pritjes.** Vonesa ne pritje lidhet me kohen, qe duhet pritur derisa te verifikohet nje pasazh (hendek) makinash i pranueshem ne rrymen e qarkullimit.

Ne rastet kur formohen radhe ne degen hyrese, vonesa ne pritje do te influencohej edhe nga koha e humbur ne kete radhe. Pra, vonesa ne pritje e nje mjeti do te varet nga fakti, nese atij do ti duhet te presi ne kete radhe apo jo, e kjo varet nga shkalla e ngopjes.

Tipi i shperndarjes i hipotetizuar per prurjet e qarkullimit dhe te hyrjes, do te influencoje ne llogaritjet si te kapacitetit ashtu dhe te vonesave. Per llogaritjen e kapacitetit, te gjatesise se rradheve dhe te vonesave mundet te mbeshtetemi ne disa aplikime qe lidhen me shkallen e ngopjes se trafikut.

Vleresimi i kapacitetit te hyrjeve kerkon te dhena nga flukset e trafikut te cdo dege hyrese dhe ndryshimin kohor mes tyre. Si rezultat i perseritjes midis ardhjeve te rastesishme te mjeteve ne nje rrrethrrotullim, ne nje periudhe te caktuar kohe, krijohet mundesia qe, kapaciteti i nje ose me shume hyrjeve te kaloje (shkalla e ngopjes >1) me radhet e krijuara gjate periudhes se pikut. Teknikat e para per vleresimin e gjatesive te radheve dhe te vonesave, i perkisnin kryesisht vendosjes se koheve te cikleve te kryqezimeve semaforike dhe i referoheshin per gjithesisht aplikimeve kompjuterike (Kimber, Marlow, Hollisme Mayne 1977)

Per te bere lidhjen kohe-varesi dhe aplikimet e tyre per rrrethrrotullimet jane perdorur dy perfarime:

-nje prezantim me nje percaktim te sakte, ne te cilin gjatesia e radhes eshte llogaritur ne intervale te vogla te njepasnjeshme, (psh. prej 5 min) qe jane treguese per projektin dhe per analizen e rrjetit, etj.

-nje prezantim me nje percaktim jo shume te sakte, ne te cilin flukset e trafikut jane llogaritur per nje periudhe te gjate kohore (psh 1 ore), qe lejon llogaritjen e nje vonese totale ne nje periudhe piku, duke u nisur edhe nga nje vleresim ekonomik i sistemimit te kryqezimit.

Keto metoda kohe-varesi konsiderojne probabiliteten e gjatesive te ndryshme te radheve si funksion i kohes, e nga ky probabilitet, llogarisin gjatesine mesatare te radhes se parashikuar.

Jane zhvilluar disa ekuacione per te reduktuar kohen e llogaritjes, qe jane perafrime te mbyllura, duke perdorur disa trasformime koordinatash per trasformimin e rezultateve ne gjendjen e ndaluar, ne menyre qe ato te jepin ekuacionin percaktues. Gjatesia mesatare e radhes L e vleresuar ne shume prova, ndryshon me kohen dhe mund te merret nga ekuacioni:

$$L'(t) = \sum_{n=2}^N n p_n(t) \quad [4.31]$$

ne te cilin:

N - eshte numri maksimal i mjeteve ne pritje qe mund te sistemohet;

p(t) - eshte perqindja e provave, per te cilat verifikohet nje rradhe e n mjeteve ne kohen t;

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

$L(t)$  - perfshin mjetet ne “sherbin”, p.sh. ne linjen e perparese. Ndryshe mund te perdoret formula e meposhtme:

$$L'(t) = \sum_{n=2}^N (n-1) \cdot p_n(t) \quad [4.32]$$

ne te cilen  $L'(t)$  perjashton mjetin “ne sherbin”.

Meqe  $p_n(t)$  varet nga kërkesa e fluksit  $\mathbf{q}$  dhe nga kapaciteti  $\mathbf{m}$ , dhe keto jane dhene si një funksion me shkalle, jo te vazhduar,  $L$  duhet te vleresohet nga segmentet e tjere kohore. Segmenti mund te jete shume i vogel sa e lejojne informacionet mbi kërkesen dhe kapacitetin.

Vonesa e mjeteve totale eshte thjesht siperfaqja poshte kurbes qe shpreh gjatesine mesatare te radhes ne funksion te kohes:

$$D = \int_t^n L(t) \cdot dt \quad [4.33]$$

Kjo vonese perfshin edhe ate te pesuar nga mjetet e pranishem ne radhe ne kohen  $t_1$  dhe perjashton vonesen e pesuar nga mjetet te nisur ne radhe ne kohen  $t_2$ .

Ne terma “percaktues” zhvillimi ose dedikimi ne radhe ndjek thjesht diferenca mes kërkeses dhe kapacitetit (ofertes).

Kjo eshte shume e ndjeshme kur kërkesa dhe kapaciteti jane perafersisht te njejtë. Ne rrrethrotullimet, fluksi qarkullues  $Q$  perbehet nga trafiku, qe ka hyre ne rrrethrotullim nga rruga te tjera. Nese kërkesa eshte e mjaftueshme per te shkaktuar një radhitje ne nje apo me shume dege, kapacitetet e vecanta te cdo hyrje behen super te varur e mund te llogariten me tentativa. Ata ndryshojne ne kohe, ashtu sic ndryshon kërkesa e flukseve dhe levizjet e kthesave ne afime. Duke bere llogaritjen e perseritur te kapacitetit per cdo segment te perkohshem pasardhes, ne funksion te kërkeses se perkoheshme te fluksit, kapaciteti gjate segmentit mund te llogaritet per cdo hyrje. Trafiku ne ardhje ne cdo hyrje mund te trajtohet ashtu si nje fluks i vecante dhe llogaritjet e pritjes mund te permiresohen. Ne fig 4.8 tregohet lidhja mes kapacitetit hyres per 2 dege hyrese, A dhe D, me kushte te ndryshme hyrjeje (nga TRRL, RR35).




Figura 4.8 – Lidhja midis kapacitetit te dy degeve A dhe D

Ky program ndjek vleresimin e kapacitetit te hyrjeve, te radheve, te vonesave, te frekuencave te aksidenteve dhe efektet e kalimeve te kembesoreve.

Procedura qe ndjek programi ARCADY per llogaritjen e radheve e te vonesave eshte si me poshte.

Konsiderohet nje interval i shkurter  $t$ , ne te cilin kerkesa e fluksit  $q$  dhe e kapacitetit  $m$  (ku  $\mu=Q_e$  ose kapaciteti ne hyrje) mund te konsiderohen me afersi konstante.

Ka disa raste te ndryshme qe varen nga rapporti  $p$  i fluksit me kapacitetin ( $q = q/\mu$ ) dhe nese  $q < 1$ , nga vlera relative e  $L_0$  (radha ne fillim te intervalit ne shqyrtim), e gjatesia e ekuilibruar e radhes  $l = q/1-p$

Keto ekuacione perfaqesojne zhvillimin ose dobesimin e gjatesise se radhes brenda nje intervali  $t$ . Vonesa mesatare totale gjate kesaj kohe merret duke perdorur nje algoritem, qe eshte ekuivalent me integrimin e nje ekuacioni te gjatesise se radhes ne segmentin kohor.

Ne rrrethrotullim, vonesa gjeometrike eshte zakonisht e perfshire ne intervalin nga 12 dhe 15 sekonda, e ne pernjithesi eshte me e madhe se sa vonesa ne pritje, vecse kur kerkesa e trafikut arrin kapacitetin e afrimit. Ne kete rast, procesi eshte i dominuar nga efektet kohe-varesi. Elementet e vonesave te pranishme ne matjet e vonesave gjeometrike jane identifikuar, edhe pse ka qene e njohur nje lloj mbivendosje me ato, te perfshira ne mekanizmat e llogaritjes se modeleve te krijimit te rradheve. Vonesa totale per mjet nuk eshte shuma e matur e vonesave gjeometrike dhe e voneses ne pritje. Megjithese vonesa gjeometrike mund te rishihet per te eliminuar mbivendosjen, kjo do ta bente ate te pa llogaritshme.

**4.4.2 Studimet e bera ne France mbi bazat statistikore**

Studimet e udhehequra nga Louahne 1988 mbi 56 hyrje ne 17 rrrethrotullime franceze kane cuar, pas analizes se te dhenave e perdorimit te metodave te regresit, ne nje funksion te tipit linear per llogaritjen e nje kapaciteti QE te nje hyrjeje:

$$QE = (1330 - 0.7 * QG) * (1 + 0.1(ENT - 3.5)) \quad (\text{mjete/orë}) \quad [4.34]$$

ku: QG eshte fluksi "i trazuar" funksion i fluksit qarkullues QT, atij dales QS, te gjeresise se ishullit ndares SEP dhe e atij te unazes ANN. Fluksi "i trazuar" QG eshte dhene nga kjo shprehje:

$$QG = \left[ QT + \frac{2}{3} \cdot QS \left( 1 - \frac{SEP}{15} \right) \right] \cdot [1 - 0.085 \cdot (ANN - 8)] \quad [4.35]$$


variablat e te ciles tregohen ne fig. 4.8, me gjeresite e fluksset e shprehura ne njesite perkatese.

Nese  $SEP > 15m$  duhet thene se  $QS = 0$ , pra nuk ka influence ne futje. Kapaciteti varet pra nga hapesira e hyrjes e nga trafiku me "trazira", i perbere nga trafiku ne unaze ne afersi te hyrjes QT dhe nga ai dales. Turbullimi i trafikut dales eshte ne proporcion te zhdrojte me gjeresine e ishullit ndares SEP, deri ne disa ishuj te gjere mbi 15 m, qe eliminojne efektin e trafikut dales. Mundet te konsiderohet edhe vec trafiku dales ekuivalent me  $QS'$  i barabarte me:

$$QS' = QS \cdot \left( 1 - \frac{SEP}{15} \right) \quad [4.36]$$

duke marre  $QS' = 0$  kur  $SEP > 15m$ . Nga rezultatet franceze mund te verehet qe:

- variabli gjeometrik me i theksuar dhe gjeresia hyrese ENT, e matur nga prapa mjetit te ndaluar ne linjen e perparese. Eshte verejtur se per cdo rritje me nje meter, duke nisur nga nje vlere minimale 3.5 m, kapaciteti rritet me 10% (shih ekuacionin e QE)
- trafiku ne unazen QT nuk eshte i dallueshem, ne rastin e shume korsive qarkulluese, ne fluksin e jashtem e te brendshem, per thjeshtesi e per faktin se dallimi nuk ka pasur nje kuptim statistikor
- gjeresia e unazes nuk ka shume influence ne turbullimin ose traziren e trafikut QS



*Figura 4.9 – Parametrat per formulat e kapacitetit te rrrethrotullimeve*

Per percaktimin e kapacitetit ne hyrjet QE (koncept i ngjashem me ate te fluksit te ngopjes te kryqezimeve semaforike) te rrrethrotullimeve urbane perdoret nje procedure e bere nga CETUR e bazuar ne kete mardhenie:

$$QS' = \gamma^*(1500 - 0.38QG) \quad [4.37]$$

ne te cilen:

$$QG = b * QT + 0.2QS \quad [4.38]$$

dhe ku :

- per korsi te vecanta  $\gamma=1$ , per ato shumefishe  $\gamma=1.5$
- per  $ANN < 8m$  vlen  $b=1$ , ndersa per  $ANN > 8m$  dhe  $R > 20m$   $b=0.7$ , nese  $ANN > 8m$  e  $R < 20m$  vlen  $b=0.9$

Eksperiencia analoge ka patur edhe ne vende te tjera europiane (Gjermani, Zvicer), por si studimet, edhe rezultatet, kane qene shume te ngjashme me eksperienten franceze per te cilat menjanohen diskutimet relative.

#### *4.4.3 Krahasimi midis modeleve te prezantuara per llogaritjen e kapaciteteve te fluksave hyrese*

Krahasohen ketu tre metoda llogaritje te perdorura per vleresimin e kapaciteteve te degeve ne hyrje te kryqezimeve me rrrethrotullim, per ti studjuar ndryshimet qe lindin, me vlera te fluksit te barabarta te marra apriori. Metodat perkatese per kryqezimet me rrrethrotullim, qe do te krahasohen jane:

- *Metoda e Kimber (model anglez i natyres empirike)*
- *Metoda e Louah (model francez i natyres empirike)*

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

---

- *Metode llogaritjeje e perdorur ne Sidra (dhe ky i natyres empirike)*

Duke ditur ne fakt qe kapaciteti total i nje kryqezimi me rrrethrrrotulim eshte shuma e fluksave hyrese njeheresh nga cdo dege, ne menyre qe cdo hyrje te jete ne kushte saturimi, quhet kapacitet hyres  $C_e$ , per nje dege te vetme, ajo vlore e fluksit ne hyrje qe percakton formimin e radheve, dmth pranine e mjetave ne pritje per te bere manovren e hyrjes. Nje vlore e tille e fluksit eshte e ndikuar nga fluksi qarkullues, $Q_c$ , pra nga shperndarja e fluksave te ndryshem ne hyrje dhe dalje per deget e tjera, si dhe nga fluksi ne dalje,  $Q_u$ , per degen ne prove.

Ketu ne vazhdim do te krahasojme rezultatet e llogaritjeve te kapacitetit per nje hyrje qofte me 1 ose me 2 korsi te modeleve te listuar, duke zgjedhur vlerat referuese te meposhtme.

**Parametrat per rrrethrrrotullime me nje korsi:**

Diametri i jashtem, $De$ ,	35 m
Rrezja hyrese, $r_e$ ,	30 m
Kendi i hyrjes, $\varphi$ ,	30°
Gjeresia e unazes, $e_a$	6 m
Gjeresia e korsive hyrese, $e_c$	4.5 m
Gjatesia e pritjes, $l$	10 m
Numri i korsive ne unaze	1
Numri i korsive hyrese	1

**Parametrat per rrrethrrrotullime me 2 korsi:**

Diametri i jashtem, $De$ ,	80 m
Rrezja hyrese, $r_e$ ,	50 m
Kendi i hyrjes, $\varphi$ ,	30°
Gjeresia e unazes, $e_a$	10 m
Gjeresia e korsive hyrese, $e_c$	8
Gjatesia e pritjes, $l$	20 m
Numri i korsive ne unaze	2
Numri i korsive hyrese	2

Rotondo me 1 korsi	$Q_e$ (mjete/ore)	$Q_e$ (mjete/ore)	$C_e$ (mjete/ore)	$Q_e/C_e$
Kimber	642	658	995	0.65
Sidra	642	658	781	0.82
Louah	642	658	897	0.71

Rotondo me 1 korsi	$Q_e$ (mjete/ore)	$Q_e$ (mjete/ore)	$C_e$ (mjete/ore)	$Q_e/C_e$
Kimber	1063	1079	1852	0.57
Sidra	1063	1079	1239	0.85
Louah	1063	1079	1568	0.68

Nga rezultatet e listuara ne tabele dallohen menjehere ndryshimet midis modeleve te ndryshme llogaritese. Faktikisht vihet re qe, metoda me e kujdeshme dhe strikte eshte ajo e Sidra, meqenese jane marre parasysh ne llogaritje vlerat e kapacitetit si nga grafiket kapacitet/fluks te manualit te programit ashtu edhe te manualit HCM 2000. Vlerat baze te programit te “critical gap” dhe “follow up time” do te jepnин rezultate me te mira nga ato te listuara me siper. Gabimi dhe ndryshimet qe ndodhin jane te rendit 20%, per sa i perket vlerave ne kryqezimet me 1 korsi, ndersa shkon deri ne 30%, ne kryqezimet me 2 korsi. Metoda llogaritese e Louah jep rezultate te ndermjetme midis Sidra dhe Kimber. Duhet kujtuar qe, vlerat e llogaritjes qe jane nxjerre ne modelin e Kimber jane llogaritur, pa patur parasysh fluksin ngacmues, qe duke zgjedhur daljen pasardhese te menjehershme, nuk merren parasysh ne llogaritje per reduktimin e kapacitetit. Kjo sjell nje mbidimensionim te kapacitetit ne hyrje te unazes, sic eshte paraqitur ne tabela. Modele te tjera te perdorura marrin parasysh kete efekt, nepermjet perdorimit te koeficienteve te reduktimit ne formulat llogaritese.

#### **4.5 Perafrimi i bazuar ne teorine e “gap acceptance”**

Percaktimi i kapacitetit dhe vonesave ne rrrethrrrotullime bazohet ne teorine e “gap acceptance”, pra ne sjelljen e shoferit, qe vlereson sasine e rrymes qarkulluese dhe e krahason me vlerat e “voneses se pranueshme” e gatshme per tu humbur dhe kohes se nevojshme per hyrje.

Rezultatet e ketyre studimeve kane nxerre ne pah nje numer te konsiderueshem menyrash sjelljeje ne trafik, qe ndikojne ne analizen e kapacitetit dhe te vonesave. Keto jane:

- mjetet hyrese ne per gjithesi i jepin perpareti atyre qarkulluese ne unaze edhe nese dalin ne hyrje pasardhese. Shoferet hyres shpesh nuk dine nese nje mjet qarkullues ne te majten e tyre del ne daljen pasardhese, apo nese, vazhdon rrrethrrrotullimin, keshtu qe tentojne te jepin perpareti atyre qarkullues, edhe kur unaza ka nje karrekhate me 2 ose me shume korsi. Nje perjashtim ka kur mjetet hyjne nga nje korsi ndihmese vetem per kthimet djathtas. Nese kjo korsi ndihmese dhe kthesa hyrese, jane projektuar ne menyre te tille, qe mjetet hyrese jane te mbrojtur nga trafiku qarkullues, shoferet hyres vazhdojne, pa dhene perpareti atyre qarkullues, pra pa patur kushtezime dhe vonesa;

- ne hyrjet me shume korsi mjetet hyjne njekohesisht perkrah mjeteteve te tjera hyrese ne te njejten hyrje;
- drejtuesit e mjeteteve hyrese ne korsi te ndryshme te se njejtes hyrje kane sjellje te ndryshme;

- zakonisht mjetet dalese kane efekte te vogla mbi ato hyrese te te njejtes dege, pervec rastit kur ato kane shpejtesi te madhe pershkuese, ose rrerrotullimi eshte i vogel dhe mjetet hyrese ne kete rast kane veshtiresi te kuqtojne, nese nje mjet qarkullues do te dale ose jo.

Keto vezhgime kane ndikuar ne llogaritjen e kapacitetit dhe te vonesave. Hipoteza kryesore e ardhur nga te dhenat pasardhese eshte qe, drejtuesit sillen ndryshe ne cdo korsi hyrese te nje perafrimi te vecante. Kjo do te thote qe, cdo korsi hyrese do te kete kapacite te ndryshme dhe vonesa, keshtu qe per nje numer dyfish korsish hyrjeje, ne per gjithesi nuk korrespondon nje dyfishim ne kapacitetin hyres.

Termat me te perdorshem per te percaktuar sjelljen “gap acceptance” jane:

- critical acceptance , ta
- follow up time, tf

“*Critical acceptance gap*” eshte distance minimale ne nje rryme trafiku qe do te jete e pranueshme nga nje mase e madhe e shofereve. “Follow up time” eshte vonesa minimale e mjeteve te rrymes me te vogel, qe hyjne ne hapesirat e perkoreshme me te gjata te trafikut qarkullues.

Sipas HCM-se (Manuali 2000), “critical gap” eshte intervali minimal i kohes ne rrugen me shume trafik, qe lejon hyrjen ne kryqezim nga ana e mjetit te ardhur nga rruga me pak e rendesishme, nderkohe qe “follow up time” perfaqeson kohen ndermjet nisjes se nje mjeti nga rruga me e vogel dhe nisjes se mjetit pasardhes, qe perdor te njejten hapesire per futjen ne rrugen me te madhe, duke supozuar kushtet e rradheve te vazhdueshme ne rruget me rendesi te vogel.

“Gap acceptance” me terma bashkekohore shprehet si vlere mesatare per te gjithe shoferet. Ne menyre analoge flitet per kapacetet mesatar te parashikuar dhe per vleren mesatare te voneses. Supozohet qe, te gjithe shoferet perbejne nje popullim homogen dhe per kete sillen ne te njejten menyre, cdo here qe i ofrohet atyre nje hapesire (gap). Supozohet gjithashtu qe dhe keto sillen sipas parimit: nje shofer nuk refuzon nje hapesire te disponueshme per te pranuar nje me te shkurter me vone, dhe me shume te gjithe shoferet pranojn ne hapesire me te madhe kritike ( Plank dhe Catchpole 1984-1986 – Troutbeck 1988).

Per shkak te sjelljeve te ndryshme te shofereve ne hyrje te ndryshme, ne secilen prej tyre do te kene parametra te ndryshem te “critical gap” dhe “follow up”. Ne realitet, edhe pse 2 parametrat e permendur jane variabla te rastit, ne praktiken e projektimit perdoret gati nje vlere e vetme.

#### *Analiza dhe organizimi i te dhenave te trafikut*

Ky kapitull jep nje teknike analitike te ardhur nga eksperienca dhe praktika australiane, qe mund te jape rezultate te mjaftueshem sakte (Mainroads 1990).

**Tema e Doktoraturës:**


**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

Ne situata, ku nuk eshte e kerkuar nje grade tjeter sakte sie, figurat 4.11 dhe 4.13 mund te perdoren per te arritur vleresime te per gjithshme te kapacitetit ne rrrethrotullime.

Kapaciteti i nje rrrethrotullimi ndikohet nga gjeometria i tij, nepermjet parametrave te “critical gap”. Procedura per analizen e kapacitetit te cdo hyrjeje eshte ajo e pershkruara ne vazhdim.

Levizjet dhe perberja e qarkullimit;

Te dhenat e trafikut dhe varacionet relative stokastike dhe ciklike, duhet te rigrupohen ne flukes hyrese, flukse qarkulluese dhe flukes dalese. Figura 4.10 tregon konvertimin nga levizje tipike te kthesave te nje kryqezimi tradicional me flukse hyrese, qarkullues dalese nga nje rrrethrotullim.



*Figura 4.10 – Numri i korsive te kerkuara*

Flukset duhet te shprehen ne njesi mjete dhe pasagjere (pcu's), duke shumezuar numrin e mjeteve te ndryshem nga autoveturat per faktore te ndryshem ekuivalentimi.

Kur numri i autokarrove eshte me i vogel se 5% te fluksit total te mjeteve, ato mund te konsiderohen me nje njesi ‘mjete pasagjere’ (pcu's). Kur volumet e flukseve te renda jane me te medha se 5%, autokarrot duhet te konvertohen ne pcu's duke pershtatur nje faktor ekuivalence te barabarte me 2 pcu's, nderkohe qe nje mjet fizarmonike konsiderohet me 3 pcu's. Motocikletat dhe mjetet e tillë mund te konsiderohen me 0.5 pcu's. Nje vleresim me i kujdeshem mund te behet duke pershtatur faktore te ndryshem te ekuivalences per hyrjet dhe per karrehaten qarkulluese. Per shembull, motocikletat mund te konsiderohen afersisht 0.2 pcu's ne hyrje, ndersa kur pershkojne unazën, ato mund te konsiderohen 0.8 pcu's. Autokarrot hyrese dhe ato qarkulluese mund te konsiderohen respektivisht 1.9 dhe 1.7 pcu's.

**Korsite hyrese dhe korsite qarkulluese:**

Numri i korsive hyrese do te jete per gjithesht i percaktuar nga numri i korsive te karrekhates prane. Megjithate, normalisht, nje hyrje mund te jete zmadhuar, ose ngushtuar, sidomos nese ka flukse shume te medha. Zakonisht pershtatet nje numer korsish qarkulluese i barabarte me numrin e korsive hyrese ne cdo dege. Kjo hipoteze, nese eshte e nevojshme, mund edhe te mos merret parasysh.

Ne figuren 4.10 jepet nje grafik per zgjidhjen i nje rrrethrrrotullimi me korsi teke, ose me shume korsi ne baze te flukseve hyrese dhe qarkulluese. Zonat e hijezuara tregojne zonat e tranzicionit, ku zgjedhja nuk eshte unike. Per shembull, nese kushtet ne rrrethrrrotullim japin nje pike te perfshire midis fashave te hijezuara ne figuren 4.10, atehere do te pranohet nje rrrethrrrotullim me 2 korsi ne funksion te gjeometrise se hyrjes dhe nje grade te pranueshme te ngopjes. Figura 4.10 bazohet ne nje grade ngopje te pranueshme me te vogel se 0.8. Nga projekt funksional i rrrethrrrotullimit ose nga dimensionet efektive (nese nuk eshte ndertuar akoma) duhen fiksuar vlerat per:

- diametrin brendashkruar  $D_i$  ;

- numrin e korsive te hyrjes,  $n_e$  ;

$n_e = 1$  per hyrjet me gjeresi me pak se 6 m.

$n_e = 2$  per hyrjet me gjeresi nga 6 ne 10 m.

$n_e = 1$  per hyrjet me gjeresi me shume se 10m.

- numri i korsive qarkulluese  $n_c$  :

$n_c = 1$  per karrekhate te gjera me pak se 10 m.

$n_c = 2$  per karrekhate te gjera nga 10 ne 15 m.

$n_c = 1$  per karrekhate te gjera me shume se 15 m.

- gjeresia mesatare e korsise se hyrjes, (ose rapporti i gjeresise me numrin e korsive te hyrjes)

Ne fund, duhen klasifikuar korsite e hyrjes ne “korsi dominante” dhe “korsi sub-dominante”, sepse kur ne nje afrim kemi 2, ose me shume korsi hyrese, nje nga keto “dominon” mbi te tjerat. Ne praktike ndodh qe shoferet e kesaj korsie tentojne te influencoje ne sjelljet e shofereve ne korsite e tjera hyrese. Korsia hyrese me fluksin maksimal eshte zgjedhur si dominantja, keshtu qe te tjerat do te jene “sub-dominante”. Nese kemi 3 korsi hyrese, 2 do te jene sub-dominante dhe 1 do jete dominante. Nese kemi vetem 1 korsi hyrese ne nje afrim, atehere ajo korsi do te konsiderohet dominante.

**Vleresimi i parametrave te “gap acceptance” kritik.**

Parametrat e “gap acceptance” varen nga gjeometria e hyrjes. Gjeometrit qe ofrojne nje rrule te lehte shoqerohen me vlera te uleta te gap acceptance. Keto parametra jane edhe baze te funksionit te fluksit qarkullues:

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Ne prezence te flukseve qarkullues te larte, shpejtesite pershkuese te unazes jane te uleta dhe shoferet jane me te predispozuar te pranojne hapesira me te vogla. Mund te ndodhe qe, nese ka flukse te larte qarkullues, shoferet ne unaze, ngadalesojne dhe lejojne shoferet hyres te futen ne unaze. Kjo sjell “shperndarjen e perparese” ose dhe ndryshimin e rregullit te perparese.

a) *Per nje hyrje me nje korsi*

Tabela 4.2 liston “follow up headway” te rrymes dominuese ( $t_{fd}$ ). Ne rast se kemi nje korsi te vetme qarkulluese, ( $n_c=1$ ), keto vlera do te perdoren per rrymen hyrese. Nese ne fakt kemi 2, ose me shume korsi qarkulluese ( $n_c=2$  ose 3), atehere vlerat e tabeles 4.2 duhet te rriten me 0.39.

Diametri i brendashkruar (m)	Fluksi qarkullues (mjete/ore)					
	0	500	1000	1500	2000	2500
20	2.99	2.79	2.6	2.4	2.2	2
25	2.91	2.71	2.51	2.31	2.12	1.92
30	9.83	2.63	2.43	2.24	2.04	1.84
35	2.75	2.55	2.36	2.16	1.96	1.77
40	2.68	2.48	2.29	2.09	1.89	1.7
45	2.61	2.42	2.22	2.02	1.83	1.63
50	2.55	2.36	2.16	1.96	1.73	1.59
55	2.49	2.3	2.1	1.9	1.71	1.51
60	2.44	2.25	2.05	1.85	1.65	1.46
65	2.39	2.2	2	1.8	1.61	1.41
70	2.35	2.15	1.96	1.76	1.56	1.36
75	2.31	2.11	1.98	1.72	1.52	1.33
80	2.27	2.08	1.88	1.68	1.49	1.39

*Tabela – 4.2 Follow-up Headways ( $t_{fd}$ ) e rrymes dominante ne s (vlera fillestare)*

b) *Per hyrjet ne korsite e shumefishuara*

Per te vleresuar flukset e korsive hyrese ne afrime me dy apo me shume korsi, mund te hipotetizohet se, drejtuesit e mjeteve, qe deshirojne te kthehen ne te majte, do perdonin korsine ne te majte te hyrjes dhe ata qe duan te kthehen ne te djathe, do te perdonin korsine ne te djathe (llogjikisht mjetet qe ecin drejt mund te zgjedhin ne menyra te ndryshme cilen korsi te perdonin). Ne disa situata korsite mund te

shenohen me shenje e shigjeta mbi shtresen asfaltike, per te kufizuar manovra specifike. Per te kompletuar flukset e korsive hyrese, trafiku i drejtë mund te shperndahet ne menyre te barabarte mbi korsite qe i jane caktuar atij. Ndersa udhezimet e meparshme na jepin sistemimin me te mire, dhe eshte treguar se shperndarjet e trafikut neper korsi, nuk infuencojne mjaftueshem ne vleresimin e kapacitetit midis korsive.

Sic thame, korsia hyrese me fluksin maksimal ne afritet eshte quajtur “korsia dominuese” dhe trafiku ne korsi eshte quajtur ndryshe trafiku, ose rryma dominuese, korsite e tjera permbajne rryma sub-dominuese.

Parametrat e intervalit kritik per nje afrim me dy ose me shume korsi jane vleresuar duke perdorur tabelen 4.2, 4.3, 4.4 dhe 4.5.

Tabela 4.2 jep vlerat e “follow up headway” per rrymen dominuese. Keto vlera pershtaten, ne qofte se numri i korsive hyrese ndryshon nga numri i korsive qarkulluese. Faktoret korrigjues jane dhene ne tabelen 4.4.

Tabela 4.5 e “follow up headway” per rrymen sub-dominuese ( $t_{fs}$ ) si nje funksion i “follow up headway” te rrymes dominuese ( $t_{fd}$ ) eshte rapporti i fluksit dominues mbi atet rrymes sub-dominuese.

Numri i korsive te unazës	1			>1		
	3	4	5	3	4	5
Gjeresia mesatare e korsise hyrese	3	4	5	3	4	5
Fluksi qarkullues (mjete/orë)	2.32	1.98	1.64	20.4	1.7	1.36
200	2.26	1.92	1.58	1.98	1.64	1.3
400	2.19	1.85	1.52	1.92	1.58	1.24
600	2.13	1.79	1.45	1.85	1.51	1.18
800	2.07	1.73	1.39	1.79	1.45	1.11
1000	2.01	1.67	1.33	1.73	1.39	1.1
1200	1.94	1.6	1.26	1.67	1.33	1.1
1400	1.88	1.54	1.2	1.6	1.26	1.1
1600	1.82	1.48	1.14	1.54	1.2	1.1
1800				1.48	1.14	1.1
2000				1.41	1.1	1.1
2200				1.35	1.1	1.1
2400				1.29	1.1	1.1
2600				1.23	1.1	1.1

*Tabela 4.3 – Raporti midis Critical Gap Acceptance dhe Follow up Headway*

**Tema e Doktoraturës:**  
**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

Numri i korsive te unazes	Numri i korsive te hyrjes		
	1	2	3
1	0	-0.39	
2	0.39	0	-0.39
3		0.39	0

*Tabela 4.4 – Kohet e kalimit per Follow-up headway te rrymes dominante*

Follow-up headways te rrymes dominante	Follow-up headways te rrymes nen dominante				
	Raporti i flukseve dominante/ nendominante				
	1.0	1.5	2.0	2.5	3.0
1.5	2.05	1.99	1.94	1.89	1.84
1.6	2.1	2.07	2.05	2.02	1.99
1.7	2.15	2.15	2.15	2.15	2.15
1.8	2.20	2.23	2.25	2.28	2.30
1.9	2.25	2.30	2.35	2.40	2.46
2	2.30	2.38	2.46	2.53	2.61
2.1	2.35	2.46	2.56	2.66	2.76
2.2	2.41	2.53	2.66	2.79	2.92
2.3	2.46	2.61	2.76	2.92	3.07
2.4	2.51	2.69	2.87	3.05	3.23
2.5	2.56	2.76	2.97	3.17	3.38
2.6	2.61	2.84	3.07	3.30	3.53
2.7	2.70	3.92	3.17	3.40	3.69
2.8	2.80	3.00	3.28	3.56	3.84
2.9	2.90	3.07	3.38	3.69	4.00
3.0	3.00	3.15	3.48	3.82	4.15

*Tabela 4.5 – Follow-up headways e rrymave nen dominante*

Vlerat e intervalit te lejuar kritik per cdo korsi jane dhene nga produkti i “follow up headway” (nga tabelat 4.2 dhe 4.3) per te dhenat e tabellez 4.3. Sic e thame, vlerat e intervalit te lejuar kritik duhet te llogariten per cdo korsi hyrese.

**Shembull i perdomimit te tabellez 4.2:** Duke ditur nje diameter prej rrerh 35 m (duke hipotetizuar nje korsi hyrese ne unaze), ka nje vlore te “follow up headway” te barabarte me 2.75 sek, ne qofte se fluksi qarkullues ne unaze nuk ekziston; nje vlore prej 2.55 sek, ne qofte se fluksi qarkullues eshte prej 500 mjete/h e keshtu me rradhe; vihet re se duke rritur si fluksin ne unaze edhe diametrin ne rrethrrrotullim, zvogelohet “follow up”, meqe cdo mjet ka mundesi te vogla qe te hyje dhe eshte i detyruar te rrise shpejtesine e levizjes. Per vlera te ndermjetme te variablate, qe nuk jane ne tabelle eshte bere interpolim. Pra si perfundim na duhet te kujtojme qe, tek tabela 4.4 mund te vendosim disa korrigjime te vlerave te “follow up time” te

shenuara, ne qofte se kane gjeometri me me shume korsi. Ne fakt sa me i madh eshte numri i korsive ne hyrje (e barabarte me korsite qarkulluese), aq me i vogel eshte “follow up time”, nderkohe qe, sa me i madh eshte numri i korsive qarkulluese (i barabarte me korsite ne hyrje), aq me i madh do te jete dhe “follow up time”.

**Shembull i perdonimit te tabelles 4.3:** Duke patur pranine ne rrrethrotullim te nje korsie te vetme me gjeresi 4m, me nje fluks qarkullues rreth 1000 mjete/ore, ka nje raport midis intervalit kritik dhe kohes se parakalimit prej 1.67 sek; vihet re se duke rritur, si fluksin ne unaze, numrin e korsive te rrrethrotullimit, ashtu edhe gjeresine e korsive, zvogelohet rapporti ne objekte.

Per vlera te ndermjetme te variablave qe nuk jane ne tabele eshte bere interpolim.

**Shembull i perdonimit te tabelles 4.5:** Duke ditur nje kohe parakalimi te fluksit dominues prej 2 sek, merret nje vlere e kohes se parakalimit te fluksit sub-dominues e barabarte me 2,3 sek, ne qofte se rapporti ndermjet dy flukseve te konsideruara (dominues/sub-dominues) eshte 1; dhe nje vlere prej 2,38 sek, ne qofte se ky rapport eshte 1,5 e keshtu me rradhe. Per vlera te ndermjetme te variablave, qe nuk jane ne tabele, eshte bere interpolim.

**Karakteristikat e trafikut qarkullues.** Meqenese normalisht drejtuesit e mjeteve hyrese u japin perparesi te gjitha mjeteve qarkulluese, trafiku qarkullues mund te jete i konsideruar si te ishte i gjithi i nje korsie. Megjithese, jane disa karakteristika te trafikut qarkullues, qe ndryshojne me fluksin dhe numrin e korsive te unazes.

Me rritjen e numrit te korsive te unazes zvogelohet “headway”mesatar midis mjeteve te grupuara ne te gjitha korsite. Ne qofte se jane dy, apo me shume korsi qarkulluese, atehere “headway”mesatar ( $\tau$ ) midis mjeteve te grupuara, eshte rreth 1 sek dhe ne qofte se eshte vetem nje korsi, ajo vlen 2 sek.

Ne rastin kur nje karrexitate qarkulluese , me nje gjeresi te njejte, ose me te madhe se 10 m, e perdonur nga nje fluks me i madh se 1000 mjete/ore, mund te hipotetizohet qe ne praktike fluksi te ndahet ne dy rryma dhe “headway” mesatar midis dy mjeteve te grupuara ( $\tau$ ) te jete 1sek (tabela 4.6).

Fluksi qarkullues	Gjeresia e karrexitates qarkulluese			
	< 10m		$\geq 10m$	
	Nr.i korsive efektive	Headway midis mjeteve te grupuara( $\tau$ )(s)	Nr.i korsive efektive	Headway midis mjeteve te grupuara( $\tau$ )(s)
<1000 mjete/h	1	2	2	1
>1000 mjete/h	1(o2)	2(o1)	2	1

Tabela.4.6

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

*Headway mesatar midis mjeteve te grupuara ne trafikun qarkullues ( $\tau$ ) dhe numrit te korsive efektive ne unaze*

Numri efektiv i korsive qarkulluese	1	>1
Headway mesatar midis mjeteve te grupuara , $\tau$ ,(s)	2.0	1.0

Fluksi qarkullues(mjete/h)		
0	0.250	0.250
300	0.375	0.313
600	0.500	0.375
900	0.625	0.438
1200	0.750	0.500
1500	0.875	0.563
1800	1.000	0.625
2000		0.667
2200		0.708
2400		0.750
2600		0.792

*Tabela 4.7 Pergindjet e makinave te grupuara,  $\Theta$*

Kur vleresohen “follow up headway” mund te jete e nevojshme te konsultohemi me tabelen 4.4.

Perqindja e mjeteve te grupuara  $\Theta$  (apo qofte numri i mjeteve qe akumulohen ne hyrje te degeve te ndryshme qe jane te gatshme per hyrjen ne unaze) eshte e influencuar nga fluksi qarkullues, nga numri i korsive efektive qarkulluese (e karakterizuar nga “headway” mesatar midis mjeteve) dhe nga afersia e rrethrrrotullimeve ne kryqezimet semaforike, ose situata te tjera qe rritin rigrupimet. Troutbeck (1989) na jep ekuacione per te vleresuar perqindjet e mjeteve te lira, qe do te thote ato ta pagrupuara. Nga keto ekuacione jane llogaritur vlera per perqindjet e mjeteve te grupuara; keto vlera jane te raportuara ne tabelen 4.7.

Supozohet se vlerat e dhena ne kete tabele, te korrigohen me pas ne funksion te afersise te rrethrrrotullimeve me kryqezimet semaforike, apo situata te tjera, qe influencoje kushtet e trafikut ne hyrje dhe fluksin qarkullues ne rrthrrrotullim. Vlerat duhet te jene te rritura, ose te zvogeluara, deri ne nje maksimum prej 0.2 sek, ne funksion te rigrupimeve te shkaktuara.

Perqindja e mjeteve te grupuara hipotetizohet ne intervalin nga 0, per trafikun e zakonshem, ne 0.8 per trafikun shume rradhesh. Vlera shume te rrituara, si midis 0.8 dhe 0.9, kane qene te vezhguara vetem ne raste ekstreme. Kjo eshte ekuivalente me

nje gjatesi te ‘plotone’ nga 1 ne rreth 3÷4 mjete, ne pjesen me te madhe te kushteve dhe mbi 10 mjete ne kushtet me te keqja.

**Shembull i perdorimit te tabelës 4.7:** Duke marre si te dhene nje korsi qarkulluese (duke hipotetizuar nje korsi ne hyrje dhe ne unaze edhe nje “headway” mesatar prej rreth 2 sek), merret nje perqindje e mjeteve te gruvara e barabarte me 50%, ne qofte se fluksi qarkullues ne unaze eshte prej 600 mjete/h; nje vlera prej 75%, ne qofte se fluksi qarkullues eshte prej 1200 mjete/h e keshtu me rradhe; thuhet se, duke u rritur fluksi, rritet perqindja e mjeteve te gruvara; ne te kundert duke rritur numrin e korsive ne hyrje, zvogelohet e njejtë perqindje.

Per vlera mesatare te variablave qe nuk jane ne tabele eshte bere interpolim.

**Kapaciteti dhe mbisaturimi i nje rrrethrotullimi.** Kapaciteti absorbues i cdo korsi hyrese eshte llogaritur nga parametrat e “gap acceptance” te korsise ne hyrje ( $t_a$  dhe  $t_f$ ), te aplikuara ne korsine dominuese dhe ne cdo korsi sub-dominuese hyrese dhe karakteristikat e fluksit ( $O_c, t, \Theta$ ).

$$C = \frac{3600(1-\Theta)qc * e^{-\lambda(t_a - \tau)}}{1 - e^{-\lambda * t_f}} \quad [4.39]$$

Ku:


- C = kapaciteti absorbues i cdo korsi (mjete/ore);
- $\Theta$  = perqindja e mjeteve te gruvara ne rruget qarkulluese;
- $q_c$  = fluksi i mjeteve ne rruget qarkulluese;
- $t_a$  = intervali i lejuar kritik ne varesi te korsise dominuese apo sub-dominante (sek)
- $t_f$  = vonesa ndermjet mjeteve (ne perparesi), ne varesi te korsive dominuese dhe sub-dominuese (sek)
- $\tau$  = perparezia minimale ne rruget qarkulluese, e lidhur kjo eshte nga relacioni:

$$\lambda = \frac{(1-\Theta)qc}{1 - \tau * qc} \quad [4.40]$$


Nenvizohet se, kapaciteti i llogaritur ne ekuacionin [4.38] eshte ai i parashikuar ne situate te konsoliduar te maksimumit te fluksit hyres, dhe nuk paraqet fluksin praktik (duke pare diskutimin e mesiperme ne graden e mbisaturimit).

Figurat 4.12 dhe 4.13 mund te perdoren per te marre nje vleresim te shpejte, per ta perdorur ne planifikimin e nje projekti te parashikuar te nje rrrethrotullimi per nje vendndodhje te caktuar.

Figura 4.12 i referohet nje rrrethrotullimi me nje korsi ne hyrje me 4 m gjeresi dhe nje korsi qarkulluese, nderohe figura 4.13 i referohet nje rrrethrotullimi me dy korsi ne hyrje me 4 m gjeresi dhe dy korsi qarkulluese. Ekzistojne diagrama qe pasqyrojne kushtet kur jane rrrethrotullimet ne perdorim.



*Figura 4.11 – Kapaciteti ne hyrje te nje rrethrrrotullimi qe ka nje korsi hyrese te gjere 4 m dhe vetem nje korsi qarkulluese*



*Figura 4.12 – Kapaciteti ne hyrje te nje rrethrrrotullimi qe ka dy korsi hyrese te gjera 4 m dhe dy korsi qarkulluese*

Per flukse qarkulluese shume te larta (me te medhenj se 1700 mjete/ore per korsi me nje kalim, ose 3400 mjete/ore per korsi me shume kalime), kapaciteti i hyrjes ne ekuacionin e  $w_h$  i afrohet zeros. Ne raste te ngjashme me keto mund te supozohet qe te merret nje kapacetet hyres minimal. Shkalla e ngopjes te nje korsie hyrjeje jepet nga rapporti i fluksit te arritjes dhe kapacitetit te hyrjes (absorbimit) te korsise:

$$x = Qm/C \quad [4.41]$$

ne te cilen:

Qm - fluksi ne arritje i korsise hyrese ne mjetë/ore

C - kapaciteti i korsise hyrese ne mjetë/ore, i llogaritur me ekuacionin e  $w_h$  ose e treguar ne figuren e mesiperme (4.13)

Gjendja e ngarkimit per nje korsi hyrese, per nje funksionim te kenaqshem, gjate periudhes se projektimit duhet te jete me e vogel se 0.8-0.9, megjithese kjo nuk eshte gjithmone e praktikueshme.

Brenda ketij intervali qe tregon gjendjen e ngarkimit, projektuesit duhet qe te kene parasysh dhe vonesat si matjet, ne menyre qe te kemi nje funksionim sa me te pershtashem.

Shkalla maksimale e ngarkimit (praktikisht) korrenspondon me konceptin e “kapacitetit praktik” (kapaciteti punues i korsise)

Per shembull: nqs shkalla e ngarkimit x eshte e barabarte me 0.85, kapaciteti praktik (kapaciteti punues i korsise) do te jete  $0.85 \cdot C$ , ku C eshte kapaciteti hyres i llogaritur me pare.

#### *4.5.1. Vonesat ne rrethrrrotullime*

Vonesa ne rrethrrrotullime perbehet nga dy elemente, te cilat mund ti grupojme ne dy grupe:

- 1) vonesa nga pritja
- 2) vonesa gjeometrike

Vonesa nga pritja vjen per shkak te kohes, qe u duhet shofereve te mjeteve te pranojne nje distance ne trafikun qarkullues, (ne menyre qe te mos krijohet kaos ne rrethrrrotullim)

➤ Vonesa gjeometrike mund te jete:

a) vonesa, qe shoferet pesojne per shkak te uljes se shpejtesise, (shpejtesi e cila lejon qe te kalohet rrethrrrotullimi), per te kaluar rrethrrrotullimin dhe pastaj te vazhdojne ecjen me shpejtesi normale te korsise perkatese.

b) vonesa, qe shoferet pesojne per shkak te distances, qe duhet te kene nga mjetet e e tjera, dhe me pas te marrin shpejtesine qe duhet per te kaluar rrethrrrotullimin dhe me pas te ecin me shpejtesi normale ne korsi. Perjashtohet koha qe duhet per te arritur nje distance te pranueshme nga mjeti ne mjet.

Ne disa raste eshte me e pershatshme, qe te meret parasysh vetem vonesa nga pritja, per shembull kur kerkohen vetem rezultate te peraferta, ose kur ne kryqezime vendosen tabelat STOP dhe PERPARESI.

Ne keto raste, vonesat gjeometrike ne trafikun hyres nga rruget sekondare, qe vijne nga anet e rruges kryesore (qe jane te kontrolluara), shkaktojne te njejtën vonese si ne nje rrrethrrrotullim.

Ne raste te tjera eshte e mundur qe te merren parasysh te gjitha vonesat, pra vonesat totale, per shembull, kur rezulatat jane perdonur per te bere nje krahasim mes kalimeve te cilat kane semafore, ose ne analiza ekonomike.

Eshte e qarte qe vonesa totale jepet nga shuma e voneses nga pritja dhe voneses gjeometrike.

#### Vonesa nga pritja

Per te llogaritur vonesen mesatare nga pritja, ne fillim llogaritet vonesa minimale per kushte ku trafiku hyres eshte shume i ulet, duke perdonur relacionin

$$wh = \frac{e^{\lambda(t-a-\tau)}}{(1-\theta)qc} - ta - \frac{1}{\lambda} + \frac{\lambda\tau^2 - 2\tau\theta}{2(\lambda - \tau + 1 - \theta)} \quad [4.42]$$

Ne te cilen parametrat e distances se pranueshme  $t$ ,  $T$ ,  $A$  dhe  $\theta$  jane ato te ekuacionit (4.38) dhe fluksi qarkullues q eshte i shprehur ne mjete/sek.

Formula per te llogaritur vonesen mesatare nga pritja per mjete, eshte e njejtë per te gjitha rastet dhe eshte kjo :

$$wm = wh + 900T \left( Z + \sqrt{Z^2 + \frac{mx}{ct}} \right) \quad [4.43]$$

ku:

$w_m$  - vonesa mesatare per mjete ne sekonde

$w_h$  - vonesa minimale ne sekonda, kur trafiku hyres eshte shume i ulet nga ekuacioni per llogaritjen e  $w_h$

$T$  - zyrtarja e periudhes qe i referohet llogaritjes se fluksit ne ore, per shembull intervali i kohes gjate se ciles konsiston nje kerkese mesatare ne fluksin hyres  $Q_m$  (perdoret 1 ore, 0.5 ore, ose 0.25 ore)

$Z-x-l$ ;

$x$  - shkalla e saturimit te korsise hyrese

$C$  - kapaciteti i korsise hyrese ne mjete/ore

$m$  - nje parameter vonese i cili jepet nga  $m=w^*c/450$

Termi i dyte ne ekuacionin per llogaritjen e  $w_m$  nenkupton vonesen nga pritja qe duhet te kete ne korsi hyrese.

#### Vonesa gjeometrike

Vonesa gjeometrike totale per mjetet varet dhe nga fakti qe ato ndalen ose jo, ne hyrje te rrrethrrrotullimit, (ndalojne nqs eshte tabela STOP per ti dhene perparese mjeteve ne unaze). Nje metode per te llogaritur vonesen mesatare gjeometrike eshte kjo e meposhtmja:

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

$$d_g = P_s d_s + (1 - P_s) d_u \quad 4.43$$

Ne te cilen:


$P_s$  - perqindja e mjeteve hyrese qe duhet te ndalojne;

$d_s$  - vonesa gjeometrike per mjetet qe duhet te ndalojne;

$(1-P_s)$  - perqindja e mjeteve hyrese qe nuk duhet te ndalojne;

$d_u$  - vonesa gjeometrike per mjeten qe nuk duhet te ndalojne;

Perqindja e mjeteve hyrese qe duhet te ndalojne,  $P_s$ , mund te merret duke perdorur figuren 4.12 ne funksion te numrit te korsive te unazes. Kjo perqindje varet nga fluksi ne korsite hyrese dhe ne korsite e unazes. Rritja e ketyre flukseve do te rrise perqindjen e mjeteve hyrese, qe do te duhet te ndalojne. Vija pothuajse e drejte ne figuren 4.12 eshte nje funksion i fluksit qarkullues dhe varet nga parametrat e hapesires (distances) se pranuar dhe nga niveli i grupimit ne rrymen qarkulluese.



*Figurat 4.13 – Perqindja e mjeteve te ndaluara ne nje rrethrrrotullim tek*

Tabela 4.8 dhe 4.9 jane zhvilluar per te dhene nje vleresim te kenaqshem te  $d_s$  dhe te  $d_u$  dhe lejojne qe te llogaritet vonesa gjeometrike, per cdo hyrje te rrethrrrotullimit.

Vonesa gjeometrike eshte e ndryshme per cdo manover (kthim majtas, kthim djathtas, perpara) ne cdo hyrje dhe duhet te llogaritet vec e vec per secilen nga keto situata.

Shpejtesia e arritjes (km/ore)	Distanca * perreth rrethrrrotullimit D(m)	Shpejtesia e negocijimit nepermjet rrethrrrotullimeve Vn (km/ore)							
		15	20	25	30	35	40	45	50
40	20	10	8	7	7	7			
40	60	19	15	12	9	7			
40	100		22	17	13	10			
40	140				18	14			


**Tema e Doktoraturës:**  
**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

40	180					18			
60	20	13	11	10	10	10	10	10	10
60	60	23	18	15	13	10	10	10	10
60	100		26	21	18	15	12	10	10
60	140				22	19	15	12	10
60	180					23	19	15	10
80	20	17	15	13	13	13	13	13	
80	60	26	22	19	17	14	13	13	
80	100		29	25	21	19	16	13	
80	140				26	23	19	16	
80	180					27	23	19	
100	20	20	18	17	17	17	17	17	
100	60	30	25	22	20	18	17	17	
100	100		33	28	25	22	20	17	
100	140				30	26	23	20	
100	180					30	27	24	

*Tabela 4.8 – Vonesa gjeometrike per mjetet e “ndaluara”*

Vonesa mesatare e pote

Vonesa mesatare e pote eshte shuma e voneses nga pritja dhe asaj gjeometrike. Vonesa totale nuk do te jete e njejtë per te gjitha mjetet qe perdorin korsi hyrese te ndryshme dhe qe kryejne manovra te ndryshme.



*Figurat 4.14 – Perqindja e mjetave te ndaluara ne nje rrrethrotullim me korsi shumefiske*  
Vonesa mesatare e pote per mjetet ne nje hyrje duhet te jete e llogaritur duke perdorur perqindjen e mjetave, te cilet bejne secili nga nje manover te vetme me vonesat e tyre perkatese.

Shpejtesia e arritjes (km/ore)	Distanca * perreth rrrethrotullimit	Shpejtesia e negocijimit nepermjet rrrethrotullimit $V_n$ (km/ore)							
		15	20	25	30	35	40	45	50
40	20	7	4	2	1	0			

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrotullimeve”**

40	60	17	11	7	4	0					
40	100		19	13	8	4					
40	140				13	8					
40	180						12				
60	20	11	8	5	4	3	2	1	1		
60	60	20	15	11	8	4	2	1	1		
60	100		22	17	13	9	5	1	1		
60	140				17	13	8	4	1		
60	180						17	12	7	2	
80	20	14	11	9	7	6	5	4	3		
80	60	24	19	15	11	8	5	4	3		
80	100		26	20	16	13	9	5	3		
80	140				21	17	13	9	4		
80	180						21	16	12	7	
100	20	18	15	12	10	9	8	7	6		
100	60	27	22	18	15	12	9	7	6		
100	100		29	24	20	16	13	10	6		
100	140				25	20	17	13	12		
100	180						25	20	16		

*Tabela 4.9 – Vonesa gjeometrike per mjetet “jo te ndaluara”*



*Figurat 4.15 – Percaktimi i termave te perdorura ne Tabelat 4.8 e 4.9*

**Shembull i perdorimit te tabelave 4.8 dhe 4.9:** Duke vendosur nje shpejtesi arritjeje prej 40 km/ora dhe nje distance te pranuar prej 60 m para rrrethrrotullimit (duke pranuar nje shpejtesi per te kaluar kryqezimin te barabarte me 25 km/ora), do te kemi nje vonese mesatare te automjeteve (te ndaluar sipas tabeles se treguar) te barabarte me 7 sekonda per automjet; nuk do te kemi vonesa per shpejtesi me te medha se 35 km/ora keshtu me rradhe; vihet re qe, sa me e vogel te jete diferenca mes shpejtesise se kalimit dhe asaj te pranuar, aq me e vogel do te jete dhe vonesa relative.

Per vlera te ndermjetme te variablate, qe nuk jane ne tabele, eshte pranuar qe te merren me interpolim.

#### *4.5.2. Studime te tjera per distancen e pranuar mes automjeteve (gap acceptance)*

Studime ne Britanine e Madhe. Pas 1966, me futjen e perparese ne rrrethrrotullim, u be evidente qe, formula e meparshme ishte e vjeteruar dhe ishte e nevojshme qe ajo te zevendesohej me nje formule me te re dhe me te kenaqshme dhe qe te luante rolin organizues ne ceshjen e permendur me lart te perparese. Ne rrrethrrotullimet me te vogla dhe pa asnje lidhje (pa devijime ne korsite hyrese dhe me dimensione te rendit 15-20 m diametra), sjellja e drejtuesve te automjeteve ishte bere e ngjashme me ate ne kryqezimet me perparesi; mjetet e rrugeve sekondare futeshin ne kete hapesire, dhe edhe pse keto rrrethrrotullime ishin me dimensione jashtë limiteve gjeometrike te rekomanduara, ato kishin nje funksionim mjaft te mire. Keshtu, gjate kesaj periudhe u bene shume propozime per proceduren e vleresimit te kapaciteteve te rrrethrrotullimeve, duke perfshire dhe teorine e distances te pranuar mes automjeteve.

Ne vitet 1966-'67 Faulkner mati parametrat e “GAP ACCEPTANCE”, duke analizuar imazh per imazh vezhgimet e bera per nje kryqezim me kater krahe (dege). Ky kryqezim kishte nje ishull qendor me diameter 65 m, nje karrexe qarkulluese te gjere 13 m dhe ishte subjekt i formimit te radheve te gjata ne secilin krahe (dege). Ky studim tregoi qe 56 % e drejtuesve pranonin deri ne 4 s, ndersa totali prej 100% pranonin “gapin” deri 6 s. Duke krahasuar keto rezultate me ato te matura ne 1968 ne Aberdeen, dolen ne pah ndryshimet e “gapit” ne baze te pozicionit gjeografik. Ne 1968 Grant mati kapacitetin e “gapit” ne 14 kryqezime me diameter te vogel ne Aberdeen, duke trajtuar secilin si nje kryqezim me perparesi. Kryqezimet kishin nje diameter qendor 13 m, karrexe qarkulluese 6.5-8 m, krahet te gjere me shume se 9.7 m dhe pa rakordime ne hyrje. Matjet u bene vetem ne hyrje, ku kishte rradhe trafiku. “Headway” dhe “gapet” u regjistruan duke perdonur regjistrues ngjarjesh me 4 kanale, duke e dhene sinjalin ne letra te ndjeshme, per 4 klasifikimet e trafikut.

Shperndarja e “gapit” e marre nga rezultatet tregonote qe:

- 41 % e drejtuesve pranonte “gap” me te vogel se 4 s
- 66 % e drejtuesve pranonte “gap” me te vogel se 5 s
- 86.5 % e drejtuesve pranonte “gap” me te vogel se 6 s

U propozua nje kurbe e pershtatur per kapacitetet e matura, (te shprehur ne mjete/ore), per te perfaqesuar kapacitetin maksimal ne kryqezime te ngjashme.

Ne fund, per te ulur kohen e prites, (voneses) u propozua te adoptohej nje kapacitet projektimi jo me i madh se 80 % e kapacitetit maksimal.

Lidhja ndermjet fluksit hyres dhe atij rotullues nuk u gjet matematikisht, megjithese u duk e ngjashme me nje kurbe eksponentiale negative  $e^{-xt}$ , u duk faktikisht qe kishte nje relacion linear.

Dy rezultate, persa i perket kryqezimeve me lehtesi per hyrjen ne te majte, treguan nje rritje te kapacitetit deri ne 30 %.

Perfundimet ishin si me poshte:

- Shpejtesite e ulta tregonin qe, ne nje rrerrotullim me diameter te vogel i lejonin drejtuesve te pranonin nje “gap” me te vogel, kjo lejonte arritjen e kapaciteteve te larta.
- Per rrerrotullimet me diameter te ishullit qendror jo me te madh se 19 m, cdo hyrje duhet te trajtohet si kryqezim me precedence.

Ne 1971 Bennett propozoi qe, pas prezantimit te precedences ne rrerth, manovrat ne kryqezime do kishin ndikuar ne punimet e Tanner, ne kryqezimet me perparese.

Bennett dha nje seri te kurbave, bazuar ne vlera te ndryshme me “headway” minimal per te dy flukset, me te vegjel ne hyrje dhe me te medhenj ne rrerth, dhe te disa “gapeve” minimale per fluks me te madh.

Ne 1973, Ashworth e Field propozuan idene e tyre per te perdorur flukset ne hyrje dhe ne rrerth, ne vend te perberesve te rakordimeve, duke thjeshtuar aplikacionet e kryqezimeve te formules Tanner, duke marre nje fluks rastesor ne rruget kryesore dhe duke marre ne vazhdim qe “headway” minimal i rruges me te vogel ishte i barabarte me minimumin e “gapit” ne rrujen me te madhe.

Kjo shprehet:

$$q_1 = \frac{1}{t} \cdot \ln(1 + R) \quad [4.44]$$

Ku:

t - “headway” minimal i rruges me te vogel i barabarte me minimumin e “gapit” te rruges me te madhe

R-maksimumi i ( $q_1/q_2$ )

$q_1$ -volumi i rruges me te madhe (mjetë/ore)

$q_2$ -volumi i rruges me te vogel (mjetë/ore)

Keto perfundime ishin baza e nje verifikimi te kapacitetit te gjashte seksioneve te rakordimeve ne kryqezime ne krahasim me formulen Wardrop, qe perdorej deri ne ate kohe ne mjetë/ore.

$$Q_p = \frac{160 \cdot w \left(1 + \frac{e}{w}\right)}{\left(1 + \frac{w}{l}\right)} \quad [4.45]$$

Ku: e, w, l jadin parametrat gjometrike (respektivisht vlera mesatare e gjeresise ne hyrje dhe korsise rrerrotulluese, gjateria e korsise rrerrotulluese, gjatesia mes dy degeve te njepasnjeshme).

Keto kerkime se bashku me ato qe u zhvilluan ne te njejten kohe, treguan qe perqindja e mjeteve te renda nuk kishte shume ndikim ne kapacitetin e kryqezimeve

dhe keshtu publikimet e suksesshme te guidave te projektit H2/75 del DoT pranuan nje formule Wardrop te modifikuar.

Ne 1978 Ashworth dhe Laurence dhane nje relacion per kapacitetin e derivuar nga modeli Tanner per kryqezimet me perparesti:

$$q_2 = \frac{q_1 \cdot e^{-\alpha q_1}}{1 - e^{-\beta_2 q_1}} \quad [4.46]$$

(per hyrjet me nje korsi)

Ku:  $q_1$ - fluksi rrrethor (mjete/ore)

$q_2$ - fluksi ne hyrje (mjete/ore)

$\alpha$ -“gapi” minimal i pranuar ne fluksin rrrethor, i pranuar konstant per te gjithe mjetet

$\beta_2$ -“headway” minimal mes dy mjeteve duke pranuar “gap”te njeje, i hipotezuar konstant

Modeli hipotetizon flukse rastesore ne karrehaten rrrethore. Studimet e para kane treguar qe  $\alpha$  e  $\beta$  mund te jene me te rjejtin rend rrrites, keshtu doli ekuacioni:

$$q_2 = \frac{N \cdot q_1}{e^{q_1 t} - 1} \quad [4.47]$$

Ku: N-numri i korsive hyrese

$$t=\alpha=\beta$$

Formula mundet te jetë gjithashtu e shprehur ne formen:

$$Q_2 = \frac{N \cdot Q_1}{e^{\left(\frac{Q_1}{A}\right)} - 1} \quad (\text{mjete/ore}) \quad [4.48]$$

Ku:  $A=3600/t$  [4.49]

Per mjetet e renda, nga analizat e regresit u morr nje pcu ekuivalente e barabarte me 2.5. Ne procedurat e projektimit mjetet e renda u konsideruan te ndare, vetem kur ishin me shume se 10 %. U perpunua edhe nje regresion linear, nga i cili doli qarte vetem gjeresia e mjeteve te renda dhe, ne vazhdimesi, jane bere ndryshime te formules eksponenciale baze. Nga analiza e te dhenave u nxoren edhe ndryshimet gjeografike, me “gap” kritik prej 3.16 s ne Londer dhe 3.49 s ne Sheffield.

Formula me e pershtatshme me  $A=1153$  u krahasua me tre te tjera te pavaruara. Formulat e tjera ishin:

1) nje formule eksponenciale e modifikuar, dqe permban nje faktor korrigues per gjeresine e hyrjes

2) nje formule e thjeshte empirike lineare e tipit:

$$Q_2 = N (868 - 0.2 Q_1) \quad [4.50]$$

- 3) “formula e modifikuar Wardrop” e parashikuar ne guidat e projektit H2/75 (provizore)

U pershkrua gjithashtu nje procedure praktike e projektit, qe nuk merrete parasysh parametra te tjere, pervec gjerese se hyrjes, ndersa rrezja e ishullit qendor nuk dukej te kishte shume ndikim.

Studimet ne Suedi: Ne vitet '70 u bene kerkime per kapacitetin dhe sigurine e kryqezimeve dhe u percaktuan disa modele te kapacitetit, kostos se dobishme dhe sigurise se bazuar ne te dhena empirike.

Anveden ne 1988 dhe Berg ne 1991 iu referuan “Manualit te kapacitetit Suedez” dhe programit CAPCAL (rrrethrotullimet ne Suedi funksiononin me precedence ne unaze nga mesi i viteve '60, por jane trajtuar si nje seri kryqezimesh T, per kete aplikohet dhe teoria e “gap-acceptance”.

Raporti i 1988 ka pershkruar bazat teorike ne detaje te ndryshme. Nje pershkrim i shkurter i procedures i datuar ne 1991 per llogaritjen e kapacitetit eshte si me poshte:




Figura 4.16 - Parametrat gjeometrike per llogaritjen e kapacitetit

- 1) trafiku ne hyrje eshte ndare ne grupe korsish sipas tipit te ktheses: majtas, drejt, djathtas.
- 2) flukset me te medha jane marre nga te dhena empirike ose literatura, kur jane kryer studimet e fizibilitetit.
- 3) “gapi” kritik “a” eshte arritur duke perdonur parametrat gjeometrike, limitet e shpejtese dhe tipet e kryqezimeve, me korrigimet per dimensionet e qytetit dhe perqindjen e mjeteve te renda

Te gjitha korrigimet shtohen (mblidhen)

Per rrrethrotullimet vlera e “gap-acceptance” jepet:

$$a_r = 3.06 + 1.1 \frac{W}{L} + 2.375 \left( \frac{W}{L} \right)^2 \quad [4.51]$$

$$a_{s1} = 3.06 + 2.6 \frac{W}{L} + 2.75 \left( \frac{W}{L} \right)^2 \quad [4.52]$$

Koha follow-up=0.6a

- 4) koha e sherbimit “b”(dmth koha efektive e funksionimit dhe e defluksit te rrymave ne hyrje, i lejuar nga vonesat e flukseve qarkulluese dhe keqesimi i stakeve). Jane kater raste te shperndarjes “headway” te fluksit me te madh, per rrrethrotullimet pershtatet nje kombinim i rasteve B e C.

Rasti B: “headway” eksponentiale

Rasti C: shperndarja Pirson e tipit te III

Rasti D:  $b = (1-x)$  rastiB + x rasti C

me  $x = 0.29q_f e^{0.25a}$  ku:  $q_f$  eshte fluksi me i madh aktual (mjete/sek)

- 5) ngopja e pjesshme “ $B_p$ ” eshte llogaritur per cdo manover me vehte:

$$B_p = q_m b \quad (\text{nr.mjete}) \quad [4.53]$$

Ku:  $q_m$  - fluksi i manovres (mjete/sek)

$b$  - koha e sherbimit

- 6) llogaritja e shkalles se ngopjes “ $B_a$ ” ne hyrjet:

$$B_a = \frac{(B_{p_{m1}} + B_{p_{m2}} + \dots)}{N_a} \quad (\text{Mjete/manover}) \quad [4.54]$$

Ku:  $B_{pm1}$  - saturimi i pjesshem

$N_a$  -numri i korsive ne hyrje

- 7) llogaritja e kapacitetit ne hyrjet si:

$$C_a = \frac{Q_a}{B_a} \quad (\text{mjete/ore}) \quad [4.55]$$

Ku:  $Q_a$  - fluksi ne hyrje (mjete/ore)

- 8) kodi “C” (i shprehur ne numer mjetesh), vonesa “d”(sek/mjete) dhe % e ndalesave “ps” per hyrje, jane llogaritur si me poshte:

$$C = 0.75 \frac{B_a}{1 - B_a} \quad [4.56]$$

$$d = C \frac{N_a}{q_a} \quad [4.57]$$

$$ps = 100(1 - p_f \cdot B_a) \quad [4.58]$$

$$p_f = e^{a \cdot qr} \quad [4.59]$$

Ku:  $q_a$ -fluksi i mberritjes (mjete/sek)

$p_f$ -propabiliteti i marrjes se voneses se pare (lag)

Vleresimi merr parasysh kostot operative dhe ato e mbetjeve. Te gjithe mjetet qe kthehen, dhe ato te ndaluar, ose gati te ndaluar, jane menduar te kene nje kosto operative (VOC) dhe kosto mbetjesh CH<sub>4</sub>, N<sub>ox</sub>, CO dhe CO<sub>2</sub>.

Per nje rrrethrrotullim me prerje normale (=40 m), te gjithe mjetet ne hyrje merren me nje VOC dhe mbetje extra, pothuaj  $\frac{3}{4}$  e kryqezimeve kryq.

#### 4.6 Projekti gjemmetrik i rrrethrrotullimeve

Vezhgimi i disa pershkrimeve, persa i perket kryesisht gjemmetrike se elementeve te rrrethrrotullimeve, eshte i nevojshem per te arritur standarte te pershtashme sigurie, qe perbejne proregativat specifike, nepermjet te cilave projektuesit e rrrethrrotullimeve, propozojne uljen e shpejtesise ne arritje, duke favorizuar cilesine e tranzitit te mjeteve te cdo tipi.

Te dhenat baze te projektit jane pothuajse te njejtat, si per rrrethrrotullimet urbane, ashtu edhe per ato extraurbane. Nje difference e theksuar mund te ekzistoje midis rrrethrrotullimeve ne rruget dytesore dhe atyre ne rruget e rendesise se pare (psh ato shteterore), nderkaq ne te parat jane me te shpeshta kufizime te karakterit fizik dhe ekonomik, per te cilat standartet e projektit do te jene me te uleta ne krahasim me ato te rrrethrrotullimeve ne rruget principale.

*Elementet proceduriale dhe projektues.* Ne projektimin e konfiguracionit gjemmetrik te nje rrrethrrotullimi duhet ndjekur nje procedure hap pas hapi qe eshte:

- Seleksionimi i kritereve te per gjithshme per tu pershtatur ne projekt:
- Seleksionimi i mjeteve te projektit te pershtatur me vendin. Sipas rendesise se rrugeve te interesuara, mjeti i projektit do te jete gjysemrimorkio per arteriet kryesore dhe autokarro e thjeshte (pa rimorkio) per rruget sekondare.

- Futja e nje rrezeje minimale per mjetet ne kthim. Vlerat e per gjithshme jane rrerh 15 m (shpejtesia e ktheses nga 5-15 km/h) ne arterie dhe 12.5 m ne rruget lidhese (shpejtesia e ktheses 0-5 km/h)
- Percaktimi i kapacitetit per analizen paraprake, duke perdorur edhe teknika te tjera, nqs eshte e nevojshme, dhe numrit te korsive te kerkuar ne hyrje, ne dalje dhe ne karrehaten rrethore.
- Individualizimi i nevojave te kembesoreve dhe ciklisteve, si dhe cdo kerkese per mjetet e permasave te medha.

1. Identifikimi i karakteristikave te vendit, si kufijte e prones, distributoret dhe mekaniket, pemet, parkimet dhe kerkesat per hyrje, etj dhe stabilizimi i hapesires se domosdoshme per rrrethrotullim, duke mare parasysh renditjen e per gjithshme dhe renditjen e cdo dege te kryqezimit.
2. Seleksionimi i nje diametri prove per ishullin qendor per percaktimi i gjerese se nevojshme per karrehaten rrethore, ne baze te numrit te korsive hyrese te kerkuara, per cdo hyrje dhe kerkesave te kalimit te ktheses.
3. Projektimi i ishullit qendor ne nje pozicion prove, duke shenjuar gjerese e karrehatet rrethore dhe projektin e rrerhit te brendashkruar.
4. Kontrolli i dimensioneve dhe formes, ne menyre qe te jene te pershtatshem per te pranuar numrin e degeve qe kryqezohen, se bashku me ndarjen midis tyre, qe manovrat te jene efikase, duke dhene nje hapesire te nevojshme per ishujt e kanalizimit dhe per rrezet e kurbatures te deshiruara per hyrje dalje.
5. Pozicioni gjeometrik i hyrjeve e daljeve, duke u nisur nga gjerese e karrehatave te afrimit dhe hyrjes, si dhe karakteristikave te korsive hyrese dalese, duke percaktuar keshtu formen e per gjithshme dhe pozicionin e ishujve ndares.
6. Kontrolli i arritjes se nje defleksioni te pershtatshem. Ne qofte se kjo nuk eshte e mjaftueshme, duhet korigjuar konfigurimi i rrrethrotullimit, duke modifikuar karakteristikat e ishujve ndares dhe atij qendor.
7. Kontrolli i distances se shikimit ne cdo hyrje.
8. Ekzekutimi i nje analize te detajuar te kapacitetit dhe grades se saturimit per pozicionin gjeometrik aktual te kerkuar.
9. Kontrolli i te gjitha kerkesave te levizjeve per kthesa, me gjurmen e pershtatshme te mjeteve ne kthese. Identifikimi i te gjitha zonave ku jane te nevojshme trajtime speciale per mjetet e vecanta.
10. Kompletimi i projektit te bazamentit ne te gjitha hyrjet dhe daljet, duke futur detajet e ishujve ndares dhe duke pershtatur rrezet konvekse.
11. Venia ne dispozicion e sinjalistikes horizontale se nevojshme per te gjitha korsite.
12. Ekzekutimi i nje projekti ndricimi, duke treguar pozicionin dhe tipin e ndricuesave te kerkuar.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrotullimeve”**

---

Ne tabelen 4.10 jepet një klasifikim i rrrethrrotullimeve urbane me dimensionet e elementeve gjeometrike, ndersa ne tabelen 4.11, janë listuar disa tregues të sherbimeve lidhur gjithmone me rrrethrrotullimet urbane.

<b>Emertimi</b>	<b>Konvecionet urbane</b>	<b>Ishuj <math>\frac{1}{2}</math> te kontrolluar</b>	<b>Hyrja e zonave te banuara</b>
Fusha e aplikimit	Kudo	Zone urbane	Kryqezime kryq
<b>Gjeometria</b>			
Rrezja e ishullit qendror	7-20 m	3.5-5 m	10-40 m
Kalimet kembesore	0-2 m	1.5-2 m	0-2 m
Rrezja e jashtme	15-30 m	11-15 m	$\geq 18$ m
Gjeresia unazore	7-12 m	6-8 m	$\geq 8$ m
Gjeresia hyrese	1-2 korsi	1 korsi	1-2 korsi
Gjeresia e ishullit ndares	$\geq 2.5$ m	$\geq 1.5$ m	$\geq 4$ m
Niveli optimal i trafikut	$\leq 2500$ uvp/h(>per hyrje me 2 korsi)	$\leq 2000$ uvp/h	$\leq 3000$ uvp/h(>per hyrje me 2 korsi)

*Tabela 4.10 - Klasifikimi i rrrethrrotullimeve urbane - elementet gjeometrike*

<b>Emertimi</b>	<b>Kondicionet urbane</b>	<b>Ishuj <math>\frac{1}{2}</math> te kontrolluar</b>	<b>Hyrja e zonave te banuara</b>
Kalim per kembesoret	Trafikndaresit e vijezuar	Trafikndaresit e vijezuar	Trafikndaresit e vijezuar
Kalim per mjetet me 2 rrota	Pista e ciklisteve	Asnje	Mundesia e pasjes se pistes ciklistike
Transporti publik	Evitohen rrezet shume te gjata te linjes publike	Per tu evituar linjat e gjata te transportit publik	
Ndricimi	Perimetral ose qendror	Perimetral	Perimetral

*Tabela 4.11 - Klasifikimi i rrrethrrotullimeve urbane-shembuj ushtrimesh*

Mjeti i referimit projektues. Mjeti i referimit projektues, qe perdoret per konfiguracionin gjeometrik te rrrethrrotullimeve, ne rruge me rendesi te rendit te pare, do te jete normalisht i njejti, si per format e tjera te kryqezimeve te vendosura ne rruge te te njejtes klase.

Ne baze te normativave, mjeti qe ze me shume hapesire, normalisht okupon nje zone me rreze te jashtme deri ne 12.5 metra, dhe te brendshme deri ne 5.30 metra.

Ne rastet kur afer rrrethrrotullimeve ka centrale emergjence, duhet verifikuar qe mjetet e emergjences mund ta kalojne rrrethrrotullimin pa veshtiresi.

Numri i korsive hyrese dhe te unazes. Ky numer varet nga dy faktore kryesore:

Volumi i trafikut dhe numri i korsive te rruges mberritese.

Pergjithesisht numri i korsive qarkulluese duhet te jete i barabarte me korsite hyrese. Ka nje perjashtim kur, ne prani te nje numri te larte te kthesave ne te djathte, ka nje korsi ekskluzive per kete manover dhe karrekhata rrethore ndermjet hyrjes dhe daljes eshte pershtatur per te eliminuar konfliktet me trafikun qarkullues.

Ne praktike, kjo zgjidhje furnizon edhe nje korsi largimi per kthesat djathtas ne brendesi te karrekhates rrethore dhe kjo korsi, bashke me flukset e trafikut, mund te mos jete e perfshire ne analizat per percaktimin e numrit te korsive hyrese.

Numri i korsive dhe gjeresia e tyre duhet te jene te tilla per te garantuar kapacitetin e projektit. Pershtatja e gjeresive te teperta te karrekhata hyrese, te atyre rrethore dhe atyre dalese, mund te sjelle nje numer te madh incidentesh me rritje te padobishme shpenzimesh.

Ishulli qendror. Ishulli qendror duhet te jete preferueshmerisht rrethor ne menyre qe, duke ndryshuar ne menyre te vazhduar kurbaturen e karekhates rrethore, te kerkoje nje vemendje te madhe gjate drejtimit.

Megjithate, ndonjehere behet e domosdoshme pershtatja e formave drejtakendore, ose e tipeve te tjera per situata te vecanta.

Permasa e ishullit qendror eshte funksion kryesisht i hapesires se nevojshme dhe domosdoshmerise per te mbajtur nje defleksion te mjaftueshem, per te kontrolluar shpejtesine e mjeteve qe kalojne rrrethrrotullimin.

Rrethrrotullimet me nje diameter te brendshem te madh, e per rrjedhoje me nje ishull te madh qendror, kane nje kapacetet te krahasueshem me te tjerat, por nje siguri me te mire.


Pergjithesisht nje ishull qendror i madh, jep nje ndarje te madhe midis zonave te konfliktit prane dhe ben akoma me te thjeshte kuptimin e manovrave te mjeteve qarkullues per automobilistet qe hyjne, dmth, nese dalin ne daljen korresponduese te hyrjes ne fjale, ose vazhdojne rrrotullimin ne unaze. Ishujt qendrore me te medhenj jane normalisht me te nevojshme per rrrethrrotullimet ne zonat me shpejtesi te larte, ose ne kryqezimet e shumefishta.

Ishujt qendrore akoma me te medhenj mund te permiresojne levizjen ne kryqezime nga ana e automobilisteve. Megjithate, kosto e realizimit eshte perpjithesisht e lidhur me dimensionin e ishullit qendror; pervec kesaj ishujt shume te medhenj nuk garantojne nje defleksion te mjaftueshem dhe kontrolli i shpejtesise se mjeteve duhet te mbahet mjete te tjera.

Per keto arsyen nuk rekomandohen ishujt shume te medhenj. Per te kryer manovrat e ktheses se mjeteve te medha, pjesa e jashtme e ishullit qendror mund te modifikohet, duke realizuar nje rrip te pershkruar nga mjetet e renda.

Ky rrip (5-7.5 cm) mund te vishet me nje pjese bllokuese, per te pasur nje pendenca (nga jashte) me te madhe se ajo e karrekhates rrethore, ne menyre qe te mund te perdoret kryesisht nga mjetet e rende.

Kjo zgjidhje nuk keshillohet kur perqindja e mjeteve te rende behet edhe me e madhe



*Figura 4.17 - Gjeresia e karrekhates rrethore per rrrethrrrotullimet*

Gjeresia e karrekhates rrethore. Gjeresia e karrekhates rrethore varet nga faktore te ndryshem, nga te cilet me te rendesishem jane: numri i korsive te hyrjes dhe rrezja e pershkimit te mjeteve nga ana e brendshme e rrrethrrrotullimit.

Tabela 4.12 demontron gjeresine e kerkuar per nje, dy, ose tre mjetet, qe kthehen njehkosisht ne rreze te ndryshme. Keto gjeresi janin hipoteza qe ka vetem nje mjet ne secilin grup mjetesh, qe leviz ne menyre simultane. Duke njobur kompozimin e trafikut, tabela 4.12 mund te perdoret per te percaktuar gjeresine ne pika te ndryshme te karrekhates rrethore. Per rrrethrrrotullimin e figures 4.18, gjeresia e karrekhates eshte percaktuar nga nje shembull ne te cilin trafiku perballat:

- Ose me dy korsi, qe levizin ne te majte me rreze minimale  $R_2$  (do te ishte shume e pazakonte te ishin ne dispozicion 3 korsi te gjitha per kthimin ne te majte)
- Ose me tre korsi, qe kalojne ne rrrethrrrotullim nga cepi ne cep me rreze  $R_1$  kthese dhe e okupuar me nje kombinim mjetesh te kolones 4 (autoartikulues + 2 automobila)

Ne kete rast te vecante:

$$R_2 = 12 \text{ m}, \text{ qe i korrespondon } 10.3 \text{ m ne tabelen 4.12}$$

$$R_1 = 50 \text{ m}, \text{ qe i korrespondon } 12.6 \text{ m ne tabelen 4.12}$$

Domethene gjeresia e unazes duhet te jetë 12.6 m.

Duhet mare ne konsiderate edhe gjeresia e mjeteve ne kthese. Per kete qellim duhet perdorur profili i rruges se ktheses se mjetit projektues, ose nje dizenzim ne kompjuter. Gjeresia e karrekhates rrethore e dhene ne tabelen 4.12 eshte e mjaftueshme per nje  $\frac{1}{2}$ rimorkio, qe kthehet afer ishullit qendror; per kete del e

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

---

nevojshme percaktimi i te dhenave te matjeve, per te cilat edhe mjetet me te larget mund te peshkojne kurben ne hyrje.

<b>Rrezja minimale e ktheses ne rruge R(m)</b>	<b>Nje mjet artikulues (m)</b>	<b>Nje mjet artikulues + 1 automobil (m)</b>	<b>Nje mjet artikulues + 2 automobila (m)</b>
5	7.6		*
8	7.1		*
10	6.7		*
12	6.5	10.3	*
14	6.2	10.1	*
16	6	9.9	*
18	5.9	9.7	*
20	5.7	9.6	13.5
22	5.6	9.5	13.4
24	5.5	9.4	13.3
26	5.4	9.3	13.2
28	5.4	9.2	13
30	5.3	9.1	12.9
50	5	8.8	12.6
100	4.6	8.4	12.2


*Tabela 4.12 - Gjeresite e kerkuara per mjetet qe kthehen prane njeri tjetrit*

<b>Diametri i ishullit qendror (m)</b>	<b>R<sub>1</sub> (m)</b>	<b>R<sub>2</sub> (m)</b>	<b>ICD minimal (m)</b>
4	3	13	28
6	4	13.4	28.8
8	5	13.9	29.8
10	6	14.4	20.8
12	7	16	32
14	8	15.6	33.2
16	9	16.3	34.6
18	10	17	36

*Tabela 4.13 - Gjeresite e kerkuara per rrrethrrrotullimet me permasa reale*

Persa i perket ktheses se mjeteve te rende, disa kerkime angleze kane verifikuar qe mjeti qe ze pjesen me te madhe te hapesires eshte perfaqesuar nga nje autoartikulues i gjate 15.5 m dhe rimorkio qe ka nje aks te vetem posterior.

Ne tabelen 4.13 jane dhene dimensionet minimale per te garantuar levizjen e autoartikuluesit.



- a: ishulli qendror
- b: kamion me rimorkio
- c: karrekhata rrethore
- d: mjeti projektues
- e: fraksioni minimal 1 m
- f: diametri i brendashkruar

Diametri i brendashkruar (ICD) eshte limituar deri ne 36 m, sepse diametrat me te medhenj kane problem persa i perket garantimit te nje defleksioni te pershtatshem, prandaj gjenden zgjidhje te tjera, si minirrethrrrotullime ose realizimi i “kamioneve me rimorkio”.

Ndonjehere mund te jete i nevojshem percaktimi i gjerësise se karrekhates rrethore per cdo seksion, por ne pjesen derrmuese te rasteve do te pershtatet nje gjerësi e barabarte ose pak me e madhe se e ajo e karrekhates hyrese me te gjere. Ne cdo rast gjerësia e unazes nuk duhet te jete me shume se 1.2 here gjerësine e hyrjes me te gjere, ose jo me e vogel se 15 m.

Ne ndonje rast, nje rrethrrrotullim mund te kete nje numer korish variable ne sektione te ndryshme te karrekhates rrethore, vetem nqs kjo nuk eshte e keshilluar.

Ndonjehere, si ne rrethrrrotullimet me karrekhatea dhe me korsi te shumefishte, mund te percaktohet lehtesisht gjerësia per te garantuar shtimin e nje defleksioni te pershtatshem.

Ishulli i kanalizimit, kurbat e hyrjes dhe daljes. Ishujt e kanalizimit duhet te realizohen ne te gjitha rrethrrrotulimet te vendosura ne arterie ose rruge lidhese, si ne zona urbane ashtu edhe ne ato rurale. Ato janë një mbështetje për kembesoret, bashkepunojne ne kontrollin e shpejtësise, kanalizojnë trafikun ne rrethrrrotullim dhe detyrojnë berjen e kthimit ne te majte ne menyren korrekte, ashtu sic ilustrohet ne figuren 4.20.

Ishujt e kanalizimit duhet te projektohen per te drejtuar mjetet ne rrrethrrotullim ne nje kurbe te bute, me nje kend te tille, qe i lejon drejtuesve te mjeteteve nje dallim te shpejte te trafikut qe arrin ne unaze. Kurba ne pjesen hyrese te nje ishulli kanalizimi, ku futet ne karrexfaten qendrore, duhet te jete tangent me ishullin qendror sic tregohet ne figuren 4.19. Megjithate, ne disa raste, projeksionit te kurbes hyrese mund ti lejohet prerja e lehte e ishullit qendror.

*Guida e rrrethrrotullimit te Florides*, per rrugjet shteterore, keshillon nje gjeresi minimale te ishullit ndares prej 2.4 m perballë ishullit qendror, ndersa gjesia minimale e keshilluar per pjesen perballë arritjes eshte 1.2 m.

Gjatesia minimale e ishullit ndares duhet te jete ne varesi te gjatesise se automjetit (4-5 m). Keto dimensione supozojne nje ishull me nje siperfaqe te pakten  $10 \text{ m}^2$ .




Figura 4.18 - Perdorimi i ishullit te kanalizimit per te eliminuar manovrat e rrezikshme dhe te gabuara

Vija e mberritjes nuk duhet te fshehe faktin qe ka nje hyrje ne rrrethrrotullim dhe kjo do te evidentohet me shume, nese drejtuesit e mjeteteve mund te shohin karrexfaten qarkulluese, ishullin qendror dhe formen e pergjithshme te rrrethrrotullimit.

Ne rrugjet me shpejtesi te larte ishujt ndares duhet, atje ku eshte e mundur, te shtrihen gjate gjithe korsive te afritit per te qene te dukshem nga drejtuesit qe vijne, sic tregohet ne figuren 4.22.

Gjatesia e ishullit te kanalizimit duhet te jete e tille qe ti jape nje njoftim te mjaftueshem drejtuesve, qe jane duke hyre ne rrrethrrotullim dhe duhet te ulin shpejtesine (gjatesia ideale duhet te jete te pakten 60 m).


Sinjalistika horizontale e tij duhet te jete e shtrire me pas deri ne pikën ku supozohet se drejtuesit duhet te fillojnë uljen e shpejtesise. Vijezi i ishullit te kanalizimit favorizon ngadalesimin e shpejtesise se mjeteteve qe afrohen ne pikën hyrese.

Ne krahun e djathte te rruges mberritese duhet te vihen kufijtë e trotuareve dhe kunetat, te pakten deri ne  $\frac{1}{2}$  e gjatesise se ishullit te kanalizimit, ne menyre qe te riforcohet vijezi.


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

Trotuaret duhet te lidhen me kunetat ne ishujt e kanalizimit, ne ishullin qendorr dhe ne pjesen e jashtme te trotuarit per te penguar “prerjen e kurbes hyrese”.



*Figura 4.19 - Konfigurimi tipik i hyrjes dhe daljes se nje rrrethrrrotullimi ne zone urbane*



*Figura 4.20 - Dizenjimi tipik i nje rrrethrrrotullimi per nje zone rurale (ne rruge me shpejtesi te larte)*

Gjatesia e kurbes ne anen hyrese te ishullit te kanalizimit duhet te jetet e mjaftueshme per ti lejuar drejtuesve te njojin lehte kendin e kurbatureve, qe do takojne ne rrrethrrrotullim. Kjo kerkohet vecanerisht ne rruge me karrekhata te ndara, ku shpejtesia e mjeteve ne ardhje shtohet. Ne keto raste eshte e pelqyeshme nje gjatesi minimale e kurbes e barabarte me 60 m.

Gjeresia e korsive te hyrjes dhe daljes. Pasi jane percaktuar numri i korsive hyrese te nevojshme, eshte i domosdoshem percaktimi i gjeresive te kerkuara te korsive. Pergjithesisht gjeresite e korsiave jane 3.4 - 4 m. Perjashtim bejne korsite hyrese dhe dalese me nje korsi te kufizuar me trotuar, ku nevojitet nje gjeresi minimale prej 5 m, ndermjet bordurave te trotuareve per te lejuar parakalimin e nje mjeti me defekt.

Kurba e arritjes dhe hyrjes. Atje ku eshte nje kurbe mberritje, qe drejton kurben hyrese ne rrrethrotullim, ajo duhet te kete te njejten rreze, ose pak me te madhe, se ajo e kurbes, qe nje mjet duhet te beje per te pershkuar rrrethrotullimin. Shpejtesia e pershkimit te kurbes se afrit me perjashtim nuk duhet te jete me e madhe se 10-15 km/h te shpejtesise maksimale te kalimit te rrrethrotullimit. Projektimi me nje rreze sa me te duhur te ktheses rakorduese, ben qe automobilistet te ulin shpejtesine perpara se te arijne rrrethrotullimin. Duhen marre masa per te siguruar qe rrezja rakorduese e ktheses te mos jete shume e madhe, per te lejuar nje shpejtesi me te larte sec duhet ne hyrje te karexhates qarkulluese.

Ne rruget me dy ose me shume korsi, rrezja e kurbes hyrese nuk duhet te jete aq e vogel sa ta ule aq shume shpejtesine ne nje nivel, qe shoferet ta konsiderojne te paaresyeshem, ose te atille, sa te krijoje problem ne kalim. Mund te ndodhe qe shoferet te injorojne vijen ndarese te korsive dhe te “presin” nepermjet korsive ngjitur me to, sidomos kur kthesa eshte e vogel. Rrezja minimale e deshiruar per nje rrrethrotullim me dy korsi eshte 30 m.

Kurbat e daljes. Korsite e daljes ne nje rrrethrotullim duhet te jene te thjeshta per tu pershkruar. Pasi kane ulur shpejtesine nga kurba e hyrjes ne karrehaten qarkulluese, mjetet duhet te rrisin shpejtesine ne daljen nga unaza. Per kete arsyte rrezja e daljes duhet te jete perjashtim me e madhe se rrezja e karrehates qarkulluese. Ne menyre ideale, nje levizje e drekte tangenciale me ishullin qendror, sic tregohet ne figuren 4.19, preferohet per mjetet ne dalje, ne drejtim te kundert me levizjet rrrethore te hyrjes, qe kane funksion tu tregojne shofereve te ulin shpejtesine.

Kontrolli i shpejtesise nepermjet devijimeve ne rrrethrotullim. Faktori me i rendesishem i sigurise ne rrrethrotullim eshte devijimi ne segmente te rruges te pershkruar nga mjetet qe hyjne ne te. Rrrethrotullimet duhen projektuar te tille qe, ne brendesi te tyre, shpejtesia e te gjitha mjetave jete minimum 40 km/ore. Kjo realizohet duke modifikuar gjeometrine e karrehates se hyrjes dhe duke siguruar qe te gjitha segmentet e pershkruara nga mjetet, te devijohen me nje nga keto menyrat:

: vendosja ne vije te drejte e mjetave ne karrehaten e hyrjes dhe forma, pozicioni i ishujve ne kanalizimin e drejtimit

: vendosja ne nje pozicion dhe permase te caktuar te ishullit qendror

: vendosja e nje drejtimi joparalel mes hyrjes dhe daljes

Rendesia e arritjes se nje devijimi sa me te pershatshem eshte nenvizuar edhe nga studimet e bera ne Britanine e Madhe. Keto kane treguar nje rritje te frekuences se aksidenteve, per shkak te zvogelimit te devijimit. Edhe eksperienca australiane ka

treguar rendesine e nje devijimi te pershtatshem e te nje vendosjeje gjeometrike te pershtatshme, me synimin e kontrollit te shpejtesise se mjeteve, para hyrjes ne karrehaten qarkulluese. Ne zona me shpejtesi te larte, kjo mund te kerkoste masa te tjera shtese per te permiresuar kontrollin e shpejtesise se trafikut ne afersi te rrrethrotullimit.

Per sa thuhet edhe me siper, lidhur me rendesine e nje devijimi te pershtatshem, ka dhe raste, ne te cilet mund te pranohet nje devijim me i ulet, si ne zonat kur mjetet jane duke udhetuar me shpejtesi te ulet. Megjithate, edhe ne keto raste, rrrethrotullimet me devijim me te vogel se ajo e deshiruar, per gjithesht nuk jane te sigurta. Eshte e rendesishme te vleresohet devijim i nevojshem per te ulur shpejtesine e te gjitha mjeteve, edhe ato te shofereve, qe perdonin rrrethrotullimin ne kushte te nje fluksi shume te ulet.

Ne kushtet me trafik te ulet, devijimi i treguar siguron qe keto automobiliste gjithsesi do te ulin shpejtesine ne nje shpejtesi me te vogel se 40-50 km/ore.

Shpejtesia e projektit. Shpejtesia e projektimit nepermjet rrrethrotullimit mund te llogaritet nga formula:

$$v^2 = 127 * R (e+f)$$


Ku :

v – shpejtesia ne km/ore, e kalimit qe ka per rreze maksimale ate te kalimit te rrrethrotullimit nga mjetet, sic tregohet ne figurat 4.22 4.23;

R – rrezja ne metra e pershkrimit maximal te rrrethrotullimit;

e - eshte mbilartesimi ne m/m (negative, nese eshte pjerresia eshte e drejtuar drejt ishullit qendoror)

f - koeficient i ferkimit gjatesor qe ndodhet mes rrotave te mjetit dhe shtreses rrugore Ne rrrethrotullime, ashtu si dhe ne tipe te tjera kryqezimesh, drejtuesit e mjeteve pranojne vlera te larta te nxitimit radial (centrifugal), ne krahasim me ate cka pranojme drejtuesit e mjetit ne pjesë rruge normale.



*Figura 4.21 - Ilustrimi i kriterit te devijimit te nje rrethrotullimi me nje korsi*

Per rrethrotullimin mund te perdoret vlera te koeficientit te ferkimit ne nje interval 0.2 me 50 km / ore e 0.3 per 25 km/ ore. Per vlera te ndermjetme behet me interpolim

Defleksioni ne rrethrotullim me unaze me nje korsi. "Design Speed" (shpejtesia e projektuar) maksimale eshte marre, nese segmenti i mjeteve (i hipotetizuar i gjere 2 m) ka nje rreze me te vogel se 100 m. Kjo rreze kurbature i korespondon paraprakisht nje shpejtesie deri ne 50 km/ore, duke hipotetizuar nje force anesore te barabarte me 0.2 g. Devijimi i nevojshem i mjeteve per nje rrethrotullim me nje korsi te vetme, tregohet ne figuren 4.22. Ne kete rast, faktoret e kontrollit jane permasat e ishullit qendror dhe gjeometria e afritit.

Defleksioni ne rrethrotullime me dy ose tre korsi qarkulluese. Ne rrethrotullime me disa korsi (me dy ose tre korsi qarkulluese ) eshte pergjithesisht i veshtire per tu arritur i gjithe devijimi i rekomanduar perpara nje rrethrotullimi me nje korsi teke. Ne keto raste, eshte pranuar qe, devijimi kalimeve te pershkruara nga mjetet, duhet matur sic tregohet ne figuren 4.23. Kjo ka nje diferenca nga ajo e perdonur ne rrethrotullime me nje korsi, per aq kohe sa hipotetizohet qe, segmenti i pershkruar nga mjetet me te shpejta (me rreze maksimale), niset nga e djathta e korsise se hyrjes, kalon korsise qarkulluese duke e prere, kalon 1.5 m afer ishullit qendror, duke dale nga rrethrotullimi ne korsine djathtas.

#### 4.7 Rrethrotullimet e vogla

Me termin minirrethrotullime shpesh tregohen ato rrethrotullime me dimensione te vogla (diametri i jashtem nga 14-20 m), qe kane ishullin qendror te kalueshem dhe ndonjehere, thjesht te vijezaur ne siperfaqen e rruges. Edhe pse ne Shtetet e Bashkuara qe ne fillim te shekullit, u ndertuan disa minirrethrotullime, vetem ne vitet e e fundit ka patur nje fluks perdonimi te ketij tipi te kryqezimeve rrugore.

Nje nga shtetet e para qe adoptoi ne nje shkalle te gjere minirrethrotullimet ishte Mbreteria e Bashkuar. Ne kete shtet minirrethretullimet u eksperimentuan qe ne fillim te viteve 70 dhe perdorimi i kompletuar u lejua ne 1975. Megjithate eshte qe nga mesi dyte i viteve 80, qe ne Mbreterine e Bashkuar, ndertimi i minrrethretullimeve eshte bere i zakonshem, kryesisht per te permiresuar funksionimin e kryqezimeve, ne te cilat hapesira disponibile ishte shume e kufizuar. Ndertimi i minirrethrotullimeve eshte bere shume i zakonshem edhe ne shtete te tjera, si Norvegja, Zvicra, Gjermania e Suedia, sa qe jane zhvilluar nje sere kerkimesh e rregullimesh, per sa i perket bazave te projektimit mbi to. Megjithate, shteti ne te cilin jane bere me shume kerkime, per pasoje edhe jane publikuar me shume material, per sa i perket minirrethrotullimeve, eshte Mbreteria e Bashkuar.

*Te per gjithshme.* Mini rrrethrotullimi perfaqeson nje menyre per te zgjidhur problemet lidhur me kryqezimet qe kane hapesira shume te kufizuara, ne te cilin trafiku i mjeteve te renda eshte i paperfillshem.

Sic kemi thene, minirrethrotullimet karakterizohen nga te paturit e dimensioneve e reduktuara si dhe te nje ishulli qendror te pakalueshem. Kjo karakteristike e fundit u lejon edhe mjeteve e renda kryerjen e manovres te kthimit majtas e djathtas, nderkohe qe nuk eshte gjithmone i lejuar kthimi ne forme – U. Lidhur me kalueshmerine, jo gjithmone, jo komode, te ishullit qendror, eshte e nevojshme, qe shpejtesia e afrimit ne te gjithe krahet te jete e ulet, ne praktike gjithmone me e ulet se 40-50 km/ora.

Ne rastet ku gjeometria e rruges se afrimit nuk garanton keto shpejtesi te uleta, duhen realizuar ishuj te pershatshem devijimi ne deget e e afrimit, ne menyre qe te imponohet fizikisht ulja e shpejtesise (figura 4.23). Nese nuk eshte e mundur ne asnjë menyre qe te imponohen disa shpejtesi te uleta efektive, atehere realizimi i nje minirrethrotullimi nuk keshillohet.




Figura 4.22 – Shembull permasimi per uljen e shpejtesise se afrimit

Ishulli qendor i minirrethrotullimeve realizohet zakonisht nga një material i ndryshem nga ai i shtreses se sipërfaçës se rruges (cimento, guri natyral, etj), dhe me një forme kupole me një pendençë të tille, që te bëje jo komode mundesine e kalimit ne të të mjetëve të lehta dhe atyre me dy rrota.

Ishulli qendor i minirrethrotullimit duhet te jete i lyer i gjithi me boje te bardhe reflekuese, e lire nga cdo shenje rrugore. Kjo mase e fundit sherben për te lejuar manovra të kthimit të mjetëve të renda; ato mund te kalojnë kryqezimin duke shkelur mbi ishullin qendor me rrotat e pasme, ose me ato te rimorkios. Mjetet e renda do te kryejne manovrat e kthimit me shpejtësi shume te ulet, gje kjo e cila sjell dhe shkeljen me rrotat e mjetit mbi dyshemene e ishullit qendor. Kjo shkelje demton si bazamentin, ashtu edhe bojen e bardhe, per kete aresye duhet kontrolluar ne menyre frekuente shikuesheria dhe gjendja e ishullit qendor, duke parashikuar permiresimin e vazhdueshem te kushteve me ndërhyrje periodike mirembajtjeje. Per sa i perket dimensioneve te ishullit qendor, mund te ndiqen disa rekomandime që ofrojnë normativat angleze lidhur me: gjeresia mund te varioje nga 1 ne 4 m (duhet te jete maksimumi i pranuar nga kryqezimi) dhe forma “kupole” duhet e kete një lartesi maksimale deri ne 125 mm per ishujt te gjere deri ne 4 m, ndërkohe per te tjerat me gjeresite me te vogel, lartesia do te zvogelohet ne menyre proporcionale. Ishulli duhet te jete i kufizuar nga një trotuar i ngritur nga 6 - 1.5 mm nga sipërfaqja e rruges.

Eshë perhapur dhe një tip tjeter minirrethrotullimi, ne te cilin ishulli qendor bojatiset vetem mbi dyshemene e rruges dhe nuk ka asnje ndalese fizike ne kalimin direkt te kryqezimit. Ky tip minirrethrotullimi mund te adoptohet vetem ne ato kryqezime urbane, ne te cilat shpejtesite e afrimit te disa degeve jane shume te uleta.

#### *4.7.1 Siguria ne minirrethrotullime*

Kerkimet me te shumta mbi sigurine e levizjes ne minirrethrotullime jane bere Mbreterine e Bashkuar. Nje kerkim i bere ne 1974 nxorri ne pah qe, perdonimi i mini ishujve qendrore nuk ishte i pershtatshem per shendrrimin e rrrethrotullimeve te medha ne rruge te shpejta. Aty ku shpejtesite nuk mund te uleshin ne 30 mjetë/ore (48 km/ore) me metoda te tjera, duhej te sigurohej fizikisht nje devijim i pershtatshem ndaj pershkrimeve te mjeteve. Nje tjeter studim i zhvilluar nga 1970 deri ne 1975, mbi aksidentet me te plagosur, ne 20 minirrethrotullime, tregoi se numri total i aksidenteve ishte zvogluar me 30% (kunder 39% i regjistruar ne rrrethrotullime), me nje zvogelim me te madh perkundrejt atyre te automjeteve, edhe pse midis kembesoreve, ishte rregjistruar nje ulje e te plagosurve. Rezultatet e kerkimeve te tjera, te kryera nga autoritete lokale, u publikuan ne 1987. Nga keto kerkime u publikuan rezulatat e meposhtme.

- Instalimi i nje minirrethrotullimi ne nje kryqezim egzistues me precedence ne zone urbane, mund te redukoje numrin total te aksidenteve nga 30% deri ne 40 %, ndersa ulja e aksidenteve te renda eshte me e madhe: (40-60%)
- Rrrethrotullimet e vogla me 4 krahe me qasje e me ishuj te vegjel qendoror jepin norma aksidentesh me te medha ne raport me rrrethrotullimet konvencionale
- Ne rrrethrotullimet e vogla me 4 krahe regjistrohet nje % e larte e aksidenteve mes mjeteve ne hyrje e atyre ne qarkullim. Nje tjeter tip aksidentesh shume i ndeshur eshte ai mes autove dhe mjeteve me dy rrota.
- Minirrethrotullimet nuk jane me pak te sigurt per kembesoret ne raport me tipet e tjera te kryqezimeve.

Ne tabelen 4.14 jane sjelle normat e aksidenteve (PIA/vit) te matura ne minirrethrotullimet angleze, te ndara per numrin e kraheve dhe te krahasuar me ato te ndodhur me kryqezimet rurale ne forme T.

Minirrethrotullim	PIA/Vit
3 dege	0.61
4 dege	0.88
Tip "Dopio	0.88
Totali	0.74
Kryqezimet rurale	0.5

*Tabela 4.14 - Frekuencia mesatare e PIA ne vit per kryqezim*

Si konkluzion, nga kerkimet e bera, mund te pohohet se minrrrethrotullimet nuk paraqesin probleme te vecanta sigurie dhe mund te pershtaten per zevendesimin e kryqezimeve me precedence me norma te larta aksidentesh, edhe pse te mirat e tyre nuk jane kaq te dukshme ne raport me rrrethrotullimet konvencionale.

#### **4.8 Semaforizimi i rrrethrotullimeve**

Per zgjidhjen e problemeve te konvergjimit te paraqitura ne rrrethrotullimin me fluksin e ngritur ose te paekuilibruar te mjeteve, eshte bere shume e zakonshme ne keto vitet e fundit rendja drejt semaforizimit te tyre.

Ky kapitull trajton disa koncepte baze te projektimit te rrrethrotullimeve dhe efektet e tyre mbi kapacitetin, si dhe analizon teknikat per analizen dhe kontrollin, duke u bazuar mbi sa eshte publikuar e eksperimentuar. Qellimi i kapitullit eshte te:

- : te jape informacione dhe sqarime se si operojne rrrethrotullimet e semaforizuara
- : te tregoje diferenca mes rrrethrotullimeve te semaforizuara dhe kryqezimeve te semaforizuara
- : te korrigjoje disa perkufizime te gabuara

## Tema e Doktoraturës:

“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”

## KAPITULLI 5

### SIMULIMI I PERFORMANCESE SE KRYQEZIMEVE

#### 5.1. Modeli S.I.D.R.A

Programi S.I.D.R.A. (Signalised & Unsignalised Intersection Design & Research Aid), i perpunuar nga Akcelik dhe te tjere, eshte nje program shume i perdorshem. Nga gama e gjere e programeve per kontrollin semaforik, eshte konsideruar si programi i llogaritjes automatike me i kompletuari per kryqezimet e izoluara.

SIDRA nuk perdoret ekskluzivisht per kryqezimet e pajisura me semafor, duke nisur nga versioni i viti 1991, ai eshte ne gjendje te studioje edhe rrrethrotullimet dhe kryqezimet me te drejte precedence.

SIDRA eshte nje program shume fleksibel; ai eshte ne gjendje te percaktoje kapacitetin, vonesen, gjatesine e vargut te trafikut, sasine e gazrave ndotes, kostot si dhe shume tregues te tjere specifike per dege te vecanta, perafrimet e thjeshta dhe kryqezimin, apo per te gjithe kryqezimin me karakteristikat e tij.

Per kryqezimet, ku nuk njihet kohezgjatja e ciklit, si dhe ndarja midis dy fazave te semaforit jeshil, SIDRA mund te llogarise disa plane te ndryshme te ndarjes ne menyre optimale te kohes, midis te cilave operatori mund te zgjedhe ate me te pershtatshmen.

#### 5.2 Struktura e modelit SIDRA

Arkitektura e modelit SIDRA eshte treguar ne figuren e meposhtme nr. 5.1.:




Figura 5.1 – Arkitektura e procedurave prezente ne SIDRA

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

RIDES (Road Intersection Data Editing System), eshte procedura qe mundeson futjen e te dhenave Input ne nje menyre mjaft te thjeshte: te gjitha informacionet qofte gjeometrike, qofte te trafikut, qofte te kohezgjatjes semaforike, futen nga operatori ne "screens" te vecanta, qe perzgjidhen duke i seleksionuar tek menuja kryesore. Paraqitjet grafike te pranishme ne keto "screens", jo vetem qe lehtesojne perdorimin e programit edhe per operatore joeksperte, por lejojne qe te kemi nje kontroll viziv te menjehershem te te dhenave te futura ne sistem. RIDES fut automatikisht vlerat 'default' (te vetepercaktuara nga programi) per parametrat e papercaktuar nga operatori dhe kontrollon qe, parametrat e futur te mos kene kaluar vlerat normative. Duke dale nga RIDES aktivizohet procedura SIDDAP "Process input data", qe kontrollon te gjitha te dhenat Input ne kerkim te gabimeve te mundshme dhe nqs nuk i gjen, nis proceduren e llogaritjes SIDRUN "Compute and generate output", nga e cila perfitohen te dhenat Output.

Te dhenat ne dalje mund te pasqyrohen grafikisht fale procedures GOSID "aa Sidra output" (Graphical Output System for Intersection Design), ose mund te pershkruhen nga nje file tekst.

Ne fund procedura CONFIG sherben per te percaktuar disa parametra thelbesore per futjen e te dhenave Input, per proceduren e llogaritjes dhe per pershkrimin e parametrave Output. Me kete procedure, ne menyre te vecante, SIDRA i mundeson perdoruesit te specifikoje objektivin e procesit te optimalizimit, duke zgjedhur nga nje game e gjere masash midis te cilave: kohen e pritjes, gjatesine e vargut te automjeteve ne rradhe, shkallen e saturimit, nivelin e sherbimit, konsumin e karburantit, ndotjen e ambjentit, koston monetare, etj.

Gjithashtu disa nga keto funksione mund te karakterizon akoma me shume, psh per te shprehur vonesen mund te zgjidhet midis 5 shprehjeve te ndryshme, sic shprehet ne tabelat e mpsh:

Percaktimi i rradhes se pritjes	Rradha (*) ( )	Tipi Kurrizi i rradhes Mesatarja e ciklit	Perqindja ( ) Mean ( ) 30% ( ) 95% ( ) 98%
Percaktimi i nivelist te sherbimit	(*) ( ) ( ) ( )	Vonesa (HCM) Shkalla e ngopjes Vonesa (HCM) dhe Shkalla e ngopjes Vonesa (RTANSW)	
Sinjalet e vendosura (default)		Max-Jeshile Levizje e madhe Levizje e vogel	Vendosja e gapit 5.0 2.0

*Tabela 5.1.a – Lista e parametrave thelbesore te pranishem ne CONFIG (pjesa e pare)*

**Tema e Doktoraturës:**  
**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Lloji i Kryqezimit			
(*) Sinjalizues	Kontrolli (*) Ora fikse ( ) Venia ne veprim  Gjeometria (*) Ne kategorine e kryqezimit ( ) Vetem nje pike shkembimi ( ) Kalim per kembesoret	Rruja Kryesore (Autostrade) (*) Asnje ( ) Lindje-Perendim ( ) Veri-Jug  Sinjal i koordinimit (*) Asnje ( ) Lindje-Perendim ( ) Veri-Jug ( ) Te dyja	
( ) I terthorte			
( ) Stop	Kontrolli (*) Dy Drejtime Stop ( ) Te gjitha drejtimet Stop	Rruja Kryesore (*) Lindje-Perendim ( ) Veri-jug	
( ) Tregues	Rruja Kryesore (*) Lindje-Perendim ( ) Veri-jug		
Model Setup	Setup (*) Standart krahut i majte ( ) Standart krahut i djathte ( ) Zelande e Re ( ) US HCM (US Njesi) ( ) US HCM (Njesi metrike)	Tjetër [ ] Zelande e Re rregullore [ ] Kthim ne te kuqe	
Shpejtesi kundervajtje	Periudha totale e shpejtesise HV  Periudha kulmore e shpejtesise HV  Faktori kulmor i shpejtesise	60 30 90	Te dhenat opsonale  (*) Ndarje e LV dhe HV ( ) Perqindja dhe totali i HV  ( ) Total dhe HV
	Metoda e kohes njesi (*) Periudha totale e shpejtesise ( ) Norma per ore		
Vleresimi i perfomances	(*) E vonuar ( ) Rradhe ( ) Norma e ndaluar ( ) Indeksi i performances	( ) Shkalla e ngopjes ( ) kapaciteti ( ) Rezerve kapaciteti ( ) Lende e pare/Cmimi/ Rezultat	
Aresyet e voneses	( ) Vonese e per gjithshme dhe Vonese gjeometrike ( ) Vonese e per gjithshme pa Vonese gjeometrike ( ) Ndalese e vonuar – metoda SIDRA ( ) Ndalese e vonuar - metoda HCM [ ] formula e voneses HCM		

*Tabela 5.1.b – Lista e parametrave thelbesore te pranishem ne CONFIG (pjesa e dyte)*

### 5.3. Te dhenat Input

Nder te dhenat e para te kerkuara gjejme ato qe lidhen me volumin e trafikut; duhet te specifikohet kohezgjatja totale e vezhgimit te fluksit ( $T$ ), kohezgjatja e periudhes te pikut ( $T_p$ ) dhe faktori i pikut (PFF), qe shpreh raportin midis vellimit te trafikut mesatar ( $q_a$ ) regjistruar gjate ( $T$ ) dhe volumit te periudhes se pikut ( $q_p$ ).

Pervec parametrave te siperpermendur duhet te sinjalizohet perberja e volumit te trafikut. Persa i perket perfaqesimit gjeometrik te kryqezimit, SIDRA mundeson te analizohen edhe kryqezime me numer degesh me te madh se 4.

Nje aspekt thelbesor i procedures SIDRA eshte evidentimi i levizjeve; koncepti i levizjes eshte i ngjashem me konceptin e grupit te korsive tipike te HCM, dhe lidhjes ne programin TRANSYT, por tek SIDRA operatori ka nje fleksibilitet te madh zgjedhjesh. P.sh rrymat qe i perkasin fazave te ndryshme, ose qe kane vlera te ndryshme te fillim/mbarimit, ose qe marrin vlera te ndryshme te fluksit te mbisaturimit, mund te specifikohen si levizje te ndryshme.

Ne perjithesi kemi nje nivel te mire detajimi, duke shoqeruar nje levizje me cdo manover kthimi per hyrje ne kryqezim.

Ne vazhdim po paraqesim vlerat Default per parametrat e volumit te trafikut:




Figura 5.2 – Vlerat e pranuara per parametrat e volumit te trafikut

Ku termat e paraqitur ne figuren e mesiperme jane respektivisht:

- $q_a$ - eshte perqindja e fluksit ne ardhje ne nje korsi hyrese (numri mesatar i mjeteve ne njesine e kohes)
- $q_p$ - eshte perqindja e fluksit ne ardhje ne nje korsi hyrese ne oren e pikut
- $T_p$ - eshte periudha e kohes per vezhgimin e pikut te fluksit
- $T$ - eshte periudha e kohes per vezhgimin e flukseve te mjeteve

## Tema e Doktoraturës:

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Fluksi i saturimit te levizjeve mund te percaktohet direkt nga perdoruesi, ose mund te llogaritet nga programi, nepermjet nje procedure qe korrigjon nje fluks saturimi baze, i referuar nje situate ideale me koeficente te pershtatshem, qe marrin parasysh karakteristikat gjeometrike dhe ato te perberjes se trafikut te vete kesaj levizjeje; ne menyre te vecante, ne kete version te programit, SIDRA formulon nje shprehje te re per llogaritjen e fluksit te saturimit te manovrave te kthimit.


Per cdo korsi, pervec karakteristikave gjeometrike, duhet specifikuar perdorimi nga ana e levizjeve, mundesia eventuale e parkimit ne ane te karrekhates, ose prezencia e ndalesave eventuale te mjeteve publike.

SIDRA lejon nje liri te theksuar zgjedhjeje, edhe persa perk jet zgjedhjes se tipologjise se fazave (deri ne 18 te tilla) dhe te sekuences se tyre, edhe pse mund te jape automatikisht nje seri sekuencash faze, nqs keto nuk specifikohen nga perdoruesi. Gjithashtu sekuanca e fazave te vendosura mund te reduktohet me proceduren e optimizimit; SIDRA ne fakt i identifikon fazat e panevojshme dhe i eliminon ato.

Nje screen me vete i eshte dedikuar pershkrimit te manovrave te penguara, nga te cilat tregohen levizjet e kunderta dhe parametrat perkates karakteristike.

Per cdo levizje (nenkuptohet manovra e kryer nga nje mjet per kthim, ose pershkrim) tregohen minimumi dhe maksimumi i kohes se semaforit jeshil te sinjalizuar, vlera e portokallise dhe e gjithe semaforit te kuq, si dhe koha e humbur.

Ne Figuren 5.4 ilustrohet sekuanca e koheve qe formojne fazen semaforike me evidentimin e termave qe jane sjelle me vlerat Default ne skemen e futjes se te dhenave (start lag, start loss, effective green time, end gain).



*Figura 5.3 – Percaktimi i parametrave te kohes ne levizjet e mjeteve*

#### 5.4. Procedura e llogaritjes se kohes

SIDRA si hap te pare te procedures se llogaritjes percakton per cdo faze levizjet kritike, duke piketuar keshtu ato levizje qe kerkojne nje vlore me te madhe te jeshilit shprehur nga formula 5.1:

$$t = \frac{y \cdot c}{x_p} + l \quad [5.1]$$

Ku:

- y- tregon raportin midis fluksit hyres dhe fluksit te saturimit
- c- kohezgjatjen e ciklit
- l- kohen e humbur
- $x_p$ - graden e saturimit max te hipotezuar (Default 0.9)

Ne nje hap te dyte SIDRA vlereson te gjitha kombinimet e mundshme te levizjeve qe kompletojne nje cikel, dhe duke mbledhur vlerat e kohes se nevojshme, identifikon planin kritik qe i korrespondon atij, ne te cilën shuma e mesiperme ka vlore maksimale.

Keshtu qe percakton kohen e humbur totale L, raportin e fluksit Y dhe kohen e kerkuar U te kryqezimit, si shumen e vlerave korresponduese referuar levizjeve qe kryhen brenda te njejtit kryqezim.

Keto vlera mundesojne te llogasim te ashtuquajturen koha e ciklit praktik Cp, 5.2:

$$c_p = \frac{L}{1-U} \quad [5.2]$$

Koha e ciklit optimal Cav gjendet nepermjet perseritjeve e tentativave te njepasnjeshe, ne te cilën llogaritet kohe pas kohe nje cikel mesatar qe ka shprehjen e me poshtme, 5.3:

$$c_{av} = \frac{c_{i-1} + 3c_p}{4} \quad [5.3]$$

dhe ku  $C_{i-1}$  eshte koha e ciklit te gjetur ne iteracionin e mesiperme dhe  $C_p$  ai i llogaritur ne iteracionin aktual

Koha e re e ciklit te perdorur per iteracionin aktual eshte marre duke perafruar ciklin e mesem Cav ne lidhje me rritjet e parashikuara ne cikel. Vlera perfundimtare e zgjedhur e ciklit ne fund te perseritjeve krahasohet me vlerat min e max te vendosura.

Ekziston edhe një tjeter procedure e llogaritjes se kohes se ciklit, e quajtur koha e cikleve variabel. Ne kete procedure ne fillim percaktohet një funksion objektiv per tu optimizuar, pastaj llogaritet vlera e kesaj madhesie per rritje te metejshme te ciklit, duke nisur nga cikli minimal dhe me një hap te percaktuar nga operatori.

Cikli optimal do te jete ai që do ti korrespondoje vleres optimale te funksionit objektiv.

## 5.5. Te dhenat Output

Pershkrimi i te dhenave output eshte shume i gjere dhe jep informacione per levizje, per korsi, per menyre hyrjeje, ose per grupe levizjesh te percaktuara nga perdoruesi. Ato mund te analizohen, qofte ne një file teksti, qofte nepermjet një serie paraqitjesh grafike te aktivizuara nga procedura GOSID.

Ne filen e tekshit rezultatet e marra renditen ne skeda te njepasnijeshme, ku ne secilen prej tyre jepet respektivisht: te dhenat lidhur me volumin e trafikut, parametrat e kohes se semaforizimit, vlerat lidhur me kapacitetin dhe tregues te tjere.

Ketu po sillen disa nga perkufizimet e parametrave te Output te programit, si permbajte te tableles “Intersetion summary” dhe qe jasin një permblehdje numerike te efikasitetit te kryqezimit te projektuar.

*Fluksi i kerkeses (Demand Flow).* Kjo e dhene Input tregon numrin e automjete qe dalin ne oren e pikut, nepermjet seksionit rrugor te deges korresponduese. Vihet re se, vlerat e dhena te futjes se flukseve te trafikut ndryshojne nga vlerat e Demand Flow, qofte, sepse merren parasysh luhatjet e trafikut ne oren e pikut, qofte, per prezencen e mjeteve te renduar. Ne te dyja rastet, sa me te medha jane vlerat e konsideruara, aq ma te medha jane diferenca midis “Input Volumes” e “Demand Flow”.

*Shkalla e saturimit (Degree of Saturation).* Eshte rapporti midis fluksit prezent “Demand Flow” dhe kapacitetit te seksionit rrugor te konsideruar. Ky llogaritet, si per cdo dege te vetme te kryqezimit, ashtu edhe per cdo lloj manovre. Nqs nuk ka dege te paperdorura vlerat e  $q/C$  jane te ngjashme, por mund te ndodh qe, një dege ne vecanti, ose edhe një manover (zakonisht ajo e kthimit majtas), rezulton te kete një vlere shume te ndryshme, krahasuar me vlerat mesatare per deget e tjera, ne menyre te tille qe te nenkuptoje një perkeqesim te Grades se saturimit te kryqezimit. Ne fakt, vlera qe jepet ne skeden grafike te Output-it, eshte ajo me e renda midis te gjitha levizjeve te degeve te ndryshme.

*Kapaciteti (Capacity Total).* Eshte numri maksimal i mjeteve qe mund te rrjedhe nepermjet korsise, ose grupit te korsive, te karrekhates rrugore te ciles i referohet. Kjo e fundit differencohe ne varesi te karakteristikave te kryqezimit te marre ne konsiderate. Kapaciteti eshte percaktuar si:

### Kryqezime te semaforizuara

- $Q = S \cdot g / C$  per cdo korsi te **kryqezimeve te semaforizuara** ne kushte ideale; duke konsideruar prezencen e fluksit ne drejtim te kundert, marrim ekuacionin e mpsh, 5.4:

$$s_u = \frac{3600}{\beta} (1 - \Delta_0 q_0 + 0.5 \cdot \beta \cdot \varphi_0 \cdot q_0) e^{-\lambda(\alpha - \Delta_0)} \quad [5.4]$$

Ku:

$s_u$  = fluksi i saturimit te ktheses qe ka trafik ne drejtim te kundert (veh/h),

$\alpha, \beta$  = critical gap (boshlek kritik) dhe follow-up headway (intervali kohes shoqerues) ne (sek),

$q_0$  = norma e fluksit total ne drejtim te kundert (pcu/s), e llogaritur si shuma e normave te flukseve per te gjitha levizjet e rrymave me drejtim te kundert, duke patur parasysh edhe korrigjimet si pasoje e prezences se mjeteve te renda,

$\Delta_0$  = intra-bunch headway (brenda intervalit kohor) (sek) perfaqeson intervalin e kohes qe i nevojitet nje automjeti, qe te futet ne grupin e automjeteve ne rrrethrotullim,

$\varphi_0$  = perqindja e automjeteve te pagrupuar (te lire) i te gjitha rrymave te trafikut me drejtim te kundert,

$$\lambda = \frac{\varphi_0 \cdot q_0}{1 - \Delta_0 q_0} \quad (\text{nqs } q_0 > 0.98 / \Delta_0 \Rightarrow q_0 = 0.98 / \Delta_0, \text{ ne te kundert merret vlera e } q_0)$$

### Rrrethrotullime

- $Q = F - f \cdot Q$  (model regresioni linear, Kimber, Akcelik, studiuar midis 1977 dhe 1980 me publikimet e mpsh – “In search of a new capacity formula for conventional roundabouts” 1977, “The capacity of offside priority entries” 1978, “The traffic capacity of roundabouts” 1980) per rrrethrotullimet, ku ne vazhdim qartesohet shprehja me koeficentet perkates te konsideruar nga programi:

$$Q_e = \max[(f_{od} \cdot f_{HVe} \cdot Q_g), Q_m] - \text{kapaciteti ne hyrje} \quad [5.5]$$

Ku:

$Q_g = \frac{3600}{\beta} (1 - \Delta_0 q_0 + 0.5 \cdot \beta \cdot \varphi_c \cdot q) e^{-\lambda(\alpha - \Delta_c)}$  - kapacitet i vleresuar duke perdorur metoden “gap acceptance” ne te cilen  $\varphi_c$  eshte perqindja e automjeteve te lira ne fluksion qarkullues,

$$f_{od} = 1 - f_{qc} (P_{qd} \cdot P_{cd})$$

ne te cilen vlera e kalibrimit fqc varet nga entiteti i fluksit qarkullues dhe nga tipi i rrrethrotullimit

pqd = perqindja e automjeteve ne rradhe tek perqasja dominante e rrrethrotullimit (me fluksin me te madh)

pcd = perqindja e fluksit qarkullues total ne rrrethrotullim i gjeneruar nga perqasja dominante,

$Q_m = \min(q_{ai,60} n_m)$  - kapaciteti minimal i fluksit ne drejtim te kundert

Ku:

qai = norma e fluksit se korsise hyrese e korrigjuar me treguesin e automjeteve qe ndodhen ne rradhe,

$n_m$  = numri min i automjeteve ne minute qe mund te hyjne ne fluksin qarkullues

**95% Rradhe (Back of Queue).** Eshte parametri qe pershkruan formimin e rradheve ne deget e ndryshme te kryqezimit te konsideruar. I nevojshem per qellime projektimi, referuar hapesirave te nevojshme per grumbullimin e automjeteve, paraqet vleren kufitare te rradhes, qe mund te verifikohet me probabilitet 95% (dmth vetem ne 5% te rasteve mund te kemi vlera me te medha, zakonisht te diktuara nga anomali te trafikut). Shprehet si ne numer automjetesh, edhe ne gjatesi (m), duke qene se programi pranon si te dhene Input ngarkesen e automjeteve ne rradhe (qofte e lehta apo e rende). Vlerat e paracaktuarta te ngarkeses se automjeteve jane 7m per automjetet e lehta dhe 14m per automjetet e renda.

Formula e llogaritjes eshte e mpsh:

$$N_{bp\%} = f_{bp\%} \cdot N_b = f_{bp\%} (N_{b1} + N_{b2}) \quad [5.6]$$

ku:

$f_{bp\%}$  eshte nje faktor qe merr parasysh vleren ne perqindje te zgjedhur per llogaritjen e automjeteve ne rradhe (gjatesine e kesaj radhe)

$N_b$  eshte vlera mesatare e formimit te rradhes (cycle average queue);

$$N_{b1} = f_{b1} \cdot N_{bu} = f_{b1} [q_{ai} \cdot r / (1 - y)] \quad (\text{nqs } x \leq 1) \text{ ose}$$

$$N_{b1} = f_{b1} \cdot N_{bu} = f_{b1(x=1)} [q_{ai} \cdot C / (1 - y)] \quad (\text{nqs } x > 1),$$

$$N_{b2} = 0.25 Q_e T_f \left[ z + \sqrt{z^2 + \frac{8k_b(x - x_0)}{Q_e T_f} + \frac{16k_b \cdot N_i}{Q_e T_f}} \right] \quad (\text{nqs } x' > x_0) \text{ ose}$$

e barabarte me zero ne rastet e tjera,

ku:

$Q_{ai}$  = norma e fluksit te korsise ne hyrje e korrigjuar me treguesin e automjeteve qe ndodhen ne rradhe (queued vehicles)

C = koha e ciklit;

r = koha mesatare e semaforit te kuq efektiv (red);

y = norma e fluksit te ardhjeve (arrivals during red/green);

x = grada e saturimit;




Figura 5.4 – Percaktimi i parametrave ne rradhet e automjeteve.

$x_0$  = grada e saturimit kritik;

$x'$  = grada e saturimit efektiv, qe merr parasysh efektet e rradhes se automjeteve;

$Q_e$  = kapaciteti i nje korsie te vetme,

$N_i$  = kerkesa fillestare per rradhe automjetesh (queue at end red);

$T_f$  = kohezgjatja e periudhes se vezhgimit per vleresimin e kerkeses se fluksit, eshte per tu theksuar qe vlerat  $z$ ,  $k_b$  dhe  $f_{b1}$  kane shprehje ne varesi te tipit te kryqezimit;

**Koha e humbur (Control Delay).** Perfaqeson kohen mesatare te humbur nga secili automjet si pasoje e prezences se kryqezimit. Kjo eshte shuma e voneses gjometrike ‘dig’ dhe e voneses se shkaktuar nga pritja ne rradhe ‘ $d_{SL}$ ’. Ne kete kontest behen te rendesishem Input-et e dhena ne tabelen e parametrave te negociatave (dmth parametrat qe i perkasin shpejtesise, distances dhe rrezes se kurbature, qe pershkruajne levizjen e kalimit te kryqezimit). Ketu ne vazhdim jane rradhitur formulat e perdonura per llogaritjen e vonesave dhe grafiku qe evidenton dy termat:

$d_{ic} = d_{SL} + d_{ig}$  - Vonesa mesatare e cdo automjeti si pasoje e prezences se kryqezimit [5.8]

$d_{ig}$  - Vonesa mesatare e cdo automjeti per efekt te gjometrise se kryqezimit  
(Hp per  $q=0$ ).

$d_{SL} = d_1 + d_2$  Vonesa mesatare e cdo automjeti ne momentin e prezences se vijes ‘STOP’

$d_1 = f_{dl} \cdot d_u = f_{dl} [0,5 \cdot r(1-u) / (1-y)]$  (nqs  $x' \leq 1$ ) ose

$d_1 = f_{bl(x'=1)} [0,5 \cdot r]$  (nqs  $x' > 1$ ),

$$d_2 = 900T_f \left[ z + \sqrt{z^2 + \frac{8k_d(x-x_0)}{Q_e T_f} + \frac{16k_d \cdot N_i}{Q_e T_f}} \right] \quad (\text{nqs } x' > x_0)$$

ose e barabarte me zero ne rastet e tjera,

ku:

$r$  = koha mesatare e semaforit te kuq efektiv (red);

$u$  = perqindje e semaforit jeshil g/C;

$y$  = norme e fluksit ne mberritje;

$x$  = grada e saturimit;

$x_0$  = grada e saturimit kritik;

$x'$  = grada e saturimit efektiv, qe merr parasysh efektet e rradhes se automjeteve;

$Q_e$  = kapaciteti i nje korsie te vetme;

$N_i$  = kerkesa fillestare per rradhe automjetesh (queue at end red);

$T_f$  = kohegjatja e periudhes se vezhgimit per vlersimin e kerkeses se fluksit,

eshte per tu theksuar qe vlerat  $z$ ,  $k_d$  dhe  $f_{dl}$  kane shprehje ne varesi te tipit te kryqezimit

### *Level of Service (worst movement)*

Eshte nje tregues artificial perfaquesues i cilesise se perjithshme se qarkullimit ne kryqezim. Parametri qe konsiderohet per vleresimin e NSH te kryqezimit, ose te degeve te lidhura me te dhe te manovrave relative, eshte vonesa mesatare per automjet.

**Ndalesat efektive (Total Effective Stops).** Perfaqeson numrin total te ndalesave, qe te gjithe mjetet jane te detyruar te bejne gjate qendrimit ne kryqezim per ta kaluar ate. Software jep nje vlere totale dhe nje vlere mesatare qe perfaqeson numrin e ndalesave qe cdo automjet i vecante kryen ne te njejtin Effective stop rate.

**Shpejtesia e udhetimit (Travel Speed).** Eshte vlera mesatare e shpejtesise qe automjeti mban gjate pershkimit te kryqezimit, duke patur parasysh kushtet e motorit, ne frenim, ne nxitim, ne qendrim. Formula eshte:

$$v_t = \frac{3600L_t}{t_t} = \frac{3600L_t}{t_u \cdot L_t + d_t} = \frac{3600L_t}{\frac{3600L_t}{v_{ac}} + d_t} \quad [5.9]$$




Figura 5.5 – Percaktimi i shpejtesive per nje mjet qe perballat me nje kryqezim te semaforizuar

ku:

$v_t$  = shpejtesia mesatare e udhetimit duke konsideruar rrjedhen e nderprere;

$L_t$  = distanca e udhetimit;

$t_t$  = koha e udhetimit e nderprere;

$t_u$  = koha e udhetimit per njesi te distances se panderprere;

$v_{ac}$  = shpejtesia e afrimit ne kryqezim;

$t_u \cdot L_t$  = koha e udhetimit te panderprere;

$d_t$  = vonese e udhetimit si shume e te gjithe komponenteve te pritjes;

**Kostoja e operimit (Operating Cost).** Sasia perfshin te gjitha kostot, qofshin direkte apo indirekte, qe dalja e nje automjeti te vetem mund te percaktoje. Ne te vertete ne kete ze hyjne te gjitha zerat e shpenzimeve, qe perdoruesi duhet te perballoje dhe qe percepton ne menyre direkte si kosto e karburantit, e mirembajtejes, e gomave, te vajit lubrifikues, te riparimeve te ndryshme. Ne vleresimin e tij hyn edhe kostoja qe merret nga koha e humbur gjate udhetimit i perbere nga termat “running + stop”.

$$C_t = \frac{k_0 \cdot F_t}{100} + k_t \cdot T_t \quad [5.10]$$

ku:

$F_t$  = konsumi total i karburantit;

$T_t$  = koha totale e udhetimit te automjeteve;

$k_0 = f_c \cdot f_r \cdot P_p / 100$  = faktor kostoje operativ;

$f_c$  = faktor kostoje qe merr parasysh gjithe shpenzimet per mirembajtjen e automjetit;

$f_r$  = faktor kostoje qe merr parasysh burimin e karburantit;

$P_p$  = cmimi i karburantit;

$k_t = f_0 \cdot f_p \cdot W$  = koha e kostos per cdo automjet;

$f_0$  = punesimi mesatar i cdo automjeti;

$f_p$  = faktor i kthimit te rroges mesatare ne kohe udhetimi;

W = rroga mesatare orare;

*Konsumi i karburantit (Fuel Consumption, Carbon Dioxide (CO<sub>2</sub>), Hydrocarbons (CH<sub>x</sub>), Carbon Monoxide (CO), NO<sub>x</sub>).*

Jane te gjithe parametrat qe percaktojne ndotjen atmosferike te gjeneruar nga automjetet qe levizin ne kryqezimin e konsideruar. Vlerat finale rrjedhin nga shumat e llogaritura ne deget e ndryshme dhe shprehen respektivisht ne litra/h per karburantin, ne Kg/h per te gjitha emertimet e permendura. Ekuacionet per llogaritjen e sasise se permendur jane analoge me ato te pershkruara mesiper, te referuara kushteve te ndryshme te motorit.

Programi jep skema permbledhese qe permblajne te gjithe parametrat Output te llogaritur, te ndare per manovra dhe grupe korsish. Parametrat qe jane llogaritur e paraqitur jane prezent ne pjesen e majte te ekranit ne figuren 5.11, me emertimet e mpsh:

- Capaciteti (degree of saturation, practical spare capacity, capacity total);
- Kosto (operating costs);
- Vonesa (control delay, geometric delay, stop-line delay);
- Flukset (approach - circulating - exiting flows, PHV, demand flow, input volumes);
- Karburanti dhe clirimi i tij (CO, CO<sub>2</sub>, fuel consuption, CH<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>);
- Pershkrimi i levizjes;
- NSH (Level of service);
- Rradhet (queue distance, queue storage ratio, queue);
- Shpejtesia e mjeteve (cruise speed, running speed, travel speed);
- Ndalesat (proportion queued, effective stop rate, total effective stops).

Egziston gjithashtu mundesa per te pare sesi mund te nderveprojne reciprokisht disa madhesi. Ne fakt ne aksin e abhisave vendosen parametrat Input (variacion 0-200%), ndersa ne aksin e ordinatave vendosen parametrat perkates Output, ne menyre qe te vleresohen variacionet perkatese:

INPUT	OUTPUT
Maximumi jeshiles per sinjalet e vendosur	<b>Kapaciteti</b>
<b>Gjereria e korsise</b>	CO <sub>2</sub>
Shkalla e perdorimit te korsise	CO
<b>Diametri i ishullit te rrethrrrotullimit</b>	<b>Vonese ne kontroll</b>
Diametri i brendshem i	Koha e ciklit

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

rrethrrrotullimit	
<b>Follow-up headway &amp; critical gap</b>	Shkalla e ngopjes
	Fluksi i kerkeses
	Ndalesa efektive
	Konsumi i karburantit
	CHx
	Rradha me e gjate
	Nox
	<b>Kosto e operimit</b>
	Indexi i performances
	Kapaciteti i hapesires
	Vonesa ne linjen e ndalimit
	Shpejtesia e udhetimit

Te gjithe parametrat mund te kombinohen per te mundesuar grafiket perkates nga te cilet sillet nje shembull.

Pervec kesaj mund edhe te parashikohet gjeometria e kryqezimit per ta kuptuar me mire ate.

### **5.7 Simulimi i funksionalitetit**

Mbas nje pershkrimi te shkurter te bazave teorike te kontrollit ne kryqezime dhe nje shqyrtimi te shpejte te modeleve kryesore te aplikuar ne literature, per percaktimin e NSH, niveli te sherbimit, behet nje krahasim operativ nepermjet aplikimit te programit SIDRA, midis kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve.

Jane zgjedhur per analize tre kryqezime ne hyrje te qytetit te Durrësit.

Do te jepet gjithashtu nje tabele permblehdhese qe do te rendise te gjithe rezultatet e programit per kryqezimet e ndryshme te marra ne konsiderate, duke bere edhe krahasimin e tyre.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

---



**Matjet e bera dhe rezultatet e marra**

Matjet jane bere ne tre kryqezime ne hyrje te qytetit te Durrësit. Ato jane hedhur ne program dhe jane gjeneruar rezultatet per tre variante zgjidhjeje per cdo kryqezim: semaforik, semaforik me nje korsi shtese kthimi majtas, dhe me rrrethrrrotullim.


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**


**VARIANTI 1**



**Kryqezimi 1**





**Kryqezimi 2**




**Kryqezimi 3**


## VARIANTI 2



**Kryqezimi 1**



**Kryqezimi 2**





**Kryqezimi 3**

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

**VARIANTI 3**




**Kryqezimi 1**


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---



**Kryqezimi 2**




**Kryqezimi 3**

## ANALIZA E VARIANTIT 1

### Kryqezimi 1

Ne variantin e pare kryqezimi 1 eshte parashikuar te jetë me dy korsi per secilin drejtim. Ne kete rast nuk kemi korsi te specializuar per kthimin majtas . Gjeometria e kryqezimit eshte modeluar te jetë si ne projekt-idene e cila eshte perbatitur ne Autocad Civil 3D.


Ne figuren e meposhteme eshte dhene konfiguracioni i kryqezimit i cili eshte modeluar me ane te software-it SIDRA.



### Matjet e Trafikut


Per te llogaritur volumin e trafikut ne kryqezim jane kryer matje trafiku reale per nje peridhe 5 oreshe. Te dhenat e trafikut jane dhene ne figuren e meposhtme.

Volumi i trafikut eshte dhene ne figuren e meposhtme. Te dhenat jane orare, qe nenkupton qe, volumet e trafikut jene orare pra mjete ne ore.



### Niveli i Sherbimit


Ne baze te volumeve te trafikut, numrit te korsive si dhe koheve te semaforeve eshte llogaritur dhe niveli i sherbimit te kryqezimit. Po te verejme me vemandje ne figuren e meposhteme kuqtojme qe niveli i sherbimit C eshte ne kthimin majtas te krahut lindor dhe perendimor te kryqezimit.



### Fazat Semaforike


Ne fazat semaforike eshte presupozuar qe komandimi i semaforit eshte i kompjuterizuar, qe do te thote qe per orare te ndryshme ne baze te volumeve te trafikut, semafori vete rregullohet. Koha e ciklit eshte llogaritur te jete 46 sekonda, ndersa numri i fazave 2.

Detaje lidhur me fazat e semaforit jane dhene ne figuren e meposhtme. Ne percaktimin e koheve semaforike eshte marre parasysh dhe numri i kembesoreve.




### Shkalla e saturimit

Shkalla e saturimit te kryqezimit jepet ne figuren e meposhtme. Ky tregues eshte i lidhur me nivelin e sherbimit NSH. Kuptohet qe per kapacitetin qe ka, dhe interseksioni mund te funksionoje mire.




## Kryqezimi 2

Gjeometria e kryqezimit 2 eshte pothuaj e njejtë me ate te kryqezimit 1, sepse dhe vete hapesira na e lejon nje gje te tille. Pra kemi nje rrugë me 2 korsi nga secili drejtim.



## Matjet e trafikut

Matjet e trafikut tregojne qe volumet e trafikut ne kete kryqezim jane te ngjashme me volumet ne kryqezimin paraardhes.




## Kohet semaforike

Kohet semaforike jepen ne tabelen e meposhteme


**Tema e Doktoraturës:**  
**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---



## Shkalla e saturimit

Shkalla e saturimit eshte nga 24-40 % sipas krahut te kryqezimit.






## Niveli i Sherbimit

Per cdo krah te kryqezimit eshte llogaritur niveli i sherbimit.

### Kryqezimi 3

Kryqezimi 3 eshte parashikuar te jetë me te njejtin konfiguracion si ne variantin e pare ashtu dhe ne variantin e dyte.





## ANALIZA E VARIANTIT 2

Ne variantin e dyte kryqezimet 1 dhe 2 kane te njejten konfiguracion . Ne variantin e dyte ne ndryshim nga i pari eshte qe kemi shtuar nje korsi e kthimit majtas te dedikuar.


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**


Me perjashtim te kryqezimet 3, i cili ka konfiguracion te njeje me ate te variantit te pare, per kryqezimet e tjera jane bere llogaritjet e nivelist te sherbimit si dhe koheve semaforike

### Kryqezimi 1

#### Gjeometria




#### Niveli sherbimit




## Tema e Doktoraturës:

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**


### Cikli Semaforik



### Volumi Trafikut



### Vonesa ne kryqezim




## Tema e Doktoraturës:

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**


---

### Kohet semaforike




### Kryqezimi 2


#### Gjeometria




### Kohet semaforike




## Volumi Trafikut



## Shkalla e saturimit



## Vonesat ne kryqezim




## **ANALIZA E VARIANTIT 3**


Ne variantin 3 kryqezimet jane parashikuar te jene rrrethrrrotullime. Njesoj si ne variantet e tjera jane bere po te njejtat llogaritje per te pare nivelin e sherbimit te kryqezimeve.

### **Kryqezimi 1**

#### **Gjeometria**




#### **Volumi Trafikut**




## Tema e Doktoraturës:

“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”


### Niveli Sherbimit



### Shkalla e saturimit




### Vonesat ne Kryqezim




## Kryqezimi 2


### Gjeometria



### Volumet e trafikut




### Shkalla e saturimit



**Tema e Doktoraturës:**


**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

## Vonesat ne Kryqezim




## Kryqezimi 3


### Gjeometria




## Volumet e trafikut



## Shkalla e saturimit



## Niveli i sherbimit



**TABELE KRAHASUESE E REZULTATEVE TE PROGRAMIT**

<b>Kryqezimi 1</b>	<b>Niveli i sherbimit</b>	<b>Vonesa mesatare/sek</b>
Varianti 1	B	15.8
Varianti 2	B	15.8
Varianti3	A	8.4
<b>Kryqezimi 2</b>	<b>Niveli i sherbimit</b>	<b>Vonesa mesatare/sek</b>
Varianti 1	B	16.3
Varianti 2	B	16.3
Varianti3	A	8.6
<b>Kryqezimi 3</b>	<b>Niveli i sherbimit</b>	<b>Vonesa mesatare/sek</b>
Varianti 1	B	13.8
Varianti 2	B	13.8
Varianti3	A	8.3

*Konsiderata mbi rezultatet*

Nga analizat e simulimeve te kryera, vihet re menjehere qe kryqezimet me rrrethrotullim, funksionojne me mire se ato te semaforizuara, ne kushte te nje trafiku larg saturimit dhe kur prania e kthesave majtas eshte e dukshme ne te gjitha deget e kryqezimit. Ne te kundert, ne shumicen e rasteve te propozuara, funksionojne me mire kryqezimet e semaforizuara. Ne fakt, me pak trafik, ne rrrethrotullim vonesa jepet nga gjeometria e te njejtes, qe ben devijimin e trajktoreve, ndersa semafori percakton nje humbje kohe me te madhe, nga momenti kur, edhe me programin e optimizimit te fazave, duhet te mbahen disa kohe jeshile minimale per defluksin e cdo rryme automjetesh. Diskutimi ndryshon me volume me larta te trafikut, meqe te gjithe mjetet duhet ti japin perparesti ne kalimin e nje rrrethrotullimi, per te cilin voneses gjeometrike i shtohet ne menyre thelbesore vonesa e shkaktuar nga ngadalesimi per ndalimin mbi linjen e dhenies perparesti dhe asaj te ndalimit efektiv ne krye. Funksionon keshtu me mire kryqezimi i semaforizuar, meqe ne rrrethrotullim, fluksi me pak i rendesishem, pengon ate me te madhin, duke percaktuar humbjet me te medha ne kohe.

## **KAPITULLI 6**

### **6.1 Siguria ne rrethrrotullime**

Nje nga karakteristikat me te mira te rrethrrotullimeve eshte siguria e tyre, qe konkretizohet ne nje numer me te vogel aksidentesh dhe mbi te gjitha me nje rrezikshmeri me te ulet. Siguria e rrethrrotullimeve vjen si pasoje e disa faktoreve, ku me kryesoret jane: reduktimi i shpejtesise, numri me i vogel i pikave te konfliktit (nje kryqezim me 4 dege ka 28 pika konflikti, nje rrethrrotullim ka vetem 8) dhe kujdesi me i madh i kerkuar nga drejtuesit. Pikat e konfliktit jane te pakta, sepse ne saje te trafikut me nje kalim ne karrehaten qarkulluese, mund te eliminohen manovrat per kthim majtas, qe jane edhe ato qe shkaktojne aksidentet me te renda. Per te projektuar dhe ndertuar rrethrrotullime qe te kene karakteristika sigurie te mira, vonesa te pranueshme si dhe kapacitete te pershtatshme, duhen njohur marredheniet midis elementeve te ndryshem te konfigurimit te tyre, sjelljet e drejtuesve dhe rreziqet e aksidenteve. Sic do te shikojme ne vazhdim, problemet me te medha i perkasin sigurise se kembesoreve dhe te mjeteve ne dy rrota (ciklista dhe ciklomotora), prandaj do ti kushtohet nje vemendje e vecante per evidentimin e elementeve, qe mund te ndikojne ne sigurine e tyre dhe te masave te pershtatshme per ta garantuar ate.

Ne kete kapitull do te analizohen kerkimet e bera ne shtete te ndryshme, vecanerishte ato te zhvilluara ne Britanine e Madhe dhe ne France si dhe do te jepen indikacione mbi cfare duhet bere per te permiresuar sigurine ne nje rrethrrotullim.

#### ***6.1.1 Konsiderata mbi sigurine e rrethrrotullimeve modern ne USA***

Rrethrrotullimet jane bere te njohura edhe ne USA per sigurine e tyre vetem koheve te fundit. Opinion i perhapur eshte se rrethrrotullimet, te ndertuara ne nje faqe te vecante, duke ndjekur rregullat e projektimit per rrethrrotullimet moderne, jane tipi i kryqezimit me i sigurte. Rezultatet e kerkimeve te ndryshme kane konfirmuar qe ne rrethrrotullime shkalla e aksidenteve eshte me e vogel se ne kryqezimet e tjera, ne vecanti ne kryqezimet e semaforizuara.

#### ***6.1.2 Siguria ne Britanine e Madhe. Konsiderata mbi sigurine e rrethrrotullimeve para vitit 1966***

Per nje kohe te gjate, edhe ne kohet e sotme, ne Britanine e Madhe projektimi i rrethrrotullimeve eshte perqendruar ekskluzivisht ne llogaritjen e kapaciteteve dhe te vonesave, edhe pse ishte evidente, qe keto jepnin rezultate optimale edhe persa i perket sigurise.

Ne 1956 Garwood e Tanner publikonin rezultatet e disa studimeve, te kryera perpara dhe pas ndertimit te nje rrrethrrotullimi ne Londer, qe tregonin nje reduktim te aksidenteve me 60%, me perqindje me te madhe ne ato me ishuj qendrore me te gjere.

Manuali “Roads in Urban Areas” perfshin disa rekomandime mbi sigurine ne projektet e rrrethrrotullimeve konvencionale.

Keto mund te permblidhen:

- ne ishullin qendoror dhe ne perimetrin e nje rrrethrrotullimi, shtyllat e ndricimit duhen vendosur ne pikë ku eshte i ulet rreziku, qe te goditen nga mjetet qe humbin kontrollin;
- strehim per kembesoret, ose ishuj devijimi, duhet te vendosen ne cdo dege per te ndihmuar kembesoret dhe per te kanalizuar trafikun ne seksionin e rakordimit me nje kend te pershatshem. Ishujt e kanalizimit behen sa me te gjera, por pa nderhyre ne rrugen optimale te mjeteteve.
- ku ka flukse te larte kembesoresh nepermjet daljeve, rrezja e tyre duhet te jetet e ngjashme me ate te hyrjeve per te mbajtur shpejtesite e uleta. RUA rekomandon te vendosen kalimet e kembesoreve me larg nga rrrethrrotullimi ne daljet dhe te vendosen *guardrail* (*rrethoje mbrojtese*) per te penguari kalimin mbi ishullin qendoror. Aty ku eshte e mundur keshillohet ndarja e niveleve per kembesore edhe çikliste.

#### *6.1.3 Efektet mbi sigurine te shkaktuara nga nderrimi i rregullave te perparese ne rrrethrrotullime*

Efektet e mundshme te rregullit te ri mbi perparese ne unaze, qe ne fakt eshte vendosur ne Britanine e Madhe vetem ne 1967, u studiuani nga Blackmore qysh ne 1963. Mbi bazen e eksperimenteve te zhvilluara qysh ne 1956, ai arriti ne perfundimin se futja e rregullit te ri do te ndikonte ne siguri per dy arsyet kryesore:

- arsyja e pare ishte qe, nje rregull i njohur per te gjithe automobilistet, do ti lejonte gjithesecilit per te parashikuar me mire levizjet e te tjereve dhe per te kontrolluar mjetin e tij ne menyre me te sigurte;
- arsyja e dyte ishte qe, nuk ishte normale ti kerkohet trafikut me te shpejte te ardhur nga deget, ti jepte perparese atij me te ngadalte ne karrehaten qarkulluese, ndaj ishte rreziku qe te mos respektohej ky rregull nga drejtuesit. Nga ana tjeter ndersa trafiku qarkullues nuk ishte shume i shpejte, me rregullin e ri mjetet ne ardhje me shume mundesi do ta rregullonin me mire shpejtesine e tyre dhe do te hynin me shume kujdes ne rrrethrrotullim.

Ne kete periudhe nuk u zhvilluan studime per te identifikuar efektet kryesore te rregullit te ri dhe ne te gjashte rrrethrrotullimet, per te cilat ishin te disponueshme te dhenat para e pas ndryshimit eksperimental te perparese, u verifikua nje zvogelim i aksidenteve me te plagosur me reth 40%.

Ne vazhdim te ndryshimit te perparese ne 1968 u publikua manuali “Layout of Roads in Rural Areas” i MoT. Ky permbante edhe indikacionet e para persa i perket sigurise:

- ndricimi i rrrethrrrotullimeve, si ai i te gjithe kryqezimeve te rendesishme, ishte i pashmangshem per te patur gjithmone nje shikueshmeri te duhur, ne menyre qe drejtuesit te ndiqnin rrugetimin e duhur dhe te kryenin me siguri te gjitha manovrat;
- do te nevojiten konsiderata specifike projektimi mbi sigurine, perfshire nje pjese mbi te kuptuarit e automobilistave, derisa drejtuesit ne hyrje ne nje kryqezim te mund te kuption konfigurimin e plote te rrrethrrrotullimit, ose te semaforeve dhe rrugetimin per te ndjekur; per te percaktuar rruget e ndryshme duhet te perdoreshin: konfigurimi, ishujt, sinjalistika horizontale dhe vertikale;
- te shmangen perqasjet e pjerreta ne kryqezim, dmth ato me pjerresi te tepruar, pasi keto ia veshtiresojne automobilistave te kuptuarit e konfigurimit dhe bejne te veshtire nisjen;
- duheshin shmangur, persa ishte e mundur, rrezet teper te mprehta dhe pershkimet komplekse.

#### *6.1.4 Efektet mbi sigurine te projekteve te reja te rrrethrrrotullimeve*

Midis viteve 1968-1969 nga ana e TRRL u zhvilluan eksperimente te tjera ne piste, me qellimin per te kuptuar si kishin ndryshuar sjelljet e automobilistave si pasoje e ndryshimit te rregullit te perparese. Objktivi ishte te kuptohej si keto sjellje te reja influenconin ne kapacitetin e rrrethrrrotullimeve.

Ne 1970 Blackmore (Capacity measurements on experimental) studio rezultatet e eksperimenteve te TRRL te kryera ne rruget e Peterborough, Cardiff e Hillingdon. Ai verejti se, duke reduktuar permasesen e rrrethrrrotullimit, duke adoptuar ne te njeften kohe masa per te patur nje devijim te pershtatshem, kapaciteti rritej. Kjo dukej shume e rendesishme, persa devijimi impononte nje ulje te shpejtesise, e cila kontribuonte ne menyre percaktuese ne rritjen e sigurise. Dy vendet qe perfaqesonin rrule publike, dmth ate me 3 dege ne Peterborough dhe ate me 4 dege ne Cardiff, nuk tregojne ndryshime te dukshme ne numrin e aksidenteve pas 18 muajsh. Fillimisht kembesoret, vecanerisht me te vjetrit, hasnin disa veshtiresi pershtatjeje, por pas pak muajsh, te gjithe perdoruesit e rruges, kembesoret ashtu si automobilistet, mbeten te kenaqur per permiresimin e arritur ne kapacetet.

Ne Hil-lingdon nje rrule me 5 dege, ishulli qendror u reduktua nga 46 ne 15 m, gje qe mundesoi zgjerimin e hyrjeve.

Pavaresisht ketyre eksperimenteve, te dhenat dhe kerkimet mbi sigurine ishin akoma pak dhe te pamjaftueshme, kjo si pasoje e faktit qe projektuesit konsideronin akoma kapacitetin dhe vonesat si elementet e vetem per tu marre ne konsiderate ne projektimin e nje rrrethrrrotullimi.

Ne 1972, me publikimin e Technical Memorandum H7/71, zbulohet nevoja per te kryer monitorime mbi aksidentet ne rrrethrotullime, ne vecanti duheshin bere studimet mbi “para e pas” shnderrimit nga nje kryqezim tradicional ne nje rrrethrotullim.

Eksperimentet e kryera ne rruge me shpejtesi te madhe evidentuan se ne rruget e shpejta ishte e nevojshme te zvogelohej shpejtesia ne kryqezime ne vlera me te uleta se 30 mph ( $\approx 48$  km/h). Kjo mund te arrihej duke perdorur:

- devijim ne hyrje, e realizuar nepermjet ishujve te kanalizimit, koloncinave te shndrritshme, sinjalistika horizontale dhe vertikale;
- dimensionet dhe pozicionin e ishullit qendror;
- rreshtimin e daljeve, ne menyre qe mos te jene paralele, ose shfazimin e hyrje/daljeve;
- bashkevendosja dhe sistemimi i kryqezimit, ne menyre te tille qe te kete sigurine e nevojshme.

Vecanerisht interesante ishin rezultatet e nje studimi mbi aksidentet ne 100 kryqezime, ne te cilet rrrethrotullimet e vegjel kishin zevendesuar format e tjera te kontrollit. Keto rezultate tregonin qe, aksidentet ishin ulur ne kryqezimet e kontrolluara me pare nga semaforet, ose nga kontrollet e precedences, por ishin rritur aty ku nje ishull konvencional i meparshem, thjesht ishte reduktuar per te realizuar nje rrrethrotullim te vogel me nje kapacitet me te madh.

Nga viti 1974 kishte prova te tjera qe, duke reduktuar permasat e ishullit qendror ne nje rrrethrotullim konvencional (rrrethrotullim me perparesti ne unaze) per te rritur kapacitetin, rriteshin aksidentet ne menyre te ndjeshme (deri ne 90%). Kjo i atribuohej shpejtesise se tepruar te mjeteve neper kryqezim, si pasoje e mungeses se devijimit ne rrrethrotullime te vogla, e realizuar vetem nepermjet zvogelimit te dimensioneve te ishullit qendror, krahasuar me nje rrrethrotullim konvencional.

Nje kerkim tjeter i zhvilluar nga Green ne 1977 konfirmonte tendencen ne rritje te aksidenteve ne rastet e transformimit nga nje rrrethrotullim konvencional ne nje rrrethrotullim te vogel. Ky kerkim i perket aksidenteve me te plagosur (PIA, Personal Injury Accidents) ne 150 kryqezime, para e pas kthimit ne rrrethrotullime me ishuj te vegjel, te vetme ose te shumefishta, me ose pa bordura. Nga keto rrrethrotullime, 132 rregulloheshin nga nje limit shpejtesie prej 30-40 mph (48-64 km/h) dhe kontrollet ne kryqezime para kthimit ishin te tre llojeve:

- A. kontroll i perparestive (88 vende);
- B. semafor (13 vende);
- C. rrrethrotullime te gjera te stilit te vjeter (konvencionale) (31vende);

Rezultatet per tre tipet ishin respektivisht:

- 1) nje reduktim domethenes statistikor prej 34% te gjithe PIA dhe 45% te aksidenteve te renda;
- 2) nje zvogelim prej 62% te aksidenteve te renda
- 3) te gjitha rrrethrrotullimet, pervec atyre me ishuj te percaktuara mire me bordura e tre krahe, tregojne nje rritje prej 91% te gjithe PIA, edhe me te madh per aksidentet e renda (ne disa raste prej 200%).

Mund te vihet re, se si keto konvertime te para, pavaresisht se ishin projekte te papershtatshme per sigurine, ishin qartazi me te sigurta se kryqezimet me perparesti dhe te atyre me semafore dhe vetem krahasimi me rrrethrrotullimet konvencionale te meparshme, jepte rezultate negative.

#### *6.1.5 Aksidentet ne rrrethrrotullimet me 4 dege*

Nje studim mbi aksidentet me te plagosur (PIA) ne rrrethrrotullimet me 4 dege u krye nga Maycock e Hall ne vitet 1974/79 (Publikim TRRL 1984). Mostra perfshinte 84 rrrethrrotullime te ndara ne 6 kategori (pa perfshire rrrethrrotullimet e vogla) sic tregohet ne Tabelen 6.1 :

*Tabela 6.1 – Numri i rrrethrotullimeve ne mostren e ndare sipas tipit te kryqezimit*

	Grupe te limitit te shpejtesise	
	30- 40 mph (48-64 km/h)	50-70 mph (80-112 km/h)
Rrethrotullime me ishuj te vegjel > 4m (jo mini rrrethrotulime)	25	11
Rrethrotullime konvencionale	11	11
Rrethrotullime konvencionale me dy karrekhata	14	12

Gati te gjitha rrrethrrotullimet e kategorise 30-40 mph perfshinin fluks kembesoresh. Per te gjitha perqasjet te cdo rrrethrrotullimi u regjistruan karakteristikat e meposhtme: diametri i rrethit brendashkruar, klasi i rruges, lloji i karrekhates, pjerresia e limiti i shpejtesise ne perqasje. U shenuan edhe te dhenat e karakteristikave te degeve, kurbatura e rruges ne hyrje, gjereria e hyrjes, permasat e ishujve ndares.

Te dhenat dhe rezultatet u prezantuan ne LR 1120 ne 24 tabela, te cilat tregonin frekuencen e aksidenteve, rendesine dhe shkallen e aksidenteve per tipet e rrrethrrotullimeve. Aksidentet u analizuan edhe per tipin dhe perdoruesit e perfshire (Ciklista, motociklista, kembesore, etj.). Shpeshtesa e aksidenteve per tip iu referua fluksit te trafikut dhe gjeometrise se rrrethrrotullimit, duke perdorur metoda regresi, duke realizuar nje model te parashikimit te aksidenteve. Me kete qellim u hartuan

disa ekuacione per vleresimin e rrezikut te aksidenteve, ne menyre per ti perdorur ne projektimin e rrrethrotullimeve.

Ne vazhdim do te tregohen rezultatet me domethenese dhe marredheniet kryesore midis faktoreve te ndryshem.

Disa nga rezultatet kryesore te kerkimit ishin:

- 1) shperndarja ne kohe e aksidenteve ne kampionin e marre ne studim pasqyronte modelin kombtar (dmth numrin e aksidenteve qe ndodhin gjate nje viti ne shkalle vendi);
- 2) frekuencia mesatare e aksidenteve (te kampionit) ishte 3.31 PIA/vit, nga te cilat 16% ishin vdekjeprurese ose te renda;
- 3) shkalla mesatare e aksidenteve cdo  $10^8$  mjete qe pershkojne kryqezimin ishte e barabarte me 27,5;
- 4) rrrethrrorullimet e vogla ne zonat 30-40 mph kishin si frekuencia me te medha edhe shkalle te aksidenteve me te larte se rrrethrotullimet e tjera;
- 5) analiza per llojin e aksidentit tregon te qe, modeli per rrrethrotullimet e vogla ishte i ndryshem nga ai per rrrethrotullimet konvencionale; me shume se 2/3 (71%) e aksidenteve te parat ishin hyrese/qarkulluese, ndersa ata ne te dytati ishin te ndare uniformisht midis hyrese/qarkulluese (ndikim midis mjetave hyrese ne unaze dhe mjetave ne unaze), mjetave ne hyrje (ne afersi te deges hyrese) dhe aksidenteve individuale;
- 6) te gjitha rrrethrotullimet kishin nje shkalle te larte te perfshirjes se mjetave me dy rrota: shkalla per  $10^8$  perdorues ishte afersisht 10-15 here nga ajo lidhur me pasagjeret ne auto; ne rrrethrotullimet e vogla, PIA ne lidhje me ciklistat ishte 14 here te atyre ne auto.

Objekti i analizes se regresit ishte relazioni midis frekuencies se aksidenteve ne vendet e rrrethrotullimeve dhe intervalit te variaconit te parametrave shpjegues duke perdorur Generalised Linear Modelling. Ne vazhdim renditen parametrat shpjegues kryesore:

$$\text{Fluksi hyres (Q_c)} = \text{Fluksi qarkullues (Q_c)}$$




Figura 6.1 – Efektet e parashikuara te fluksit te trafikut




Figura 6.2 – Aksidente me te plagosur ne vitet 1975-80 ne rruget me dopio karrekhate

- 1) hyrese/qarkulluese: perplasje midis mjeteve hyrese dhe qarkulluese (perfshire edhe ciklistat);
- 2) ne perqasje: mjete qe devijojne ose nderrojnë korsi;
- 3) individuale: perplasje me pjese te rruges nga ana e mjeteve te vecante;
- 4) te tjere: si perplasia midis mjeteve qarkulluese;
- 5) kembesore (vetem per kryqezimet me limit shpejtësie 30-40 mph).

Per keto aksidente rezultonte i pershtatshem modelli ne formen  $A = k \cdot Q^\alpha$  [6.1], ose me sakte  $A' = k \cdot Q_1^\alpha \cdot Q_2^\beta$  [6.2] (ishte perdorur kryesisht per flukse hyrese/qarkulluese, ne funksion te produktit kryq te flukseve);

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

ku:

$A'$  = aksidente/viti/dege

$Q, Q_1, Q_2$  = jane funksione fluksi, si fluksi hyres dhe qarkullues;

$k, \alpha, \beta$  jane parametrat qe duhen percaktuar.

Rezultatet e aksidenteve hyrese/qarkulluese dhe ato qe perfshijne kembesore jane te ngjashme me ligjin e percaktuar nga Colgate e Tanner per kryqezime te kontrolluar me precedence,  $\alpha=0,52$  e  $\beta=0,53$  respektivisht. Kategori te tjera rriten me shpejt dhe figura 6.2 tregon efektet e parashikuara nga fluksi i trafikut qe jane gati lineare.

Per te patur ne konsiderate per variablat e tjera gjeometrike, modelet u shtrine ne formen:

$$A = kQ^\alpha \exp(b_1 G_1 + b_2 G_2 + b_3 G_3 + \dots) = kQ^\alpha \exp(\sum_i b_i G_i) \quad [6.3]$$

Ne kete ekuacion  $G_i$  eshte variabilja gjeometrike dhe  $b_i$  koeficenti per tu vleresuar.

Cdo tip aksidenti kishte grupin e tij te variablave gjeometrike me peshen relative te dhene.

Instituti amerikan FHWA i bazon kerkimet e tija mbi sigurine e kryqezimeve me rrrethrotullim me formulat e marra nga studimet e zhvilluara ne Mbretine e Bashkuar dhe ne Queensland ne Australi, qe kane prodhuar formulat eksperimentale ne baze te atyre te para paraprakisht, duke i personalizuar me koeficiente ne saje te tipit te aksidentit qe merret ne konsiderate, por edhe ne funksion te llojit te sjelljes se perdoruesve te rruges (ne fakt sjelljet e drejtimit mund te ndryshojne nga nje shtet ne tjeter);

*Instituti Mainroads i Australis (Model australian) jep shprehjet e me poshtme:*

Aksident midis fluksit hyres dhe fluksit qarkullues:

$$A_e = \frac{7,31 \cdot 10^{-7} \cdot Q_a^{0,47} \cdot N_c^{0,9} \cdot (\sum Q_{ci})^{0,41} \cdot S_{ra}^{1,38}}{t_{Ga}^{0,21}} \quad [6.4]$$

ku  $A_e$  eshte numri i aksidenteve i tipologjise se shqyrtuar qe ndoshin cdo vit ne cdo perqasje;

$Q_a$  eshte fluksi i trafikut mesatar ditor vjetor per rrymen e perqasjes (AADT, veh/d);

$N_c$  eshte numri i korsive qarkulluese ne rrrethrotullim;

$Q_{ci}$  jane fluksset e ndryshme te trafikut ne karrehaten qarkulluese ne afersi te perqasjes nga cdo drejtim (veh/d);

$S_{ra}$  eshte shpejtesia relative (rreth 85%) midis mjeteve (ata te ktheses ne rruge dhe atyre ne karrehaten qarkulluese

$t_{Ga}$  eshte koha mesatare e udhetimit e percaktuar nga vija per te dhene precedente rruges se meparshme tek pika e intersektimit midis mjeteve hyrese dhe qarkulluese;

ndersa

$$P_e = \frac{N_c^{0,9} \cdot S_n^{1,38}}{t_{Gi}^{0,21}} \quad [6.5]$$

ku  $P_e$  eshte nje parameter kombinimi qe merr ne konsiderate numrin e aksidenteve qe, me kufizimet e pershtatshme, ben te mundur zvogelimin e ndodhjes se tyre. Ne fakt vlera kufi qe nuk duhet kaluar eshte rreth 300.

Aksidente te mjeteve ne perqasje (pergjate deges se hyrjes ne unaze):

$$A_r = 1,81 \cdot 10^{-18} \cdot Q_a^{1,39} (\sum Q_{ci})^{0,65} \cdot S_a^{4,77} \cdot N_a^{2,31} \quad [6.6]$$

ku  $A_r$  eshte numri i aksidenteve te tipologjise se konsideruar qe ndodhin cdo vit ne cdo perqasje rruge;

$Q_a$  eshte fluksi i trafikut mesatar ditor i shqyrtuar ne vetem nje vije (AADT, veh/d);

$Q_{ci}$  jane flukset e ndryshem te trafikut ne karrehaten qarkulluese ne afersi te perqasjes nga cdo drejtim (veh/d);

$S_a$  eshte shpejtësia ne kthesen e perqasjes (rreth 85%);

$N_a$  eshte numri i korsive ne perqasje te rrrethrotullimit;

Aksident i mjetit te vetem:

$$A_{sp} = \frac{1,64 \cdot 10^{-12} \cdot Q^{1,17} \cdot L(S + \Delta S)^{4,12}}{R^{1,91}} \quad [6.7]$$

$$A_{sa} = \frac{1,79 \cdot 10^{-9} \cdot Q^{0,91} \cdot L(S + \Delta S)^{1,93}}{R^{0,65}} \quad [6.8]$$

ku  $A_{sp}$  eshte numri i aksidenteve te tipologjise se konsideruar qe ndodhin cdo vit ne cdo perqasje perpara vijes se perparese;

$A_{sa}$  eshte numri i aksidenteve te konsideruar qe ndodhin cdo vit ne cdo perqasje pas vijes se perparese;

$Q$  eshte fluksi i trafikut ditor mesatar vjetor i konsideruar vetem per nje vije trafiku (AADT, veh/d);

L eshte gjatesia e udhetimit te drejtuesit per te pershkuar elementet gjeometrike horizontale;

S eshte shpejtesia ne pershkimin e elementeve gjeometrike horizontale;

$\Delta S$  eshte zvogelimi i shpejtesise si pasoje e gjeometrise horizontale te rrrethrrrotullimit (qe imponon disa trajktore me kthese e kunderkthese te menjehereshme);

$N_a$  eshte numri i korsive ne perqasje te rrrethrrrotullimit;

R eshte rrezja e pershkimit gjeometrik horizontal te mjetit te i-te;

Aksident midis fluksit hyres dhe fluksit qarkullues:

$$A_d = 1,33 \cdot 10^{-11} (\Sigma Q_{ci})^{0,32} (\Sigma Q_{ei})^{0,68} S_{ra}^{4,13} \quad [6.9]$$

ku  $A_d$  eshte numri i aksidenteve te tipologjise se konsideruar qe ndodhin cdo vit ne cdo dege;

$Q_c$  jane flukset e ndryshme te trafikut ditor mesatar vjetor (AADT, veh/d) qe afer pikes se daljes, vazhdojne te qarkullojne ne rrrethrrrotullim;

$Q_e$  jane flukset e ndryshme te trafikut ditor mesatar vjetor (AADT, veh/d) te drejtuar ne degen e daljes;

$S_{ra}$  eshte shpejtesia relative (rreth 85%) midis mjeteve (ata qe jane duke dale nga rrrethrrrotullimi dhe atyre ne karrexfaten qarkulluese);

Aksident me goditje anesore midis mjeteve:

$$A_{ss} = 6,49 \cdot 10^{-8} (Q \cdot Q_t)^{0,72} \Delta f_1^{0,59} \quad [6.10]$$

ku  $A_{ss}$  eshte eshte numri i aksidenteve te tipologjise se konsideruar qe ndodhin cdo vit ne cdo dege;

$Q$  eshte fluksi i trafikut ditor mesatar vjetor (AADT, veh/d) per levizjen specifike mbi elementin gjeometrik te vecante;

$Q_t$  eshte fluksi i trafikut ditor mesatar vjetor (AADT, veh/d) mbi elementin gjeometrik te vecante;

$\Delta f_1$  eshte koeficenti i ferkimit sic shpjegohet ne vazhdim me ekuacionin [6.11];

$$\Delta f_1 = ABS \left[ \frac{(S_e + \Delta S_e)^2}{(127 \cdot R)} - \frac{(S_e + \Delta S_e)^2}{(127 \cdot R_e)} \right] \quad [6.11]$$

ku  $\Delta f_1$  eshte diferenca tek koeficenti i ferkimit potencial;

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrerrotullimeve”**

---

$S_c$  eshte shpejtesia relative (rreth 85%) tek elementi gjeometrik horizontal per levizjen e vecante te prerjes se korsise;

$\Delta S_c$  eshte zvogelimi i shpejtesise (rreth 85%) ne fillim te elementit gjeometrik horizontal per mjetet qe presin korsine;

$R$  eshte rrezja e pershkimit te mjetit qe nuk pret korsine;

$R_c$  eshte rrezja e pershkimit te mjetit qe pret korsine;

*Instituti i kerkimeve i Britanise se Madhe (Modeli anglez) jep shprehjet e me poshtme.*

Aksident midis fluksit hyres dhe fluksit qarkullues:

$$A = 0,052 \cdot Q_e^{0,7} Q_c^{0,4} \exp(-40C_e + 0,14e - 0,007ev - \frac{1}{1 + \exp(4R - 7)} + 0,2P_m - 0,01\theta) \quad [6.12]$$

ku te gjithe termat qe bejne pjese ne ekuacion shpjegohen ne vazhdim, ndersa  $P_m$  perfaqeson perqindjen e mjeteve me dy rrota ne fluksset e kryqezim te marre ne shqyrtim.

Aksident i fluksit ne perqasje:

$$A = 0,0057 \cdot Q_e^{1,7} \exp(20C_e + 0,1e) \quad [6.13]$$

Aksident i mjetit te vetem:

$$A = 0,0064 \cdot Q_e^{0,8} \exp(25C_e + 0,2v - 45C_a) \quad [6.14]$$

Lloje te tjera aksidentesh:

$$A = 0,0064 \cdot Q_{ec}^{0,8} \exp(25C_e + 0,2v - 45C_a) \quad [6.15]$$

$$\text{ku } Q_{ec} = Q_e \cdot Q_c.$$

Aksident midis mjetit dhe kembesorit:

$$A = 0,029 \cdot Q_{ep}^{0,5} \quad [6.16]$$

$$Q_{ep} = (Q_e + Q_{ex})Q_p$$

ku dhe  $Q_{ex}$  perfaqeson fluksin e mjeteve ne dalje.

### **6.1.6 Efektet mbi sigurine te variablate gjometrike**

Percaktuesit kryesore te tre llojeve te para te aksidenteve lidhen me faktore qe kane te bejne me hyrjen ose perqasjen ne rrerhrotullime. Keta faktore jane:

Kurbatura maksimale, ne pjesen hyrese te pershkimeve te drejte te mundshem te mjeteve ( $C_e$ ), gjeresia e hyrjes (e) dhe gjysme gjeresia e perqasjes (v). Kjo e gjitha jepet ne menyre grafike ne Figuren 4.4.

Kurbatura e rruges hyrese ( $C_e$ ): eshte nje variabel shpjegues me domethenje te rrezes hyrese dhe eshte gjithmone variabilja statistikisht me efikase. Kurbatura eshte pozitive nqs devijimi eshte majtas dhe negative nqs rrugetimi devijon djathtas. Kurbatura nuk jep nje norme aksidentesh te barabarte me 8.5 here te asaj se arritur me devijim maksimal te verejtur (te barabarte me  $0.053 \text{ m}^{-1}$ ). Disa here kurbatura hyrese mund te percaktohet jo vetem nga gjeometria hyrese, por edhe nga gjeometria ose rreshtimi i daljes. Rreza maksimale prej 100 m e lejuar per devijimin ( $C_e = 0,01 \text{ m}^{-1}$ ), perfaqeson nje koeficent te barabarte me 1,13 per frekuencen e aksidenteve hyrese/qarkulluese. Maycock e Hall propozonin se nje zvogelim i konsiderueshem i aksidenteve mund te arrihej, duke imponuar nje devijim me te madh (Publikim TRRL 1984).

Perqindja e zvogelimit te shpejtesise se vendosur nga norma e 1984 zvogelohet ne menyre te ndjeshme me uljen e shpejtesise se projektuar. Kjo dmth se, per shpejtesi projekti te uleta, kerkohet nje rreze kurbature e vogel e rruges ne hyrje. Sugjerohet nje ulje e shpejtesise prej 14% per nje shpejtesi projekti prej 70 km/h dhe mbi 26% per 120 km/h. Kjo do te jepte nje interval per rrezen maksimale te kurbatures ne rrugen hyrese te perfshire midis 60 m (konteksti urban) dhe 100 m (rural). Vlera e kurbatures ne rrugen hyrese per frekuencen minimale te aksidenteve eshte afersisht  $0,015 \text{ m}^{-1}$  per hyrje paralele dhe rritet deri ne  $0.05 \text{ m}^{-1}$  per hyrje shume te gjera. Keto vlera korrespondojnë respektivisht nje rreze kurbature te barabarte me 65 m dhe 20 m. Nje propozim per te rritur rreptesine e normes se devijimit ne hyrje duke ripercaktuar rrugen ne hyrje u propozua ne 1990 dhe u inkorporua tek DOT Design Manual for Roads and Bridges nel 1993.

Gjeresia e hyrjes (e): eshte shume sinjifikative qofte ne lidhje me aksidentet hyrese/qarkulluese qofte me ate “ne perqasje”. Hyrjeve shume te gjera i korrespondojnë frekuencia te larta aksidentesh, ndersa ne rastin e aksidenteve “ne perqasje” ndodh e kunderta. (Fakti per te konsideruar “mprethesine e gjeresise” ( $s = (e - v)/l$ ) nuk permiresoi parashikimin).

Kendi  $\Theta$  midis nje krahut dhe atij pasardhes (ne kahun orar): eshte nje variabel me e vogel, por mjaft influente. Me rritjen e saj, konfliktet e shumta hyrese/qarkulluese behen me te paket se ata ne lidhje me nje kalim dhe me te shumte se ata korrespondues se nje

manovre hyrese. Aksidentet minimizohen kur deget me fluksin me te madh kane Θ me te madh (kjo nuk eshte gjithmone e praktikueshme ose e deshirueshme).

Pjerresia (g): eshte shume pak e rendesishme tek aksidentet “ne perqasje” dhe tek ata “hyres/qarkullues”, prandaj nuk eshte perfshire tek ekuacioni i parashikimit.

Distanca e shikueshmerise djathtas (V): (i nje objekti te larte mbi 1.05 m) jep rezultate te mira, ne perputhje me uljen e ndjeshmerise me rritjen e distances se shikueshmerise (nga 15 ne 25 m mbrapa). Kjo eshte domethenese qofte per aksidentet “ne perqasje” qofte per ata “mjet i vecante”, por aksidentet rriten me rritjen e distances se shikueshmerise. Nuk eshte gjetur nje korrelacion domethenes me aksidentet “hyres/qarkullues”.

Diametri i rrerhit te brendashkruar (Inscribed Circle Diameter, ICD) dhe Diametrit te ishullit qendror (Central Island Diameter, CID): jane dy variabla qe te vetme jane relativisht joefikase, por raporti ICD/CID (ose R) jep nje zevendesues se efektshem te faktorit Te vogel/Konvencional te kategorise se rrrethrotullimeve.

Faktori Raport (RF): eshte nje variabel gjeometrike e perkufizuar si:

$$RF = \frac{1}{1 + e^{(4R-7)}} \quad [6.17]$$

ku R eshte rapporti ICD/CID (konstantet 4 dhe 7 jane percaktuar per te minimizuar shmangien e modelit me “pershtatjen me te mire”).

Kjo variabel ka nje ndryshim me 2,5 dhe eshte shume domethenese ne perfaqesimin e dallimit te kategorive Te vogela/Konvencionale.

Gjeresia e perqasjes ( $v$ ) dhe kurbatura e perqasjes ( $C_a$ ): te dyja influencoje vetem aksidentet “mjet i vecante”. Permaza e termit ( $v$ ) mund te marre vlera te ndryshme, duke dhene nje seri shumezuese me 6, ne sensin qe, frekuencat e aksidenteve jane te larta per rruge te gjera dhe ka nje marredhenie te forte me fluksin hyres. Kurbatura gjeometrike e perqasjes ( $C_a$ ) eshte shume domethenese ne parashikimin e aksidenteve “individuale”.

Dallimi i bere ne baze te limiteve te shpejtesise ne perqasje nuk ka efekt cfaredo per cdo lloj aksidenti. Variablat e perqasjes mund te shikohen sakteisht si variabla te projektit te rrrethrotullimit, keshtu e para varet nga lloji i rruges (nje ose dy kalime) dhe e fundit nga rreshtimi i lidhjeve.

Perqindja e “dy rrrotakeve” – E perfshire si nje perqindje per variabla gjeometrike. Aksidentet e dyrrotakeve perfaqesojnë gati 50% te aksidenteve ne rrrethrotullime. Vetem perqindja e motociklisteve ishte sinifikative ne aksidentet “hyrese/qarkulluese” dhe ne ate “mjete te vecante”. Motociklistet perfshihen ne 30-

40% te aksidenteve dhe ciklistet ne 13-16%. Duhet specifikuar qe, shume aksidente te ciklisteve nuk raportohen, edhe pse kerkimet e kryera ne arkivat e spitaleve kane treguar qe, disa prej tyre nuk jane banale, por mund te klasifikohen si aksidente te renda, duke ndryshuar rezultatet e analizes.

Kembesore – Aksidentet qe perfshijne kembesoret perfaqesojne 4-6% te aksidenteve te kampionit te marre ne studim. Keta lidheshin vetem me flukset e mjeteve dhe kembesoreve. Nuk u gjeten variabla gjeometrike qe te lidheshin me kembesoret. Pervec variablave te siper cituara, u morren ne konsiderate edhe te me poshtmet:

Chevron (sinjale zig-zag) – U verejten efekte pozitive ne aksidentet hyrese/qarkulluese nga sistemimi i chevron shtese.

*Shikueshmeria perreth ishullit qendror (perafersisht shikueshmeria e perqasjes)– domethenese vetem per aksidentet me kembesore ne kategorine 30-40 mp/h.*

*Numri i sinjaleve ne perqasje (numri total ne te dyja anet, duke perfshire sinjalet e rrezikut dhe te drejtimit, por jo shenimet e rruges (sic mund te jete vija e verdhe))* – Keto variabla nuk ishin domethenese per te gjithe llojet e aksidenteve.

#### *6.1.7 Karakteristika qe ndikojne ne siguri tek standartet e tanishme*

Ne Britanine e Madhe ne 1990 u verifikan rrith 258000 aksidente me te plagosur (PIA). Gati 5.5% e tyre u verifikan ne rrethrrrotullime. Perqindja e vdekshmerise se PIA-s ne rrethrrrotullime ishte 0.43%, ndersa tek kryqezimet e tjera ishte 1.3% dhe 2.8%. Kjo tregon se ne rrethrrrotullime kishte një zvogelim te aksidenteve te renda krahasuar me kryqezimet e tjera. Kosto mesatare e aksidenteve ne rrethrrrotullim eshte rrith 50% me e vogel krahasur me llojet e tjera te kryqezimeve. Ne Figuren 6.2 jepet një grafik qe tregon marredhenien midis aksidenteve te renda dhe llojit te kryqezimit ne rruget me karrekhata te ndara. Pavaresisht se ky grafik tregon perparesine e rrethrrrotullimeve, masa te rendesishme mund te merren ne konfigurimin e tyre per te siguruar aspektet thelbesore te sigurise.

Problemi me i zakonshem qe influencon sigurine eshte shpejtesia e tepert ne hyrjen dhe ne brendesi te rrethrrrotullimit.

Faktoret me domethenes qe kontribuojnë tek shpejtesite e larta ne hyrjen dhe ne karrehaten qarkulluese janë:

- devijim i papershtatshem i hyrjes;
- shikueshmeri e paket e vijes se perparesise;
- projektim ose vendosje e dobet te sinjaleve te rrezikut dhe te drejtimit;
- sinjali “Ul shpejtesine” i pozicionuar gabim;
- me shume se kater dege qe sjellin një konfigurim me te gjere.

Adoptimi i kendeve te ulet te hyrjes i detyron automobilistet te futen ne fluks ne pozicione te veshtira te tilla, qe ti detyrojne te shikojne mbi kurrizin e tyre ne te majte, per te verejtur mjetet ne ardhje ne unaze, ose te tentojne manovren e hyrjes, duke perdorur vetem pasqyrat e mjetit te tyre (me problemet ne lidhje me neglizhencen e vijes se perparesise dhe te gjenerojne shpejtesi te larta hyrjeje).

Nga ana tjeter kendet e larta te hyrjes prodhojne nje devijim te tepert dhe mund te cojne ne pershkime “me prerje rrule” ne hyrje e shoqeruar me aksidente . U verejt se kendi me i mire per hyrje eshte rrreth 30°.

Tek rreshtimi i korsive te hyrjes eshte lidhur kendi i hyrjes. Per te maksimalizuar kapacitetin eshte normale te perkulesh bordin e ishullit te devijimit, ne menyre qe projektimi i tij te jete tangent me kurben e bordit te ishullit qendror, por kjo favorizon hyrje te shpejta ne kurriz te sigurise.

Aspekte te tjera per tu marre ne konsiderate mbi sigurine ne nje projektim te konfigurimit, perfshijne:

- *Pjerresia* – Normalisht duhet zvogeluar pjerresia e perqasjes ne rrreth 2%, ose edhe me pak; gjithsesi disa kerkime qe kane zhvilluar disa vende kane treguar qe kjo ka vetem nje efekt te vogel pozitiv ne potencialin e aksidentit.
- *Shikueshmeria djathtas (majtas ne Itali/Shqiperi) ne hyrje* – Kjo ka relativisht nje influence te vogel ne rrezikun e aksidentit.

Faktore te tjere qe konsiderohen ndikues ne sigurine e rrrethrotullimeve, por qe nuk perdoren normalisht si variabla gjeometrike, jane:

- ulja e kryqezimit dhe drenazhimi;
- ndricimi;
- perdorimi i sinjalistikes horizontale dhe vertikale;
- mbajtja e nje rezistence ndaj rreshqitjes ne rrrethrotullim dhe ne perqasjet;
- karakteristikat e siperfaqes se ishullit qendror;
- jeshilja urbane, dmth bimet dhe sistemimi urbanistik.

Eshte verifikuar se nje sinjal i vetem me dimensione te pershtatshme dhe i vendosur saktesisht, eshte me i rendesishem krahasuar me sasine. Shume sinjale destinacioni te vendosur shume afer, ose brenda rrrethrotullimit, ku automobilistet nuk kane kohen te asimilojne dhe te perpunojne informacionet, jane perjegjes per shperqendrimin e automobilistave.

#### *6.1.8 Permiresimi i sigurise ne rrrethrotullimet ekzistente*

Udhezimet e projektimit te 1993 (TD.16/93) rendisin disa masa qe u kerkuan per tu perdorur ne rrrethrotullimet ekzistuese qe kane mangesi ne siguri, ne menyre per ta rikthyer ne standarte te pranueshme. Keto masa perfshijne:

- a) pozicionimin ose perfocimin e sinjaleve te rrezikut, pajisja me sinjale drejtimi te tipit harte, duke theksuar linjat e perparesise me te shpeshta, duke sposhtuar chevron-et e ishullit qendror me djathtas per te theksuar kedin e kthimit,

duke vendosur sinjale te tjere chevron ne pozicionin normal dhe te tjere ne trafik-ndaresin te rrugeve me dy karrekhata ne vijedrejte me korsine e perqasjes se jashtme;

- b) pajisja me “vija te verdha” ne perqasjet e shpejta me karrekhata te ndara; TRRL Report LR 1010 tregon qe nje zvogelin me mbi 5% te aksidenteve mund te arrihet me “vija te verdha”;
- c) adoptimi i niveleve te pershtatshme te rezistences ndaj rreshqitjes ne perqasjet dhe ne karrekhatat qarkulluese;
- d) shmangia e mbingritjeve te papritura dhe te teperta ne zonen e hyrjes;
- e) reduktimi i gjeresive te teperta ne hyrje nepermjet vijave te nderprera ose elementeve fizike;
- f) vendosja e nje sinjali “Ngadalesoni” dhe/ose shenja te “Numerimi mbrapsh” (vija me trashesi zbriteze);

Ne hyrje problemet jane shkaktuar nga shikueshmeria e keqe ne te djathte, rezultate te mira arrihen, duke spostuar perpara vijen e perparese se bashku me reduktimin e karrekhates qarkulluese ngjitur me rrugen, ose zgjatjen e ishullit te devijimit.

*Pembledhje mbi sigurine ne projektimin e rrrethrotullimeve.* Raporti i 1990 mbi udhezimet e projektimit te 1984 (DTp) zbulon nevojen per te rritur rendesine e sigurise ne konfliktet midis kapacitetit dhe sigurise ne DOT Guidelines Standard and Advice Note pij Roundabout Design te 1993.

Normat e aksidenteve dhe shkalles se rendesise se tyre ne rrrethrotullimet e projektuara sakteisht jane per gjithsisht me te uleta sesa ato te te gjithe llojeve te tjera te kryqezimeve te rrafsheta me flukse te ngashme trafiku. Manuali i DTp jep nje krahasim midis normave te aksidenteve te tipeve te ndryshme te kryqezimeve; tabela e mpsh jep disa nga keto te dhena.

*Krahasim midis frekuencave te aksidenteve per norma te fluksit kryq*

Lloji i kryqezimit	C=10 K	C=50 K	C=100 K
Kryqezim rural ne forme T	0.06	1.2	1.6
Semaforik urban	2.2	3	3.5
Rrrethrotullim	0.2	0.8	1.4

*Tabela 6.2 - Frekuanca vjetore e aksidenteve ne grade C te fluksit te pershkimit*

Rezultatet e studimeve te ndryshme te kryera midis 1984 dhe 1986, te perqendruar ne prodhimin e modeleve te parashikimit te frekuencies se aksidenteve per kryqezimet, u publikuan nga Hall e McDonald ne 1988. Analizat fillestare te tyre mbi aksidentet tregohen ne tabelen 6.3.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Kategoria e kryqezimit	Limiti i shpejtesise	Numri i hyrjeve	Frekuencia e aksidenteve (aks/vit)	Rendesia e aksidenteve ne % te vdekjeve te renda	Fluksi mesatar ne 24 ore	Numri i aksidenteve per 100 milion automjete
Rrrethrotullime	48-64	497	4.38	18	33.7	37.1
Te vogla	80-112	150	2.83	14	27.8	28.7
Te medha (konvencionale)	48-64	146	2.36	27	298	21.2
(80-112)	244	193	3.1	16	29.7	21.2
Dopio	48-64	244	3.37	13	42.6	22.5
Karrekhate	80-112	197	2.88	11.3	6.8	22.4
Semafore	48	1772	2.65	20	21.2	34.4
Kryqezim ne forme T me perparesi	80-96	674	0.48	36	7.8	17.1

*Tabela 6.3 - Numri i frekuences, rendesia dhe norma e aksidenteve*

Hall e McDonald verenin se norma e aksidenteve per kryqezimet rurale ne forme T-je ishte me e ulet se per rrrethrotullimet me kater dege dhe kryqezimet e semaforizuara, por krahasimi i frekuences se aksidenteve ishte me vlera te kufizuara, nqs ekspozimi i rrezikut ne terma te fluksit te trafikut nuk merrej ne konsiderate.

Me perjashtim te aksidenteve hyrese/qarkulluese ne rrrethrotullim, u gjet se fluksi i trafikut ishte nje variabel e rendesishme ne modelin e parashikimit te frekuences s e aksidenteve. Nje krahasim i dobishem mund te behet ne baze te rendesise se aksidenteve. Perqindja e aksidenteve te renda ne rrrethrotullimet e studiuara ishte rrreth 16%. Aksidentet ne kryqezimet urbane te semaforizuara kishin nje nivel rendesie pak me superior, gati 20%, ndersa kryqezimet rurale ne forme T-je kishin nivelin me te larte te barabarte me 36%.

Sistemimet per sigurine mund te realizohen duke perdorur programet per projektimin e rrrethrotullimit. Nje model parashikimi per aksidentet, qe llogarit frekuencen e aksidenteve dhe treguesit, eshte e vendosur ne paketen software ARCADY/3. Perdorimi i modeleve mund te ndihmoje ne zgjedhjen e kryqezimit dhe siguron qe projekti final minimizon potencialin e aksidenteve dhe mund te ndihmoje per te arritur nje ekuilibër midis nevoja te kunderta, per te patur vonesa minimale dhe standarte te mira sigurie (qe do te thote edhe kosto te ulet si pasoje e aksidenteve).

CETUR ka publikuar rezultatet e disa kerkimeve te kryera ne 1988 mbi aksidentet ne rrrethrotullime. Te dhenat e shqyrtuara i perkasin tre kampioneve te ndryshme te rrrethrotullimeve urbane dhe te periferise:

KAMPIONI I: i perbere nga 458 rrrethrotullime per te cilat jane shqyrtuar aksidentet me te plagosur te 1988;

KAMPIONI II: mbledh te dhenat e 202 aksidenteve me te plagosur te ndodhur midis 1984 dhe 1988 ne 179 rrrethrrrotullime te Frances perendimore;

KAMPIONI III: perfshin 179 rrrethrrrotullime te 15 qyteteve ne perendim te Frances dhe perdoret per te bere nje krahasim te sigurise midis kryqezimeve te semaforizuara dhe rrrethrrrotullimeve.

### **6.1.9 Analiza e kampionit 1**

Rezultatet e kampionit te pare jane grupuar ne baze te:

- viti i venies ne sherbim;
- rrezja dhe numri i aksidenteve;
- trafiku dhe numri i aksidenteve.

Te dhenat e ketij modeli evidentojne se si rrrethrrrotullimet kane karakteristika te mira sigurie. Rezultatet e kerkimit tregojne:

- 0,15 aksidente ne vit dhe per kryqezim;
- 4,45 aksidente cdo  $10^8$  mjete;
- 1,57 aksidente me te plagosur rende cdo  $10^8$  mjete;
- 0,19 aksidente vdekjeprures cdo  $10^8$  mjete.

Keto shifra konfirmojne rezultatet e marra nga SETRA ne 1983, te cilet i referoheshin 19 kryqezimeve te kthyer ne rrrethrrrotullime dhe tregonin nje ulje prej 78% te numrit te aksidenteve me te plagosur dhe prej 95% te numrit te aksidenteve vdekjeprures.

Do te analizojme tanë te dhenat e kampionit te pare na baze te vitit se venies ne sherbim, numrin e aksidenteve ne funksion te rrezes dhe te trafikut.

*Viti i venies ne sherbim.* Tabela 6.4 grupon te dhenat mbi aksidentet e ndodhura ne 1988 ne funksion te vitit se venies ne sherbim te rrrethrrrotullimeve.

<b>Viti i venies ne sherbim</b>	<b>&lt;1980</b>	<b>1981</b>	<b>1982</b>	<b>1983</b>	<b>1984</b>	<b>1985</b>	<b>1986</b>	<b>1987</b>	<b>Totali</b>
<b>Nr.rrrethrotullimesh</b>	110	18	26	29	54	54	70	97	458
<b>Nr.aksidentesh ne 1988</b>	29	4	2	4	9	3	4	16	71
<b>Nr.aksidentesh (100 rrrethrrrotullime)</b>	26.4	22.2	7.6	13.8	16.6	5.6	5.7	16.5	15.5
<b>Trafiku mesatar (automjete ne dite)</b>	10600	9500	11900	8100	8000	8700	9800	9300	

*Tabela 6.4- Numri i aksidenteve te verifikuar ne 1988 te ndare ne baze te vitit se venies ne sherbim te rrrethrrrotullimeve*

Nga analiza e rezultateve mund te verehet nje tendence e per gjithshme e zvogelimit te rrezikut ne funksion te vitit se venies ne sherbim. Kjo tregon si eksperiencia e fituar ne fushen e projektimit mundeson permiresimin e kushteve te sigurise. Gjithsesi verehet nje mesatare shume e larte e aksidenteve per rrrethrrrotullimet e vena ne

sherbim ne 1987: kjo tregon qe risia ne nje sistemim perben nje faktor rreziku ne muajt qe ndjekin venien ne sherbim.

*Rrezja dhe numri i aksidenteve.* Histogrami i Figures 6.3 tregon perqindjen e aksidenteve ne funksion te rrezes se rrrethrotullimit.

Rrrethrotullimet me forma te ndryshme nga ajo rrethore (ovale ose drejtordeshe) jane te perfshira ne fushen “Ovale”.

Perfundimet qe mund te merren nga analiza e ketij Histogrami jane:

- rrrethrotullimet qe nuk kane rrethore kane nje frekuence aksidentesh me te madhe se ato me konfigurim rrethor;
- frekuencia e aksidenteve duket se rritet me rrezen, duke patur parasysh edhe nivelet e trafikut. Ndaj duhet shmangur rritja e papershtatshme ne rrezen e nje rrrethrotullimi, vec se nuk kerkohet nga disponueshmeria ose gjeresia e rrugeve.




Figura 6.3 - Numri i aksidenteve ne funksion te rrezes se brendshme te rrrethrotullimeve.

Trafiku dhe numri i aksidenteve. Histogrami i Figures 6.4 tregon marredhenien midis perqindjes se aksidenteve dhe fluksit te plote hyres ne nje rrrethrotullim. Nga analiza e grafikut deduktohet qe ekziston nje koreacion midis nivelit te trafikut dhe numrit te aksidenteve, ne kuptim qe me rritjen e trafikut rritet perqindja e aksidenteve. Ky koreacion nuk duket te kete nje tendence lineare.




Figura 6.4 - Numri i aksidenteve ne funksion te fluksit te trafikut

#### 6.1.10 Analiza e modelit 2

*Tipologjia e aksidenteve.* Rezultatet e modelit te dyte lejojne kryerjen e nje studimi mbi tipologjinë e aksidenteve ne lidhje me karakteristikat e rrrethrotullimeve dhe tipit te aksidentit.

*Perdorues te perfshire ne aksidente.* Tabela 6.5 tregon nje ndarje te aksidenteve ne funksion te llojit te perdoruesve te perfshire. Rezultatet e referuara kampionit te dyte (kollona majtas) krahasohen me ata te nje statistike te SETRA-s ne 1990, mbi nje kerkim analog i kryer mbi kryqezimet e aglomerateve urban me shume se 20.000 banore.


Perqindja e perfshirjes ne aksidente me te demtuar ne rrrethrotullimet urbane		Perqindja e perfshirjes ne aksidente me te demtuar ne kryqezimet e qendrave urbane me shume se 20000 banore.
Kembesore	5.6%	6.1%
Bicikleta	7.3%	2.5%
Motocikleta	16.95	10.4%
Moto	4.8%	8.0%
Automjete	61.2%	68.4%
Te tjera	4.2%	4.6%
<i>Totali</i>	100 %	100 %

Tabela 6.5 – Perdoruesit e perfshire ne aksidente

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

*Tipologjia.* Te 202 aksidentet e anketuar ne modelin 2 u kataloguan ne 16 tipe qe perfaqesojne gati te gjitha rastet e mundshme ne qendrat urbane (Tabela 6.6 dhe Figura 6.5 te faqes pasardhese).



*Figura 6.5 – Skematizimi i aksidenteve*

Nr.	Lloji i aksidentit	Nr. i aksidenteve te zbuluar
1	Refuzim per te dhene priorititet hyres	74
2	Humbje e kontrollit ne hyrje	23
3	Humbje e kontrollit ne unaze	33
4	Humbje e kontrollit ne dalje	5
5	Perplasje ballore ne hyrje	5
6	Goditje ne hyrje	15
7	Goditje ne unaze	1
8	Goditje ne dalje	2
9	Prerje ne dalje	12
10	Parakalim i gabuar ne hyrje	2
11	Hyrje e gabuar ne unaze	5
12	Parakalim i gabuar ne dalje	2
13	Trafik ne dalje	2
14	Kembesore ne vijat e bardha	12
15	Kembesore ne unaze	7
16	Kembesore jashte vijave te bardha	2

*Tabela 6.6 – Katalogimi i tipeve te aksidenteve*

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

---

Mund te konstatohet se tre tipet e aksidenteve me te shpeshta ne rrrethrrrotullimet urbane jane:

- perparesite e munguara ne hyrje,
- humbja e kontrollit ne hyrje,
- humbja e kontrollit ne unaze.

Per te kryer nje analize me te thelle duhet bere nje krahasim midis tipit te aksidenteve dhe kategorive te perdoruesve.

Ndarja sipas kategorive te perdoruesve dhe tipit te aksidentit. Ne tabelen 6.7 aksidentet e kampionit te dyte jane ndare sipas tipit te aksidentit dhe kategorive te perdoruesve. Te dhenat e sjella ne kete tabele jane vlerat absolute te aksidenteve, jo perqindjet.

Mund te verehet se mjetet e lehta (automjetet) jane perfshire gati ne te gjithe tipet e aksidenteve, me nje dominim te ndjeshem te mungeses se dhenies se perparese ne hyrje.

Nr	Lloje aksidentesh	Kembesore	Bicikleta	Motocikleta	Moto	Auto	Mjete te renda
1	Refuzim per te dhene priorititetit hyres		18	31	5	66	4
2	Humbje e kontrollit ne hyrje				4	18	1
3	Humbje e kontrollit ne unaze			17	5	10	1
4	Humbje e kontrollit ne dalje				1	4	
5	Perplasje ballore ne hyrje					5	1
6	Goditje ne hyrje			1		15	1
7	Goditje ne unaze					1	
8	Goditje ne dalje				1	2	
9	Prerje ne dalje		3	5	1	12	
10	Parakalim i gabuar ne hyrje		1	1		2	
11	Hyrje e gabuar ne unaze			3		5	
12	Parakalim i gabuar ne dalje		2				2
13	Trafik ne dalje			1		1	1
14	Kembesore ne vijat e bardha	11	1	1		11	
15	Kembesore ne unaze	7				7	
16	Kembesore jashte vijave te bardha	2				2	

*Tabela 6.7 – Rradhitja e tipeve te ndryshme te aksidenteve*

*Perfundime.* Nga rezultatet e analizes se modelit 2 tregohet si numri i aksidenteve lidhet me volumin e trafikut ne rrrethrrrotullime. Mund te konfirmohet se, me nje mesatare prej 0,15 aksidente ne vit per rrrethrrrotullim, rrrethrrrotullimet kane karakteristika te mira sigurie.

Analiza e aksidenteve sugjeron disa zgjidhje qe mund te permiresojne edhe me shume sigurine ne rrrethrrrotullime:

- ato me te vjetra duhen modifikuar ne baze te eksperiences se fituar kohet e fundit;
- te shmanget ndertimi i rrrethrrrotullimeve me permase te teperta dhe me forma te ndryshme nga ajo rrethore;
- te llogariten mire flukset e trafikut qe rrrethrrrotullimi do te duhet te suportoje, ne menyre qe te mos dimensionohen me pak hyrjet, gjereria e unazes dhe ajo e daljeve;
- te shmanget sistemimi i pengesave qe pengojne shikueshmerine e ishullit qendror.

Ne fund verejme sa eshte e rendesishme ne rrrethrrrotullime siguria e dyrotakeve dhe e kembesoreve, pasi keta perdonues duken me te ceneshem ne rrrethrrrotullime. Arsyja kryesore e modelit 3 qe do shikojme ne vazhdim, eshte pikerisht siguria e kembesoreve dhe ciklisteve.

#### *6.1.11 Analiza e modelit 3*

Te dhenat e kampionit te trete jane perdonur per te bere nje krahasim midis aksidenteve me te plagosur ne rrrethrrrotullime dhe atyre ne kryqezimet e semaforizuara urbane. Jane marre ne konsiderate 1238 kryqezime dhe 179 rrrethrrrotullime, te gjithe te ndodhur ne 15 qytete. edhe pse rrrethrrrotullimet dhe kryqezimet e krahasuar kane permaza mjaft te ndryshme midis tyre, mund te hipotizohet se kryqezimet e semaforizuara dhe rrrethrrrotullimet kane nivele qarkullimi ekuivalente, perderisa rrrethrrrotullimet me te vjeter nuk jane gje tjeter, vecse kryqezime te semaforizuara te transformuara.

Te dhenat e marra, qofte ne rrrethrrrotullime qofte ne kryqezimet e semaforizuara, i referohen aksidenteve me te plagosur qe kane ndodhur ne vitin 1998. Ne tabelen perkatese numri i aksidenteve ne kryqezimet e semaforizuara dhe rrrethrrrotullimet jane marre rezultatet e kerkimit. Nga analiza e kesaj tabele duket qarte se si numri i aksidenteve me te plagosur eshte ndjeshem me i ulet, gati sa gjysma, ne rrrethrrrotullime krahasuar me kryqezimet e semaforizuara.

Persa i perket aksidenteve qe perfshijne mjetet e lehta me dy rrota, verehet gjithmone se rrrethrrrotullimet rezultojne me te sigurta krahasuar me kryqezimet e semaforizuar, por ulja relative e raportit aksidente/kryqezim eshte me i vogel (-40%) se ai i pergjithshem (49%). Edhe aksidentet e renda per kembesoret jane me pak te shpeshta ne rrrethrrrotullime, por edhe ne kete rast diferenca (-28%) me ata ne kryqezimet e semaforizuara nuk eshte shnuar si ajo qe i perket totalit te aksidenteve.

*Siguria e kembesoreve ne rrrethrrrotullime.* Rezultatet e tre kerkimeve mbi aksidentet, ne vecanti ata te modelit 3, kane evidentuar nje siguri me te madhe ne rrrethrrrotullime krahasuar me lloje te tjera kryqezimesh. Gjithsesi nga analiza mund te verehet

gjithashtu se si ne rrrethrotullim problemet kryesore i perkasin sigurise se kembesoreve dhe mjeteve me dy rrota.

*Tipologja e aksidenteve.* Rezultatet e modelit 2 (Tabela e katalogimit e tipit te aksidentit) tregojne se aksidentet ku jane te perfshire kembesoret jane 21 dhe perfaqesojne 10,4% te aksidenteve totale. Me qellim krahasimi, nje kerkim i SETRA-s ne 1989 ka percaktuar se aksidentet qe lidhen me kembesoret perfaqesojne 10,9% te aksidenteve qe ndodhin ne zonen urbane. Edhe pse keto te dhena nuk tregojne qe rrrethrotullimet jane vecanerisht te rrezikshme per kembesoret, perderisa norma e aksidenteve te tyre nuk peson uljen e konsiderueshme qe peson ajo e automjeteve. Ne fakt te dhenat e aksidenteve te treguar ne Tabellen 6,8 jane me te vogla ne rrrethrotullime vetem sepse krahasimi eshte bere mbi te dhena trafiku shume te perziera.

Te 21 aksidentet e percaktuara ne modelin 2 ndahen keshtu ne:

- 8 ne kalimet pedonale qe pershkijn ne hyrje te rrrethrotullimit;
- 7 kane ndodhur ne hyrje me 2 korsi;
- 7 ne unaze: kembesore te dehur, persona te moshuar qe donin te shikonin sistemimin e sheshit dhe kembesore qe nuk kane perdorur vendkalimet e kembesoreve te kanalizuar pasi jane shume te gjate;
- 7 jane verifikuar ne vendkalimet e kembesoreve te ngjitur me vijen e perparese;
- 6 kane ndodhur ne rrrethrotullime qe mbajne mese 20.000 mjete/ore;
- 5 te pakten kane perfshire njerez te moshuar ose femije;
- 4 kane ndodhur ne oren e pikut;
- 2 ne vend-kalimet e kembesoreve ne dalje te rrrethrotullimit;
- 2 si pasoj e kalimit ne drejtim te rrymes ne rrrethrotullim;
- 1 ka ndoshur ne nje kalim kembesoresh pa mbrojtje.

Mund te verehet si kombinimi:

Trafik i larte + hyrje me dy korsi

eshte shume i papershtatshem nga pikepamja e sigurise se kembesoreve.

	<i>Kryqezime me semafor</i>	<i>Rrethrotulime</i>
Madhesia e kampionit	1238	179
Nr.total i aksidenteve	794	59
“ “ “ me dy rrota te perfshira	278	28
“ “ “ me kembesore te perfshire	105	11
Aksidente te renda me njerez	40	3
Raporti aksident / kryqezim	0.641	0.329
“ aksident me dy rrota / kryqezim	0.225	0.134
“ aksident me kembesor / kryqezim	0.085	0.061
“ aksident I rende me kembesor / aksident me kembesor	0.381	0.273

*Tabela 6.8 – Numri i aksidenteve me perdorues te dobet*

*Konsiderata:* Ne perfundim mund te themi se rrrethrrrotullimet me siguri nuk jane nje sistemim ideal nga pikepamja e komoditetit per kembesoret: per shkak te formes se tyre, ne per gjithesi ato zgjasin rrugen dhe nevojitet nje vemendje e vecante ne momentin kur kembesori pershkoni deget e tyre.

Gjithsesi nuk duket se ky lloj kryqezimi sjell probleme te vecanta per sigurine e kembesoreve, sidomos kur ndiqen rregullat e mpsh:

- hyrjet dhe daljet kane nje korsi te vetme;
- parashikimi i ishujve ndares (strehim/mbrojtje per kembesoret);
- pozicionimi optimal i vend-kalimeve te kembesoreve.

Persa i perkthet probleme te rrrethrrrotullimeve me hyrje dhe/ose dalje me dy korsi, problemi qendron ne keto terma:

- ne nje rrrethrrrotullim urban, kur llogaritjet e kapacitetit tregonje nje rrezik ngopje ne oret e pikut ne hyrje me nje korsi, duhet zgjedhur dhe mund te pranohen periudha te shkurtra (te rendit 15 minuta) me rrezik formimi rradhe trafiku dhe nga ana tjeter te garantohet nje siguri e mire per kembesoret, ose te realizohen hyrje me dy korsi duke anashkaluar sigurine e kembesoreve.
- nqs dy apo me shume korsite jane absolutisht te nevojshme per kapacitetin e nje hyrje e perskuar nga nje fluks kembesoresh i konsiderueshem, do te duhet te studiohen variante te tjera kryqezimi pervec rrrethrrrotullimit.

#### *6.1.12 Siguria e ciklisteve dhe te ciklomotoreve ne rrrethrrrotullimet urbane*

Analiza e modelit 2 tregoi se perqindja e mjeteteve te lehta me dy rrota (ciklomotore dhe bicikleta) te perfshire ne aksidente ne rrrethrrrotullime eshte relativisht e larte: mjetet e lehta me dy rrota jane perfshire ne 85 nga 202 aksidente te barabarte me nje perqindje prej 42,1%. Gjithashtu ciklistet dhe drejtuesit e ciklomotoreve perfaqesojne 36% te te vdekurve ose plagosurve. Me qellim krahasimi, statistikat nacionale franceze (SETRA 1989) qe perfshijne teresine e aksidenteve te ndodhura ne kryqezimet urbane theksojne se:

- 26,9% e aksidenteve te ndodhura ne kryqezimet urbane perfshijne nje mjet me dy rrota te lehte,
- perdoruesit e dy rrotakeve te lehte perfaqesojne 22,2% te te vdekurve dhe te plagosurve ne kryqezime.

Nga keto shifra nuk duhet nxjerr perfundimi se qe rrrethrrrotullimet jane me te rrezikshme se llojet e tjera te kryqezimeve, pasi globalisht mesatarja a aksidenteve ne vit per rrrethrrrotullim eshte shume e ulet (gati 0,15 aksidente/vit/rrrethrrrotullim).

*Tipologjia e aksidenteve qe perfshijne mjetet me dy rrota te lehte.* 85 aksidentet e modelit 2 qe perfshijne dy rrotaket jane grupuar ne tabelen 6.9 ne baze te llojit te aksidentit. Mjetet me dy rrota te lehte jane ndare ne bicikleta dhe ciklomotore.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrrotullimeve”**

---

	Lloji i aksidentit	Bicikleta	Motocikleta	%
1	Mos funksionim ne dy rrota	16	27	50.
2	Mos funksionim i dy rrotave	2	4	7.0
3	Automjete kurder bordeve hyrese	1	1	2.4
4	Automjete kurder bordeve dalese	2		2.4
5	Nderprerje e trajektores se automjeteve ne dalje	3	3	7.0
6	Nderprerje e trajektores se dy rrotave ne dalje		2	2.4
7	Goditje ne unaze		3	3.5

*Tabela 6.9 – Numri i aksidenteve me perdorues te dobet, Modeli 2*

Rekomandimet e pergjithshme persa i perket sigurise se mjeteve me dy rrota jane te mpsh:

- persa te jete e mundur, dmth nqs nuk jane vertet te nevojshme per kapacitetin dhe rrjedhshmerine, do te duhet te shmangen rrrethrrrotullimet me hyrje dhe dalje me dy korsi dhe te unazave me tre korsi;
- per nje rrrethrrrotullim te vogel, duhet te shqetesohesh derisa asnje trajktore te mos lejoje nje pershkrim shume te shpejte, duke realizuar nje reduktim te unazes me nje bordure pak te ngritur, e pershkueshme normalisht vetem nga mjetet e renda. Do te duhet te shmangen hyrjet shume te ngushta dhe rrezet e daljeve shume te vogla;
- ndertimi i nje piste te pershkueshme mund te konsiderohet:
  - ne rrrethrrrotullimet e mesme dhe te medha (rrezja e jashtme  $> 20m$ );
  - nqs e kerkon trafiku i mjeteve te lehta me dy rrota, ne vecanti kur ka nje prezence te konsiderueshme ciklistash;
  - ne vazhdim te pistave me nje drejtim nga njera ane ne tjetren te kryqezimit;
  - ne mungese te hyrjeve dhe daljeve me 2 a me shume korsi.
- Pershkimi i karrekhatave duhet bere ne 2 kohe, per te cilin nevojiten disa ishuj ndares relativisht te gjere.
- nje piste te pershkueshme mund te realizohet:
  - ne rrrethrrrotullimet me permasa te reduktuara (me rreze te jashtme nga 15 ne 25 m);
  - per nivele trafiku mesatar ose te larte te dy rrotakeve, me nje perqindje te konsiderueshme bicikletash;
  - ne vazhdimesi te pistave te pershkueshme ne perqasje.
- Pista e pershkueshme duhet te materializohet fortesisht ne unaze. Hyrjet dhe daljet do te jene, persa te jete e mundur, te ndara nga qarkullimi i pergjithshem.
- nje piste e pershkueshme me sens te dyfishte me trafik te larte dy rrotakesh, qe shperndahet ne drejtime te ndryshme ne rrrethrrrotullim, mund te trajtohet

si nje dege e vecante e rrrethrrotullimit, qe lejon te sjellesh trafikun e lehte ne qarkullimin e pergjithshem ne unaze.

Pame se cilet jane problemet kryesore ne lidhje me sigurine ne rrrethrrotullime dhe masat me te pershtatshme qe duhen shmangur per te ulur rrezikun e aksidenteve, me nje vemendje te vecante ndaj kembesoreve, ciklisteve dhe drejtuesve te ciklomotoreve. Mund te perfundojme se, per te patur karakteristika te mira sigurie, ne projektimin dhe ndertimin e nje rrrethrrotullimi duhen respektuar indikacionet e mpsh:

- te evitohet ndertimi i rrrethrrotullimeve te gjera dhe me korsi te shumefishta, nqs kjo nuk eshte rigorozisht e kerkuar nga kushtet e trafikut;
- te tregohet qartesisht, me sinjalistike horizontale dhe vertikale, mjeteve ne ardhje prezenca e rrrethrrotullimit dhe detyrimi i dhenies se perparese;
- ti kushtohet vemendje e vecante kembesoreve, duke sistemuar vend-kalimet e kembesoreve ne nje distance te pershtatshme nga kryqezimi ( $\approx 4m$ ) dhe duke realizuar ishuj ndares me mbrojtje per kembesoret. Gjithashtu te shmanget ndertimi i hyrjeve dhe daljeve me korsi te shumefishta, vetem nqs nuk eshte rigorozisht e nevojshme;
- ne pranine e flukseve te larta te ciklisteve, te pajiset rrrethrrotullimi me nje piste te pershkueshme, duke e sistemuar ne pjesen e jashtme te unazes, ne menyre per te ndare flukset automobilistike nga ata ciklistike.

Masat e mesiperme te vetme nuk do te cojne ne nje siguri perfekte ne rruge, duhet garantuar qe shikuesheria dhe perceptimi viziv te jene optimale. Vizibiliteti (shikuesheria) duhet te jete i garantuar gjithmone, prandaj duhet realizuar nje impian ndricimi i pershtatshem. Nqs ndricimi artificial lejon nje perceptim te sakte te konfigurimit te rrrethrrotullimit dhe te mjeteve te tjera, automobilistet do te mund te pershkojne rrrethrrotullimin ne menyre te sigurt dhe pa kaluar rreziqe te vecanta. Rregullat e ndricimit jane te ngjashme me ato per tipet e tjera te kryqezimit; mund te perdoren shtylla te gjata anesore (perimetrale ose qendrore).

Nje studim i kryer ne Hollande duke nisur nga vitet '80 rreth variacionit te numrit te aksidenteve pas ndertimit te nje rrrethrrotullimi, ka perfshire 181 lokalite dhe mese 400 rrrethrrotullime per rreth 6 vjet vezhgimesh. Rezultate, e sjella ne tabele, tregojne nje zvogelim te numrit te aksidenteve per vit: 4,9 aks/vit ne ate “pas rrrethrrotullimit”, e barabarte me -51%. Numri i viktimate (te plagosur + te vdekur) ne vit peson nje ulje me te madhe (-72%) duke kaluar nga 1,3 ne 0,37, ndersa viktimat midis ciklisteve ulen ne menyre me pak te ndjeshme (-44%) duke kaluar nga 0,55 ne 0,31 viktima/vit.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

	Periudha “para” (kryqezimit)	Periudha “pas” (rrrethrotullimit)
Nr. i vendeve	181	181
Nr. total i studimeve/vit	957.7	359.1
Mesatarja e studimeve /vit/vende	5.3	2.0
Nr. i aksidenteve	4705	868
Aksidente/vit	4.9	2.4
Nr. total i viktimave	1256	133
Viktima/vit	1.3	0.37
Nr. i viktimave ciklista	529	111
Viktima ciklista /vit	0.55	0.31

*Tabela 6.10 – Te dhena dhe rezultate te per gjithshme te studimit para/pas*

Aksidentet jane ndare edhe sipas rendesise, llojit, moshes se te plagosurve, llojit te perdoruesit, sic tregohet ne Tabelen 6.12. Nga analiza e rendesise se aksidenteve mund te verehet si eshte vecanerisht e theksuar ulja e aksidenteve vdekjeprures (-76%) dhe si ulja e viktimave (-71%) eshte superiore nga ajo e aksidenteve (-47%). Persa i perket ndarjes per llojin e aksidentit, vezhgohen disa te dhena ne pamje te pare kundershtuese: nga njera ane verehet nje ulje e ndjeshme e aksidenteve te tipit “frontal/ballor” (-41% per aksidentet, -71% per viktimat), nga tjetra verehet nje rritje e ndjeshme e numrit (+100%) dhe mbit te gjitha e viktimave (+300%) per aksidentet e tipit “individuale”. Kjo e dhene e fundit nuk duhet te shqetesoj, pasi numri i per gjithshem i aksidenteve dhe i viktimave per kete lloj aksidenti eshte shume i ulet (9 viktima ne periudhen “para” dhe 15 ne ate “pas”). Gjithashtu reduktimi i aksidenteve te llojeve te tjera kompesojne gjerisht keto rritje, keshtu qe ne perfundim kemi nje reduktim te aksidenteve dhe te viktimave te barabarta ripspektivisht me -47% dhe -71%.

Rritja e aksidenteve “individuale” ka si shkak kryesor hyrjet direkte ne rrrethrotullim, dmth rasteve kur mjetet nuk duhet te ndalojne per te dhene perpare sine. Zvogelimi i aksidenteve ballore eshte rezultat i qarkullimit me sens unik ne unaze, qe shmanget shume situata rreziku qe shkaktojne kete lloj aksidenti. Duke analizuar ndarjen sipas moshes se viktimave, verehet zvogelimi me i madh per perdoruesit ne moshe mbi 40vjec (-76%), ndersa ajo me e ulet i perket perdoruesve me te rinj (-64%). Ndarja per llojin e perdoruesit tregon uljen e madhe te viktimave midis pasagjereve te automjeteve (-95%), por mund te verehet si reduktimi i viktimave midis ciklisteve eshte me i ulti, “vetem 30.”

Kjo vlere eshte relativisht e vogel nqs krahasohet me ate te llojeve te tjera, perqindjet e te cileve perfshihen midis -63% te ciklomotoreve dhe -95% te pasagjereve te automjeteve. Per tu theksuar ne fund, edhe renia drastike e viktimave midis kembesoreve me plot 89%.

**Tema e Doktoraturës:**  
**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Karakteristikat e aksidenteve	Ulja ne % e viktimate	Ulja ne % e aksidenteve
<b>a) Rendesia e aksidenteve</b>		
me vdekje	76	72
te renda	65	
me shtrim ne spital		81
te tjera		67
vetem deme materiale	4	
<b>TOTALI</b>	<b>47</b>	<b>71</b>
<b>b) Tipi i aksidenteve</b>		
ballor	87	96
anesor	64	76
tamponim individual	31	4
	-100	-300
<b>TOTALI</b>	<b>47</b>	<b>71</b>
<b>c) Mosha</b>		64
00-17		
18-40		73
41 e lart		76
<b>TOTALI</b>		<b>71</b>
<b>d) Tipi i perdoruesit</b>		
pasagjere automobili	63	95
drejtues ciklomotorri	34	63
ciklista	8	30
kembesore	73	89
<b>TOTALI</b>	<b>51</b>	<b>72</b>

*Tabela 6.11 – Zvogelimi i numrit te aksidenteve dhe viktimate*

Tabela 6.11 si pasoje e kthimit te kryqezimeve ne rrrethrotullime dhe per tipologji rrugore i ndan aksidentet dhe viktimat sipas karakteristikave te ndryshme rrugore. Gjithashtu raportohet numri i viktimate midis ciklistave dhe numri i lokaliteve me karakteristika analoge.

Karakteristika e pare e marre ne konsiderate jane zonat e banuara: rrrethrotullimet e ndertuara jashte ketyre zonave tregojne nje zvogelim me te madh te viktimate (-86%) krahasuar me ato brenda zonave te banuara (-69%). Kjo mund atribuohet, midis te tjerave, faktit qe efektet e reduktimit te shpejtesise jane me pak te shenuara ne zonat e banuara, pasi ne keto trafiku eshte mjaft i ngadalte.

Karakteristika e dyte e marre ne konsiderate eshte tipi i kontrollit te trafikut ekzistues ne kryqezimin paraprakisht kthimit. Mund te verehet se zvogelimi i

aksidenteve dhe viktimate eshte relativisht e ulet kur kryqezimi ishte paraprakisht i kontrolluar nga nje impiant semaforik (respektivisht -27% dhe -33%).

<i><b>Tipologja rrugore</b></i>	<i><b>Reduktimi i perqindjes se: Aksidenteve</b></i>	<i><b>Nr. i vendeve Viktimate</b></i>	
		<i><b>Total</b></i>	<i><b>Ciklista</b></i>
<b>a) Zona e ndertuar</b>			
Brenda zones se ndertuar	53	69	42
Zona tranzit	57	87	72
Jashte zones se ndertuar	42	86	64
<i>Totali</i>	51	72	44
			181
<b>b) Rregulli i trafikut para ndryshimit</b>			
Asnje	62	40	5
Perparesi	50	75	49
Semafore	27	33	4
<i>Totali</i>	50	72	44
			179
<b>c) Kryqezim i meparshem i tre rrugeve</b>			
Rrethrotullim me tre krahe	28	31	2
Rrethrotullim me kater krahe	21	14	22
<b>d) Kryqezim i meparshem i kater rrugeve</b>			
Rrethrotullim me kater krahe	56	76	49
			141

*Tabela 6.12 – Zvogelimi i numrit te aksidenteve dhe viktimate si pasoj e kthimit te kryqezimeve ne rrethrotullime dhe per tipologji rrugore*

Konvertimi i nje kryqezimi me tre rruge ne nje rrethrotullim eshte me pak i leverdishem se ajo me kater rruge ne nje rrethrotullim me kater krahe. Ne fakt, per aksidentet zvogelimi ne rastin e pare eshte 28% dhe ne te dytin prej 56%, ndersa renia e numrit te viktimate eshte respektivisht e barabarte me 31% dhe 76%. Eshte befasuese te verehet se ne nje transformim nga nje kryqezim me tre dege ne nje rrethrotullim me kater krahe, numri i aksidenteve dhe ai i viktimate midis ciklisteve rritet ne menyre te konsiderueshme (respektivisht me 21% dhe 22%). Arsyet e kesaj rritjeje te numrit te aksidenteve nuk dihen me siguri, por kjo duhet te jete nga efektet negative te kendeve shume te larte ( $\leq 120^\circ$ ) midis hyrjeve.

Studimi ben edhe një krahasim midis masave të ndryshme specifike per sigurine e ciklisteve: korsia e ciklisteve dhe pista e ciklisteve. Rezultatet janë dhene ne Tabelen 6.11. Duke vrojtuar tabelen nuk vihen re ndryshime te medha persa i perket kryqezimeve, ndersa viktimat variojne ne menyre shume te ndjeshme:

- ne kryqezim pa asnje mase per ciklista qe konvertohet ne një rrrethrrotullim me një korsi bicikletash prezanton një ulje te madhe te numrit te viktimate, e barabarte me 94% (reduktimi per ciklistat eshte prej 100%). Transformimi i ketij lloji te kryqezimit ne një rrrethrrotullim me një korsi bicikletash ose ne një rrrethrrotullim pa masa per ciklistet ul zvogelimin e viktimate ne një mesatare prej 78%;
- konvertimi nga një kryqezim me një rrugë ciklistash ne një rrrethrrotullim me një korsi ciklistash perfaqeson një reduktim te viktimate midis ciklistave prej 6%, kundrejtje një reduktimi totale prej 48%. Kjo do te thote se kjo kategori e perdoruesve perfiton vetem ne menyre minimale nga avantazhet e kesaj zgjidhjeje;
- transformimi i një kryqezimi me piste bicikletash ne një rrrethrrotullim e pajisur edhe kjo me piste bicikletash ofron zgjidhjen me te mire krahasuar me te tjerat (-91% e viktimate dhe -89% te viktimate midis ciklistave).




Figura 6.6 – Numri mesatar i aksidenteve ne vit per rrrethrrotullim ne funksion te intensitetit te trafikut ne rrrethrrotullim

#### 6.1.13 Zvogelimi i sigurise me moshen e rrrethrrotullimit

Duke krahasuar rezultatet e kerkimit te realizuar nga SETRA (1992/93) me ata te nje studimi tjeter mbi rrrethrrotullimit e kryer nga SWOV ne 1990, verehet se numri i viktimate ne vit per rrrethrrotullim eshte rritur, duke kaluar nga 0,23 ne 0,39

viktima/vit/rrrethrrotullim (70%). Nje rritje analoge nuk eshte verejtur per aksidentet, gje qe duket mjaft e cuditshme.

Kerkimi i kryer ne 1992/93 ka hulumtuar edhe mbi menyren ne te cilen numri mesatar i viktimate ndryshon me moshën e rrrethrrotullimit. Ne tabelen 6.15 “Performanca e numrit mesatar te viktimate per rrrethrrotullim ne vit” jane sjelle rezultatet e kesaj analize te kryer ne 16 rrrethrrotullime qe ishin ne perdorim prej se paku 4 vitesh. Tabela tregon nje luhatje te shenuar te te dhenave: vitin e pare u regjistruan vetem 0.19 viktima, te dytin 1.06 dhe te tretin 0.75. Nje shpjegim per rritjen e viktima qendron ne faktin se ne periudhen fillestare pas hapjes se trefikut, familjariteti i paket me rrrethrrotullimin çon drejtuesit drejt qe te kene shume kujdes. Me kalimin e kohes, drejtuesit fitojne me shume konfidence dhe kjo i çon ne rritjen e shpejtesise se pershkimit te rrrethrrotullimit gje qe rrit demet si pasoj e aksidenteve, duke rritur rendesine e ketyre te fundit dhe numrit te viktimate.

Mosha e rrrethrrotullimit	Numri i rrrethrrotullimeve	Numri mesatar i viktimate/vit/per rrrethrrotullim, gjate:		
		viti i pare	viti i dyte	viti i trete
4 vjecare	17	0.19	1.06	0.75

*Tabela 6.15 – Performanca e numrit mesatar te viktimate per rrrethrrotullim ne vit*

*Perfundime.* Kemi konstatuar, fale gjithe kerkimeve te kryera ne vende te ndryshme, qe rrrethrrotullimet perbejne formen me te sigurte te kryqezimeve ne nje nivel. Te shikojme tani kush jane udhezimet per tu ndjekur per te patur sigurine maksimale ne nje rrrethrrotullim e rezultuar nga eksperientat e jashtme.

*Konfigurimi dhe permasat.* Nje nga arsyet pse rrrethrrotullimet rezultojne me te sigurta eshte pa dyshim devijimi qe keto i imponojne mjeteteve qe e pershkojne, duke ju penguar ketyre te pershkojne trajktore te drejta permes kryqezimit dhe duke imponuar reduktimin e shpejtesise se pershkimit. Nqs permasat e rrrethrrotullimit jane tejet mase te medha (diametra te medhenj te jashtem ose ishuj te vegjel qendror) dhe/ose nqs mungojne masat e nevojshme per te garantuar nje devijim te nevojshem, atehere mjetet nuk do te jene te detyruar te ulin shpejtesine dhe rreziku i aksidenteve do te jete me i larte. Prandaj keshillohet te perdoren diametra te jashtem jo shume te larte, vetem nqs nuk eshte e domosdoshme kerkesave per kapacitet dhe te permbajtjes se vonesave. Duhet kushtuar shume vemendje edhe adoptimit te masave te pershtatshme per te garantuar devijimin e rruges. Me kete qellim mund te perdoren:

- ishuj devijimi (ose kanalizimi), qe ftojne mjetet te kryejne xhiron rrreth ishullit qendror. Keto duhen realizuar ne menyre qe trajktoria e percaktuar te jete tangente me ishullin qendror;

- ishujt qendror relativisht te medhenj, nqs eshte e mundur, gjithmone per te patur nje devijim te pershtatshem;
- kurbatura ne hyrje, qe te beje paraprakisht uljen e shpejtesise se mjeteve. Normal angleze imponojne nje rreze kurbature maksimale per rruget ne hyrje te barabarte me 100m;
- adoptimit te konfiguracioneve, kur eshte e mundur, te tilla qe te kemi kende  $90^\circ$  midis degeve, ose nqs flukset jane disproporcionale mund te proporcionalizohen kendet ne flukset e hyrjeve (zgjidhje jo teresisht ideale). Keshillohen rrrethrrrotullimet me tre dege me kende nga  $120^\circ$ , kur nuk ofrojne sigurine e mjaftueshme; ne keto raste eshte e pershtatshme te provohen zgjidhje te tjera pervec rrrethrrrotullimeve;
- pjerresia duhet te jete me e vogel se 2% (ne raste kufitare pranohet edhe 4%), praktikisht vetem ajo e nevojshme per drenazhimin. Per te patur nje shikueshmeri te mire te konfigurimit dhe te mjeteve, eshte mire te ndertohet rrrethrrrotullimi ne nje zone me disniveli jo te theksuar, pa patur pjerresira te tepruara tek rruget hyrese (perqasjet). Duhet shmangur pozicionimi i rrrethrrrotullimeve mbi gunga, duke qene se nuk kemi nje shikueshmeri te pershtatshme;

*Sinjalistika dhe ndricimi.* Eshte shume e rendesishme tu sinjalizohet perdoruesve qe hyjne ne nje rrrethrrrotullim detyrimi per te dhene perpare sine, pasi keta mund te besojne se, konform rregullit te pergjithshem te perpare sine se krahut te djathte, kane ata perpare sine mbi mjetet qarkulluese. Eshte gjithashtu e nevojshme te vendosen sinjale “ULNI SHPEJTESINE” dhe rreziku pervec atyre qe tregojne prezencen e rrrethrrrotullimit.

Sinjalistika horizontale duhet te perbehet nga vijat e kufizimit te korsive dhe karrekhates, nga vijat e bardha ne zonat ku nuk duhet te kete mjetet dhe mbi te gjitha nga vija e ndalimit per te dhene perpare sine (me figurat perkatese ne forme trekendeshi qe tregojne detyrimin per te dhene perpare sine).

Ne rrrethrrrotullim duhet te jete i ndaluar qendrimi dhe eshte e nevojshme te sinjalizohet ky ndalim.

Ndricimi eshte i rendesishem ne nje rrrethrrrotullim pasi drejtuesit dueht te shikojne gjithmone qarte qofte konfigurimin e rrrethrrrotullimit si dhe mjetet e tjera. Shume aksidente jane shkaktuar nga ndrimi i paket naten, qe nuk i lejon mjetete ne hyrje te shquajne konfigurimin e rrrethrrrotullimit.

#### *6.1.14 Siguria e kembesoreve*

Duhet shmangur patjeter mundesa qe kembesoret te mund te hyjne ne ishullin qendror, pasi pershkimi i karrekhates qarkulluese mund te jete shume i rrezikshem. Vend-kalimet e kembesoreve duhet te jene te pozicionuar tek deget ne nje distance te

volitshme, as shume afer as shume larg vijes se perparesise, dmth te pakten 5m nga kjo e fundit (e barabarte gati mer gjatesine e nje automjeti).

Ne te gjitha rastet kur flukset e kembesoreve nuk jane te neglizhueshem duhen bere udhezimet e mpsh:

- te ndertohen ishuj ndares (te gjera te pakten 1.5m) midis karrekhates ne hyrje dhe asaj ne dalje, ne menyre qe tu japesh nje mbrojte kembesoreve dhe tu mundesosh atyre pershkimin ne dy faza;
- te shmanget, nqs eshte e mundur, realizimi i rrrethrrrotullimeve me korsi te shumefishta. Ne menyre te vecante eshte e keshillueshme qe deget te kene nje korsi te vetme per sens levizjeje dhe qe karrekhata te mos kete me shume se dy korsi;
- nqs flukset jane te larta, eshte e nevojshme te perdoret nje rreze kurbature te daljes te ngjashme me ate te hyrjes, ne menyre qe te reduktohet shpejtesia e mjeteve dalese.

#### *6.1.15 Siguria e ciklisteve*

Shume nga kerkimet e zhvilluara kane evidentuar si ciklistat jane ata qe perfitorje nga avantazhet ne lidhje me sigurine te ardhura nga ndertimi i nje rrrethrrrotullimi. Kur trafiku eshte i larte ( $>8000$  mjete/dite) preferohet ndertimi i nje piste per ciklistat, sidomos nqs ajo eshte prezente ne rruget e kryqezimit. Per intensitetet me te vogla trafiku realizimi i nje piste ose i nje korsie per ciklistet nuk permireson sigurine krahasuar me nje rrrethrrrotullim pa keto masa. Ne rast se vendoset te ndertohet nje korsi per ciklistat, eshte e verifikuar se siguria e ciklisteve eshte rritur nga optimimi i nje gjesti te thjeshte: lyerja me ngjyre te kuqe e dyshemese se korsise.

## **KAPITULLI 7**

### **SIMULIMET E SIGURISE NE KRYQEZIME**

#### **7.1 Modelet e simulimeve per sigurine ne rruge**

Modelet per te percaktuar dhe perfaquesuar sigurine ne kryqezimet rrugore jane perhapur vetem ne vitet e fundit, sidomos nga ndergjegjesimet e qeverisjeve te ndryshme persa i perket problemit te aksidenteve rrugore dhe efekteve te tyre. Keto modele dhe ne ditet e sotme jane te pakta dhe trajtojne ne vecanti kryqezimet e terthorta.

Sic eshte parashtruar dhe ne kapitullin 6, ne Britanine e Madhe dhe ne Australi eshte bere monitorimi i nje pjese te kryqezimeve me te rendesishme, per te studiuar me pas nje model eksperimental regresioni qe te parashikoje ne menyren me te mire te mundshme numrin e aksidenteve ne te ardhmen (ne varesi te faktoreve te ndryshem te projektimit).

Ne kete kapitull jane listuar modelet e permenduara ne kap.6, duke u thelluar ne ndjeshmerine dhe ne principin e funksionalitetit te modelit Australian, ne baze te variacionit te variablate nga te cilat varet. Do te merren parasysh vetem tipet e aksidenteve me te perhapura ne periudhen qe kemi marre ne referim.

#### **7.2 Modeli Anglez (TRRL)**

Metoda eshte nxjerre nga studimi i nje numri te konsiderueshem rrrethrotullimesh e 4- krahe ne Mbreterine Bashkuar, nga Maycock ne Hall ne periudhen 1974-1979 (Accidents at 4-arm roundabouts-TRRL Laboratory Report 1120) per te arritur ne nje ekuacion, nga i cili te marrim nje pershkrim te mire te sjelljes shofereve ne kalimin e nje kryqezimi. Kjo bazohet ne nje ekuacion eksponencial, qe ka parasysh nje kombinim linear te variablate te koeficentave relative per kalibrim.

Ndjeshmeria me e madhe e modelit ne lidhje me fluksin (hyres,qarkullues,etj.) eshte drejt variablate gjeometrike, te cilat paraqiten ne menyre te qarte ne formulat e ekuacioneve [6.12-6.14]

#### **7.3 Modeli Australian (Mainroads)**

Metoda eshte nxjerre nga studimi i nje numri rrrethrotullimesh ne Queensland, nga grupi i kerkimit te Mainroads. Fillimisht, per llogaritjen e numrit te aksidenteve, nuk eshte marre parasysh sjellja e e shoferit, por u zbulua se ky aspekt ishte thelbesor, krahasuar me ate te vleresimit te parametrave gjeometrike ne kuptimin e ngushte (ne te vertete cdo perdorues mund te kaloje rrrethrotullimin ne menyre subjektive, ne baze te shkalles se sigurise ne udhetim, te njohjes se kryqezimit, te cilat influencojne ne tipin e trajektores dhe vleres se shpejtesise).

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---


Keshtu qe modeli u bazua sidomos ne vleresimin e shpejtesise, qe secili nga mjetet zoteron ne kalimin e rrrethrotullimit dhe qe varet nga gjemmetria e kryqezimit. Keto koncepte fillimisht jane zhvilluar dhe studiuar nga Mc.Lean ne vitin 1978, duke u nisur nga matjet e e bera ne rruget rurale.

Ne fig.7.1 eshte evidentuar frekuencat e aksidenteve qe jane verifikuar ne kryqezimet e studiuara; sic shihet norma me e larte eshte ajo e perfaquesuar nga mjetet hyrese/qarkulluese qe ze rrreth 50.8%, dmth eshte norma principale qe duhet zvogeluar me ndryshimet e projektuara per te ardhmen.

Me ane te nje software stimulimi “ARNDI” (A Roundabout Numerical Design Tool) llogaritet automatikisht siguria e nje kryqezimi te terhorte, me ane te perdorimit te parametrave te listuar ne ekuacionin [6.4-6.11] te kap.6. Software gjeneron si output, vlerat perfaquesuese te nr. te aksidenteve qe verifikohen cdo vit, per secilen tipologji te konsideruar ne cdo dege te kryqezimit.

Simulacionet qe do te ilistrohen ne vijim bazohen ne studimin e nje kryqezimi standart te terhorte nisur nga parametrat e meposhtem:

- Trafiku mesatar ditor ne dege i konsideruar afersisht 16000 mjete;
- Trafiku qarkullues ne unaze afersisht 9000 mjete;
- Numri i korsive be hyrje te unazes = 2;
- Rrezja e pershkuar e mjetit i-te per kalimin e rrrethrotullimit afersiht = 40m
- Gjatesia e rruges se pershkuar(me fillim 50m para dhe pas rrrethrotullimit) se shoferit per te kaluar elementet gjemmetrike horizontale rrreth  $200 \div 300$ m;
- Ulja e shpejtesise ne afresi te kryqezimit te terhorte per efekt te formes gjemmetrike te rrrethrotullimit baraz me 20 km/h ;
- Shpejtesia ne kthesen e qasjes baraz me 30 km/h;
- Shpejtesia relative midis mjeteve hyrese dhe qarkulluese baraz me 10 km/h.
- Koha mesatare e udhetimit nga qasja e meparshme baraz me  $10 \div 15$  sek.




*Figura 7.1 - Kategorite dhe frekuencat e aksidenteve*

## Tema e Doktoraturës:

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---



*Figura 7.2- Elementet gjeometrike te nje rrrethrotullimi dhe tipologjite e aksidenteve te rregjistruar me vende te aferta te zonave ku ndodhin*

Do te vleresojme ndryshimet e variablate te perfshira per tipologji te aksidenteve qe mund te verifikohen me shpesh ne nje rrrethrotullim, sipas modelit Australian ( $A_e$  perfaqeson numrin e aksidenteve per nje tipologji te percaktuar, qe verifikohet cdo vit per cdo dege te kryqezimit)

Aksidenti midis fluksit hyres dhe fluksit qarkullues:

$$A_e = \frac{7.31 * 10^{-7} * Q_a^{0.47} * N_c^{0.9} * (\sum Q_{ci})^{0.41} * S_{ra}^{1.38}}{t_{Ga}^{0.21}}$$

Referuar ekuacionit 6.4 ku:

$A_e$  – nr. i aksidenteve te tipologjise se konsideruar qe verifikohen cdo vit ne secilin afrim.

$Q_a$  – fluksi i trafikut vjetor, mesatar ditor (AADT, mjete/dite)

$N_c$  – nr. i korsive qarkulluese ne rrrethrotullim

$Q_{ci}$  – flukset e trafikut ne karrehaten qarkulluese te unazes,ngjitur ne cdo qasje (veh/d)

$S_{ra}$ - shpejtesi relative (fracttile 85 %) e mjeteve ne qasje dhe atyre ne karrehaten qarkulluese

**Tema e Doktoraturës:**


**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

$T_{Ga}$  – koha mesatare e udhetimit e konsideruar nga qasja e meparshe, per ti dhene prioritet ne piken e kryqezimit mjeteve hyrese dhe atyre qarkulluese.



$$Pe = \frac{N_c^{0.9} * S_{ri}^{1.38}}{t_{Ga}^{0.21}}$$

Referuar ekuacionit 6.5 ku:

$P_e$  – parameter I kombinimit lidhur me nr.e aksidanteve qe , te kufizuara ne limit, ben te mundur zvogelimin e dukurise. Vlera kufitare qe nuk duhet te kalohet eshte rreth 300.



*Figura 7.3.a - Grafiket e mesiperme tregojne nr. e aksidenteve te mjeteve hyrese/qarkulluese ne funksion te parametrave te ekuacionit 7.1.trafiku mesatar ditor ne afersi te kryqezimit, trafiku ne karrehaten qarkulluese, shpejtesia relative e mjeteve hyres/qarkullues, koha e gjysem udhetimit nga qasja e meparshme.*




Per kete tipologji aksidentesh rezulton se parametri qe e ben me te ndjeshem modelin eshte ai i shpejtesise relative (diferencia e shpejtesise midis mjeteve hyrese dhe mjeteve ne unazën qarkulluese) qe vjen nga mjetet ne konflikt (hyres/qarkullues), pra ulja e ketij parametri do te thote uljen e ndodhjes se aksidenteve, apo per te rritur sigurine ne krahun e konsideruar (duke projektuar rreze oportune te ktheses, si ne unaze, ashtu dhe ne qasje, ne menyre qe te ulet diferenca e shpejtesise).

Vihet re se cdo parameter (si p.sh nr. i korsive) qe influencon ne menyre pozitive ne variacionin e shpejtesise ndikon ne rritjen e aksidenteve.

Me poshte jane bere krahasime me tabelat e duhura dhe histograma varacionet e marra nga intervallet e vlerava te marra ne konsiderate.

Ne tabele jane treguar respektivisht vlerat ekstreme te intervaleve te variacioneve, diferenca e vlerës ( $\Delta$ ) dhe përqindja e konsideruar si peshë në numrin e aksidenteve.



*Figura 7.4 - Histograma e ndjeshmerise e variablateve te ekuacionit Aksidente te jeteve hyrese/qarkulluese*

Parametra intervallesh ekstreme	Qa [5000-28000 v/gg]	Nc [1-5 korsi]	Qci [5000-2800 v/gg]	Sra [0-40 Km/h]	tGa [0.0001-0.017 h]
Eks. Intervallesh nga model aksidentesh	[0.2380-0.5348]  0.296797	[0.221-0.942]  0.720797	[0.3392-0.6875]  0.348242	[0-2.798]  <b>2.797727</b>	[0.861-0.181]  -0.680206
$\Delta$ vlerat e intervaleve Ndryshimi % ne lidhje me parametrin qe shkakton ndryshimin max.	10.5%	26%	12.5%	100%	24%

*Tabela 7.1 - Raporti i rezultateve te analizes se sensibilitetit*

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrotullimeve”**

Ne tabelen e mesiperme jane radhitur intervalte variacionesh te variablate te bera ne ekuacionin 7.1 dhe vlerat respective te nr. te aksidenteve (jane listuar ekstremet e intervalave) diferencate tyre dhe variacionet e perqindjeve ndaj vleres totale.

Nga ekzaminimi i tabeles se mesiperme del se ndryshimi i shpejtesise relative midis mjeteve eshte ajo e formules (qe do te thote se variabla  $N_c = \text{nr. korshish}$  eshte me pak e ndjeshme se nje faktor 4, qe del nga raporti  $100/26$  midis vlerave te histograms, ne krahasim me  $S_{ra} = \text{shpetesi relative midis mjeteve hyrese/qarkulluese}, \text{apo qe eshte me e ndjeshme se nje factor 2, qe del nga raporti } 26/12.5$  midis vlerave te histograms, ne krahasim me  $Q_{ci} = \text{fluksin e trafikut ne karrehaten qarkulluese ne afersi te qasjes}.$ )

Aksidente te mjeteve ne qasje

$$Ar = 1.81 * 10^{-18} * Q_a^{1.39} (\sum Q_{ci})^{0.65} * S_a^{4.77} * N_a^{2.31}$$

Ku:



$Ar$  – nr. i aksidenteve te tipologjise se konsideruar, qe verifikohen cdo vit ne cdo qasje;

$Q_a$  – fluksi i trafikut vjetor,mesatar ditor (AADT, veh/d);

$Q_{ci}$  – fluksi i trafikut ne karrehaten qarkulluese te unazes ngjitur me qasjen(veh/d);

$S_a$  – shpejtesia e qasjes (85 % fractile);

$N_a$  – nr . i korsive ne qasje te rrethrotullimit;







Figura 7.5.a - Grafiket e mesiperme tregojne nr. e aksidenteve te mjeteve ne qasje ne funksion te parametrave te ek.7.3 trafiku mesatar ditor ne afersi te kryqezimit, trafiku ne karrehaten qarkulluese, shpejtesia ne qasje, nr. i korsive ne qasje.



Per kete tipologji aksidenti rezulton se parametri qe e ben me te ndjeshem modelin eshte ai i shpejtësise ne qasje, qe arrihet nga mjetet gjate kalimit, ndaj zvogelimi i ketij parametri (p.sh duke rritur lakimin e segmentit rrugor ku filon unaza), do te thote kufizimin e ndodhjes se aksidenteve apo te rrisim sigurine.

Me poshte jane bere krahasime me tabelat e duhura dhe histograma per variacionet e marra nga intervallet e vlerava te marra ne konsiderate.

Ne tabele jane treguar respektivisht vlerat ekstreme te intervaleve te variacioneve, diferenca e vlerës ( $\Delta$ ) dhe përqindja e konsideruar si peshë në numrin e aksidenteve.


**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

Parametra intervalesh ekstreme	Qa [5000-28000 v/gg]	Na [1-5 korsi]	Qci [5000-2800 v/gg]	Sa [20-80 Km/h]
Eks. Intervalesh nga model aksidentesh	[0.0048;0.0525]	[0.018;0.055]	[0.0049;0.2031]	[0.0035; 2.6324]
	0.047726	0.036962	0.198171	<b>2.62884</b>
Δ vlerat e intervaleve	1.8%	1.5%	7%	<b>100%</b>
Ndryshimi % ne lidhje me parametrin qe shkakton ndryshimin max.				

*Figura 7.6 - Histograma e ndjeshmerise e variablate te ekuacionit Aksidente te mjetave ne qasje*



Variacioni i shpejtesise ne qasje eshte ajo e formules (qe do te thote se variabla  $N_a =$  nr. korshish ne qasje eshte me pak e ndjeshme se nje faktor 14, qe del nga rapporti 100/7 midis vlerave te histograms, ne krahasim me  $S_a =$  shpetesi ne kthesen e qasjes, apo qe eshte me e ndjeshme se nje factor 4.5, qe del nga rapporti 7/1.5 midis vlerave te histograms, ne krahasim me  $Q_{ci} =$  fluksin e trafikut ne karrexfaten qarkulluese ne afersi te qasjes).

Aksidenti i nje mjeti te vetem (fig.7.2)

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

$$Asp = \frac{1.64 \cdot 10^{-12} \cdot Q^{1.17} \cdot L(S + \Delta S)^{4.12}}{R^{1.91}} \quad [7.4] \Rightarrow \text{referuar ek.6.7}$$

$$Asa = \frac{1.79 \cdot 10^{-9} \cdot Q^{0.91} \cdot L(S + \Delta S)^{1.93}}{R^{0.65}} \quad [7.5] \Rightarrow \text{referuar ek.6.8}$$

Ku:

$Asp$  - nr. I aksidenteve te tipologjise se konsideruar, qe verifikohen cdo vit ne cdo qasje perpara vijes se perpresise.

$Asa$  -nr. I aksidenteve te tipologjise se konsideruar, qe verifikohen cdo vit ne cdo qasje pas vijes se perparesise.

$Q$  -luksi I trafikut vjetor,mesatar ditor (AADT, veh/d)



$L$  - gjatesia e rruges se shoferit per te kaluar kryqezimin e terthorte

$S$  - shpejtesia per te pershkuar rrrethrotullimin

$\Delta S$  – renia e shpejtesie ne fillim te kalimit te rrrethrotullimit

$N_a$  - nr I korsive te afersi te rrrethrotullimit


$R$ - rrezja e rruges per kalimin e rrrethrotullimit te mjetit te i-te





**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---



*Figura 7.7 a - Grafiket tregojne nr. e aksidenteve me nje mjet te vetem ne funksion te parametrave te ekuacionit 7.4 dhe 7.5, trafiku mesatar ditor ne qasje te kryqezimit,gjatesi e pershkuar, zvogelim te shpejtesise ne rrrethrotullim,shpejtesi kali, rreze e pershkuar*




*Figura 7.7 b - Grafiket tregojne nr. e aksidenteve me nje mjet te vetem ne funksion te parametrave te ekuacionit 7.4 dhe 7.5, trafiku mesatar ditor ne qasje te kryqezimit,gjatesi e pershkuar, zvogelim te shpejtesise ne rrerrotullim,shpejtesi kali, rreze e pershkuar*

Duke aplikuar kete model per kete tipologji aksidenti rezulton se parametri qe e ben me te ndjeshem modelin jane: shpejtesia qe do te mbahet nga mjetet gjate kalimit te kryqezimit dhe rrezja min e kalimit tese njejtës rruge.prandaj levizja e duhur me keto parametra do te thote te kufizosh ndodhjen e ketyre aksidenteve apo te rrites sigurine e rruges ne fjale(p.sh duke kufizuar lakimin e rrugetimit te mjetit te per gjithhem ne menyre qe te marrim nje perfitim te dyfishte.me poshte do te krafashen me tabela dhe histograma variacionet e marra nga intervalt e vlerave te marra ne considerate.

Ne tab.7.3 jane perfaquesuar respektivisht vlerat e ekstreme te intervalave te variacioneve,diferenca e te njejtës peshe dhe perqindja e konsideruar se pesh ne variacionet e numirt te aksidenteve.

Vlerat me te larta ne kete tipologji aksidentesh lindin duke konsideruar vlerat e variablate shume te larta. Megjithate vihet re pothuajse menjehere se vlera e grafikut bie menjehere ne vlere te pranueshme dhe me te ulet, ne krahasim me tipologjine me frekuente te mjetve qe jane hyres/qarkullues.



*Figura 7.8 - Histograma e parametrave te variablate te ekuacionit Aksidente me nje mjet te vetem*

Tabela e mesiperme dhe histograma kane te njejtën domethenie me rastet e siperpermendura, me ndryshimin e vetem qe jane konsideruar aksidentet qe ndodhin para vijes se ndaleses per hyrjen ne unaze.

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrethrrrotullimeve”**

---

Variacioni i rrezes se rugetimit eshte ajo e mbizotueruese ne formulen e konsideruar (kjo do te thote se variabli  $R =$  rreze e rrugetimit gjeometrik horizontal te mjetit te i – te eshte me e ndjeshme se nje faktor 1.5 ne krahasim me  $S$ - shpejtesise per te pershkuar elementet gjeometrike horizontal, apo eshte me e ndjeshme se nje faktor 3.7, ne krahasim me  $\Delta S =$  zvogelimin e shpejtesise ne fillim te gjeometrise horizontale te rrethrrrotullimit te konsideruar).

## **KAPITULLI 8**

### **KONKLUZIONE**

**Analiza permblehdhese lidhur me funksionalitetin dhe sigurine e kryqezimeve te rrafshta ne zonat urbane.**

Pjesa e pare e kesaj teme doktorature ka te beje me evolucionin ne kohe te modeleve llogarites te perdorur per projektimin e kryqezimeve te rrafshta urbane. Ky evolucion lidhet jo vetem me teknikat e afrimit, nepermjet perdonimit te ekuacioneve dhe algoritmeve, qe drejtohen drejt optimizimit me te madh te trafikut, por edhe me studimin e ndryshimeve normative dhe organizative te te njejtave kryqezime.

Sipas nje rradhe jane studjuar *kryqezimet semaforike*, ato josemaforike, dhe ato me rrrethrrrotullim. Kryqezimet semaforike jane analizuar, duke u nisur nga percaktimet themelore (hyrje, rryme, manover, fluks ngopjeje, plan semaforik, faze semaforike, etj), qe sherbejne per te shpjeguar fenomenin e rregullimit semaforik, si per nje kryqezim te izoluar, ashtu edhe per nje rrjet kryqezimi. Me pas eshte kaluar ne vleresimin e vonesave te secilit mjet ne kryqezim, te perbera nga nje komponente percaktuese dhe nga nje stokastike (ne varesi se si jane marre ne konsiderate mbarevajtjet e arritjeve te plotoneve). Hapi tjeter rendit funksionet e ndryshme qe jane studjuar e analizuar ne kohe per projektimin e kryqezimeve.

*Kryqezimet josemaforike* jane analizuar duke filluar nga percaktimet themelore (volumi dhe intervali kritik, kapaciteti potencial dhe efektiv, koha e shkallezimit, etj), qe sherbejne edhe ato per te shpjeguar qarte fenomenin e defluksit qarkullues ne keto situate. Me pas eshte kaluar ne vleresimin e koheve te vonesave per cdo mjet, te gjatesive te rradheve te cdo dege, dhe te nivelist te sherbimit, sic parashikohet ne HCM.

*Kryqezimet me rrrethrrrotullim* jane analizuar, duke filluar nga percaktimet themelore gjeometrike dhe funksionale (unaza qarkulluese, kurbatura, gjeresia e dukshmerise, boshlleku kritik, perparese nga brenda dhe nga jashte, etj), qe sherbejne per te shpjeguar ne nje menyre te qarte fenomenin e defluskit (rrjedhjes) qarkullues ne keto kryqezime. Me pas eshte kaluar ne vleresimin e koheve te voneses mesatare te cdo mjeti ne kryqezim, sipas nje perafirma statistik dhe probalistik (te bazuar ne teorine e pranimit te boshllekut). Perafrimi i pare, eshte shpjeguar nepermjet vleresimit te tre studimeve te bera respektivisht nga Wardrop, persa i perket rregullit te perparese ne flukset hyres, Kimber dhe Louah, si formulime teknike te regresionit linear ne funksion te gjeometrise se kryqezimit. Hapi i metejshem, do te rendise se cilat rregullat e nje projektimi te mire, si persa i perket gjeometrise, ashtu edhe sigurise te

ketij tipi kryqezimi, duke marre ne konsiderate te gjitha eksperimentet dhe vezhgimet e bera ne kryqezimet egzistuese.

Ne pjesen e dyte te ketij studimi doktorature, ne ate aplikative, eshte kaluar ne realizimin e simulimeve llogaritese, nepermjet perdorimit te programeve specifike, “SIDRA”, lidhur me *funktionalitetin* (behet fjale per funksionimin e kryqezimit, do te thote, nese ai paraqet nje nivel te mire sherbimi, qe do te ishte shprehje e vonesave sa me te vogla, qe mjetet pesojne gjate kalimit te te njejtit kryqezim). Po keshtu, eshte synuar edhe ne dhenien e niveleve te sigurise, por simulimet llogaritese, nuk kane mundur te realizohen, ne synimet e kesaj doktorature, pasi realisht, kerkojne te dhena shume vjecare te shkalles se aksidentaliteteve, per te arritur ne konkluzione te sakta rekomanduese. Realizimi i kesaj pjese, mbetet ne detyrat e mijas te se ardhmes, per ta thelluar akoma me shume, nivelin e konkluzioneve lidhur edhe me kete pjese.

Simulimet e funksionaliteit u realizuan ne zonen urbane te qytetit te Durresit, respektivisht ne tre kryqezime te rendesishme ne hyrje te qytetit.

Vihet re menjehere qe, ne kushte afer konxhestionit (bllokimit), kryqezimi semaforik funksionon me mire se sa rrethrrrotullimi, meqe ka nje potencialitet te dukshem te defluksit te mjeteve, te perfaquesuara nga dy korsi per sens levizjeje, plus nje kthese e dedikuar majtas, qe nese projektohet e mbrojtur, do te jepte nje rritje te ndjeshme te sigurise. Ne rastin e kryqezimit me rrethrrrotullim, ka nje me tre korsi qe detyron te gjithe mjetet qe bashkohen, ti japin perparesi ne atrim, duke percaktuar ato vonesa e teperta qe jane dhene te tabeluara dhe qe rriten shume ne menyre eksponenciale, ne rastin kur jane te pranishem flukset e karrekhates qarkulluese.

Duhet marre ne konsiderate fakti qe, siguria ne rrethrrrotullime kompromentohet, ne rastin e marrjes ne konsiderate te flukseve te kembesoreve, per kete aresye nuk keshillohet ne hapesirat urbane, vetem ne rastin e perdorimit te sistemeve mbrojtues, si semafore me sinjale, ose kalime me trare.

E njejtë gje, duhet marre ne konsiderate persa i perket funksionalitetit, ne fakt flukset e kembesoreve integrohen mire me kohet e sinjalit te kuq te rrymave te mjeteve, pa gjeneruar vonese te metejshme. Ne te kundert, ne kryqezimet me rrethrrrotullim, shqetesojne dukshem flukset e ndryshme te trafikut, pervec zvogelimit te sigurise se te njejtave (per flukse kembesoresh shume te larte, arrihet bllokimi i deges ne dalje).

### **Avantazhet dhe dizavantazhet e rrethrrrotullimeve**

Avantazhet kryesore te zgjidhjes me rrethrrrotullim per kryqezimet me nje nivel mund te permblidhen si me poshte:

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrrotullimeve”**

---

- permiresimi i kushteve te sigurise ne kryqezime, ne saje te numrit te kufizuar pikave te konfliktit dhe zvogelimit te shpejtesive relative ne perplasje;
- nje funksionim me i mire (ne termat e voneses mesatare), ne saje te koheve me te shkurtra te pritjes ne hyrjet e kryqezimeve dhe lethesimit te manovrave ne kushtet e nenngopjes; konstatohet nje invers i sjelljes ne kushtet e nje ngopjeje.
- veprimet e ktheses jane me te lehta, ne raport me tipet e tjera te kryqezimeve, ne vecanti, menyrat ne te cilat zgjidhen manovrat e kthesave majtas, kontribuojne ne zvogelimin e per gjithshem te pritjeve ne hyrjet dhe ne funksionimin me te mire relativ, ne fakt, prania e ketyre manovrave ne nje kryqezim semaforik, konxhestionon korsine ne te cilen verifikohet;
- rrjedhshmeria me e madhe ne drejtimin e luhatjeve te trafikut, ne krahasim me kryqezimet semaforike, qe ne kushte te nje fluksi te ulet mjethesh, nuk arrijne te sillen me mire se rrrethrrotullimet;
- mundesa e kryerjes se manovrave me te rrezikshme (te kthimit majtas dhe te ndryshimit te marshit) me qetes me te madhe dhe ne menyre me te sigurt, pa dashur te perdoret keq kryqezimi qe po kalohet;
- zvogelimi i shpejtesive relative midis mjeteve qe e kalojne, ne menyre qe te rrisin sigurine ne kryqezim, fale pranise se efekteve te shkaktuara nga verifikimi i aksidenteve eventuale.
- ndotje me te vogla dhe konsume me te uleta karburanti, ne barazi trafiku, ne lidhje me kryqezimet semaforike, per shkak te shpejtesive te uleta te kalimit, ne nje rregjim pothuajse te vazhduar te qarkullimit dhe ne sjellje drejtimi deri ne shkallen e ngopjes te barabarte me 0,7; vihet re nje invers i tendences ne kushtet e nje bllokimi te trafikut.
- nje adoptim me i madh ne kryqezimet me me shume se 4 dege, ne zevendesim te nendarjes se kryqezimit ne disa me te thjeshta dhe per veshtiresine e semaforizimit.
- nje adoptim me i madh ne situatat e tranzicionit midis arterieve te kategorive te ndryshme, te cilat mund te jene edhe lidhjet e rrugeve urbane me ato extraurbane, ose si terminale te arterieve me karrekhata te ndara; ne keto raste, rrrethrrotullimet mund te ushtrojne nje veprim kushtezues mbi perdonuesit, duke nxitur nje moderim shpejtesie.

Ne te njejten kohe nje rrrethrrotullim paraqet edhe dizavantazhet e me poshtme, te cilat jane:

- nje rrezikshmeri me e larte kur perputhja planimetrike-altimetrike e terrenit nuk eshte e sheshte, pra e tille qe te krijoje veshtiresi te mundshme lidhur me shikueshmerine e kryqezimit;

- nje funksionim me i keq, kur ka nje disekuilber evident te flukseve ne deget e ndryshme te kryqezimit, meqe rryma me e vogel, pengon defluksin qarkullues te asaj me te madhe, duke percaktuar vlera te tepruara vonese;
- ulje te sigurise ne kryqezim ne rastin e nje shpejtesie te larte (rrrethrotullime me dy ose tre korsi) dhe ne rastin e pranise se flukseve te kembesoreve;
- funksionim me i keq ne lidhje me kryqezimet semaforike ne rastin e degeve me tre korsi per sens levizjeje, meqe te gjithe mjetet, duke u ndalur per ti dhene perparesti fluksit ne karrehaten qarkulluese, akumulojne vonese ne kalimin e kryqezimit; ne te kundert, edhe ne prani te ktheses se mbrojtur majtas, nje kryqezim semaforik funzionon me mire, meqe mbeten sidoqofte dy korsi per defluksin qarkullues per manovrat e kalimit dhe kthimit majtas;
- mungese hapesire ose kushte topografike te aksidentuara, qe nuk lejojne nje pamje te pershtatshme te lire ne siguri ose kushte te lethesuara mmnrovrimi per mjetet e renda;
- flukse te konsiderueshme mjetesh te renda, manovrat e te cilave, ne rastin e rrrethrotullimeve me karakteristika gjeometrike te kufizuara, mund te jene shkaku i vonesave me te medha dhe frekuencave te rritura te aksidentalitetit;

Ne kete periudhe po asistohet ne nje interes te vecante per rrrethrotullimet, dhe kryqezime te tilla realizohen gjithmone edhe me shpesh. Duhet nenvizuar qe eshte me rendesi, qe nje rrrethrotullim realizohet kur kushtet e zones dhe ato te trafikut e lejojne, dhe qe nuk behet thjesht nje zgjedhje e diktuar nga kerkesat estetike, urbanistike apo politike.

Per optimizimin e saj, projektimi duhet bere detyrimisht i shoqeruar me nje analize te detajuar te kushteve te trafikut dhe te aksidenteve, ne menyre qe te njohim vertet problemin dhe ta zgjidhim ate ne menyren me te mire te mundshme.

## LITERATURA

1. Akcelik & Associates Pty Ltd (febbraio 2002), *AASIDRA User Guide*
2. Akcelik R. (1992), *Roundabout capacity and performance analysis using Sidra*, Australian road research board limited Summary Report WD TE91/002
3. Bertocchi D. & Tassillo E. (2001), *Progetto rotatorie del PGTU 2000*, Comune di Bologna – Settore Traffico e Trasporti
4. Cantarella G., Festa D. C. (1982), *Modelli e metodi per l'ingegneria del traffico*, Franco Angeli
5. Esposito T., Mauro R. (1999), *Sintesi delle comunicazioni per il seminario di formazione tecnica "Rotatorie"*, Urbania - Padova Fiere
6. Glen M. G. M., Sumner S. L. & Kimber R. M. (1978), *The capacity of offside priority entries*, TRRL Supplementary Report **436**
7. Green H. (1973), *Accidents at roundabouts before and after the priority rule*, TRRL Supplementary Report **5 UC**
8. Kimber R. M. & Semmens M. C. (1977), *A track experiment on the entry capacities of offside priority roundabouts*, TRRL Supplementary Report **334**
9. Kimber R. M. (1980), *The traffic capacity of roundabouts*, TRRL Laboratory Report **942**
10. L. Marescotti & L. Mussone (1995), *Le misure di traffico nei sistemi di controllo veicolare*, Trasporti e trazione, **6/95**
11. Mantecchini L. (2004), *Criteri di calcolo della capacità delle intersezioni stradali a rotatoria. Confronto tra diverse metodologie operative*, INARCOS, **661/04**
12. Maycock G. & Hall R. D. (1984), *Accidents at 4-arm roundabouts* TRRL Laboratory Report **1120**
13. May-Jeanne Thai Van & Pascal Balmefrezol, *Design of roundabouts in France – Historical context and state of the Art*, Transportation Research Record **1737**
14. Owen K. & Eng M. (2000), *Geometric design of roundabouts for optimum safety – use of the program ARNDT*, Main Roads
15. Philbrick M. J. (1977), *In search of a new capacity formula for conventional roundabouts*, TRRL Laboratory Report **773**
16. Ruberti G. (1994), *Teoria e Tecnica del controllo del traffico stradale*, tesi di Dottorato di Ricerca in Ingegneria dei Trasporti - DISTART Università degli Studi di Bologna
17. Ruberti G. (1995), *I vincoli di capacità delle reti stradali urbane*, Trasporti e Trazione, **3/95**
18. Sawers C. P. & Blackmore F. C. (1973), *Capacity measurements on experimental roundabout designs at Colchester*, TRRL Supplementary Report **610**
19. Semmens M. C. (1985), *Arcady2: An enhanced program to model capacities, queues and delays at roundabouts*, TRRL Research Report **35**

**Tema e Doktoraturës:**

**“Kontrolli i trafikut dhe sigurise ne kryqezimet rrugore ne nje nivel, krahasimi midis performances se kryqezimeve semaforike dhe rrrethrotullimeve”**

---

20. Semmens M. C., Fairweather P.J. & Harrison I.B. (1980), *Roundabout capacity: public road experiment at Wincheap, Canterbury*, TRRL Supplementary Report 554
21. Sisiopiku V. P. & Heung-Un Oh (2001), *Evaluation of roundabout performance using Sidra*, Journal of transportation engineering (147/2 – pp 143-150)
22. Transport Research Board (2000), *Highway Capacity Manual 2000*
23. U.S. Department of Transportation, “Roundabouts: an informational guide”, FHWA RD-00-067, dicembre 1999
24. Villa M. (2000), *Intersezioni a rotatoria, Conoscere il funzionamento e proporne il dimensionamento*, Levrotto & Bella, Torino.